



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2025 – Numri: 1

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 7 janar 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 122/2024, datë 19.12.2024	Për ratifikimin e Konventës për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore të Huaja në Çështjet Civile ose Tregtare..... 3
Dekret i Presidentit nr. 431, datë 27.12.2024	Për shpallje ligji..... 25
Ligj nr. 123/2024, datë 19.12.2024	Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Veprat Penale që Lidhen me Pasurinë Kulturore, bërë në Nikosia më 19.5.2017..... 25
Dekret i Presidentit nr. 432, datë 27.12.2024	Për shpallje ligji..... 35
Dekret i Presidentit nr. 433, datë 27.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 35
Dekret i Presidentit nr. 434, datë 27.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 35
Dekret i Presidentit nr. 435, datë 27.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 36
Dekret i Presidentit nr. 436, datë 27.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 36
Dekret i Presidentit nr. 437, datë 27.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 36
Dekret i Presidentit nr. 438, datë 27.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 37
Dekret i Presidentit nr. 439, datë 27.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 37

Dekret i Presidentit nr. 440, datë 27.12.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	37
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 794, datë 19.12.2024	Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Industrisë së Mbrotjes	37
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 26.12.2024	Për miratimin e rregullores “Për klasifikimin, punën, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”	43
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 823, datë 26.12.2024	Për miratimin e rregullores “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”	80
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1094, datë 19.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	88
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1095, datë 19.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Hungarisë.....	89
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1096, datë 19.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Holandës.....	90
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1097, datë 19.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	90
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1098, datë 19.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Greqisë.....	91
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1099, datë 19.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve të shfaqur në shtetin e Italisë.....	93
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1100, datë 19.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Italisë.....	94
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1101, datë 19.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Kroacisë.....	94
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1102, datë 19.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Zvicrës.....	95
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1103, datë 19.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	97

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1104, datë 19.12.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Italisë.....	98
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1105, datë 19.12.2024	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 555, datë 22.7.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pestës së ruminantëve të vegjël të shfaqur në shtetin e Rumanisë”.....	100
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 81, datë 21.11.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 112, datë 20.10.2023, dhe nr. 117, datë 26.10.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-384, datë 5.3.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	100
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 82, datë 26.11.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-4412, datë 20.9.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.....	142
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 1046/11, datë 23.12.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 384, datë 29.6.2023, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Rehabilitimi i rrugës së ish-Repartit Ushtarak për në Aeroportin e Rinasit’”.....	151



LIGJ
Nr. 122/2024

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS
PËR NJOHJEN DHE EKZEKUTIMIN
E VENDIMEVE GJYQËSORE TË HUAJA
NË ÇËSHTJET CIVILE OSE TREGTARE**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe të nenit 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore të Huaja në Çështjet Civile ose Tregtare, bërë në Hagë më 2 korrik 2019, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 19.12.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 431, datë 27.12.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

**KONVENTA PËR NJOHJEN DHE
EKZEKUTIMIN E
VENDIMEVE GJYQËSORE TË HUAJA
NË ÇËSHTJET CIVILE OSE TREGTARE**

(nënshkruar më 2 korrik 2019)

Palët kontraktuese të kësaj Konvente,
duke synuar promovimin e aksesit efektiv në drejtësi për të gjithë dhe lehtësimin e tregtisë dhe investimeve shumëpalëshe të bazuara në rregulla, si edhe të lëvizjes, nëpërmjet bashkëpunimit gjyqësor;
duke besuar se ky bashkëpunim mund të rritet me krijimin e një grupi të unifikuar rregullash themelore

për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja në çështjet civile ose tregtare, me qëllim lehtësimin e njohjes dhe ekzekutimit të efektshëm të këtyre vendimeve gjyqësore;

duke qenë të bindura se ky bashkëpunim i shtuar gjyqësor kërkon, në veçanti, një regjim juridik ndërkombëtar që ofron parashikueshmëri dhe siguri më të madhe, në lidhje me qarkullimin global të vendimeve gjyqësore të huaja, dhe që është bashkëplotësues me *Konventën e datës 30 qershor 2005 për Marrëveshjet për Zgjedhjen e Gjykatës*,

kanë vendosur të nënshkruajnë Konventën për këtë qëllim dhe kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme:

**KAPITULLI I
FUSHA E VEPRIMIT DHE
PËRKUFIZIMET**

**Neni 1
Fusha e veprimit**

1. Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile ose tregtare. Fusha e saj e veprimit nuk shtrihet në mënyrë të veçantë të çështjet tatimore, çështjet doganore ose çështjet administrative.

2. Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin në një shtet palë kontraktues të vendimit gjyqësor të dhënë nga gjykata e një shteti tjetër palë kontraktues.

**Neni 2
Përjashtimet nga fusha e veprimit**

1. Kjo Konventë nuk zbatohet për çështjet e mëposhtme:

- a) statusi dhe zotësia juridike e personave fizikë;
- b) detyrimet për ushqim;
- c) çështjet e tjera të së drejtës familjare, përfshirë regjimet pasurore martesore dhe të drejtat ose detyrimet e tjera që lindin nga martesë apo marrëdhëniet e ngjashme;
- d) testamentet dhe trashëgimia;
- e) paaftësia paguese, përbërja, veprimet e institucioneve financiare në rast procesi falimentimi të menjëhershëm dhe çështjet e ngjashme;
- f) transporti i udhëtarëve dhe i mallrave;
- g) ndotja detare ndërkufitare, ndotja detare në zonat përtej juridiksionit kombëtar, ndotja detare



nga anijet, kufizimi i përgjegjësive për pretendimet detare dhe mesatarja e përgjithshme;

h) përgjegjësia për dëmet bërthamore;

i) vlefshmëria, pavlefshmëria, shpërbërja e personave juridikë ose e shoqatave të personave fizikë ose juridikë, si dhe vlefshmëria e vendimeve të organeve të tyre;

j) vlefshmëria e regjistrimeve në regjistrat publikë;

k) shpifja;

l) privatësia;

m) pronësia intelektuale;

n) veprimtaritë e forcave të armatosura, përfshirë veprimtaritë e personelit të tyre gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare;

o) veprimtaritë ligjzbatuese, përfshirë veprimtaritë e personelit ligjzbatues gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare;

p) çështjet anti-trust (çështjet e konkurrencës), përveç rasteve kur vendimi gjyqësor bazohet në veprime që përbëjnë marrëveshje të ndaluara ose praktikë të bashkërenduar mes konkurrentëve aktualë ose potencialë për të përcaktuar çmimet, për të bërë oferta të manipuluar, për të vendosur kufizime të produkteve ose kuota, ose për të ndarë tregjet duke caktuar konsumatorët, furnitorët, territoret ose linjat e tregtisë, dhe kur edhe këto veprime edhe efekti i tyre kanë ndodhur në shtetin e origjinës;

q) ristrukturimi i borxhit shtetëror nëpërmjet masave të njëanshme të shtetit.

2. Vendimi gjyqësor nuk përjashtohet nga fusha e veprimit të kësaj Konvente, kur një çështje për të cilën kjo Konventë nuk zbatohet, është ngritur thjesht si kërkesë paraprake gjatë procedurës që çoi në vendimin gjyqësor, dhe jo si objekt i procedurës. Në veçanti, vetë fakti që një çështje e tillë është ngritur nga mbrojtja, nuk e përjashton vendimin gjyqësor nga Konventa, nëse kjo çështje nuk ka qenë objekt i procedimit.

3. Kjo Konventë nuk zbatohet në rastin e arbitrazhit dhe procedimeve përkatëse.

4. Vendimi gjyqësor nuk përjashtohet nga fusha e veprimit të kësaj Konvente për faktin e thjeshtë se shteti, ku përfshihen qeveria, agjencia qeveritare ose çdo person që vepron për shtetin, ka qenë palë në procedim.

5. Asgjë në këtë Konventë nuk prek privilegjet dhe imunitetet e shteteve ose organizatave ndërkombëtare, në lidhje me to dhe pronën e tyre.

Neni 3

Përkufizimet

1. Në këtë Konventë:

a) “i paditur” do të thotë person ndaj të cilit është ngritur padia ose kundërpadia në shtetin e origjinës;

b) “vendim gjyqësor” do të thotë çdo vendim i gjykimit në themel, i dhënë nga gjykata, pa marrë parasysh emërtimin e vendimit, përfshirë një dekret apo një urdhër, dhe përcaktimi i kostove ose i shpenzimeve të procedurës nga gjykata (përfshirë punonjësin e gjykatës), me kusht që përcaktimi të ketë të bëjë me vendimin e gjykimit në themel, i cili mund të njihet ose të ekzekutohet sipas kësaj Konvente. Masat e sigurimit nuk janë vendime gjyqësore.

2. Subjekti i ndryshëm nga personi fizik konsiderohet se ka vendqëndrimin e zakonshëm në një shtet:

a) ku ka selinë statutore;

b) sipas ligjit të të cilit është themeluar ose formuar;

c) ku ka administratën qendrore; ose

d) ku ka vendin kryesor të ushtrimit të biznesit.

KAPITULLI II

NJOHJA DHE EKZEKUTIMI

Neni 4

Dispozita të përgjithshme

1. Vendimi gjyqësor i dhënë nga gjykata e një Shteti Kontraktues (Shteti i origjinës) njihet dhe ekzekutohet në Shtetin Kontraktues tjetër (Shteti i kërkuar), në përputhje me dispozitat e këtij kapitulli. Njohja ose ekzekutimi mund të refuzohet vetëm për arsyt e bazuara, të specifikuar në këtë Konventë.

2. Në Shtetin e kërkuar nuk bëhet shqyrtimi i çështjes në themel. Mund të ketë një shqyrtim të tillë vetëm për aq sa është i nevojshëm për zbatimin e kësaj Konvente.

3. Vendimi gjyqësor njihet vetëm nëse ai ka hyrë në fuqi në shtetin e origjinës dhe ekzekutohet vetëm nëse ai është i ekzekutueshëm në shtetin e origjinës.

4. Njohja ose ekzekutimi mund të shtyhet ose të refuzohet nëse vendimi gjyqësor i përmendur në paragrafin 3, është objekt rishikimi në shtetin e origjinës, ose nëse nuk ka kaluar afati kohor për të kërkuar ankimimin. Refuzimi nuk ndalon paraqitjen



e një kërkesë tjetër për njohjen ose ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Neni 5

Bazat për njohjen dhe ekzekutimin

1. Vendimi gjyqësor është i përshtatshëm për njohje dhe ekzekutim, nëse plotësohet një nga kushtet, si më poshtë:

a) personi ndaj të cilit kërkohet njohja ose ekzekutimi kishte vendqëndrimin e zakonshëm në shtetin e origjinës, në kohën, kur ai person u bë palë në procedurë në gjykatën e origjinës;

b) personi fizik ndaj të cilit kërkohet njohja ose ekzekutimi kishte vendin kryesor të ushtrimit të biznesit në shtetin e origjinës, në kohën kur personi u bë palë në procedurë në gjykatën e origjinës dhe padia mbi të cilën bazohet vendimi gjyqësor, lindi si pasojë e aktiviteteve të këtij biznesi;

c) personi ndaj të cilit kërkohet njohja ose ekzekutimi është personi që e ka paraqitur padinë, të ndryshme nga kundërpadia, mbi të cilën bazohet vendimi gjyqësor;

d) i padituri zotëronte një degë, agjenci ose ndërmarrje tjetër pa personalitet juridik të veçantë, në shtetin e origjinës, në kohën kur personi u bë palë në procedurë në gjykatën e origjinës, dhe padia mbi të cilën bazohet vendimi gjyqësor lindi si pasojë e aktiviteteve të asaj dege, agjencie ose ndërmarrjeje;

e) i padituri kishte dhënë pëlqimin shprehimisht për juridiksionin e gjykatës së origjinës, gjatë procedurës në të cilën u dha vendimi gjyqësor;

f) i padituri kishte parashtruar çështjen në themel para gjykatës së origjinës, pa kundërshtuar juridiksionin, brenda afatit të parashikuar me ligj në shtetin e origjinës, përveç nëse është e qartë se kundërshtimi i juridiksionit ose i ushtrimit të juridiksionit nuk do të kishte qenë e suksesshme sipas atij ligji;

g) vendimi gjyqësor shprehet për një detyrim kontraktor dhe është dhënë nga gjykata e shtetit në të cilin detyrimi është përmbushur ose duhej të ishte përmbushur, në përputhje me:

i. marrëveshjen mes palëve; ose

ii. ligjin e zbatueshëm për kontratën, në mungesë të marrëveshjes për vendin e përmbushjes së tij,

me përjashtim të rastit kur aktivitetet e të paditurit në lidhje me transaksionin, nuk përbënin në mënyrë të qartë një lidhje të qëllimshme dhe thelbësore me atë shtet;

h) vendimi gjyqësor shprehet për kontratën e qirasë së sendit të paluajtshëm (qiramarrjen) dhe është dhënë nga gjykata e shtetit në të cilin ndodhet sendi;

i) vendimi gjyqësor shprehet kundër të paditurit për detyrimin kontraktor, detyrimi që është i garantuar nga e drejta reale, *in rem*, mbi një send të paluajtshëm, që ndodhet në shtetin e origjinës, nëse padia lidhur me kontratën është paraqitur së bashku me padinë ndaj të njëjtit të paditur në lidhje me atë të drejtë reale, *in rem*;

j) vendimi gjyqësor shprehet për detyrimin jashtëkontraktor që lind nga vdekja, dëmtimi fizik, dëmi ose humbja e pasurisë e luajtshme, si dhe nga veprimi ose mosveprimi që shkaktoi drejtpërdrejt këtë lloj dëmi për shtetin e origjinës, pavarësisht se ku ka ndodhur ai dëm;

k) vendimi gjyqësor ka të bëjë me vlefshmërinë, interpretimin, efektet, administrimin ose ndryshimin e instrumentit të trustit, të krijuar vullnetarisht dhe të dokumentuar me shkrim, dhe:

i. në kohën e fillimit të procedurës, shteti i origjinës ishte përcaktuar në instrumentin e trustit si shteti, në gjykatat e të cilit do të zgjidheshin mosmarrëveshjet në lidhje me çështje të tilla; ose

ii. në kohën e fillimit të procedurës, shteti i origjinës ishte përcaktuar shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar në instrumentin e trustit si shteti në të cilin ndodhet vendi kryesor i administrimit të trustit.

Ky nënparagraf zbatohet vetëm për vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë me aspektet e brendshme të një trusti mes personave, që janë ose ishin të përfshirë brenda marrëdhënieve të trustit;

l) vendimi gjyqësor shprehet për kundërpadinë:

i. në masën që ishte në favor të kundërpaditësit, me kushtin që kundërpadia të paraqitej për të njëjtin transaksion ose të njëjtën ngjarje, si edhe padia; ose

ii. në masën që ishte kundër kundërpaditësit, me përjashtim të rastit kur ligji i shtetit të origjinës kërkonte që kundërpadia të paraqitej për të shmangur prekluzivitetin;

m) vendimi gjyqësor është dhënë nga gjykata e përcaktuar në një marrëveshje të lidhur ose të dokumentuar me shkrim ose me anë të ndonjë mjeti tjetër të komunikimit, që e bën informacionin të arritshëm, në mënyrë që të jetë i përdorshëm për referim të mëvonshëm, të ndryshme nga një marrëveshje ekskluzive për zgjedhjen e gjykatës.



Për qëllimet e këtij nënparagrafi, “marrëveshje ekskluzive për zgjedhjen e gjykatës” do të thotë një marrëveshje e lidhur nga dy a më shumë palë, që përcakton, gjykatat e një shteti ose një a më shumë gjykata specifike të një shteti, duke përjashtuar juridiksionin e gjykatave të tjera, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë lindur ose që mund të lindin në lidhje me një marrëdhënie të veçantë juridike.

2. Nëse kërkohet njohja ose ekzekutimi ndaj një personi fizik që vepron kryesisht për qëllime personale, familjare ose shtëpiake (pra, konsumator) për çështje që lidhen me një kontratë konsumatore, ose ndaj një punëmarrësi për çështje që lidhen me kontratën e tij të punës:

a) paragrafi 1(e) zbatohet vetëm nëse palët kanë shprehur pëlqimin e tyre, me gojë ose me shkrim, pranë gjykatës;

b) pikat (f), (g) dhe (m) të paragrafit 1 nuk zbatohen.

3. Paragrafi 1 nuk zbatohet për vendimin gjyqësor që shprehet për kontratën e qirasë së banimit mbi sende të paluajtshme (qiramarrjen) ose shprehet për regjistrimin e sendit të paluajtshëm. Një vendim gjyqësor i tillë është i pranueshëm për njohjen dhe ekzekutim vetëm nëse është dhënë nga gjykata e shtetit ku ndodhet sendi.

Neni 6

Baza ekskluzive për njohjen dhe për ekzekutimin

Pavarësisht nga neni 5, vendimi gjyqësor që shprehet për të drejtat reale, *in rem* të sendit të paluajtshëm njihet dhe ekzekutohet nëse dhe vetëm kur sendi ndodhet në shtetin e origjinës.

Neni 7

Refuzimi i njohjes dhe i ekzekutimit

1. Njohja ose ekzekutimi mund të refuzohet nëse:

a) dokumenti me të cilin u fillua procedura, ose një dokument ekuivalent, përfshirë një deklaratë që përmban elementet thelbësore të padisë:

i. nuk i është bërë e ditur të paditurit përmes njoftimit në kohë të mjaftueshme dhe në mënyrën që do t’ia mundësonte palës së paditur që të merrte masa për mbrojtje, përveç nëse i padituri është paraqitur në gjykatë dhe ka dhënë argumentet e veta

pa kundërshtuar njoftimin në gjykatën e origjinës, me kushtin që ligji i shtetit të origjinës lejon kundërshtimin e njoftimit; ose

ii. i është bërë e ditur të paditurit përmes njoftimit në Shtetin e kërkuar në formën që nuk përputhet me parimet themelore të Shtetit të kërkuar sa i takon dorëzimit të dokumenteve;

b) vendimi gjyqësor është marrë me mashtrim;

c) njohja ose ekzekutimi është haptazi në mospërputhje me politikën publike të Shtetit të kërkuar, përfshirë situatat kur procedurat specifike që çuan te vendimi gjyqësor, ishin në mospërputhje me parimet themelore të procesit të rregullt të atij shteti, si dhe me situata që kanë të bëjnë me cenimet e sigurisë ose të sovranitetit të tij;

d) procedurat në gjykatën e origjinës kanë qenë në kundërshtim me marrëveshjen, ose me përcaktimin e bërë në instrumentin e trustit, sipas të cilit vendimi për mosmarrëveshjen në fjalë do të merrej nga një gjykatë e një shteti të ndryshëm nga shteti i origjinës;

e) vendimi gjyqësor është në mospërputhje me vendimin gjyqësor të dhënë nga gjykata e Shtetit të kërkuar në mosmarrëveshjen mes të njëjtave palë; ose

f) vendimi gjyqësor është në mospërputhje me vendimin gjyqësor të mëparshëm të dhënë nga gjykata e një shteti tjetër mes të njëjtave palë, për të njëjtin objekt, me kushtin që vendimi gjyqësor i mëparshëm plotëson kushtet e nevojshme për njohjen e tij në Shtetin e kërkuar.

2. Njohja ose ekzekutimi mund të shtyhet ose të refuzohet nëse procedurat mes të njëjtave palë, për të njëjtin objekt, janë në pritje për shqyrtim para një gjykate të Shtetit të kërkuar, kur:

a) gjykata e Shtetit të kërkuar është vënë në lëvizje para gjykatës së origjinës; dhe

b) ekziston një lidhje e ngushtë mes mosmarrëveshjes dhe Shtetit të kërkuar.

Refuzimi sipas këtij paragrafi nuk ndalon paraqitjen e mëvonshme të kërkesës për njohjen ose ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Neni 8

Kërkesat paraprake

1. Vendimi për kërkesat paraprake nuk njihet ose nuk ekzekutohet sipas kësaj Konvente nëse vendimi lidhet me një çështje për të cilën kjo Konventë nuk zbatohet, ose me një çështje të përmendur në nenin



6, për të cilën është shprehur një gjykatë e një shteti të ndryshëm nga shteti i përmendur në atë nen.

2. Njohja ose ekzekutimi i një vendimi gjyqësor mund të refuzohet nëse, dhe deri në masën që, vendimi gjyqësor është bazuar në një vendim lidhur me një çështje për të cilën kjo Konventë nuk zbatohet, ose lidhur me një çështje, që përmendet në nenin 6, për të cilën është shprehur një gjykatë e një shteti të ndryshëm nga shteti i përmendur në atë nen.

Neni 9 Veçimi

Njohja ose ekzekutimi i pjesës së vendimit gjyqësor që mund të veçohet, është i lejuar kur bëhet kërkesë për njohjen ose ekzekutimin e asaj pjese, ose kur vetëm një pjesë e vendimit gjyqësor mund të njihet ose të ekzekutohet sipas kësaj Konvente.

Neni 10 Dëmshpërblimi

1. Njohja ose ekzekutimi i një vendimi gjyqësor mund të refuzohet nëse, dhe deri në masën që, vendimi gjyqësor cakton një dëmshpërblimin, përfshirë edhe dëmshpërblimin me karakter ndëshkues, që nuk e kompenson palën për humbjen ose dëmin e pësuar në të vërtetë.

2. Gjykata, së cilës i është drejtuar pala, merr parasysh nëse, dhe deri në çfarë mase, dëmshpërblimi i caktuar nga gjykata e origjinës, shërben për të mbuluar kostot dhe shpenzimet në lidhje me procedurat.

Neni 11 Zgjidhjet gjyqësore me pajtim (*transactions judiciaires*)

Zgjidhjet gjyqësore me pajtim (*transactions judiciaires*) që i ka miratuar gjykata e Shtetit Kontraktues, ose të cilat janë lidhur gjatë zhvillimit të procedurës para gjykatës së Shtetit Kontraktues, dhe që janë të zbatueshme në të njëjtën mënyrë si vendimi gjyqësor në shtetin e origjinës, zbatohen sipas kësaj Konvente, në të njëjtën mënyrë si vendimi gjyqësor.

Neni 12

Dokumentet që duhet të paraqiten

1. Pala që kërkon njohje ose që paraqet kërkesën për ekzekutim, duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

a) kopje të plotë dhe të noterizuar të vendimit gjyqësor;

b) nëse vendimi gjyqësor është dhënë në mungesë, origjinali ose kopje e noterizuar e dokumentit, që përcakton se dokumenti me të cilin ka filluar procedura, ose dokumenti i njëvlershëm, i është bërë i ditur përmes njoftimit palës që nuk ka qenë e pranishme në gjykim;

c) çdo dokument i nevojshëm për të vërtetuar se vendimi gjyqësor ka hyrë në fuqi ose, në është e nevojshme, është i ekzekutueshëm në shtetin e origjinës;

d) në rastin e përmendur në nenin 11, vërtetimi i gjykatës (lëshuar dhe nga një punonjës i gjykatës) së shtetit të origjinës ku deklarohet se marrëveshja gjyqësore, ose një pjesë e saj, është e ekzekutueshme në të njëjtën mënyrë si vendimi gjyqësor në shtetin e origjinës.

2. Nëse kushtet e vendimit gjyqësor nuk lejojnë që gjykata, së cilës i është drejtuar pala, të verifikojë nëse janë përmbushur kushtet e këtij kapitulli, ajo gjykatë mund të kërkojë çdo dokument të nevojshëm.

3. Kërkesa për njohjen ose ekzekutimin mund të shoqërohet me dokumentin që ka të bëjë me vendimin gjyqësor, të nxjerrë nga gjykata (lëshuar dhe nga një punonjës i gjykatës) e shtetit të origjinës, në formën e rekomanduar dhe të botuar nga Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

4. Nëse dokumentet e përmendura në këtë nen nuk janë në një gjuhë zyrtare të Shtetit të kërkuar, ato shoqërohen me përkthimin e noterizuar në një gjuhë zyrtare, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin e Shtetit të kërkuar.

Neni 13 Procedura

1. Procedura për njohjen, deklarimin e ekzekutueshmërisë, ose regjistrimin për ekzekutim, dhe ekzekutimin e vendimit gjyqësor rregullohet nga ligji i Shtetit të kërkuar, përveç rasteve kur



parashikohet ndryshe në këtë Konventë. Gjykata e Shtetit të kërkuar vepron me shpejtësi.

2. Gjykata e Shtetit të kërkuar nuk e refuzon njohjen ose ekzekutimin e vendimit gjyqësor sipas kësaj Konvente, me arsyetimin se njohja ose ekzekutimi do të duhet të kërkohej në një shtet tjetër.

Neni 14

Kostot e procedurës

1. Asnjë garanci, obligacion ose depozitë, sido që të përshkruhet, nuk kërkohej nga një palë që aplikon në një Shtet Kontraktues për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, të dhënë nga gjykata e një Shteti tjetër Kontraktues me arsyetimin e vetëm se pala e tillë ka shtetësi të huaj, ose nuk është me vendbanim, ose me vendqëndrim, në shtetin në të cilin kërkohej ekzekutimi.

2. Urdhri për pagesën e kostove ose të shpenzimeve të procedurës, i lëshuar në Shtetin Kontraktues ndaj çdo personi të përjashtuar nga kërkesat për garancinë, obligacionin ose depozitën, në bazë të paragrafit 1, ose në bazë të ligjit të shtetit ku janë filluar procedurat, bëhet i ekzekutueshëm në çdo Shtet Kontraktues tjetër, me paraqitjen e kërkesës nga personi që ka të drejtë të përfitojë nga urdhri.

3. Shteti mund të deklarojë se nuk e zbaton paragrafin 1 ose të përcaktojë përmes një deklarimi se cila nga gjykatat e tij nuk e zbaton paragrafin 1.

Neni 15

Njohja dhe ekzekutimi sipas së drejtës kombëtare

Me përjashtim të nenit 6, kjo Konventë nuk ndalon njohjen ose ekzekutimin e vendimeve gjyqësore sipas së drejtës kombëtare.

KAPITULLI III KLAUZOLA TË PËRGJITHSHME

Neni 16

Dispozita kalimtare

Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore nëse, në kohën e fillimit të procedurave në shtetin e origjinës,

Konventa kishte hyrë në fuqi mes atij shteti dhe Shtetit të kërkuar.

Neni 17

Deklarimet që kufizojnë njohjen dhe ekzekutimin

Një shtet mund të deklarojë se gjykatat e tij mund të refuzojnë të njohin ose të ekzekutojnë një vendim gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një Shteti tjetër Kontraktues, nëse palët kanë pasur vendqëndrimin e zakonshëm në Shtetin e kërkuar, dhe marrëdhëniet e palëve dhe të gjithë elementet e tjera të rëndësishme për mosmarrëveshjen, të ndryshme nga vendndodhja e gjykatës së origjinës, kanë qenë të lidhura vetëm me Shtetin e kërkuar.

Neni 18

Deklarimet lidhur me çështje specifike

1. Kur një shtet ka interes të fortë për të mos e zbatuar këtë Konventë për një çështje specifike, ai shtet mund të deklarojë se nuk do ta zbatojë Konventën për atë çështje. Shteti që bën një deklaram të tillë siguron që deklarimi nuk është më i gjerë sesa është e nevojshme, dhe se çështja specifike e përjashtuar, është përkufizuar qartë dhe me përpikëri.

2. Në lidhje me atë çështje, Konventa nuk aplikohet:

- a) në Shtetin Kontraktues që ka bërë deklarimin;
- b) në Shtetet e tjera Kontraktuese, ku kërkohej njohja ose ekzekutimi i vendimit gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një Shteti Kontraktues që ka bërë deklarimin.

Neni 19

Deklarimet në lidhje me vendimet gjyqësore që i përkasin shtetit

1. Një shtet mund të deklarojë se nuk e zbaton këtë Konventë për vendimet gjyqësore që lindin nga procedurat në të cilat është palë cilado nga palët e mëposhtme:

- a) ai shtet, ose personi fizik që vepron për atë shtet; ose
- b) një agjenci qeveritare e atij shteti, ose një person fizik që vepron për një agjenci të tillë qeveritare.



Shteti që bën një deklaram të tillë siguron që deklarimi nuk është më i gjerë sesa është e nevojshme dhe që përjashtimi nga fusha e veprimit është përkufizuar qartë dhe me përpikëri. Deklarimi nuk bën dallimin midis vendimeve gjyqësore kur shteti, një agjenci qeveritare e atij shteti, ose një person fizik që vepron për cilindo prej tyre, është i paditur ose paditës në procedurat para gjykatës së origjinës.

2. Njohja ose ekzekutimi i një vendimi gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një shteti që ka bërë deklaramin, në pajtim me paragrafin 1, mund të refuzohet nëse vendimi gjyqësor ka lindur si pasojë e procedurave në të cilat është palë qoftë shteti që ka bërë deklaramin, ose Shteti i kërkuar, një nga agjencitë e tyre qeveritare, ose një person fizik që vepron për cilindo prej tyre, në të njëjtën masë, siç specifikohet në deklaram.

Neni 20

Interpretimi i unifikuar

Në interpretimin e kësaj Konvente i kushtohet vëmendje karakterit të saj ndërkombëtar dhe nevojës për të nxitur zbatimin e unifikuar të saj.

Neni 21

Rishikimi i funksionimit praktik të Konventës

Sekretari i Përgjithshëm i Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private organizon rishikimin në intervale të rregullta të funksionimit të kësaj Konvente, përfshirë çdo deklaram, dhe i raporton Këshillit për Çështjet e Përgjithshme dhe Politikat.

Neni 22

Sistemet ligjore të paunifikuara

1. Në lidhje me Shtetin Kontraktues në të cilin zbatohen dy ose më shumë sisteme ligjore në njësi të ndryshme territoriale lidhur me çdo çështje që trajtohet në këtë Konventë:

a) çdo referim ndaj ligjit ose procedurës së një shteti interpretohet se i referohet, kur është e përshtatshme, ligjit ose procedurës në fuqi, në njësinë territoriale përkatëse;

b) çdo referim ndaj gjykatës ose gjykatave të një shteti interpretohet se i referohet, kur është e

përshtatshme, gjykatës ose gjykatave në njësinë territoriale përkatëse;

c) çdo referim ndaj lidhjes me një shtet interpretohet se i referohet, kur është e përshtatshme, lidhjes me njësinë territoriale përkatëse;

d) çdo referim ndaj një kriteri të lidhjes në raport me një shtet interpretohet se i referohet, kur është e përshtatshme, atij kriteri të lidhjes në raport me njësinë territoriale përkatëse.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, një Shtet Kontraktues me dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat aplikohen sisteme të ndryshme ligjore, nuk është i detyruar ta zbatojë këtë Konventë për situatat që kanë të bëjnë vetëm me këto njësi territoriale të ndryshme.

3. Gjykata në një njësi territoriale të një Shteti Kontraktues me dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore, nuk është e detyruar të njohë ose të zbatojë vendimin gjyqësor të një Shteti Kontraktues tjetër vetëm për arsye se vendimi gjyqësor është njohur ose zbatuar në njësinë tjetër territoriale të të njëjtit Shtet Kontraktues sipas kësaj Konvente.

4. Ky nen nuk zbatohet për organizatat rajonale të integritit ekonomik.

Neni 23

Marrëdhënia me instrumentet e tjera ndërkombëtare

1. Kjo Konventë interpretohet atëherë sa është e mundur në përputhje me traktatet e tjera në fuqi për Shtetet Kontraktuese, pavarësisht nëse janë lidhur përpara ose pas kësaj Konvente.

2. Kjo Konventë nuk ndikon në zbatimin nga ana e një Shteti Kontraktues të një traktati që është lidhur përpara kësaj Konvente.

3. Kjo Konventë nuk ndikon në zbatimin nga ana e një Shteti Kontraktues të një traktati që është lidhur pas kësaj Konvente në lidhje me njohjen ose ekzekutimin e vendimit gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një Shteti Kontraktues që është, gjithashtu, palë e atij traktati. Asgjë në traktatin tjetër nuk ndikon në detyrimet, sipas nenit 6, ndaj Shteteve Kontraktuese që nuk janë palë të atij traktati.

4. Kjo Konventë nuk ndikon në zbatimin e rregullave të Organizatës Rajonale të Integritit Ekonomik, që është palë e kësaj Konvente për sa i përket njohjes ose ekzekutimit të një vendimi



gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një Shteti Kontraktues që është, gjithashtu, shtet anëtar i Organizatës Rajonale të Integritimit Ekonomik, kur:

a) rregullat janë miratuar përpara nënshkrimit të kësaj Konvente; ose

b) rregullat janë miratuar pas nënshkrimit të kësaj Konvente, në masën që ato nuk ndikojnë në detyrimet, sipas nenit 6, ndaj Shteteve Kontraktuese që nuk janë shtete anëtare të Organizatës Rajonale të Integritimit Ekonomik.

KAPITULLI IV KLAUZOLAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet.

2. Kjo Konventë është subjekt i ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet nënshkruese.

3. Kjo Konventë është e hapur për aderim nga të gjitha shtetet.

4. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, që është Depozitari i Konventës.

Neni 25

Deklarimet në lidhje me sistemet ligjore të paunifikuara

1. Nëse një shtet ka dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore, në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë, ai mund të deklarojë se fusha e veprimit të Konventës shtrihet në të gjitha njësitë e tij territoriale, ose vetëm në një a më shumë prej tyre. Një deklaram i tillë thekson shprehimisht njësitë territoriale në të cilat zbatohet Konventa.

2. Nëse një shtet nuk bën asnjë deklaram sipas këtij neni, fusha e veprimit të Konventës shtrihet në të gjitha njësitë territoriale të atij shteti.

3. Ky nen nuk zbatohet për organizatat rajonale të integritimit ekonomik.

Neni 26

Organizatrat rajonale të integritimit ekonomik

1. Organizata Rajonale e Integritimit Ekonomik, e cila përbëhet vetëm nga shtete sovrane dhe ka kompetencë mbi disa ose mbi të gjitha çështjet e rregulluara me këtë Konventë, mund të nënshkruajë, pranojë, miratojë ose aderojë në këtë Konventë. Në këtë rast, Organizata Rajonale e Integritimit Ekonomik ka të drejtat dhe detyrimet e një Shteti Kontraktues, në masën që Organizata ka kompetencë mbi çështjet e rregulluara me këtë Konventë.

2. Në momentin e nënshkrimit, pranimit, miratimit ose aderimit, Organizata Rajonale e Integritimit Ekonomik njofton me shkrim Depozitarin për çështjet që rregullohen me këtë Konventë, në lidhje me kompetencat që shtetet anëtare i kanë transferuar kësaj Organizate. Organizata njofton menjëherë me shkrim Depozitarin, për çdo ndryshim në kompetencat e saj, siç specifikohet në njoftimin më të fundit, të dhënë sipas këtij paragrafi.

3. Për qëllimet e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integritimit ekonomik nuk llogaritet nëse Organizata Rajonale e Integritimit Ekonomik nuk deklaron në përputhje me nenin 27(1) se shtetet anëtare të saj nuk do të jenë palë në këtë Konventë.

4. Çdo referim ndaj një “Shteti Kontraktues” ose “Shteti” në këtë Konventë zbatohet në mënyrë të barabartë, kur është e përshtatshme, për Organizatën Rajonale të Integritimit Ekonomik.

Neni 27

Organizata Rajonale e Integritimit Ekonomik si palë kontraktuese pa Shtetet Anëtare të saj

1. Në momentin e nënshkrimit, pranimit, miratimit ose aderimit, një organizatë rajonale e integritimit ekonomik mund të deklarojë se ushtron kompetencën mbi të gjitha çështjet e rregulluara me këtë Konventë dhe se shtetet anëtare të saj nuk do të jenë palë në këtë Konventë, por do të kenë detyrime si pasojë e nënshkrimit, pranimit, miratimit ose aderimit të Organizatës.

2. Në rast të deklarimit të bërë nga një organizatë rajonale e integritimit ekonomik, në përputhje me paragrafin 1, çdo referim ndaj një “Shteti



Kontraktues” ose një “Shteti” në këtë Konventë zbatohet në mënyrë të barabartë, kur është e përshtatshme, për shtetet anëtare të Organizatës.

Neni 28

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, në përfundim të periudhës gjatë së cilës mund të jetë bërë njoftimi, në përputhje me nenin 29(2) që ka të bëjë me shtetin e dytë që ka depozituar instrumentin e tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, të përmendur në nenin 24.

2. Pas kësaj, kjo Konventë hyn në fuqi:

a) për çdo shtet që në vijim do të ratifikojë, pranojë, miratojë ose aderojë në të, në ditën e parë të muajit në përfundim të periudhës gjatë së cilës mund të bëhen njoftimet, në përputhje me nenin 29(2) që ka të bëjë me atë shtet;

b) për njësinë territoriale në të cilën është shtrirë fusha e veprimit të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 25, pasi Konventa të ketë hyrë në fuqi për shtetin që bën deklarin, në ditën e parë të muajit në përfundim të tre muajve, pas njoftimit të deklaramit të referuar në atë nen.

Neni 29

Vendosja e marrëdhënieve në përputhje me Konventën

1. Kjo Konventë do jetë e zbatueshme nga të dyja Shtetet Kontraktuese, përveç rasteve kur njëri prej tyre ka njoftuar Depozitarin në lidhje me shtetin tjetrin, në përputhje me paragrafin 2 ose 3. Në mungesë të një njoftimi të tillë, Konventa ka efekt mes dy Shteteve Kontraktuese nga dita e parë e muajit, në përfundim të periudhës gjatë së cilës mund të bëhen njoftimet.

2. Një shtet kontraktues mund të njoftojë Depozitarin, brenda 12 muajve nga data e njoftimit nga Depozitari, që përmendet në nenin 32(a), se ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i një shteti tjetër nuk ka efekt për vendosjen e marrëdhënieve mes të dy shteteve në përputhje me këtë Konventë.

3. Një shtet mund të njoftojë Depozitarin, me depozitimin e instrumentit të tij, në përputhje me nenin 24(4), se ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i tij nuk ka efekt për vendosjen e marrëdhënieve me një Shtet Kontraktues në përputhje me këtë Konventë.

4. Një Shteti Kontraktues mund të tërheqë në çdo kohë njoftimin që ka bërë sipas paragrafit 2 ose 3. Një tërheqje e tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, në përfundim të tre muajve nga data e njoftimit.

Neni 30

Deklarimet

1. Deklarimet e përmendura në nenet 14, 17, 18, 19 dhe 25 mund të bëhen me nënshkrimin, ratifikimin, pranimin, miratimin ose aderimin, ose në çdo kohë pas kësaj, dhe mund të ndryshohen ose të tërhiqen në çdo kohë.

2. Deklarimet, ndryshimet dhe tërheqjet i njoftohen Depozitarit.

3. Deklarimi i bërë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit hyn në fuqi njëkohësisht me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente për shtetin në fjalë.

4. Deklarimi i bërë në një kohë të mëvonshme dhe çdo ndryshim, ose tërheqje e deklaramit, hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, në përfundim të tre muajve, pas datës në të cilën njoftimi pranohet nga Depozitari.

5. Deklarimi i bërë në një kohë të mëvonshme dhe çdo ndryshim, ose tërheqje e deklaramit, nuk zbatohen për vendime gjyqësore që rezultojnë nga procedura, që tashmë kanë filluar pranë gjykatës së origjinës, kur deklarata hyn në fuqi.

Neni 31

Denoncimi

1. Një Shtet Kontraktues i kësaj Konvente mund ta denoncojë atë përmes njoftimit me shkrim, drejtuar Depozitarit. Denoncimi mund të kufizohet në njësi të caktuara territoriale të një sistemi ligjor të paunifikuar, për të cilin zbatohet kjo Konventë.

2. Denoncimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, në përfundim të 12 muajve, pas datës në të cilën njoftimi merret nga Depozitari. Kur në njoftim specifikohet një periudhë më e gjatë derisa denoncimi të hyjë në fuqi, denoncimi hyn në fuqi në përfundim të kësaj periudhe, pas datës në të cilën njoftimi merret nga Depozitari.



Neni 32

Njoftimet nga Depozitari

Depozitari njofton anëtarët e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, shtetet tjera dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik që kanë nënshkruar, ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në këtë Konventë, në përputhje me nenet 24, 26 dhe 27, për sa më poshtë:

a) nënshkrimet, ratifikimet, pranimet, miratimet dhe aderimet e përmendura në nenet 24, 26 dhe 27;

b) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi sipas nenit 28;

c) njoftimet, deklaratimet, ndryshimet dhe tërheqjet e përmendura në nenet 26, 27, 29 dhe 30; dhe

d) denoncimet e përmendura në nenin 31.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Hartuar në Hagë, më 2 korrik 2019, në gjuhët angleze dhe frënge, ku të dyja tekstet janë njëloj autentike, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Qeverisë së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, që i dërgon nëpërmjet kanaleve diplomatike një kopje të noterizuar secilit anëtar të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, në kohën e Sesionit të 22-të dhe secilit shtet tjetër që ka marrë pjesë në atë Sesion.

**CONVENTION ON THE RECOGNITION AND ENFORCEMENT OF FOREIGN
JUDGMENTS IN CIVIL OR COMMERCIAL MATTERS**

(concluded 2 July 2019)

The Contracting Parties to the present Convention,

Desiring to promote effective access to justice for all and to facilitate rule-based multilateral trade and investment, and mobility, through judicial co-operation,

Believing that such co-operation can be enhanced through the creation of a uniform set of core rules on recognition and enforcement of foreign judgments in civil or commercial matters, to facilitate the effective recognition and enforcement of such judgments,

Convinced that such enhanced judicial co-operation requires, in particular, an international legal regime that provides greater predictability and certainty in relation to the global circulation of foreign judgments, and that is complementary to the *Convention of 30 June 2005 on Choice of Court Agreements*,

Have resolved to conclude this Convention to this effect and have agreed upon the following provisions –

CHAPTER I – SCOPE AND DEFINITIONS

Article 1

Scope

1. This Convention shall apply to the recognition and enforcement of judgments in civil or commercial matters. It shall not extend in particular to revenue, customs or administrative matters.
2. This Convention shall apply to the recognition and enforcement in one Contracting State of a judgment given by a court of another Contracting State.

Article 2

Exclusions from scope

1. This Convention shall not apply to the following matters –
 - (a) the status and legal capacity of natural persons;
 - (b) maintenance obligations;



- (c) other family law matters, including matrimonial property regimes and other rights or obligations arising out of marriage or similar relationships;
- (d) wills and succession;
- (e) insolvency, composition, resolution of financial institutions, and analogous matters;
- (f) the carriage of passengers and goods;
- (g) transboundary marine pollution, marine pollution in areas beyond national jurisdiction, ship-source marine pollution, limitation of liability for maritime claims, and general average;
- (h) liability for nuclear damage;
- (i) the validity, nullity, or dissolution of legal persons or associations of natural or legal persons, and the validity of decisions of their organs;
- (j) the validity of entries in public registers;
- (k) defamation;
- (l) privacy;
- (m) intellectual property;
- (n) activities of armed forces, including the activities of their personnel in the exercise of their official duties;
- (o) law enforcement activities, including the activities of law enforcement personnel in the exercise of their official duties;
- (p) anti-trust (competition) matters, except where the judgment is based on conduct that constitutes an anti-competitive agreement or concerted practice among actual or potential competitors to fix prices, make rigged bids, establish output restrictions or quotas, or divide markets by allocating customers, suppliers, territories or lines of commerce, and where such conduct and its effect both occurred in the State of origin;
- (q) sovereign debt restructuring through unilateral State measures.

2. A judgment is not excluded from the scope of this Convention where a matter to which this Convention does not apply arose merely as a preliminary question in the proceedings in which the judgment was given, and not as an object of the proceedings. In particular, the mere fact that such a matter arose by way of defence does not exclude a judgment from the Convention, if that matter was not an object of the proceedings.

3. This Convention shall not apply to arbitration and related proceedings.

4. A judgment is not excluded from the scope of this Convention by the mere fact that a State, including a government, a governmental agency or any person acting for a State, was a party to the proceedings.

5. Nothing in this Convention shall affect privileges and immunities of States or of international organisations, in respect of themselves and of their property.



Article 3
Definitions

1. In this Convention –
 - (a) “defendant” means a person against whom the claim or counterclaim was brought in the State of origin;
 - (b) “judgment” means any decision on the merits given by a court, whatever that decision may be called, including a decree or order, and a determination of costs or expenses of the proceedings by the court (including an officer of the court), provided that the determination relates to a decision on the merits which may be recognised or enforced under this Convention. An interim measure of protection is not a judgment.
2. An entity or person other than a natural person shall be considered to be habitually resident in the State –
 - (a) where it has its statutory seat;
 - (b) under the law of which it was incorporated or formed;
 - (c) where it has its central administration; or
 - (d) where it has its principal place of business.

CHAPTER II – RECOGNITION AND ENFORCEMENT

Article 4
General provisions

1. A judgment given by a court of a Contracting State (State of origin) shall be recognised and enforced in another Contracting State (requested State) in accordance with the provisions of this Chapter. Recognition or enforcement may be refused only on the grounds specified in this Convention.
2. There shall be no review of the merits of the judgment in the requested State. There may only be such consideration as is necessary for the application of this Convention.
3. A judgment shall be recognised only if it has effect in the State of origin, and shall be enforced only if it is enforceable in the State of origin.
4. Recognition or enforcement may be postponed or refused if the judgment referred to under paragraph 3 is the subject of review in the State of origin or if the time limit for seeking ordinary review has not expired. A refusal does not prevent a subsequent application for recognition or enforcement of the judgment.

Article 5
Bases for recognition and enforcement

1. A judgment is eligible for recognition and enforcement if one of the following requirements is met –



- (a) the person against whom recognition or enforcement is sought was habitually resident in the State of origin at the time that person became a party to the proceedings in the court of origin;
- (b) the natural person against whom recognition or enforcement is sought had their principal place of business in the State of origin at the time that person became a party to the proceedings in the court of origin and the claim on which the judgment is based arose out of the activities of that business;
- (c) the person against whom recognition or enforcement is sought is the person that brought the claim, other than a counterclaim, on which the judgment is based;
- (d) the defendant maintained a branch, agency, or other establishment without separate legal personality in the State of origin at the time that person became a party to the proceedings in the court of origin, and the claim on which the judgment is based arose out of the activities of that branch, agency, or establishment;
- (e) the defendant expressly consented to the jurisdiction of the court of origin in the course of the proceedings in which the judgment was given;
- (f) the defendant argued on the merits before the court of origin without contesting jurisdiction within the timeframe provided in the law of the State of origin, unless it is evident that an objection to jurisdiction or to the exercise of jurisdiction would not have succeeded under that law;
- (g) the judgment ruled on a contractual obligation and it was given by a court of the State in which performance of that obligation took place, or should have taken place, in accordance with
 - (i) the agreement of the parties, or
 - (ii) the law applicable to the contract, in the absence of an agreed place of performance, unless the activities of the defendant in relation to the transaction clearly did not constitute a purposeful and substantial connection to that State;
- (h) the judgment ruled on a lease of immovable property (tenancy) and it was given by a court of the State in which the property is situated;
- (i) the judgment ruled against the defendant on a contractual obligation secured by a right *in rem* in immovable property located in the State of origin, if the contractual claim was brought together with a claim against the same defendant relating to that right *in rem*;
- (j) the judgment ruled on a non-contractual obligation arising from death, physical injury, damage to or loss of tangible property, and the act or omission directly causing such harm occurred in the State of origin, irrespective of where that harm occurred;
- (k) the judgment concerns the validity, construction, effects, administration or variation of a trust created voluntarily and evidenced in writing, and –
 - (i) at the time the proceedings were instituted, the State of origin was designated in the trust instrument as a State in the courts of which disputes about such matters are to be determined; or
 - (ii) at the time the proceedings were instituted, the State of origin was expressly or impliedly designated in the trust instrument as the State in which the principal place of administration of the trust is situated.

This sub-paragraph only applies to judgments regarding internal aspects of a trust between persons who are or were within the trust relationship;



- (l) the judgment ruled on a counterclaim –
 - (i) to the extent that it was in favour of the counterclaimant, provided that the counterclaim arose out of the same transaction or occurrence as the claim; or
 - (ii) to the extent that it was against the counterclaimant, unless the law of the State of origin required the counterclaim to be filed in order to avoid preclusion;
- (m) the judgment was given by a court designated in an agreement concluded or documented in writing or by any other means of communication which renders information accessible so as to be usable for subsequent reference, other than an exclusive choice of court agreement.

For the purposes of this sub-paragraph, an “exclusive choice of court agreement” means an agreement concluded by two or more parties that designates, for the purpose of deciding disputes which have arisen or may arise in connection with a particular legal relationship, the courts of one State or one or more specific courts of one State to the exclusion of the jurisdiction of any other courts.

2. If recognition or enforcement is sought against a natural person acting primarily for personal, family or household purposes (a consumer) in matters relating to a consumer contract, or against an employee in matters relating to the employee’s contract of employment –

- (a) paragraph 1(e) applies only if the consent was addressed to the court, orally or in writing;
- (b) paragraph 1(f), (g) and (m) do not apply.

3. Paragraph 1 does not apply to a judgment that ruled on a residential lease of immovable property (tenancy) or ruled on the registration of immovable property. Such a judgment is eligible for recognition and enforcement only if it was given by a court of the State where the property is situated.

Article 6

Exclusive basis for recognition and enforcement

Notwithstanding Article 5, a judgment that ruled on rights *in rem* in immovable property shall be recognised and enforced if and only if the property is situated in the State of origin.

Article 7

Refusal of recognition and enforcement

1. Recognition or enforcement may be refused if –
 - (a) the document which instituted the proceedings or an equivalent document, including a statement of the essential elements of the claim –
 - (i) was not notified to the defendant in sufficient time and in such a way as to enable them to arrange for their defence, unless the defendant entered an appearance and presented their case without contesting notification in the court of origin, provided that the law of the State of origin permitted notification to be contested; or
 - (ii) was notified to the defendant in the requested State in a manner that is incompatible with fundamental principles of the requested State concerning service of documents;
 - (b) the judgment was obtained by fraud;



- (c) recognition or enforcement would be manifestly incompatible with the public policy of the requested State, including situations where the specific proceedings leading to the judgment were incompatible with fundamental principles of procedural fairness of that State and situations involving infringements of security or sovereignty of that State;
 - (d) the proceedings in the court of origin were contrary to an agreement, or a designation in a trust instrument, under which the dispute in question was to be determined in a court of a State other than the State of origin;
 - (e) the judgment is inconsistent with a judgment given by a court of the requested State in a dispute between the same parties; or
 - (f) the judgment is inconsistent with an earlier judgment given by a court of another State between the same parties on the same subject matter, provided that the earlier judgment fulfils the conditions necessary for its recognition in the requested State.
2. Recognition or enforcement may be postponed or refused if proceedings between the same parties on the same subject matter are pending before a court of the requested State, where –
- (a) the court of the requested State was seised before the court of origin; and
 - (b) there is a close connection between the dispute and the requested State.

A refusal under this paragraph does not prevent a subsequent application for recognition or enforcement of the judgment.

Article 8 *Preliminary questions*

1. A ruling on a preliminary question shall not be recognised or enforced under this Convention if the ruling is on a matter to which this Convention does not apply or on a matter referred to in Article 6 on which a court of a State other than the State referred to in that Article ruled.
2. Recognition or enforcement of a judgment may be refused if, and to the extent that, the judgment was based on a ruling on a matter to which this Convention does not apply, or on a matter referred to in Article 6 on which a court of a State other than the State referred to in that Article ruled.

Article 9 *Severability*

Recognition or enforcement of a severable part of a judgment shall be granted where recognition or enforcement of that part is applied for, or only part of the judgment is capable of being recognised or enforced under this Convention.

Article 10 *Damages*

1. Recognition or enforcement of a judgment may be refused if, and to the extent that, the judgment awards damages, including exemplary or punitive damages, that do not compensate a party for actual loss or harm suffered.



2. The court addressed shall take into account whether and to what extent the damages awarded by the court of origin serve to cover costs and expenses relating to the proceedings.

Article 11

Judicial settlements (transactions judiciaires)

Judicial settlements (*transactions judiciaires*) which a court of a Contracting State has approved, or which have been concluded in the course of proceedings before a court of a Contracting State, and which are enforceable in the same manner as a judgment in the State of origin, shall be enforced under this Convention in the same manner as a judgment.

Article 12

Documents to be produced

1. The party seeking recognition or applying for enforcement shall produce –
 - (a) a complete and certified copy of the judgment;
 - (b) if the judgment was given by default, the original or a certified copy of a document establishing that the document which instituted the proceedings or an equivalent document was notified to the defaulting party;
 - (c) any documents necessary to establish that the judgment has effect or, where applicable, is enforceable in the State of origin;
 - (d) in the case referred to in Article 11, a certificate of a court (including an officer of the court) of the State of origin stating that the judicial settlement or a part of it is enforceable in the same manner as a judgment in the State of origin.
2. If the terms of the judgment do not permit the court addressed to verify whether the conditions of this Chapter have been complied with, that court may require any necessary documents.
3. An application for recognition or enforcement may be accompanied by a document relating to the judgment, issued by a court (including an officer of the court) of the State of origin, in the form recommended and published by the Hague Conference on Private International Law.
4. If the documents referred to in this Article are not in an official language of the requested State, they shall be accompanied by a certified translation into an official language, unless the law of the requested State provides otherwise.

Article 13

Procedure

1. The procedure for recognition, declaration of enforceability or registration for enforcement, and the enforcement of the judgment, are governed by the law of the requested State unless this Convention provides otherwise. The court of the requested State shall act expeditiously.
2. The court of the requested State shall not refuse the recognition or enforcement of a judgment under this Convention on the ground that recognition or enforcement should be sought in another State.



Article 14
Costs of proceedings

1. No security, bond or deposit, however described, shall be required from a party who in one Contracting State applies for enforcement of a judgment given by a court of another Contracting State on the sole ground that such party is a foreign national or is not domiciled or resident in the State in which enforcement is sought.
2. An order for payment of costs or expenses of proceedings, made in a Contracting State against any person exempt from requirements as to security, bond, or deposit by virtue of paragraph 1 or of the law of the State where proceedings have been instituted, shall, on the application of the person entitled to the benefit of the order, be rendered enforceable in any other Contracting State.
3. A State may declare that it shall not apply paragraph 1 or designate by a declaration which of its courts shall not apply paragraph 1.

Article 15
Recognition and enforcement under national law

Subject to Article 6, this Convention does not prevent the recognition or enforcement of judgments under national law.

CHAPTER III – GENERAL CLAUSES

Article 16
Transitional provision

This Convention shall apply to the recognition and enforcement of judgments if, at the time the proceedings were instituted in the State of origin, the Convention had effect between that State and the requested State.

Article 17
Declarations limiting recognition and enforcement

A State may declare that its courts may refuse to recognise or enforce a judgment given by a court of another Contracting State if the parties were resident in the requested State, and the relationship of the parties and all other elements relevant to the dispute, other than the location of the court of origin, were connected only with the requested State.

Article 18
Declarations with respect to specific matters

1. Where a State has a strong interest in not applying this Convention to a specific matter, that State may declare that it will not apply the Convention to that matter. The State making such a declaration shall ensure that the declaration is no broader than necessary and that the specific matter excluded is clearly and precisely defined.
2. With regard to that matter, the Convention shall not apply –
 - (a) in the Contracting State that made the declaration;



- (b) in other Contracting States, where recognition or enforcement of a judgment given by a court of a Contracting State that made the declaration is sought.

Article 19

Declarations with respect to judgments pertaining to a State

1. A State may declare that it shall not apply this Convention to judgments arising from proceedings to which any of the following is a party –

- (a) that State, or a natural person acting for that State; or
- (b) a government agency of that State, or a natural person acting for such a government agency.

The State making such a declaration shall ensure that the declaration is no broader than necessary and that the exclusion from scope is clearly and precisely defined. The declaration shall not distinguish between judgments where the State, a government agency of that State or a natural person acting for either of them is a defendant or claimant in the proceedings before the court of origin.

2. Recognition or enforcement of a judgment given by a court of a State that made a declaration pursuant to paragraph 1 may be refused if the judgment arose from proceedings to which either the State that made the declaration or the requested State, one of their government agencies or a natural person acting for either of them is a party, to the same extent as specified in the declaration.

Article 20

Uniform interpretation

In the interpretation of this Convention, regard shall be had to its international character and to the need to promote uniformity in its application.

Article 21

Review of operation of the Convention

The Secretary General of the Hague Conference on Private International Law shall at regular intervals make arrangements for review of the operation of this Convention, including any declarations, and shall report to the Council on General Affairs and Policy.

Article 22

Non-unified legal systems

1. In relation to a Contracting State in which two or more systems of law apply in different territorial units with regard to any matter dealt with in this Convention –

- (a) any reference to the law or procedure of a State shall be construed as referring, where appropriate, to the law or procedure in force in the relevant territorial unit;
- (b) any reference to the court or courts of a State shall be construed as referring, where appropriate, to the court or courts in the relevant territorial unit;



- (c) any reference to a connection with a State shall be construed as referring, where appropriate, to a connection with the relevant territorial unit;
 - (d) any reference to a connecting factor in relation to a State shall be construed as referring, where appropriate, to that connecting factor in relation to the relevant territorial unit.
2. Notwithstanding paragraph 1, a Contracting State with two or more territorial units in which different systems of law apply shall not be bound to apply this Convention to situations which involve solely such different territorial units.
3. A court in a territorial unit of a Contracting State with two or more territorial units in which different systems of law apply shall not be bound to recognise or enforce a judgment from another Contracting State solely because the judgment has been recognised or enforced in another territorial unit of the same Contracting State under this Convention.
4. This Article shall not apply to Regional Economic Integration Organisations.

Article 23

Relationship with other international instruments

1. This Convention shall be interpreted so far as possible to be compatible with other treaties in force for Contracting States, whether concluded before or after this Convention.
2. This Convention shall not affect the application by a Contracting State of a treaty that was concluded before this Convention.
3. This Convention shall not affect the application by a Contracting State of a treaty concluded after this Convention as concerns the recognition or enforcement of a judgment given by a court of a Contracting State that is also a Party to that treaty. Nothing in the other treaty shall affect the obligations under Article 6 towards Contracting States that are not Parties to that treaty.
4. This Convention shall not affect the application of the rules of a Regional Economic Integration Organisation that is a Party to this Convention as concerns the recognition or enforcement of a judgment given by a court of a Contracting State that is also a Member State of the Regional Economic Integration Organisation where –
- (a) the rules were adopted before this Convention was concluded; or
 - (b) the rules were adopted after this Convention was concluded, to the extent that they do not affect the obligations under Article 6 towards Contracting States that are not Member States of the Regional Economic Integration Organisation.

CHAPTER IV – FINAL CLAUSES

Article 24

Signature, ratification, acceptance, approval or accession

1. This Convention shall be open for signature by all States.
2. This Convention is subject to ratification, acceptance or approval by the signatory States.



3. This Convention shall be open for accession by all States.
4. Instruments of ratification, acceptance, approval or accession shall be deposited with the Ministry of Foreign Affairs of the Kingdom of the Netherlands, depositary of the Convention.

Article 25

Declarations with respect to non-unified legal systems

1. If a State has two or more territorial units in which different systems of law apply in relation to matters dealt with in this Convention, it may declare that the Convention shall extend to all its territorial units or only to one or more of them. Such a declaration shall state expressly the territorial units to which the Convention applies.
2. If a State makes no declaration under this Article, the Convention shall extend to all territorial units of that State.
3. This Article shall not apply to Regional Economic Integration Organisations.

Article 26

Regional Economic Integration Organisations

1. A Regional Economic Integration Organisation which is constituted solely by sovereign States and has competence over some or all of the matters governed by this Convention may sign, accept, approve or accede to this Convention. The Regional Economic Integration Organisation shall in that case have the rights and obligations of a Contracting State, to the extent that the Organisation has competence over matters governed by this Convention.
2. The Regional Economic Integration Organisation shall, at the time of signature, acceptance, approval or accession, notify the depositary in writing of the matters governed by this Convention in respect of which competence has been transferred to that Organisation by its Member States. The Organisation shall promptly notify the depositary in writing of any changes to its competence as specified in the most recent notice given under this paragraph.
3. For the purposes of the entry into force of this Convention, any instrument deposited by a Regional Economic Integration Organisation shall not be counted unless the Regional Economic Integration Organisation declares in accordance with Article 27(1) that its Member States will not be Parties to this Convention.
4. Any reference to a "Contracting State" or "State" in this Convention shall apply equally, where appropriate, to a Regional Economic Integration Organisation.

Article 27

Regional Economic Integration Organisation as a Contracting Party without its Member States

1. At the time of signature, acceptance, approval or accession, a Regional Economic Integration Organisation may declare that it exercises competence over all the matters governed by this Convention and that its Member States will not be Parties to this Convention but shall be bound by virtue of the signature, acceptance, approval or accession of the Organisation.



2. In the event that a declaration is made by a Regional Economic Integration Organisation in accordance with paragraph 1, any reference to a “Contracting State” or “State” in this Convention shall apply equally, where appropriate, to the Member States of the Organisation.

Article 28
Entry into force

1. This Convention shall enter into force on the first day of the month following the expiration of the period during which a notification may be made in accordance with Article 29(2) with respect to the second State that has deposited its instrument of ratification, acceptance, approval or accession referred to in Article 24.
2. Thereafter this Convention shall enter into force –
 - (a) for each State subsequently ratifying, accepting, approving or acceding to it, on the first day of the month following the expiration of the period during which notifications may be made in accordance with Article 29(2) with respect to that State;
 - (b) for a territorial unit to which this Convention has been extended in accordance with Article 25 after the Convention has entered into force for the State making the declaration, on the first day of the month following the expiration of three months after the notification of the declaration referred to in that Article.

Article 29
Establishment of relations pursuant to the Convention

1. This Convention shall have effect between two Contracting States only if neither of them has notified the depositary regarding the other in accordance with paragraph 2 or 3. In the absence of such a notification, the Convention has effect between two Contracting States from the first day of the month following the expiration of the period during which notifications may be made.
2. A Contracting State may notify the depositary, within 12 months after the date of the notification by the depositary referred to in Article 32(a), that the ratification, acceptance, approval or accession of another State shall not have the effect of establishing relations between the two States pursuant to this Convention.
3. A State may notify the depositary, upon the deposit of its instrument pursuant to Article 24(4), that its ratification, acceptance, approval or accession shall not have the effect of establishing relations with a Contracting State pursuant to this Convention.
4. A Contracting State may at any time withdraw a notification that it has made under paragraph 2 or 3. Such a withdrawal shall take effect on the first day of the month following the expiration of three months following the date of notification.

Article 30
Declarations

1. Declarations referred to in Articles 14, 17, 18, 19 and 25 may be made upon signature, ratification, acceptance, approval or accession or at any time thereafter, and may be modified or withdrawn at any time.
2. Declarations, modifications and withdrawals shall be notified to the depositary.



3. A declaration made at the time of signature, ratification, acceptance, approval or accession shall take effect simultaneously with the entry into force of this Convention for the State concerned.
4. A declaration made at a subsequent time, and any modification or withdrawal of a declaration, shall take effect on the first day of the month following the expiration of three months following the date on which the notification is received by the depositary.
5. A declaration made at a subsequent time, and any modification or withdrawal of a declaration, shall not apply to judgments resulting from proceedings that have already been instituted before the court of origin when the declaration takes effect.

Article 31
Denunciation

1. A Contracting State to this Convention may denounce it by a notification in writing addressed to the depositary. The denunciation may be limited to certain territorial units of a non-unified legal system to which this Convention applies.
2. The denunciation shall take effect on the first day of the month following the expiration of 12 months after the date on which the notification is received by the depositary. Where a longer period for the denunciation to take effect is specified in the notification, the denunciation shall take effect upon the expiration of such longer period after the date on which the notification is received by the depositary.

Article 32
Notifications by the depositary

The depositary shall notify the Members of the Hague Conference on Private International Law, and other States and Regional Economic Integration Organisations which have signed, ratified, accepted, approved or acceded to this Convention in accordance with Articles 24, 26 and 27 of the following –

- (a) the signatures, ratifications, acceptances, approvals and accessions referred to in Articles 24, 26 and 27;
- (b) the date on which this Convention enters into force in accordance with Article 28;
- (c) the notifications, declarations, modifications and withdrawals referred to in Articles 26, 27, 29 and 30; and
- (d) the denunciations referred to in Article 31.

In witness whereof the undersigned, being duly authorised thereto, have signed this Convention.

Done at The Hague, on the 2nd day of July 2019, in the English and French languages, both texts being equally authentic, in a single copy which shall be deposited in the archives of the Government of the Kingdom of the Netherlands, and of which a certified copy shall be sent, through diplomatic channels, to each of the Members of the Hague Conference on Private International Law at the time of its Twenty-Second Session and to each of the other States which have participated in that Session.



DEKRET

Nr. 431, datë 27.12.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 122/2024, “Për ratifikimin e Konventës për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore të Huaja në Çështjet Civile ose Tregtare”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 123/2024

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË
KËSHILLIT TË EVROPËS PËR VEPRAT
PENALE QË LIDHEN ME PASURINË
KULTURORE, BËRË NË NIKOSIA MË
19.5.2017**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Evropës për Veprat Penale që Lidhen me Pasurinë Kulturore, bërë në Nikosia më 19.5.2017, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 19.12.2024.

Shpallur me dekretin nr. 432, datë 27.12.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.



Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës – nr. 221

**Konventa e Këshillit të Evropës për Veprat
Penale që Lidhen me Pasurinë Kulturore**
Nikosia, 19.V.2017

Hyrie

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe nënshkruesit e tjerë të kësaj Konvente,
duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Evropës është të arrijë një unitet më të madh mes shteteve anëtare;

duke qenë të bindur se pasuritë e ndryshme kulturore që u përkasin popujve përbëjnë një dëshmi unike dhe të rëndësishme të kulturës dhe identitetit të këtyre popujve dhe formojnë trashëgiminë e tyre kulturore;

të shqetësuar se veprat penale që lidhen me pasuritë kulturore janë në rritje dhe se këto vepra penale po shkaktojnë gjithnjë e më shumë shkatërrimin e trashëgimisë kulturore botërore;

duke pasur parasysh se pasuritë kulturore të gërmuara dhe të eksportuara ose të importuara në mënyrë të paligjshme po shiten gjithnjë e më shumë në mënyra të ndryshme, duke përfshirë shitjen e tyre në dyqane antike dhe shtëpi ankandesh, si dhe përmes internetit;

duke pasur parasysh se krimi i organizuar është i përfshirë në trafikimin e pasurive kulturore;

të shqetësuar se grupet terroriste janë të përfshira në shkatërrimin e qëllimshëm të trashëgimisë kulturore dhe përdorin tregtinë e paligjshme të pasurive kulturore si burim financimi;

të bindur për nevojën e një Konvente të re të Këshillit të Evropës për Veprat Penale të lidhura me pasuritë kulturore, e cila përcakton sanksione penale në këtë drejtim dhe që do të zëvendësojë Konventën Evropiane për Veprat Penale të lidhura me Pasuritë Kulturore (ETS nr. 119), të hapur për nënshkrim në Delfi, më 23 qershor 1985;

duke pasur parasysh Konventën Kulturore Evropiane (ETS nr. 18, 1954), Konventën Evropiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike (ETS nr. 66, 1969; ETS nr. 143, të rishikuar në 1992), Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike të Evropës (ETS nr. 121,



1985) dhe Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë (CETS nr. 199, 2005);

duke pasur parasysh Konventën Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (ETS nr. 30, 1959) dhe Konventën Evropiane për Ekstradimin (ETS nr. 24, 1957);

duke marrë në konsideratë Rezolutën 2199 (2015) të miratuar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në mbledhjen e tij të 7379-të, më 12 shkurt 2015, dhe në veçanti paragrafët 15, 16 dhe 17; Rezolutën 2253 (2015) të miratuar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në mbledhjen e tij të 7587-të, më 17 dhjetor 2015, dhe në veçanti paragrafët 14 dhe 15; Rezolutën 2322 (2016) të miratuar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në mbledhjen e tij të 7831-të, më 12 dhjetor 2016 dhe në veçanti paragrafin 12; Rezolutën 2347 (2017) të miratuar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në mbledhjen e tij të 7907-të, më 24 mars 2017;

duke marrë në konsideratë, gjithashtu, Konventën e Hagës, të vitit 1954, për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore në Rast Konflikti të Armatosur, Protokollin e Parë të saj, të vitit 1954 dhe Protokollin e Dytë të saj të vitit 1999; Konventën e UNESCO-s, të vitit 1970, për Mjetet e Ndalimit dhe Parandalimit të Importit, Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronësisë të Pasurisë Kulturore dhe Udhëzimet e saj Operacionale, të miratuar në vitin 2015, nga mbledhja e tretë e shteteve palë; Konventën e UNESCO-s, të vitit 1972, në lidhje me Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore dhe Trashëgimisë Natyrore; Konventën e UNIDROIT, të vitit 1995, për Objektet Kulturore të Vjedhura ose të Eksportuara në mënyrë të paligjshme; Konventën e Kombeve të Bashkuara, të vitit 2000, kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Konventën e UNESCO-s, të vitit 2001, për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore;

duke marrë në konsideratë, gjithashtu, Rezolutën 2057 (2015) për trashëgiminë kulturore në situata krize dhe pas krize, të miratuar nga Komiteti i Përhershëm i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës më 22 maj 2015;

duke marrë në konsideratë Udhëzimet Ndërkombëtare për Parandalimin e Krimit dhe Kundërpërgjigjen e Drejtësisë Penale, në lidhje me trafikimin e pasurive kulturore dhe vepra të tjera penale të ndërlidhura, të miratuara nga Asambleja e

Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën e saj 69/196 të datës 18 dhjetor 2014;

duke pasur parasysh se qëllimi i kësaj Konvente është mbrojtja e pasurive kulturore nëpërmjet parandalimit dhe luftës kundër veprave penale që lidhen me pasuritë kulturore;

duke pranuar se për të luftuar me efikasitet krimet kundër pasurive kulturore, duhet të nxitet bashkëpunim i ngushtë ndërkombëtar midis shteteve anëtare dhe shteteve joanëtare të Këshillit të Evropës,

bien dakord, për sa më poshtë:

KREU I

QËLLIMI, FUSHA E ZBATIMIT, PËRDORIMI I TERMAVE

Neni 1

Qëllimi i Konventës

1. Qëllimi i kësaj Konvente është:

a) të parandalojë dhe të luftojë shkatërrimin, dëmtimin dhe trafikimin e pasurive kulturore, duke parashikuar kriminalizimin e disa akteve;

b) të forcojë parandalimin e krimit dhe kundërpërgjigjen e drejtësisë penale për të gjitha veprat penale që lidhen me pasuritë kulturore;

c) të nxisë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar në luftën kundër veprave penale që lidhen me pasuritë kulturore;

dhe si rrjedhojë të mbrojë pasuritë kulturore;

2. Për të garantuar zbatimin efektiv të dispozitave të saj nga palët, kjo Konventë krijon një mekanizëm përcjellës.

Neni 2

Fusha e zbatimit dhe përdorimi i termave

1. Kjo Konventë zbatohet për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale të përmendura në këtë Konventë, në lidhje me pasurinë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme.

2. Për qëllimet e kësaj Konvente termi “pasuri kulturore” nënkupton:

a) në lidhje me pasuritë e luajtshme, çdo objekt të vendosur në tokë ose nën ujë, ose të hequr prej aty, i cili në qarqe fetare ose laike, klasifikohet, përkufizohet ose përcaktohet në mënyrë specifike nga çdo palë në këtë konventë ose në Konventën e vitit 1970 të UNESCO-s për mjetet e ndalimit dhe



parandalimit të importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë së pasurisë kulturore, si me rëndësi për arkeologjinë, parahistorinë, etnologjinë, historinë, letërsinë, artin ose shkencën që i përket kategorive të mëposhtme:

a) koleksione të rralla dhe specimene të faunës, florës, mineraleve dhe anatomisë, si dhe objekte me interes palaeontologjik;

b) pasuri e lidhur me historinë, duke përfshirë historinë e shkencës e teknologjisë, si dhe historinë ushtarake dhe shoqërore, me jetën e udhëheqësve kombëtare, dijetarëve, shkencëtarëve dhe artistëve dhe me ngjarjet e një rëndësie kombëtare;

c) objekte të gërmimeve arkeologjike (duke përfshirë gërmimet e rregullta dhe të paligjshme) ose të zbulimeve arkeologjike;

d) elemente të monumenteve artistike apo historike ose të zonave arkeologjike të cilat janë copëzuar;

e) antikitetet më të vjetra se njëqind vjet, siç janë mbishkrimet, monedhat dhe vulat e gdhendura;

f) objekte me interes etnologjik;

g) pasuri me interes artistik, të tilla si:

i. fotografitë, pikturat dhe vizatimet e prodhuara tërësisht me dorë mbi çdo lloj vendi dhe materiali (duke përjashtuar projektet industriale dhe artikujt e zbuluar me dorë);

ii. vepra origjinale të artit të statujave dhe skulpturave në çdo material;

iii. gdhendje origjinale, gravura dhe litografi;

iv. koleksion artistik origjinal dhe montazhe prej çdo materiali;

h) dorëshkrime të rralla dhe libra të vjetër, dokumente dhe botime me interes të veçantë (historik, artistik, shkencor, letrar etj.) të vetme ose në koleksion;

i) pullat postare, fiskale dhe të ngjashme, unike ose në koleksion;

j) arkivat, duke përfshirë arkivat zanorë, fotografikë dhe kinematografikë;

k) objekte orendish më të vjetra se njëqind vjet dhe instrumente muzikore të vjetra;

b) në lidhje me pasuritë e paluajtshme, çdo monument, grup ndërtesash, vend ose strukturë e çdo lloji tjetër, qoftë të vendosur në tokë ose nën ujë, i cili në qarqe fetare ose laike, përkufizohet ose përcaktohet në mënyrë specifike nga çdo palë në këtë Konventë, ose nga çdo palë në Konventën e vitit 1970 të UNESCO-s, si me rëndësi për arkeologjinë, parahistorinë, etnologjinë, historinë,

letërsinë, artin ose shkencën, ose e renditur në përputhje me nenin 1 dhe nenin 11 (paragrafët 2 ose 4) të Konventës së vitit 1972, të UNESCO-s, në lidhje me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore.

KREU II

E DREJTA PENALE MATERIALE

Neni 3

Vjedhja dhe format e tjera të përvetësimit të paligjshëm

Secila palë garanton që vepra penale e vjedhjes dhe format e tjera të përvetësimit të paligjshëm të përcaktuara në legjislacionin e tyre të brendshëm penal, zbatohen për pasuritë kulturore të luajtshme.

Neni 4

Gërmimi dhe heqja e paligjshme

1. Secila palë garanton që sjelljet e mëposhtme përbëjnë vepër penale sipas legjislacionit të saj të brendshëm, kur ato kryhen me dashje:

a) gërmimi në tokë ose nën ujë për të gjetur dhe hequr pasuri kulturore pa autorizimin e kërkuar nga ligji i shtetit ku është kryer gërmimi;

b) heqja dhe mbajtja e pasurisë kulturore të luajtshme të gërmuar pa autorizimin e kërkuar nga ligji i shtetit ku është kryer gërmimi;

c) mbajtja e paligjshme e pasurisë kulturore të luajtshme, të gërmuar në përputhje me autorizimin e kërkuar nga ligji i shtetit ku është kryer gërmimi.

2. Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të deklarojë që gëzon të drejtën të parashikojë sanksione jopenale, në vend të sanksioneve penale për sjelljen e përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 5

Importimi i paligjshëm

1. Secila palë garanton që, kur kryhet me dashje, importimi i pasurisë kulturore të luajtshme, importimi i së cilës është i ndaluar sipas legjislacionit të brendshëm për arsye se:

a) është vjedhur në një shtet tjetër;



b) është gërmuar ose ruajtur në rrethanat e përshkruara në nenin 4 të kësaj Konvente; ose

c) është eksportuar në kundërshtim me ligjin e shtetit që e ka klasifikuar, përkufizuar ose përcaktuar në mënyrë specifike këtë pasuri kulturore në përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente,

përbën vepër penale sipas ligjit të saj të brendshëm kur shkelësi ka qenë në dijeni se pasuria kulturore është vjedhur, gërmuar ose eksportuar në kundërshtim me ligjin e atij shteti tjetër.

2. Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të deklarojë se gëzon të drejtën të parashikojë sanksione jopenale, në vend të sanksioneve penale për sjelljen e përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 6

Eksportimi i paligjshëm

1. Secila palë garanton që eksportimi i pasurisë kulturore të luajtshme, nëse eksportimi është i ndaluar ose kryhet pa autorizimin e kërkuar nga legjislacioni i saj i brendshëm, përbën vepër penale sipas legjislacionit të saj të brendshëm, kur kryhet me dashje.

2. Secila palë merr në konsideratë marrjen e masave të nevojshme për të zbatuar paragrafin 1 të këtij neni edhe në lidhje me pasuritë kulturore të luajtshme që janë importuar në mënyrë të paligjshme.

Neni 7

Blerja

1. Secila palë garanton që blerja e pasurisë kulturore të paluajtshme që është vjedhur në përputhje me nenin 3 të kësaj Konvente ose që është gërmuar, importuar ose eksportuar në rrethanat e përshkruara në nenet 4, 5 ose 6 të kësaj Konvente, përbën vepër penale sipas legjislacionit të saj të brendshëm kur personi është në dijeni të origjinës së paligjshme.

2. Secila palë merr në konsideratë marrjen e masave të nevojshme për të garantuar se sjellja e përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni përbën vepër penale edhe në rastin e një personi që duhet të ishte në dijeni të origjinës së paligjshme të pasurisë

kulturore, nëse do të kishte treguar kujdesin dhe vëmendjen e duhur në blerjen e pasurisë kulturore.

Neni 8

Vendosja në treg

1. Secila palë garanton që vendosja në treg e pasurisë kulturore të luajtshme që është vjedhur në përputhje me nenin 3 të kësaj Konvente ose që është gërmuar, importuar ose eksportuar në rrethanat e përshkruara në nenet 4, 5 ose 6 të kësaj Konvente, përbën vepër penale sipas legjislacionit të saj të brendshëm kur personi është në dijeni të origjinës së paligjshme.

2. Secila palë merr në konsideratë marrjen e masave të nevojshme për të garantuar se sjellja e përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni përbën vepër penale edhe në rastin e një personi që duhet të ishte në dijeni të origjinës së paligjshme të pasurisë kulturore, nëse do të kishte treguar kujdesin dhe vëmendjen e duhur në vendosjen e pasurisë kulturore në treg.

Neni 9

Falsifikimi i dokumenteve

Secila palë garanton se falsifikimi i dokumenteve dhe akti i ndërhyrjes në dokumente që lidhen me pasuritë kulturore të luajtshme, përbën vepër penale sipas legjislacionit të saj të brendshëm, kur këto veprime synojnë të paraqesin pasurinë si të ligjshme.

Neni 10

Shkatërrimi dhe dëmtimi

1. Secila palë garanton që sjelljet e mëposhtme përbëjnë vepër penale sipas legjislacionit të saj të brendshëm, kur ato kryhen me dashje:

a) shkatërrimi i paligjshëm ose dëmtimi i pasurisë kulturore të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht pronësisë së pasurisë;

b) heqja e paligjshme, e plotë ose e pjesshme, e ndonjë elementi nga një pasuri kulturore e luajtshme ose e paluajtshme, me qëllim importimin, eksportimin ose vendosjen në treg të këtyre elementeve në rrethanat e përshkruara në nenet 5, 6 dhe 8 të kësaj Konvente.

2. Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklaratë



drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të deklarojë se gëzon të drejtën të mos zbatojë paragrafin 1 të këtij neni, ose ta zbatojë atë vetëm në raste ose rrethana të veçanta kur pasuria kulturore është shkatërruar ose dëmtuar nga pronari i pasurisë kulturore, ose me pëlqim të pronarit.

Neni 11

Dhënia e ndihmës ose mbështetjes dhe tentativa për të kryer këto vepra

1. Secila palë garanton që dhënia e qëllimshme e ndihmës ose mbështetjes për të kryer një veprë penale të përmendur në këtë Konventë përbën, gjithashtu, një veprë penale sipas legjislacionit të saj të brendshëm.

2. Secila palë garanton që tentativa e qëllimshme për të kryer një veprë penale të përmendur në këtë Konventë me përjashtim të atyre të përcaktuara në nenin 4, paragrafi 1, nënparagrafi “a” dhe nenin 8 përbën, gjithashtu, një veprë penale sipas legjislacionit të saj të brendshëm.

3. Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të deklarojë se gëzon të drejtën të mos zbatojë, ose të zbatojë vetëm në raste dhe rrethana të veçanta, dispozitën e paragrafit 1 të këtij neni, në lidhje me veprat penale të përcaktuara në nenin 4, paragrafi 1, nënparagrafi “a”.

Neni 12

Juridiksioni

1. Secila palë merr masat e nevojshme për të përcaktuar juridiksionin për veprat penale të përmendura në këtë Konventë, kur vepra penale kryhet:

- a) në territorin e saj;
- b) në bordin e një anijeje që mban flamurin e asaj pale;
- c) në bordin e një avioni të regjistruar sipas ligjeve të asaj pale; ose
- d) nga një nga shtetasit e saj.

2. Secila palë merr masat e nevojshme për të përcaktuar juridiksionin për veprat penale të përmendura në këtë Konventë, kur i pandehuri është i pranishëm në territorin e saj dhe nuk mund

të ekstradohet në një shtet tjetër, vetëm në bazë të shtetësisë së tij.

3. Secili shtet, në momentin e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të deklarojë se gëzon të drejtën të mos zbatojë, ose të zbatojë vetëm në raste dhe rrethana të veçanta, rregullat e juridiksionit të përcaktuara në paragrafin 1, nënparagrafi “d” të këtij neni.

4. Kur më shumë se një palë pretendon juridiksion mbi një veprë penale në përputhje me këtë Konventë, palët në fjalë, sipas rastit, konsultohen me njëra-tjetrën, me qëllim përcaktimin e juridiksionit më të përshtatshëm për ndjekje penale.

5. Pa cenuar rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, kjo Konventë nuk përjashton asnjë juridiksion penal të ushtruar nga një palë në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm.

Neni 13

Përgjegjësia e personave juridikë

1. Secila palë garanton që personat juridikë të mbajnë përgjegjësi për veprat penale të përmendura në këtë Konventë, kur kryhen për llogari të tyre nga një person juridik, duke vepruar individualisht ose si pjesë e një organi të personit juridik, i cili ka pozicion drejtues brenda atij personi juridik, bazuar mbi:

- a) kompetencën për të përfaqësuar personin juridik;
- b) autoritetin për të marrë vendime në emër të personit juridik;
- c) autoritetin për të ushtruar kontroll brenda personit juridik.

2. Përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, secila palë garanton që një person juridik të mbajë përgjegjësi në rastet kur mungesa e mbikëqyrjes apo e kontrollit nga një person fizik i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, ka bërë të mundur kryerjen e një veprë penale të përmendur në këtë Konventë për llogari të atij personi juridik nga një person fizik që vepron nën autoritetin e tij.

3. Në bazë të parimeve të palëve, përgjegjësia e një personi juridik mund të jetë penale, civile ose administrative.

4. Kjo përgjegjësi nuk cenon përgjegjësinë penale të personit fizik që ka kryer veprën penale.



Neni 14

Sanksionet dhe masat

1. Secila palë garanton se veprat penale të përmendura në këtë Konventë, kur kryhen nga persona fizikë, dënohen me sanksione efikase, proporcionale dhe parandaluese, të cilat marrin në konsideratë shkallën e veprës penale. Këto sanksione përfshijnë, me përjashtim të veprave penale të përcaktuara në nenin 4, paragrafi 1, nënparagrafi “a” dhe në nenin 5, paragrafi 1, nënparagrafët “b” dhe “c” të kësaj Konvente, dënime që përfshijnë heqjen e lirisë që mund të çojë në ekstradim.

2. Secila palë garanton që personat juridikë që konstatohen përgjegjës në përputhje me nenin 13 të kësaj Konvente, i nënshtrohen sanksioneve efikase, proporcionale dhe parandaluese, të cilat përfshijnë sanksione monetare penale ose jopenale, dhe mund të përfshijnë masa të tjera, të tilla si:

- a) përjashtimi i përkohshëm ose i përhershëm nga ushtrimi i veprimtarive tregtare;
- b) përjashtimi nga e drejta e marrjes së ndihmës ose përfitimeve publike;
- c) vendosja nën mbikëqyrje gjyqësore;
- d) një urdhër gjyqësor likuidimi.

3. Secila palë merr masat e nevojshme legjislative dhe masa të tjera, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, për të lejuar sekuestrimin dhe konfiskimin e:

- a) instrumenteve të përdorura për kryerjen e veprave penale të përmendura në këtë Konventë;
- b) të ardhurave nga këto vepra penale ose pasurive, vlera e të cilave korrespondon me këto të ardhura.

4. Secila palë, kur pasuria kulturore është sekuestruar gjatë procedimeve penale por nuk kërkohet më për qëllimet e këtyre procedimeve, merr përsipër të zbatojë, sipas rastit, ligjin e saj për procedurën penale, një ligj tjetër të brendshëm ose traktate ndërkombëtare të zbatueshme kur vendos t’ia dorëzojë atë pasuri shtetit që e kishte përcaktuar, klasifikuar ose përkufizuar atë në mënyrë specifike si pasuri kulturore në përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente.

Neni 15

Rrethanat rënduese

Secila palë garanton që rrethanat e mëposhtme, për aq kohë sa ato nuk janë ende pjesë e elementeve

përbërëse të veprës penale, në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit të brendshëm, mund të konsiderohen si rrethana rënduese në përcaktimin e sanksioneve, në lidhje me veprat penale të përmendura në këtë Konventë:

a) vepra penale është kryer nga persona që kanë shpërdoruar besimin e dhënë në cilësinë e tyre si profesionistë;

b) vepra penale është kryer nga një zyrtar publik i ngarkuar me ruajtjen ose mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme ose të paluajtshme, nëse ai ose ajo nuk ka kryer qëllimisht siç duhet detyrat e tij ose të saj, me qëllimin për të siguruar përfitime personale të jashtëligjshme;

c) vepra penale është kryer në kuadër të një organizate kriminale;

d) autori është dënuar më herët për veprat penale të përmendura në këtë Konventë.

Neni 16

Vendime të mëparshme të dhëna nga një palë tjetër

Secila palë merr masat e nevojshme për të parashikuar mundësinë e marrjes në konsideratë të vendimeve të formës së prerë të dhëna nga një palë tjetër, në lidhje me veprat penale të përmendura në këtë Konventë gjatë përcaktimit të sanksioneve.

KREU III

HETIMI, NDJEKJA PENALE DHE LIGJI PROCEDURAL

Neni 17

Fillimi i procedimit

Secila palë merr masat e nevojshme legjislative dhe masa të tjera për të siguruar se hetimet ose ndjekja penale e veprave penale të përmendura në këtë Konventë nuk duhet t’i nënshtrohen një ankimi.

Neni 18

Hetimet

Secila palë merr në konsideratë marrjen e masave legjislative dhe masave të tjera për të siguruar që personat, njësitë ose shërbimet e ngarkuara me hetime janë të specializuara në fushën kundër luftës së trafikimit të pasurive kulturore ose që kanë marrë trajnimin e duhur.



Neni 19

Bashkëpunimi ndërkombëtar në çështjet penale

1. Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente dhe në zbatim të instrumenteve dhe marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale të zbatueshme, të dakordësuara mbi bazën e legjislacionit ose reciprocitetit uniform dhe legjislacionit të tyre të brendshëm, në masën më të gjerë të mundshme, me qëllim të hetimeve ose procedimeve të lidhura me veprat penale të përmendura në këtë Konventë, duke përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin.

2. Nëse një palë që e kushtëzon ekstradimin ose ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale me ekzistencën e një traktati merr një kërkesë për ekstradim ose ndihmë juridike në çështjet penale nga një palë me të cilën nuk ka një traktat të tillë, ajo, duke vepruar në përputhje të plotë me detyrimet e saj sipas legjislacionit ndërkombëtar dhe sipas kushteve të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i palës së kërkuar, mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazën ligjore për ekstradimin ose ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale, në lidhje me veprat penale të përmendura në këtë Konventë dhe mund të zbatojë, *rust pas rusti*, nenet 16 dhe 18 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Krimin e Organizuar Ndërkombëtar për këtë qëllim.

KREU IV**MASAT PARANDALUESE DHE MASA TË TJERA ADMINISTRATIVE**

Neni 20

Masa në nivel kombëtar

Secila palë, duke marrë parasysh detyrimet e saj sipas traktateve ndërkombëtare të zbatueshme, duhet të konsiderojë marrjen e masave të nevojshme legjislative dhe masave të tjera, për sa më poshtë:

a) për të krijuar dhe mbajtur inventarë ose baza të dhënash të pasurive të saj kulturore të përcaktuara në nenin 2, paragrafi 2 të kësaj Konvente;

b) për të paraqitur procedura të importit dhe eksportit, në përputhje me instrumentet ndërkombëtare përkatëse, duke përfshirë një sistem ku importimi dhe eksportimi i pasurive kulturore të luajtshme i nënshtrohen lëshimit të certifikatave

specifike;

c) për të parashikuar dispozita për kujdesin e duhur të tregtarëve të artit dhe objekteve antike, shtëpive të ankandeve dhe të personave të tjerë të përfshirë në tregtinë e pasurive kulturore, dhe për të vendosur një detyrim për mbajtjen e regjistrave të transaksioneve të tyre. Këto regjistra duhet t'u vihen në dispozicion autoriteteve kompetente në përputhje me legjislacionin e brendshëm;

d) për të ngritur një autoritet qendror kombëtar ose për të autorizuar autoritetet ekzistuese dhe për të vendosur mekanizma të tjera për bashkërendimin e aktiviteteve që lidhen me mbrojtjen e pasurive kulturore;

e) për të mundësuar monitorimin dhe raportimin/denoncimin e marrëveshjeve ose shitjeve të dyshimta në internet;

f) për të mundësuar raportimin/denoncimin e detyrueshëm pranë autoriteteve kompetente të zbulimit të rastësishëm të pasurive kulturore të trashëgimisë arkeologjike;

g) për të promovuar fushata ndërgjegjësuere drejtuar publikut të gjerë për mbrojtjen e pasurisë kulturore dhe rreziqet që sjellin krimet kundër saj;

h) për të garantuar që muzetë dhe institucionet e ngjashme, politika e blerjes e të cilave është nën kontrollin e shtetit, të mos marrin pasuri kulturore të hequra në mënyrë të paligjshme dhe të ofrojnë informacion dhe trajnim për zyrtarët përkatës për parandalimin dhe luftën kundër krimeve të lidhura me pasuritë kulturore;

i) për të inkurajuar muzetë dhe institucionet e ngjashme, politika e blerjes e të cilave nuk është nën kontrollin e shtetit, të respektojnë rregullat etike ekzistuese për blerjen e pasurive kulturore të luajtshme dhe të raportojnë pranë autoriteteve të zbatimit të ligjit çdo trafikim të dyshuar të pasurive kulturore;

j) për të inkurajuar ofruesit e shërbimeve të internetit, platformat e internetit dhe shitësit përmes internetit që të bashkëpunojnë në parandalimin e trafikimit të pasurive kulturore, duke marrë pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave përkatëse;

k) për të parandaluar përdorimin e zonave të lira portuale për qëllim të trafikimit të pasurive kulturore, qoftë nëpërmjet masave legjislative ose duke i inkurajuar ato të vendosin dhe zbatojnë në mënyrë efektive normat e brendshme nëpërmjet vetërregullimit;



l) për të përmirësuar shpërndarjen e informacionit, në lidhje me çdo pasuri kulturore që ka qenë objekt i një vepre penale sipas përcaktimit në këtë Konventë, pranë autoriteteve të saj doganore dhe policore për të parandaluar trafikimin e kësaj pasurie kulturore.

Neni 21

Masa në nivel ndërkombëtar

Secila palë bashkëpunon në masën më të gjerë të mundshme, me qëllim parandalimin dhe luftën kundër shkatërrimit të qëllimshëm, dëmtimit dhe trafikimit të pasurive kulturore. Në mënyrë të veçantë, shtetet palë duhet:

a) të promovojnë konsultimin dhe shkëmbimin e informacionit, në lidhje me identifikimin, bllokimin dhe konfiskimin e pasurisë kulturore që ka qenë objekt i një vepre penale sipas përcaktimit në këtë Konventë dhe që është gjetur brenda territorit të saj;

b) të kontribuojnë në mbledhjen e të dhënave ndërkombëtare për trafikimin e pasurive kulturore të luajtshme, duke ndarë ose ndërlidhur inventarët ose bazat e të dhënave kombëtare për pasurinë kulturore që ka qenë objekt i një vepre penale sipas përcaktimit në këtë Konventë dhe/ose duke kontribuar në inventarët ose bazat e të dhënave ndërkombëtare, të tilla si bazat e të dhënave të Interpolit për veprat e vjedhura të artit;

c) të lehtësojë bashkëpunimin, me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së pasurive kulturore në kohë paqëndrueshmërie ose konflikti.

KREU V

MEKANIZMI PËRCJELLËS

Neni 22

Komiteti i Palëve

1. Komiteti i Palëve përbëhet nga përfaqësues të palëve të Konventës.

2. Komiteti i Palëve mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës. Mbledhja e tij e parë mbahet brenda një periudhe njëvjeçare pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për nënshkruesin e dhjetë që e ka ratifikuar atë. Më pas, ai mbledhet kur të paktën një e treta e palëve ose Sekretari i Përgjithshëm e kërkon.

3. Komiteti i Palëve miraton vetë rregulloren e tij të brendshme.

4. Komiteti i Palëve asistohet nga Sekretariati i Këshillit të Evropës në kryerjen e funksioneve të tij.

5. Komiteti i Palëve mund t'i propozojë Komitetit të Ministrave mënyra për të angazhuar ekspertizën përkatëse në mbështetje të zbatimit efektiv të kësaj Konvente.

Neni 23

Përfaqësues të tjerë

1. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Komiteti Evropian për Problemet Penale (KEPP) dhe Komiteti Drejtues për Kulturën, Trashëgiminë dhe Peizazhin (KDKTP) caktojnë secila një përfaqësues në Komitetin e Palëve për të kontribuar në një qasje multisektoriale dhe multidisiplinore.

2. Komiteti i Ministrave mund të ftojë organe të tjera të Këshillit të Evropës që të caktojnë një përfaqësues në Komitetin e Palëve, pas konsultimit me komitetin.

3. Përfaqësuesit e organeve përkatëse ndërkombëtare mund të pranohen si vëzhgues në Komitetin e Palëve sipas procedurës së përcaktuar nga rregullat përkatëse të Këshillit të Evropës.

4. Përfaqësuesit e organeve zyrtare përkatëse të palëve mund të pranohen si vëzhgues në Komitetin e Palëve sipas procedurës së përcaktuar nga rregullat përkatëse të Këshillit të Evropës.

5. Përfaqësuesit e shoqërisë civile, dhe në veçanti organizatat joqeveritare, mund të pranohen si vëzhgues në Komitetin e Palëve sipas procedurës së përcaktuar nga rregullat përkatëse të Këshillit të Evropës.

6. Në caktimin e përfaqësuesve, sipas paragrafëve 2 deri në 5 të këtij neni, sigurohet një përfaqësim i balancuar i sektorëve dhe disiplinave të ndryshme.

7. Përfaqësuesit e caktuar në përputhje me paragrafët 1 deri në 5 të këtij neni, marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit të Palëve pa të drejtë vote.

Neni 24

Funksionet e Komitetit të Palëve

1. Komiteti i Palëve monitoron zbatimin e kësaj Konvente. Rregullorja e tij e brendshme cakton procedurën për vlerësimin e zbatimit të kësaj Konvente.

2. Komiteti i Palëve lehtëson, gjithashtu, mbledhjen, analizën dhe shkëmbimin e



informacionit, përvojave dhe praktikave të mira ndërmjet shteteve për të përmirësuar kapacitetin e tyre për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e pasurive kulturore. Komiteti mund të përfitojë nga ekspertiza e komiteteve dhe organeve të tjera përkatëse të Këshillit të Evropës.

3. Gjithashtu, Komiteti i Palëve, sipas rastit:

a) lehtëson përdorimin dhe zbatimin efektiv të kësaj Konvente, duke përfshirë identifikimin e çdo problemi që mund të lindë dhe efektet e çdo deklarate ose rezerve të bërë sipas kësaj Konvente;

b) shpreh një opinion për çdo çështje që lidhet me zbatimin e kësaj Konvente dhe lehtëson shkëmbimin e informacionit për zhvillime të rëndësishme ligjore, politike ose teknologjike;

c) u bën rekomandime specifike palëve, në lidhje me zbatimin e kësaj Konvente.

4. Komiteti Evropian për Problemet Penale dhe Komiteti Drejtues për Kulturën, Trashëgiminë dhe Peizazhin mbahen të informuar periodikisht për aktivitetet e përmendura në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

KREU VI

MARRËDHËNIA ME INSTRUMENTE TË TJERA NDËRKOMBËTARE

Neni 25

Marrëdhënia me instrumente të tjera ndërkombëtare

1. Kjo Konventë nuk cenon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e instrumenteve të tjera ndërkombëtare në të cilat palët e kësaj Konvente janë palë ose do të bëhen palë dhe të cilat përmbajnë dispozita për çështjet që rregullohen nga kjo Konventë. Megjithatë, kur palët vendosin marrëdhëniet e tyre, në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë ndryshe nga sa rregullohen në të, ata e bëjnë këtë në një mënyrë që është në përputhje me objektivat dhe parimet e Konventës.

2. Palët në konventë mund të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe me njëra-tjetrën për çështjet e trajtuara në këtë Konventë, për qëllime të plotësimit ose forcimit të dispozitave të saj ose të lehtësimit të zbatimit të parimeve të saj.

KREU VII

NDRYSHIMET E KONVENTËS

Neni 26

Ndryshimet

1. Çdo propozim për një ndryshim në këtë Konventë i paraqitur nga një palë i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, i cili më pas ia përcjell atë shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, shteteve joanëtare të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e saj dhe çdo shteti që ka aderuar ose është ftuar të aderojë në këtë Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 28.

2. Çdo ndryshim i propozuar nga një palë i komunikohet Komitetit Evropian për Problemet Penale dhe Komitetit Drejtues për Kulturën, Trashëgiminë dhe Peizazhin, të cilët i paraqesin Komitetit të Palëve opinionet e tyre në lidhje me ndryshimin e propozuar.

3. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës shqyrton ndryshimin e propozuar dhe opinionin e paraqitur nga Komiteti i Palëve dhe pasi konsultohet me palët e kësaj Konvente që nuk janë anëtare të Këshillit të Evropës, mund të miratojë ndryshimin nga shumica e parashikuar në nenin 20/“d” të Statutit të Këshillit të Evropës.

4. Teksti i çdo ndryshimi të miratuar nga Komiteti i Ministrave në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni i përcillet palëve për pranim.

5. Çdo ndryshim i miratuar në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe njëmuajore pas datës kur të gjitha palët kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm se e kanë pranuar atë.

KREU VIII

KLAUZOLA PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe nga shtetet joanëtare të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e saj.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit dhe miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit dhe miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.



3. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe tremujore pas ditës kur pesë nënshkrues, duke përfshirë të paktën tre shtete anëtare të Këshillit të Evropës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për të zbatuar Konventën, në përputhje me dispozitat e paragrafit të mësipërm.

4. Në lidhje me çdo nënshkrues i cili shpreh më pas pëlqimin e tij për të zbatuar Konventën, ajo hyn në fuqi, në lidhje me të, në ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe tremujore pas datës së depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit.

Neni 28

Aderimi në konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, pas konsultimit me Shtetet Kontraktuese të kësaj Konvente dhe marrjes së pëlqimit të tyre unanim, mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Evropës, i cili nuk ka marrë pjesë në hartimin e Konventës, të aderojë në këtë Konventë me një vendim të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20/“d” të Statutit të Këshillit të Evropës dhe me votë unanime të përfaqësuesve të Shteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitetin e Ministrave.

2. Në lidhje me çdo shtet aderues, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe tremujore pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 29

Zbatimi territorial

1. Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, specifikon territorin ose territoret ku zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo shtet, në çdo datë të mëvonshme, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të specifikuar në deklaratë dhe për ato marrëdhënie ndërkombëtare që është përgjegjës ose për llogari të së cilit ka autorizim të marrë angazhime. Në lidhje me një territor të tillë, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe tremujore pas datës së marrjes së kësaj deklarate nga Sekretari

i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në përputhje me dy paragrafët e mësipërm, në lidhje me çdo territor të specifikuar në një deklaratë të tillë, mund të tërhiqet përmes një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe tremujore pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 30

Rezervat

1. Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë se përdor një ose më shumë nga rezervat e parashikuara në nenet 4, 5, 10, 11 dhe 12, paragrafi 3 të kësaj Konvente. Nuk mund të bëhet asnjë rezervë tjetër në lidhje me dispozitat e kësaj Konvente.

2. Çdo palë që ka bërë një rezervë, në çdo kohë, mund ta tërheqë atë tërësisht ose pjesërisht me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Tërheqja hyn në fuqi nga data e marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Një palë që ka bërë një rezervë në lidhje me një dispozitë të kësaj Konvente nuk mund të pretendojë zbatimin e kësaj dispozite nga asnjë palë tjetër; megjithatë, nëse rezerva është e pjesshme ose e kushtëzuar, ajo mund të pretendojë zbatimin e kësaj dispozite për aq kohë sa ajo vetë e ka pranuar atë.

Neni 31

Denoncimi

1. Çdo palë mund ta denoncojë në çdo kohë këtë Konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Ky denoncim hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas përfundimit të një periudhe gjashtëmujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 32

Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e



tij, çdo nënshkrues, çdo shtet nënkontraktues dhe çdo shtet tjetër që është ftuar të aderojë në këtë Konventë, në lidhje me:

- a) çdo nënshkrim;
- b) çdo depozitë të ndonjë instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 27, paragrafët 3 dhe 4; nenin 28, paragrafi 2 dhe nenin 29, paragrafi 2;
- d) çdo ndryshim të miratuar në përputhje me nenin 26 dhe datën kur hyn në fuqi ai ndryshim;
- e) çdo rezervë dhe tërheqje rezerve të bërë në përputhje me nenin 30;
- f) çdo denoncim të bërë në përputhje me nenin 31;

g) çdo akt, deklaratë, njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë Konventë.

Në dëshmi sa më lart, të nënshkruarit, të autorizuar për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Nënshkruar në Nikosia, më 19 maj 2017, në gjuhët angleze dhe frënge, ku të dy tekstet janë njëllë autentiçe, në një kopje të vetme e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës i dërgon kopje të certifikuara secilit shtet anëtar të Këshillit të Evropës, shteteve joanëtare të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente dhe çdo shteti të ftuar të aderojë në këtë Konventë.

DEKRET

Nr. 432, datë 27.12.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 123/2024, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Veprat Penale që Lidhen me Pasurinë Kulturore, bërë në Nikosia më 19.5.2017”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 433, datë 27.12.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Jeric Teodosio Quirico Gavaran
2. Can Çelebi Halim Selim Ocal

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 434, datë 27.12.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ahmet Mohamed Abdelmoneim Osman
2. Erkan Şemseddin İpek
3. Üzeyir Sadullah Koyun



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 435, datë 27.12.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Rodelio Entia Clementino Carmona

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 436, datë 27.12.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Jeton Ndue Nreca

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 437, datë 27.12.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetasit:

1. Yllza Shaip Canaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 438, datë 27.12.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Fitore Bashkim Radogoshi
2. Ragip Hasan Kadriaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 439, datë 27.12.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetasit:

1. Brenda Isuf Feta

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 440, datë 27.12.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Armend Sadedin Prekazi
2. Dren Sadedin Prekazi
3. Mustafë Xheladin Halilaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM**Nr. 794, datë 19.12.2024****PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË
INDUSTRIË SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe



teknologjive ushtarake”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes (në vijim AIM).

Neni 2 Objekti

Objekti i këtij vendimi është:

- a) përcaktimi i aspekteve organizative dhe detyrave të AIM-së;
- b) përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësive kryesore të njësive, në funksion të realizimit të proceseve të punës;
- c) përcaktimi i kriterëve të përgjithshme për rekrutimin e punonjësve të AIM-së.

Neni 3 Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes

1. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes është institucion në varësi të ministrit të Mbrojtjes, që ushtron kompetencat, në përputhje me legjislacionin në fuqi për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake.

2. AIM-ja organizohet si drejtori e përgjithshme, sipas strukturave organizative të parashikuara në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

3. AIM-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. AIM-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi. AIM-ja është njësi shpenzuese dhe buxheti përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen.

5. AIM-ja ka stemën, vulën e vet zyrtare dhe logon. Vula ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të

Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, të ndryshuar. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes”, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”, të ndryshuar.

KREU II FUNKSIONIMI I AGJENCISË SË INDUSTRIË SË MBROJTJES

Neni 4 Detyrat e Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes

AIM-ja, në përmbushje të detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në ligj, kryen detyrat e mëposhtme:

a) Vlerëson kërkesën e operatorit ekonomik për t’u pajisur me licencë apo me autorizim në fushën e prodhimit, tregtimit, magazinimit dhe transportit të armatimit ushtarak dhe zhvillimit teknologjik, si dhe kërkesën për shtyrje apo rinovim të tyre;

b) Vlerëson rastet për pezullim apo shfuqizim të licencës apo autorizimit, sipas legjislacionit dhe procedurës në fuqi;

c) Administron regjistrin e subjekteve të licencuara dhe të autorizuara, i cili përmban të gjithë informacionin për kërkesën për licencim, vendimmarrjen për licencimin, kërkesën për autorizim, vendimmarrjen për autorizimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin, masat administrative, duke filluar nga momenti i dhënies së licencës, lejes, deri tek revokimi i tyre;

ç) Harton dhe miraton rregulloret specifike për sigurinë dhe cilësinë e produkteve dhe shërbimeve në fushën e prodhimit, tregtimit, magazinimit, transportit dhe zhvillimit teknologjik, duke përfshirë kriteret për testimin dhe certifikimin e armatimit ushtarak, përpara se ato të hyjnë në treg;

d) Kontribuon në përmirësimin e legjislacionit shqiptar në linjë me zhvillimin e kuadrit ligjor ndërkombëtar në këtë fushë;



dh) Ndërmerr veprimtari për promovimin e interesave të veçantë të Republikës së Shqipërisë në marrëdhëniet me organizatat dhe organizmat ndërkombëtarë në fushën e industrisë ushtarake;

e) Jep këshillim të specializuar dhe organizon programe informimi dhe fushata ndërgjegjësimi për operatorët ekonomikë, subjektet e licencuara dhe autoritetet publike për përparimet, objektivat, legjislacionin, procedurat dhe kufizimet në fushën e industrisë ushtarake;

ë) Kryen vlerësime paraprake sipas kërkesës së paraqitur, në lidhje me përmbushjen e kriterëve të sigurisë për subjektet e huaja, të cilat shprehin interesin për bashkëpunim dhe partneritet me çdo shoqëri, ku aksioner është shteti;

f) Kryen vlerësime për cilësinë e shërbimeve shtetërore, që ofrohen në fushën e industrisë ushtarake;

g) Siguron ndihmën administrative për operatorët ekonomikë për proceset, të cilat përfshijnë disa institucione shtetërore, që kanë kompetenca në këtë fushë;

gj) Koordinon ngritjen, ndërveprimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve *online* për ofrimin e shërbimeve;

h) Kontribuon në raportimet pranë organizatave ndërkombëtare në fushën e prodhimit të armatimit ushtarak, që janë detyruese për Republikën e Shqipërisë në përpjekjet ndërkombëtare për parandalimin e përhapjes së paligjshme të armatimit ushtarak. Për kryerjen e raportimit:

i. siguron transparencë në veprimtarinë e saj rregullatore, duke publikuar raporte të rregullta, statistika dhe analiza për gjendjen e industrisë së armatimit ushtarak në Republikën e Shqipërisë;

ii. mban dhe publikon regjistrin e posaçëm të subjekteve të përjashtuara;

iii. raporton detyrimisht një herë në vit dhe sa herë që i kërkohet pranë Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë për zhvillimet thelbësore të industrisë ushtarake;

i) I raporton ministrit të Mbrojtjes, në mënyrë periodike, për veprimtarinë e saj, si dhe paraqet raportin vjetor, i cili përmban:

i. raportin e punës së AIM-së për vitin e mëparshëm;

ii. programin vjetor të punës për vitin në vazhdim;

iii. licencat, autorizimet e lëshuara për prodhimin, magazinimin, transportin, tregtimin dhe autorizimet

e kërimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake. Nëse raporti përmban informacion të klasifikuar apo sekret tregtar, trajtohet sipas legjislacionit në fuqi;

j) Nënshkruan, sipas legjislacionit në fuqi, kontrata me persona fizikë e juridikë, me qëllim sigurimin e shërbimeve të konsulencës së nevojshme për realizimin e objektivave, brenda fushës së përgjegjësisë. Për ushtrimin e kësaj kompetence, AIM-ja, në rastet veçanërisht komplekse, siguron nëpërmjet ekspertëve të jashtëm, instituteve të kërimit, institucioneve të tjera të specializuara, laboratorëve të akredituar me ekspertizë teknike për vlerësimin, klasifikimin, standardin e armatimit ushtarak, objekteve apo teknologjive, që përdoren në proceset e prodhimit, magazinimit apo transportit. Shpenzimet që nevojiten për një ekspertizë teknike të specializuar nga ana e ekspertëve të jashtëm, instituteve të kërimit, laboratorëve të akredituar apo institucioneve të tjera të specializuara, të cilat i referohen kësaj pike, mbulohen nga subjekti privat apo publik i interesuar;

k) Shërben si sekretariat i Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, në përbërje të të cilit janë 4 (katër) nëpunës të AIM-së dhe është përgjegjës për organizimin dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe mbledhjeve të Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Për këtë qëllim, sekretariati teknik merr të gjitha masat dhe kryen çdo veprim të nevojshëm, në funksion të organizimit të punës dhe të mbledhjeve të Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Në cilësinë e sekretariatit teknik ushtron këto funksione:

i. Mbledh, përgatit, administron dhe i vë në dispozicion anëtarëve të Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të gjithë dokumentacionin dhe materialet e nevojshme për çështjet që shqyrtohen në mbledhjet e tij;

ii. Funksionon si qendër komunikimi dhe informimi midis Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, ministrave të tjerë, përfaqësuesve të institucioneve apo enteve të tjera shtetërore, përfaqësuesve të organeve të tjera shtetërore, ekspertëve, profesionistëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile, investitorëve apo personave, pa të drejtë vote;

iii. Njofton me shkrim anëtarët e Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, organet dhe subjektet e tjera pjesëmarrëse, në lidhje me mbledhjet e Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë dhe rendin e ditës së tyre;



iv. Mban procesverbalin e mbledhjeve të Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe merr masat e duhura për regjistrimin audio dhe transkriptimin e tyre;

v. U komunikon vendimet e marra në mbledhjet e Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë organeve dhe subjekteve përkatëse;

vi. Regjistron, publikon dhe arkivon vendimet e Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

vii. Mbledh dhe përpilon të dhëna statistikore periodike për mbledhjet e Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë;

viii. Zbaton urdhrat dhe porositë e kryetarit të Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë apo të kryesuesit të mbledhjes.

Neni 5

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar

1. Me qëllim bashkërendimin e punës për prodhimin, magazinimin, transportin, tregtimin dhe autorizimeve të kërkimit dhe zhvillimit të armatimit ushtarak, AIM-ja merr ose shkëmben informacion me:

- a) ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme;
- b) ministrinë përgjegjëse për punët e brendshme;
- c) ministrinë përgjegjëse për financat;
- d) Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- d) Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave;
- dh) Shërbimin Informativ të Shtetit;
- e) Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- ë) Agjencinë e Inteligjencës Financiare;
- f) Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve;
- g) çdo institucion tjetër që vlerësohet i nevojshëm bashkëpunimi.

2. AIM-ja lidh marrëveshje me institucionet e sipërpërmendura, lidhur me përcaktimin e procedurave dhe të modaliteteve për shkëmbimin e informacionit.

3. Institucionet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, si dhe institucionet e tjera që angazhohen në vlerësimin dhe shkëmbimin e informacionit për prodhimin, magazinimin, transportin, tregtimin dhe autorizimet e kërkimit dhe zhvillimit të armatimit ushtarak kthejnë përgjigje brenda 20 (njëzet) ditëve pune. Në rast se informacioni nuk vihet në

dispozicion brenda këtij afati, në mënyrë të justifikuar, palët bien dakord për shtyrjen e tij.

4. AIM-ja bashkëpunon me Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe subjekte të tjera private e shtetërore, me qëllim nxitjen, promovimin dhe rritjen e inovacionit e të zhvillimit teknologjik në fushën e mbrojtjes e të prodhimit të armatimit ushtarak.

5. AIM-ja bashkëpunon ngushtë me homologët e saj ndërkombëtarë dhe angazhohet në marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit, praktikave më të mira dhe përf forcimin e kapaciteteve në fushën e kontrollit të armatimit ushtarak.

6. AIM-ja merr pjesë në borde, grupe pune, nisma dhe forume rajonale e ndërkombëtare, që lidhen me zhvillimin dhe bashkëpunimin në fushën e industrisë së mbrojtjes.

KREU III

ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE PROCESET E PUNËS NË AGJENCINË E INDUSTRIËS SË MBROJTJES

Neni 6

Drejtori i përgjithshëm

Drejtori i përgjithshëm i AIM-së siguron drejtimin e veprimtarisë së agjencisë, si dhe bashkërendon veprimtarinë me institucione të tjera të fushës. Ai kryen funksionet kryesore të mëposhtme:

a) Nxjerr urdhra dhe udhëzime me karakter të përgjithshëm normues, në zbatim të kompetencave të tij;

b) Nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda vendit dhe me agjencitë homologe të huaja apo organizma të tjerë jashtë vendit;

c) Përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me:

- i. institucionet e tjera brenda vendit;
- ii. institucionet e tjera jashtë vendit;
- iii. NATO-n, BE-në dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare;

iv. çdo institucion tjetër, që lidhet me fushën e veprimtarisë së AIM-së;

ç) Merr pjesë në ekspozitat kombëtare dhe ekspozita ndërkombëtare të teknikës ushtarake dhe teknologjisë së lartë;



d) Autorizon inspektimet periodike për zbatimin e legjislacionit në fushën e industrisë ushtarake;

dh) Raporton te ministri përgjegjës për mbrojtjen, sa herë që i kërkohet, por jo më pak se një herë në vit për veprimtarinë e AIM-së, lidhur me prodhimin, magazinimin, transportin, tregtimin, kërkimin dhe zhvillimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake;

e) Mbikëqyr hartimin e analizave periodike të aktivitetit të AIM-së;

ë) Ngre grupe pune për çështje specifike të punës së AIM-së dhe monitoron ecurinë e përmbushjes së qëllimit të tyre;

f) Bashkërendon punën për mbikëqyrjen e përmbushjes së detyrimeve të subjekteve të ligjit, sipas dispozitave ligjore në fuqi;

g) Është përgjegjës për ngritjen dhe zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në institucion, në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi;

gj) Drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë administrative, financiare dhe buxhetore të institucionit dhe menaxhon aktivitetin e përgjithshëm;

h) Raporton detyrimisht një herë në vit dhe sa herë që i kërkohet pranë Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë për zhvillimet thelbësorë të industrisë ushtarake;

i) Kryen çdo funksion tjetër të nevojshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Procesi i licencimit dhe i autorizimit

1. Dosja e aplikimit e mbërritur pranë AIM-së përcillet nga drejtori i përgjithshëm pranë njësisë nën varësi, të cilat, sipas fushës së përgjegjësisë, kryejnë verifikimet, si më poshtë vijon:

a) Vlerësojnë dokumentacionin mbi kriteret ligjore, financiare dhe kriterin e sigurisë, dhe përgatisin një raport për gjetjet;

b) Vlerësojnë dokumentacionin mbi kriteret teknike dhe përgatisin një raport për gjetjet;

c) Vlerësojnë dokumentacionin mbi kriteret operacionale e mjedisore dhe përgatisin një raport për gjetjet.

2. Në rastet e aplikimit për autorizim kërkimi dhe zhvillimi, dosja e aplikimit përcillet pranë njësisë përgjegjëse, e cila vlerëson elementet inovatore dhe përputhshmërinë e tyre me nevojat dhe përgatit një raport për gjetjet.

3. Raporti përmbledhës për gjetjet së bashku me propozimet respektive hartohen nga njësia përgjegjëse për licencimin dhe i paraqiten drejtorit të përgjithshëm.

4. Drejtori i përgjithshëm, bazuar mbi raportin përmbledhës, vendos miratimin, refuzimin ose plotësimin e mangësive.

5. Aplikimi, miratimi apo refuzimi i licencës ose i autorizimit regjistrohen në regjistrin e licencave, që administrohet nga AIM-ja.

Neni 8

Vlerësimi i lehtësirave

1. Në rastet kur subjekti ka aplikuar për përfitimin e lehtësirave, të parashikuara në nenin 27, të ligjit nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, dosja e aplikimit e mbërritur pranë AIM-së përcillet pranë njësisë përgjegjëse për vlerësimin e lehtësirave, e cila, sipas fushës së përgjegjësisë:

a) vlerëson dokumentacionin për lehtësirat e kërkuara që mund të përfitojë subjekti;

b) koordinon me institucionet e tjera shtetërore, me të cilat lidhet kërkesa për lehtësi;

c) përgatit një raport për gjetjet për drejtorin e përgjithshëm.

2. Drejtori i përgjithshëm i AIM-së përcjell raportin për miratim pranë Komitetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

KREU IV

KRITERET DHE PROCEDURAT E REKRUTIMIT

Neni 9

Kriteret për përzgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm

Drejtor i përgjithshëm i AIM-së emërohet personi, i cili plotëson kriteret e mëposhtme:

a) Është shtetas shqiptar;

b) Ka zotësi të plotë për të vepruar;

c) Është i aftë nga ana shëndetësore;

ç) Zotëron diplomë të ciklit të dytë të studimeve në shkenca juridike, shkenca ekonomike ose degë të sigurisë dhe mbrojtjes;

d) Ka të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) vjet eksperiencë në punë, nga të cilat së paku 5 (pesë) vjet



në nivel drejtues në administratën publike apo në institucione të sigurisë dhe mbrojtjes;

dh) Nuk është larguar për shkelje disiplinore nga administrata publike, si dhe nuk ka marrë masë disiplinore që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) Nuk i është hequr e drejta për të ushtruar funksione publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;

ë) Nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

f) Plotëson kushtet e sigurisë për kontrollin e verifikimit të pasurisë e të figurës;

g) Nuk ka konflikt interesi me detyrën ose funksionin që kryen, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesit.

Neni 10

Lirimi nga detyra i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes

Drejtori i përgjithshëm i AIM-së lirohet nga detyra në rastet kur:

a) plotëson moshën për pension pleqërie;

b) jep dorëheqjen nga detyra;

c) humbet shtetësinë shqiptare;

ç) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor apo merr formë të prerë vendimi gjyqësor për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;

d) emërohet në një detyrë tjetër.

Neni 11

Shkarkimi nga detyra i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes

Drejtori i përgjithshëm i AIM-së shkarkohet kur:

a) konstatohen shkelje të dispozitave të ligjit në fuqi për industrinë ushtarake;

b) i hiqet ose i refuzohet certifikata e sigurisë, sipas legjislacionit në fuqi;

c) kryen veprimtari që krijon konflikt interesi, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesit;

ç) mungon në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme, për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë pune;

d) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës;

dh) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

e) i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;

ë) nuk përmbush objektivat e punës.

Neni 12

Punonjësi i Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes

1. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, nëpunësve dhe punonjësve administrativë të AIM-së rregullohen sipas dispozitave në fuqi të Kodit të Punës.

2. Punonjësi i AIM-së emërohet nga drejtori i përgjithshëm i AIM-së.

3. Parimet bazë, për të cilat mbështetet përzgjedhja e punonjësit, janë formimi arsimor, profesional, pastërtia e figurës, përvoja e tij dhe specifikat e pozicionit të punës.

4. Punonjësi i AIM-së, në fillim të ushtrimit të detyrës, nënshkruan një formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit deklaron se:

a) nuk ushtron asnjë veprimtari tjetër që mund të bjerë në konflikt me detyrën dhe përgjegjësitë e tyre;

b) nuk kërkon dhe nuk pranon nga askush shpërblim për kryerjen e detyrave të tyre;

c) pas largimit nga detyra ruan informacionin konfidencial, të marrë gjatë punës në AIM.

Neni 13

Kriteret dhe verifikimi i pastërtisë së figurës

1. Punonjësit e AIM-së duhet të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK).

2. Për vlerësimin dhe verifikimin e pastërtisë së figurës së aplikantëve/punonjësve të AIM-së, agjencia bashkëpunon me institucionet e mëposhtme, të cilat janë përgjegjëse për verifikimet përkatëse, konform fushës së tyre të përgjegjësisë:

a) Agjencinë e Inteligjencës së Sigurisë dhe Mbrojtjes;

b) Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK).



Neni 14

Procedura e marrjes në punë

1. Procedura e konkurimit për punonjës in AIM-së përcaktohet në rregulloren e brendshme të AIM-së.

2. Kriteret e përgjithshme për punonjës in AIM-së përcaktohen në rregulloren e brendshme të AIM-së, ndërsa kriteret specifike do të vendosen nga drejtori i përgjithshëm i AIM-së, me propozimin e njësisë përgjegjëse për burimet njerëzore.

3. Marrëdhëniet e punës të punonjës it të AIM-së fillojnë me aktin e emërimit të tyre. Akti i emërimit për punonjës in e AIM-së nënshkruhet nga drejtori i përgjithshëm i AIM-së.

**KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 15

Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Deri në momentin e krijimit të strukturave pranë AIM-së, procedurat e marrjes në punë të punonjës it të AIM-së kryhen nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen, sipas kërkesës së AIM-së.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

VENDIM**Nr. 822, datë 26.12.2024**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KLASIFIKIMIN, PUNËN,
TRANSPORTIMIN FIZIK,
DEKLASIFIKIMIN, ZHVLERËSIMIN,
ASGJËSIMIN DHE SHKATËRRIMIN E
INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR
‘SEKRET SHTETËROR’ TË NATO-s, TË
BASHKIMIT EVROPIAN, TË SHTETEVE
DHE ORGANIZATAVE TË TJERA
NDËRKOMBËTARE”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, pika 4, 18, pika 4, 19, pika 5, 20, pika 3, 22, pika 7, 24, pika 2, dhe 26, pika 3, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për klasifikimin, punën, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 263, datë 12.5.2021, “Për miratimin e rregullores për klasifikimin e informacionit ‘Sekret shtetëror’”, nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, nr. 81, datë 28.1.2008, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për asgjësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar, nr. 502, datë 23.6.2010, “Për miratimin e rregullores “Për transportimin fizik të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, nr. 312, datë 16.3.2011, “Për miratimin e rregullores për punën me informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, nr. 377, datë 31.5.2001, “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në marrëdhëniet ndërkombëtare”, të ndryshuar, dhe nr. 836, datë

¹ Ky vendim është përafshuar pjesërisht me vendimin e Këshillit, datë 23 shtator 2013, “Mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-së”

(2013/488/BE), nr. CELEX 32013D0488, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 274, datë 15.10.2013, faqe 1–50.



14.10.2015, “Për miratimin e rregullore ‘Për punën me informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe Bashkimit Evropian’”, shfuqizohen.

3. Ngarkohen ministritë, institucionet shtetërore, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar dhe operatorët ekonomikë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLORE
PËR KLASIFIKIMIN, PUNËN,
TRANSPORTIMIN FIZIK,
DEKLASIFIKIMIN, ZHVLERËSIMIN,
ASGJËSIMIN DHE SHKATËRRIMIN E
INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR
“SEKRET SHTETËROR” TË NATO-S, TË
BASHKIMIT EVROPIAN, TË SHTETEVE
DHE ORGANIZATAVE TË TJERA
NDËRKOMBËTARE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për klasifikimin, punën, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është mbrojtja e informacionit të klasifikuar nga humbja, dëmtimi, rrjedhja, komprometimi ose ekspozimi i paaautorizuar gjatë gjithë ciklit të tij.

Neni 3
Fusha e veprimit

Kjo rregullore zbatohet nga institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë, të

cilët, për ushtrimin e detyrave të tyre dhe bazuar në parimin “nevojë për njohje”, kërkohet të kenë qasje në informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

Neni 4
Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Informacion i klasifikuar i NATO-s”, çdo dokument ose material i çfarëdolloj forme, i cili ka nevojë për mbrojtje kundër përhapjes së paaautorizuar, e përcaktuar kjo nga klasifikimi i sigurisë;

2. “Informacion i klasifikuar i BE-së”, çdo dokument apo material i përfshirë në kategoritë e klasifikimit të sigurisë së Bashkimit Evropian, përdorimi i paaautorizuar i të cilit mund t’u shkaktojë dëme interesave të Bashkimit Evropian, apo një, apo më shumë shteteve anëtare të saj;

3. “Dokument i klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, çdo dokument i regjistruar, pavarësisht formës fizike ose karakteristikave, përfshirë dokumentin e shkruar të printuar ose në formë elektronike, klasifikuar sipas akteve ligjore në fuqi;

4. “Dokument i klasifikuar i NATO-s dhe/ose i BE-së”, çdo informacion i regjistruar, pavarësisht formës fizike ose karakteristikave, përfshirë këtu dokumentin e shkruar ose të printuar, kartela, kaseta, CD, DVD të ruajtjes së të dhënave, harta, diagrame, fotografi, vizatime, skica, shënime pune, kopje karboni, zë, regjistrim magnetik, elektronik, optik, video;

5. “Material i klasifikuar i NATO-s dhe/ose i BE-së”, dokumente dhe çdo pjesë makinerie / pajisjeje ose armë të prodhuara ose në proces prodhimi;

6. “Origjinatori”, institucioni, agjencia ose një strukturë e NATO-s, e Bashkimit Evropian, e shtetit anëtar të NATO-s dhe Bashkimit Evropian, e shtetit joanëtar të NATO-s/Bashkimit Evropian ose organizata ndërkombëtare, nën autoritetin e të cilëve informacioni i klasifikuar është krijuar dhe/ose është futur në strukturat e NATO-s dhe Bashkimit Evropian;

7. “Klasifikimi”, procesi përmes të cilit një informacion përcaktohet si i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, i Bashkimit Evropian dhe



organizatave të tjera ndërkombëtare, duke i caktuar nivelin e klasifikimit dhe afatin e ruajtjes së këtij klasifikimi, në përputhje me aktet ligjore në fuqi;

8. “Oficer i kontrollit *COSMIC/ATOMAL*”, punonjësi i zyrës së Regjistrat Qendror, i zyrës së Nënregjistrat apo të Pikës së Kontrollit të Informacionit të Klasifikuar të NATO-s, i cili është autorizuar me urdhër nga titullari i institucionit për të administruar edhe informacionin e klasifikuar të *COSMIC TOP SECRET* dhe *ATOMAL*;

9. “Deklasifikim i plotë”, procesi i ndryshimit të autorizuar të statusit të një informacioni të klasifikuar “Sekret shtetëror” në një informacion të paklasifikuar;

10. “Deklasifikim i pjesshëm”, procesi i ndryshimit të autorizuar të statusit të një pjese të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” në informacion të paklasifikuar;

11. “Asgjësim”, procesi, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, në të cilin, për një informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”, vendoset asgjësimi i tij, për shkak të humbjes së vlerave për ruajtje të mëtejshme dhe nuk është e nevojshme të deklasifikohet;

12. “Shkatërrim”, procesi, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, i shkatërrimit fizik të një informacioni të klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s dhe Bashkimit Evropian, i cili bëhet me mënyra dhe mjete që nuk lejojnë rindërtimin e plotë ose të pjesshëm të tij;

13. “Certifikatë e shkatërrimit”, procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Shkatërrimit të Informacionit të Klasifikuar të NATO-s dhe Bashkimit Evropian;

14. “Mediat e lëvizshme”, pajisjet memorizuese të të dhënave, që ndihmojnë për ruajtjen ose transportimin e të dhënave nga një kompjuter në një tjetër. Këtu përfshihen disqet optike, kartat e memories, shiritat magnetikë, USB, CD, DVD;

15. “Transportim fizik”, marrja, përpunimi, vijimi dhe dorëzimi i objekteve dhe i pakove postare të klasifikuara “Sekret shtetëror” në mënyrë të sigurt nga dërguesi tek i adresuari;

16. “Objekt postar i klasifikuar”, zarfi brenda të cilit ndodhet një dokument apo material i klasifikuar “Sekret shtetëror”, me shenjëzimet përkatëse mbi të;

17. “Pako postare e klasifikuar”, ambalazhimi i disa objekteve postare të klasifikuara “Sekret shtetëror” në një pako të vetme me shenjëzimet përkatëse mbi të;

18. “Mbajtje personale e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s dhe BE-së”, mbajtja e informacionit të klasifikuar jashtë ambientit të punës nga një punonjës i autorizuar për qëllime zyrtare dhe jo për arsye transportimi drejt një destinacioni tjetër.

Neni 5

Siguria e informacionit të klasifikuar

1. Me siguri të informacionit të klasifikuar kuptojmë tërësinë e procedurave dhe të standardeve, që garantojnë sigurinë e informacionit të klasifikuar gjatë procesit të krijimit, administrimit dhe mbikëqyrjes së tij.

2. Institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë, që kanë qasje në informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, të BE-së, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, zbatojnë të gjitha masat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

3. E drejta e njohjes me informacionin e klasifikuar kufizohet vetëm tek ata persona që kanë nevojë për njohje dhe përmbushin kriteret e sigurisë.

4. Një institucion nuk ka të drejtë të zbulojë informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” origjinal të klasifikuar nga një institucion tjetër, pa autorizimin e këtij të fundit.

5. Një institucion nuk ka të drejtë të zbulojë informacionin origjinal të klasifikuar nga NATO-ja dhe BE-ja, për të tretët, pa miratimin me shkrim të tyre.

6. Informacioni nuk publikohet kur është i klasifikuar “Sekret shtetëror” ose me shenjëzimet e klasifikimit të NATO-s dhe BE-së.

7. Çdo individ ka për detyrë që të mbrojë informacionin e klasifikuar sipas kësaj rregulloreje, pavarësisht nga mënyra se si ai ka arritur ta posedojë apo të garantojë të drejtën e njohjes së këtij informacioni të klasifikuar.

8. Në çdo rast, kur një individ i ndërpret marrëdhëniet e punës apo çdo marrëdhënie tjetër kontraktuese, pavarësisht funksionit, është i detyruar që të mos ekspozojë përmbajtjen e informacionit të klasifikuar, që ai ka njohur gjatë ushtrimit të një detyre apo funksioni, apo marrëdhënie kontraktuale.



Neni 6

Informacioni i huaj

1. Institucionet shtetërore janë të detyruara që një kopje të marrëveshjes ose të protokollit teknik për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ta dërgojnë pranë AKSIK-ut brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga nënshkrimi i saj.

2. Në rastet kur nuk ka marrëveshje apo protokoll teknik për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ose kur shtetet e huaja apo organizatat ndërkombëtare nuk kanë përcaktuar rregulla për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, zbatohen kërkesat e kësaj rregulloreje.

PJESA I

**INFORMACIONI I KLASIFIKUAR
“SEKRET SHTETËROR”**

KREU I

**KLASIFIKIMI I INFORMACIONIT
“SEKRET SHTETËROR”**

Neni 7

Autoriteti klasifikues

1. Autoritete klasifikuese të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë janë:

- a) Presidenti i Republikës;
- b) Kryeministri.

2. Titullarët e institucioneve të tjera e marrin këtë të drejtë me autorizim nga Kryeministri.

3. Çdo institucion shtetëror, kur e gjykon se aparati dhe strukturat në varësi të tij prodhojnë informacion që lidhet me sigurinë kombëtare dhe që duhet të klasifikohet “Sekret shtetëror”, i paraqet kërkesë AKSIK-ut për pajisjen e titullarit të institucionit me autorizimin “autoritet klasifikues” nga Kryeministri.

4. AKSIK-u shqyrton kërkesën e paraqitur, duke kontaktuar edhe me strukturat përkatëse të institucionit lidhur me informacionet që do të klasifikojë dhe, kur e gjen të bazuar në ligj dhe në aktet nënligjore, i propozon Kryeministrit lëshimin e autorizimit “autoritet klasifikues” për titullarin e institucionit.

5. Në rast se kërkesa nuk gjendet e bazuar në ligj dhe në aktet nënligjore, AKSIK-u i kthen përgjigje institucionit brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, duke i shpjeguar arsyet e mospranimi të kërkesës.

Neni 8

**Krijimi, përbërja dhe vendimmarrja e
Komisionit të klasifikimit “Sekret shtetëror” të
informacionit**

1. “Komisioni për klasifikimin “Sekret shtetëror” të informacionit” krijohet në çdo institucion qendror, që prodhon informacion të klasifikuar.

2. Një nga anëtarët e komisionit caktohet kryetar i Komisionit me urdhër të “autoritetit klasifikues”.

3. Numri i anëtarëve të Komisionit duhet të jetë gjithmonë numër tek, ku njëri është nënkryetar dhe një tjetër sekretar.

4. Komisioni mblidhet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve dhe merr vendim me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

5. Urdhri për krijimin e Komisionit përmban funksionet organike të secilit anëtar.

6. Komisioni shqyrton informacionet e propozuara për klasifikim dhe i propozon titullarit të institucionit për informacionin që duhet klasifikuar ose rivlerësuar, për nivelin e klasifikimit dhe afatin e ruajtjes së klasifikimit kur lidhet me sigurinë kombëtare, në përputhje me kategoritë e klasifikimit sipas nenit 10, të ligjit 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”. Në përfundim të shqyrtimit të informacionit të propozuar për klasifikim, sekretari i komisionit harton vendimin për listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” në institucion dhe strukturat e varësisë, ku përcaktohet emërtimi i informacionit, niveli i klasifikimit dhe afati i ruajtjes së klasifikimit.

7. Vendimi për listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” në institucion dhe në strukturat e varësisë nënshkruhet nga Komisioni dhe i propozohet autoritetit klasifikues.

8. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtën e votës “pro” ose “kundër”. Anëtar, i cili voton “kundër”, duhet të paraqesë me shkrim arsyet e votimit “kundër”.

9. Një kopje e vendimit për listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” i dërgohet AKSIK-ut brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

Neni 9

Klasifikimi i informacionit

1. Çdo informacion i klasifikuar “Sekret shtetëror” prodhohet vetëm bazuar në listën e



informacionit të klasifikuar dhe duke evidentuar saktë emërtimin e informacionit, nivelin e klasifikimit dhe afatin e ruajtjes së klasifikimit sipas listës.

2. Vendimi për listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” në institucion dhe në strukturat e varësisë duhet të njihet nga të gjithë nëpunësit/punonjësit, që prodhojnë dhe administrojnë informacion të klasifikuar.

3. Lista e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” ndryshohet në vazhdimësi kur është e nevojshme, duke ndjekur procedurën përkatëse të parashikuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje. Një kopje e listës së ndryshuar dërgohet në AKSIK brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike.

4. Çdo informacion që prodhohet pa u bazuar në listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” të institucionit dhe të strukturave në varësi, trajtohet si informacion i paklasifikuar pavarësisht nga shenjëzimet që janë vendosur në këtë informacion.

5. Operatorët ekonomikë mund të prodhojnë informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror” në kuadrin e një kontrate apo nënkontrate që përmban informacion të klasifikuar, duke u bazuar në listën e informacioneve të klasifikuara të autoritetit kontraktor.

6. Institucionet shtetërore, që nuk kanë listë të informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror”, kur marrin një kërkesë, që përmban informacion të klasifikuar, përgjigjen, gjithashtu, duhet ta kthejnë të klasifikuar. Në këtë rast, niveli i klasifikimit dhe afati i ruajtjes së klasifikimit të këtij informacioni duhet të jetë i njëjtë me informacionin e ardhur dhe duhet prodhuar e administruar, sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

7. Përkthimi, riprodhimi dhe fragmentimi i një informacioni të klasifikuar përmban të gjitha shenjëzimet e tij dhe trajtohet si i tillë.

8. Kur një informacion është i klasifikuar, e gjithë praktika ku bën pjesë ai, trajtohet në nivelin e këtij informacioni. Informacioni i paklasifikuar, pjesë e kësaj dosjeje, mund të veçohet e të shfrytëzohet me miratim të titullarit.

9. Kur në një praktikë ndodhen një ose disa informacione të klasifikuara “Sekret shtetëror”, e gjithë praktika konsiderohet e klasifikuar dhe merr nivelin me të lartë të klasifikimit të informacionit që ndodhet në të.

Neni 10

Propozimi për klasifikimin e informacionit

1. Strukturat në varësi të institucionit i propozojnë Komisionit të klasifikimit “Sekret shtetëror” të informacionit, llojet e informacionit që gjykojnë se duhen klasifikuar, ku përcaktojnë emërtimin e informacionit, nivelin e klasifikimit dhe afatin e ruajtjes së klasifikimit.

2. Çdo shtetas shqiptar, kur çmon se një informacion i caktuar nën kontrollin e shtetit ose jashtë tij duhet klasifikuar, i propozon institucionit përkatës të administratës publike klasifikimin e tij.

3. Komisioni për klasifikimin “Sekret shtetëror” të informacionit, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, merr në shqyrtim propozimet e bëra për klasifikim nga strukturat e varësisë ose shtetasit dhe vendos nëse duhen klasifikuar apo jo.

Neni 11

Shenjëzimet e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”

1. Informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror”, që të identifikohet si i tillë, duhet të përmbajë këto shenjëzime:

a) Stemen e Republikës së Shqipërisë (në qendër, lart);

b) Intestimin “Republika e Shqipërisë” (në qendër, lart);

c) Emërtimin e institucionit shtetëror dhe të strukturës përkatëse (nëse ka të tillë);

ç) Numrin e regjistrimit (protokollit) të korrespondencës (në anën e majtë);

d) Nivelin e klasifikimit (në anën e djathtë);

dh) Afatin e ruajtjes së klasifikimit (në anën e djathtë);

e) Kopje nr. (në anën e djathtë);

ë) Vendin dhe datën (në anën e djathtë);

f) Lëndën (në anën e majtë);

g) Adresën e korrespondentit (titullari/institucioni);

gj) Emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan informacionin dhe nënshkrimin e tij;

h) Vulën e institucionit prodhues.

2. Në fundin e kopjes së informacionit që qëndron në njësinë organizative përgjegjëse për informacionin e klasifikuar, në anën e majtë, shkruhen edhe shenjëzimet e mëposhtme:

a) konceptoi;



b) printoi;
c) eprori më i afërt (përgjegjës sektori, kryetar dege).

ç) eprori direkt (drejtor departamenti, drejtorie);
d) numri i kopjeve të prodhuara;
dh) numri i faqeve të shkruara për çdo kopje.

3. Niveli i klasifikimit në çdo informacion të klasifikuar vendoset poshtë vizimit të faqes së parë dhe në fillimin e fundin e çdo faqeje pasardhëse.

4. Informacionet e klasifikuara, që krijohen, qarkullojnë dhe administrohen vetëm brenda ministrisë apo institucionit, kanë të gjitha shenjëzimet identifikuese të informacioneve të klasifikuara që dërgohen apo hyjnë në ministri apo institucion.

5. Modeli i shkresës me informacion të klasifikuar për institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë përcaktohet në udhëzimin zbatues të kësaj rregulloreje, që miratohet nga AKSIK-u.

KREU II

PUNA ME INFORMACIONIN E KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR”

Neni 12

Njësia organizative përgjegjëse për informacionin e klasifikuar (NJOPIK)

1. Pranë çdo ministrie apo institucioni shtetëror dhe strukturat në varësi të tyre, që prodhojnë dhe administrojnë informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”, organizohet dhe funksionon njësia organizative përgjegjëse për informacionin e klasifikuar (në vijim “NJOPIK”).

2. NJOPIK-u është në varësi të titullarit ose të strukturës organizative përkatëse, të cilët janë dhe përgjegjës për funksionimin e saj.

3. NJOPIK-u përgjigjet për marrjen, dërgimin, regjistrimin, shpërndarjen, shfrytëzimin shumëfishimin, ruajtjen dhe arkivimin e informacionit të klasifikuar.

4. Me miratim të AKSIK-ut, NJOPIK-u mund të organizohet dhe të funksionojë edhe tek operatorët ekonomikë të pajisur me certifikatë të sigurisë industriale përkatëse. NJOPIK-u zbaton të njëjtat procedura dhe masa të sigurimit fizik të parashikuara në këtë vendim.

5. Funksionet e NJOPIK-ut, që lidhen me administrimin e informacionit të klasifikuar kryhen

nga struktura/strukturat përgjegjëse për protokoll-arkivin, kartotekën në institucionet e administratës publike, që administrojnë informacion të klasifikuar.

6. Punonjësi i NJOPIK-ut, kur largohet përkohësisht nga puna, ia dorëzon regjistrat, librat dhe vulën punonjësit të autorizuar me shkrim nga titullari i ministrisë apo i institucionit. Dorëzimi bëhet me procesverbal të firmosur nga dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim. Në qoftë se gjatë kësaj kohe kërkohet një informacion i klasifikuar, hapja e kasafortës apo e dollapit metalik dhe tërheqja e informacionit bëhet me anë të një komisioni të ngritur me urdhër të titullarit të institucionit, në përbërje të të cilit ka jo më pak se 3 (tre) anëtarë. Kjo procedurë pasqyrohet në procesverbalin përkatës, i cili mbahet dhe regjistrohet në kasafortë. Procesverballi përmban:

- a) datën;
- b) orën;
- c) llojin e informacionit;
- ç) arsyen e tërheqjes për shfrytëzim;
- d) nënshkrimin e 3 (tre) anëtarëve.

7. Në NJOPIK mund të regjistrohet, të qarkullojë, të administrohet, të shumëfishohet, të arkivohet e të ruhet edhe informacion i paklasifikuar, por në regjistra, kasaforta dhe dollapë metalike të veçantë vetëm për informacionin e paklasifikuar.

Neni 13

Organizimi dhe funksionimi i njësisë organizative përgjegjëse për informacionin e klasifikuar (NJOPIK)

1. NJOPIK-u vendoset dhe organizohet në zonën e sigurisë të klasit të parë, në mjedise të përshtatshme, në përputhje me masat që sigurojnë mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, sipas kërkesave për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”.

2. Dera e zyrës duhet të jetë e blinduar, të ketë dritare të sigurta dhe brenda të ketë banakë ndarës ose rrjetë apo barriera metalike për ndarjen e mjedisit të brendshëm nga mjedisi i jashtëm.

3. Informacionet e klasifikuara në NJOPIK mbahen dhe ruhen në kasaforta ose dollapë metalikë të kyçur. Në fund të ditës së punës informacionet sigurohen në kasaforta ose në dollapë metalikë të kyçur.



4. Dera dhe dritaret e zyrës duhet të jenë nën mbikëqyrjen e kamerave të sigurisë nga jashtë.

5. Brenda ambienteve të NJOPIK-ut ndalohet futja e pajisjeve personale, si: laptop, kamera, aparate fotografike, regjistruues zëri, ora elektronike dhe çdo pajisje tjetër memorizuese e regjistruese.

6. Ndalohet mbajtja e furnelave elektrike, e gazit, fenerëve ndriçues me lëndë djegëse, si dhe pirja e duhanit në ambientet e NJOPIK-ut. Ndriçimi dhe rrjeti elektrik vendosen sipas kërkesave të shërbimit të mbrojtjes ndaj zjarrit.

7. Në NJOPIK ndalohet kategorikisht të punojnë persona të pacertifikuar nga AKSIK-u dhe hyrja e personave të paautorizuar nga eprori direkt ose titullari i institucionit.

8. Veprimet e dorëzimit e të marrjes së një informacioni të klasifikuar apo korrespondenca me informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror” bëhen në ambientin jashtë banakut, larg informacioneve, regjistrave e librave, kompjuterit e kasafortës.

9. Një kopje e çelësve/kodeve të kasafortave e dollapëve metalikë, ku mbahet informacion i klasifikuar “Sekret shtetëror”, mbahet në zyrën e eprorit direkt, mbyllur në një zarf me shirit sigurie me ngjitës. Hapja e zarfit dhe përdorimi i çelësve/kodeve bëhet me urdhër të titullarit të ministrisë apo të institucionit, në prani të një komisioni me jo më pak se 3 (tre) anëtarë, të ngritur prej tij dhe mbahet procesverbal i përkatës.

Neni 14

Detyrat e punonjësit të NJOPIK-ut

1. Punonjësi i NJOPIK-ut i merr në dorëzim informacionet e klasifikuara vetëm pasi është pajisur me certifikatë sigurie të përshtatshme sipas akteve normative në fuqi dhe ka kryer të gjithë procesin e njohjes me aktet ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e saj.

2. Punonjësi i NJOPIK-ut ka këto detyra:

a) Zbaton me përpikëri aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në lidhje me marrjen, dërgimin, regjistrimin, qarkullimin, shfrytëzimin, shumëfishimin dhe arkivimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”;

b) Verifikon nëse informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror”, që prodhohet ose administrohet brenda institucionit, si dhe informacioni që merret e dërgohet nga institucioni përmbush kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore;

c) Shpërndan për shfrytëzim informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” me miratimin e titullarit vetëm tek ata punonjës, të cilët janë pajisur me “certifikatë sigurie” të përshtatshme dhe kundrejt nënshkrimit të marrësit në librin e qarkullimit të brendshëm të informacionit të klasifikuar;

ç) Sistemon të gjithë informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, që ka në ngarkim në mënyrë kronologjike;

d) Zbaton afatet e përcaktuara për shfrytëzim, ruajtjen dhe arkivimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”;

dh) Informon me shkrim titullarin e institucionit në rastet kur punonjësit tejkalojnë afatin ligjor të shfrytëzimit të informacioneve të klasifikuara;

e) Plotëson saktë, mirëmban dhe përdor vetëm regjistrat dhe librat e modeluar nga AKSIK-u, në lidhje me regjistrimin, qarkullimin, shfrytëzimin, marrjen, dërgimin dhe shumëfishimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”;

ë) Ruan informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” në kasafortë ose në dollapë metalikë;

f) Ndërron periodikisht kodet, por jo më pak se një herë në 6 (gjashtë) muaj në rastet e përdorimit të kasafortave apo dollapëve metalikë, që operojnë me anë të këtyre sistemeve;

g) Kryen inventarin fizik të informacioneve të klasifikuara çdo 6 (gjashtë) muaj, mban procesverbalin përkatës të inventarizimit dhe raporton tek eprori direkt;

gj) Sistemon dhe inventarizon informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” para dorëzimit në arkivin e institucionit.

h) Dorëzon informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” në arkivin e institucionit 10 (dhjetë) vjet nga koha e krijimit të tij;

i) Studion informacionet e klasifikuara që ka në administrim dhe përgatit relacionin përkatës për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e tyre bazuar në kriteret ligjore;

j) Studion informacionet e klasifikuara që ka në administrim dhe përgatit relacionin përkatës për asgjësimin e tyre, bazuar në urdhrin e titullarit të institucionit për llojet dhe kategoritë e informacioneve të klasifikuara që i nënshtrohen procesit të asgjësimit;

k) Komunikon sipas rregullave me postën dhe njësitë organizative përgjegjëse për informacionin e klasifikuar të ministrive dhe të institucioneve të tjera;



l) Në fund të ditës së punës, mbyll informacionet në kasaforta apo në dollapë metalikë;

ll) Administron, mirëmban dhe ruan vulën e institucionit.

Neni 15

Librat dhe regjistrat për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”

1. AKSIK-u, me qëllim standardizimin, përcakton modelin e regjistrave dhe librave për regjistrimin, qarkullimin, shfrytëzimin, shumëfishimin e dorëzimin e korrespondencës të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”. Institucionet shtetërore, për nevojat e tyre, prodhojnë regjistrat dhe librat vetëm sipas modeleve të përcaktuara nga AKSIK-u në udhëzimin zbatues të kësaj rregulloreje, që miratohet nga AKSIK-u.

2. Llojet e regjistrave dhe librave janë:

a) regjistri i korrespondencës së informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”;

b) regjistri i shumëfishimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”;

c) libri i qarkullimit të brendshëm të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”;

ç) libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”;

d) libri i regjistrave.

3. Në librin e regjistrave regjistrohen të gjithë regjistrat e librat për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” dhe plotësohet e mbahet nga eprori më i afërt i punonjësit të NJOPIK-ut.

4. Regjistri i korrespondencës së informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” mbyllet në fundin e çdo viti dhe numri i protokollit i shkresës së klasifikuar për vitin pasardhës fillon nga numri 1 (një).

5. Niveli i klasifikimit dhe afati i ruajtjes së klasifikimit të regjistrave të përmendur në pikën 2, të këtij neni, përcaktohet te lista e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” e ministrisë apo e institucionit shtetëror.

6. Ministrinë dhe institucionet shtetërore, si rezultat i natyrës së punës së tyre, mund të modelojnë dhe të mbajnë edhe regjistra e libra të tjerë për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, por duhet të evidentohen te vendimi për listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” të ministrisë apo të institucionit shtetëror. Në këtë listë të pasqyrohet emërtimi i regjistrat apo i

librit, niveli i klasifikimit dhe afati i ruajtjes së klasifikimit.

Neni 16

Veprimet me informacionet e klasifikuara që dërgohen nga institucioni

1. Punonjësi i NJOPIK-ut, para regjistrimit në regjistrin e korrespondencës së informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” dhe vulosjes së një shkrese që përmban ose shoqëron një informacion të klasifikuar që dërgohet nga institucioni, verifikon nëse shkresa është në përputhje me modelin e përcaktuar nga AKSIK-u dhe është firmosur nga titullari i institucionit ose i autorizuari prej tij.

Nëse nuk plotëson të dyja kushtet, nuk e regjistron dhe vulos, por e kthen atë për plotësim.

2. Kur shkresa e klasifikuar është e rregullt, NJOPIK-u bën regjistrimin e saj në regjistrin e korrespondencës së informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, vendos numrin e protokollit në mënyrë kronologjike dhe e vulos. Vula e njomë vihet përbri firmës, zhvendosur pak majtas, pa e mbuluar atë. Gjurma e vulës duhet të jetë e qartë, e lexueshme dhe e padëmtuar.

3. Shkresa me informacion të klasifikuar futet në një objekt postar (zarf), i cili duhet të jetë jo i tejdukshëm dhe i fortë.

4. Objekti postar me informacion të klasifikuar “tepër sekret”, “sekret” dhe “konfidencial”, pas mbylljes, vuloset në katër cepat dhe sigurohet me shirit sigurie, ndërsa ajo me informacion të klasifikuar në nivelin “i kufizuar” vetëm vuloset në katër cepat.

5. Në objektin postar në anën e majtë të tij, lart, shënon emërtimin e dërguesit dhe numrin e protokollit, ndërsa në të djathtë, lart, shënon nivelin e klasifikimit dhe në mes të objektit postar (zarfit) adresën e plotë të marrësit.

6. Punonjësi i NJOPIK-ut, pas mbylljes së sigurt të objektit postar, plotëson librin e dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të institucionit dërgues.

7. Ky libër, së bashku me objektin postar i dorëzohet korrierit të postës së klasifikuar të institucionit dërgues kundrejt nënshkrimit të tij në këtë libër. Korrieri i postës së klasifikuar i institucionit dërgues bën shpërndarjen e objektit postar në destinacionin e tij sipas rregullave të transportimit fizik të informacionit të klasifikuar.



8. Korrieri i postës së klasifikuar i institucionit dërgues e dorëzon objektin postar vetëm te punonjësi i NJOPIK-ut i institucionit marrës kundrejt nënshkrimit të punonjësit të NJOPIK-ut të institucionit marrës, në librin e dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të institucionit dërgues.

9. Kopja e fundit e shkresës së informacionit të klasifikuar me shenjëzimet në pjesën e poshtme (majtas), nënshkruar nga titullari i institucionit dhe e vulosur, ruhet në NJOPIK të institucionit dërgues.

10. Institucionet shtetërore dhe strukturat në varësi të tyre, të cilat, për shkak të natyrës së punës, prodhojnë informacione, relacione, raporte, memo të klasifikuara, që qarkullojnë vetëm brenda institucionit pa u vendosur në objekte postare, pasi protokollohen në NJOPIK, i dërgohen titullarit të institucionit.

11. Institucionet shtetërore mund të qarkullojnë në formë elektronike, brenda njësive të tyre, nëpërmjet sistemeve, rrjeteve informatike, mjeteve dhe pajisjeve të transmetimit, të akredituara përshtatshmërisht, informacionin e klasifikuar. Dokumenti i printuar i ka të gjitha shenjëzimet e informacionit të klasifikuar dhe regjistrohet në regjistrat përkatës. Kopja e parë e këtyre dokumenteve printohet nga prodhuesi dhe merr shenjëzimet më të mundshme të një informacioni të klasifikuar dhe regjistrohet në regjistrat përkatës për të marrë numër protokollit, ndërsa kopja elektronike që qarkullohet nëpërmjet sistemeve, rrjeteve informatike printohet dhe regjistrohet në regjistrat e njësive pritëse, për të marrë numër protokollit.

Neni 17

Veprimet me informacionet e klasifikuara që hyjnë në institucion

1. Objekti postar i klasifikuar (zarfi) që hyn në ministri apo në institucion merret në dorëzim vetëm nga punonjësi i NJOPIK-ut.

2. Punonjësi i NJOPIK-ut në fillim kontrollon objektin postar (zarfin), nëse i ka të gjitha shenjëzimet dhe vulosjet përkatëse, nëse është i dëmtuar apo është mbyllur mirë. Nëse gjithçka është në rregull, nënshkruan marrjen në dorëzim të libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të institucionit dërgues.

3. Punonjësi i NJOPIK-ut në institucionin marrës nuk e merr dhe nuk nënshkruan marrjen në

dorëzim të objektit postar (zarfit) të libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të institucionit dërgues, nëse nuk i ka të gjitha shenjëzimet, nëse shiriti ngjites i sigurisë është dëmtuar apo ka shenja se zarfi mund të mos jetë mbyllur mirë, mund të jetë dëmtuar ose hapur më parë.

4. NJOPIK-u, pas marrjes së objektit postar nga institucioni dërgues, në ambientin e zyrës, hap objektin postar. Para regjistrimit në regjistrin e korrespondencës së informacionit të klasifikuar, verifikon nëse shkresa që përmban ose shoqëron informacionin e klasifikuar brenda objektit postar i ka apo jo të gjitha shenjëzimet e informacionit të klasifikuar, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1, të nenit 11, të kësaj rregulloreje.

5. NJOPIK-u bën regjistrimin e shkresës së klasifikuar te regjistri i korrespondencës së informacionit të klasifikuar në mënyrë kronologjike, duke plotësuar saktë dhe qartë rubrikat e këtij regjistri, ndërsa në anën e djathtë, sipër, të shkresës së klasifikuar, vendos numrin e protokollit hyrës kronologjikisht dhe datën e regjistrimit.

6. Në rast se shkresa që përmban ose shoqëron një informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror” brenda objektit postar (zarfit) nuk i ka të gjitha shenjëzimet e një informacioni të klasifikuar sipas pikës 1, të nenit 11, të kësaj rregulloreje, NJOPIK-u nuk e regjistron në regjistrin e korrespondencës së informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, por, me shkresë përcjellëse, të firmosur prej titullarit të ministrisë/institucionit, ia kthen atë për plotësim institucionit dërgues, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike.

7. NJOPIK-u ia dërgon shkresën e klasifikuar të regjistruar titullarit të institucionit, i cili vendos adresimet dhe shënimet përkatëse mbi shkresën e klasifikuar. Pas këtij veprimi, titullari i institucionit ia dorëzon shkresën e klasifikuar NJOPIK-ut për të bërë shpërndarjen për shfrytëzim të adresuarit.

8. Në rastet kur shkresa e klasifikuar u adresohet njësive të varësisë së ministrisë apo institucionit shtetëror, kopja e shumëfishuar e origjinalit merret në dorëzim nga i adresuari nëpërmjet NJOPIK-ut.

9. Kopja origjinale e informacionit të klasifikuar ardhur nga institucioni dërgues qëndron gjithmonë në NJOPIK të institucionit marrës.

10. Informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror”, i cili shkëmbehet ndërmjet ministrive ose institucioneve nëpërmjet sistemeve, rrjeteve



informative, mjeteve dhe pajisjeve të transmetimit bëhet kur këto të fundit janë të akredituara përshtatshmërisht.

11. Informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror”, i cili merret nga sistemi, rrjeti informatik, mjeti dhe pajisja e transmetimit në formë elektronike me anë të mediave të lëvizshme, si: CD, DVD, USB e të ngjashme me to shoqërohet me një shkresë përcjellëse, në të cilën shënohen të gjitha shenjëzimet e një informacioni të klasifikuar. Niveli i klasifikimit të vendosur në shkresën përcjellëse është i barasvlershëm me nivelin më të lartë të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” që përmban media. Punonjësi i NJOPIK-ut vendos shenjëzimet e klasifikimit në CD, DVD, USB në nivelin më të lartë të informacionit që mbartin.

Neni 18

Shfrytëzimi i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”

1. Shfrytëzimi i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” bëhet me qëllim ushtrimin e një detyre në bazë të parimit “nevojë për njohje”, me miratim të titullarit të institucionit përkatës dhe vetëm nga persona të certifikuar përshtatshmërisht.

2. NJOPIK-u bën shpërndarjen për shfrytëzim të informacionit të klasifikuar tek i adresuari ose të adresuarit nga ana e titullarit të institucionit, të cilët duhet të jenë të certifikuar përshtatshmërisht me librin e qarkullimit të brendshëm të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” kundrejt nënshkrimit të marrësit në dorëzim.

3. Çdo punonjës, para nënshkrimit të marrjes për shfrytëzim të një informacioni të klasifikuar, kontrollon nëse informacioni:

- i është adresuar atij;
- është i padëmtuar;
- është i korrigjuar;
- i ka të gjitha lidhjet dhe, kur është i rregullt, nënshkruan marrjen në dorëzim të libri i qarkullimit të brendshëm të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”.

4. Informacioni mbahet për shfrytëzim deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e marrjes. Me miratimin e titullarit, në rastet kur është e nevojshme për shkak të ushtrimit të detyrës, informacionet e klasifikuara mund të mbahen për shfrytëzim deri në 3 (tre) muaj. Gjatë kësaj kohe, informacioni i klasifikuar pas orarit zyrtar ruhet në kasafortën e

punonjësit, që ndodhet në zyrën e tij. Në rast se nuk ka kasafortë, e dorëzon në NJOPIK.

5. NJOPIK-u informon me shkrim titullarin e institucionit në rastet kur punonjësit tejkalojnë afatin ligjor të shfrytëzimit të informacionit të klasifikuar.

6. NJOPIK-u konfirmon marrjen në dorëzim të informacionit të klasifikuar ose të kopjeve të tij dhënë për shfrytëzim, kundrejt nënshkrimit në librin e qarkullimit të brendshëm të informacionit të klasifikuar, në prezencë të dorëzuesit.

7. Kopja origjinale e informacionit të klasifikuar, të dërguar, të marrë apo që prodhohet e qarkullon brenda institucionit dhe e regjistruar në regjistrin e korrespondencës së informacionit të klasifikuar, mbahet në NJOPIK dhe nuk bëhet pjesë e një praktike, dosjeje, fashikulli.

8. Punonjësit që kanë marrë informacionet e klasifikuara për shfrytëzim kur shkëputen nga puna përkohësisht, për më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë apo emërohen në një detyrë tjetër, bëjnë dorëzimin e tyre të NJOPIK-u.

9. Çdo individ ka për detyrë të mbrojë informacionin e klasifikuar pavarësisht nga mënyra se si ai ka arritur ta posedojë apo ta garantojë të drejtën e njohjes së këtij informacioni të klasifikuar.

10. Në çdo rast, kur një individ i ndërpret marrëdhëniet e punës apo çdo marrëdhënie tjetër kontraktuese, pavarësisht funksionit, është i detyruar të mos ekspozojë përmbajtjen e informacionit të klasifikuar që ai ka njohur gjatë ushtrimit të një detyre apo funksioni apo edhe për shkak të tyre në kuadrin e një institucioni të administratës publike apo operatori ekonomik.

Neni 19

Shumëfishimi i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”

1. Shumëfishimi i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” kryhet vetëm nga NJOPIK-u pas miratimit të titullarit të institucionit dhe në ambientet e zyrës së kësaj njësie. Shumëfishimi kryhet në këto raste:

a) Kur titullari i institucionit e adreson informacionin e klasifikuar te më shumë se një punonjës dhe koha është e pamjaftueshme për shfrytëzim nga të gjithë përdoruesit, ai autorizon punonjësin e NJOPIK-ut të bëjë aq fotokopje sa është e nevojshme, duke bërë regjistrimin përkatës në regjistrin e shumëfishimit të informacionit të



klasifikuar, ndërsa shpërndarjen për shfrytëzim të të adresuarit e kryen me librin e qarkullimit të brendshëm të informacionit të klasifikuar. Në rast se informacioni i klasifikuar i adresohet vetëm një punonjësi, për shfrytëzim jepet informacioni origjinal kundrejt nënshkrimit të marrësit në librin përkatës.

b) Kur informacioni i klasifikuar është i nevojshëm të bëhet pjesë e një praktike, dosjeje, fashikulli, NJOPIK-u, me autorizim të titullarit, bën fotokopje të informacionit origjinal të cilën e regjistron dhe e shpërndan kundrejt nënshkrimit të marrësit në regjistrin e shumëfishimit të informacionit të klasifikuar. Në këtë rast, NJOPIK-u te kolona “vërejtje” e këtij regjistri bën shënimin që fotokopja ndodhet në praktikë, dosje ose fashikull. Marrësi në dorëzim i fotokopjes së informacionit të klasifikuar, pas ezaurimit, dorëzon në NJOPIK me procesverbal praktikën, dosjen ose fashikullin, ku janë vendosur fotokopjet e informacioneve të klasifikuara. E gjithë praktika, dosja, fashikulli, ku vendoset fotokopja e klasifikuar konsiderohet e klasifikuar dhe niveli i klasifikimit të kësaj është i barasvlershëm me nivelin më të lartë të informacionit të klasifikuar që ajo përmban.

2. Një institucion nuk ka të drejtë të zbulojë informacionin origjinal të klasifikuar nga një institucion tjetër pa autorizimin e këtij të fundit.

Neni 20

Digjitalizimi i informacionit të klasifikuar

1. Praktika, e cila përmban kopje origjinale të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” dhe të gjithë dokumentacionin shoqërues, mund t’i nënshtrohet digjitalizimit në rrugë elektronike përmes procesit të skanimit.

2. Ky proces kryhet nga punonjësi i NJOPIK-ut ose punonjësi i autorizuar nga titullari i institucionit.

3. Administrimi i dokumentit të digjitalizuar duhet të kryhet në sisteme të akredituara përshtatshmërisht.

4. Dokumenti i digjitalizuar mund të printohet vetëm me miratim të titullarit të institucionit në NJOPIK, duke ndjekur të gjithë hapat e përcaktuar në këtë rregullore për regjistrimin, qarkullimin dhe administrimin e tij.

Neni 21

Arkivimi i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”

1. Informacioni i klasifikuar qëndron për shfrytëzim në NJOPIK maksimumi deri në 10 (dhjetë) vjet nga koha e krijimit, pavarësisht nga niveli i klasifikimit dhe afati i ruajtjes së këtij klasifikimi. Me miratim të titullarit të institucionit mund të qëndrojë edhe mbi afatin 10-vjeçar (dhjetëvjeçar).

2. Informacion i klasifikuar, gjatë kohës që qëndron për shfrytëzim në NJOPIK, mund të deklasifikohet, të zhvlerësohet, të asgjësohet e të shkatërrohet, sipas procedurave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Pas plotësimit të afatit të qëndrimit, NJOPIK-u inventarizon të gjitha informacionet e klasifikuara dhe i dorëzon ato të përpunuara në arkivin e institucionit me procesverbal.

4. Gjatë kohës që ndodhen në arkivin e institucionit, informacionet e klasifikuara mund të deklasifikohen, zhvlerësohen, asgjësohen e shkatërrohen, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në këtë rregullore.

KREU III

TRANSPORTIMI FIZIK I INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR”

Neni 22

Marrëdhënia ndërmjet institucioneve shtetërore dhe Postës Shqiptare sh.a. për transportimin fizik të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”

1. Institucionet e administratës publike, të cilat administrojnë informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”, mund ta kryejnë vetë transportimin, por duke zbatuar rregullat e transportimit fizik të informacionit të klasifikuar.

2. Institucionet shtetërore, të cilat kanë informacion të klasifikuar, hyjnë në marrëdhënie kontraktore me Postën Shqiptare sh.a., për transportimin e objekteve dhe të pakove postare të klasifikuara “Sekret shtetëror”, si dhe për tarifat e këtij shërbimi.

3. Institucionet e administratës publike mund të hyjnë në marrëdhënie kontraktore edhe me



shërbimet postare të tjera për transportimin e objekteve dhe pakove postare të klasifikuara, por duke zbatuar rregullat e transportimit fizik të informacionit të klasifikuar.

Neni 23

Rregulla të përgjithshme

1. Pranimi, përpunimi, shoqërimi, sigurimi, transportimi dhe dorëzimi i objekteve dhe i pakove postare të klasifikuara “Sekret shtetëror” kryhet nga Posta Shqiptare sh.a., me mjetet dhe personelin e saj, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Institucionet e administratës publike, të cilat prodhojnë informacion të klasifikuar, mund ta kryejnë transportimin fizik të objekteve dhe të pakove postare me mjetet dhe personelin e vet, por duke zbatuar rregullat e transportimit fizik të informacionit të klasifikuar.

3. Transportimi fizik i objekteve dhe i pakove postare të klasifikuara kryhet gjithmonë me dy veta, korrierin dhe shoferin e postës së klasifikuar.

4. Punonjësi i postës së klasifikuar që merret me pranimin, përpunimin, shoqërimin, sigurimin, transportimin dhe dorëzimin e objekteve dhe pakove postare të klasifikuara, të jetë i pajisur më parë me “Certifikatë sigurie personeli” të përshtatshme nga AKSIK-u, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Punonjësi i postës së klasifikuar që merret me pranimin, përpunimin, shoqërimin, sigurimin, transportimin dhe dorëzimin e objekteve postare të klasifikuara, i ndalohet të njihet me përmbajtjen e tyre. Ata duhet të jenë të instruktuar më parë për procedurat e sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe përgjegjësitë, që kanë për përhapjen e paaautorizuar të këtij informacioni.

6. Objektet dhe pakot postare të klasifikuara pranohen, ruhen, përpunohen, sigurohen dhe shpërndahen në ambiente, që plotësojnë kushtet e sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar sipas legjislacionit në fuqi. Objektet dhe pakot postare të klasifikuara mbahen të veçuara nga objektet dhe pakot e tjera postare të paklasifikuara. Në fund të ditës së punës kasafortat, dollapët metalikë, ku mbahen objektet dhe pakot postare të klasifikuara dhe dyert mbyllen në mënyrë të sigurt.

7. Zyra e pranimi, përpunimi dhe dërgimi të objekteve dhe pakove postare të klasifikuara në

Filialin e Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë, dhe në çdo filial poste në qytete duhet të ketë banakë ndarës ose rrjetë metalike për ndarjen e mjedisit të brendshëm nga ai i jashtëm, dyer të blinduara dhe dritare të sigurta. Ndalohet mbajtja e furnelave elektrike, e gazit, e fenerëve ndriçues me lëndë djegëse, si dhe pirja e duhanit në ambientet e këtyre zyrave. Ndriçimi dhe rrjeti elektrik vendosen sipas kërkesave të shërbimit të mbrojtjes ndaj zjarrit. Në këto zyra ndalohet kategorikisht të punojnë persona të pacertifikuar nga AKSIK-u dhe hyrja e personave të paaautorizuar nga eprori direkt ose titullari i institucionit. Veprimet e dorëzimit e të marrjes bëhen në ambientin jashtë banakut. Nga jashtë, dera dhe dritaret e zyrës duhet të jenë nën mbikëqyrjen e kamerave të sigurisë.

8. Në automjetet transportuese të objekteve dhe të pakove postare të klasifikuara ndalohet kategorikisht marrja e personave të tjerë të paaautorizuar. Korrieri i postës së klasifikuar dhe shoferi i automjetit të certifikuar përshtatshëm nga AKSIK-u janë përgjegjës për transportimin dhe sigurimin e objekteve dhe pakove postare të klasifikuara deri tek i adresuari. Kur korrieri i postës së klasifikuar largohet nga automjeti për të dorëzuar apo për të marrë postën e klasifikuar, shoferi qëndron në automjet.

KREU IV

TRANSPORTIMI I OBJEKTEVE POSTARE TË KLASIFIKUARA NDËRMJET INSTITUCIONEVE SHETËTËRORE BRENDA QYTETIT

Neni 24

Transportimi i objekteve postare të klasifikuara nga institucioni shtetëror

1. Transportimi i objekteve postare të klasifikuara ndërmjet institucioneve shtetërore brenda qytetit kryhet me mjetet dhe personelin e çdo institucioni. Ai kryhet nga korrieri dhe shoferi i postës së klasifikuar të institucionit, pasi kanë marrë më parë certifikatën e sigurisë se personelit nga AKSIK-u. Ata caktohen dhe autorizohen nga titullari i institucionit.

2. Korrieri i postës së klasifikuar i institucionit dërgues i merr objektet postare të klasifikuara dhe librin e dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar nga njësia organizative



përgjegjëse për informacionin e klasifikuar (NJOPIK). Pasi sigurohet për rregullshmërinë e tyre dhe saktësinë e regjistrimeve të kryera nga kjo njësi, nënshkruan marrjen në dorëzim të tyre në librin e dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të institucionit dërgues. Korrieri i postës së klasifikuar, së bashku me shoferin e postës së klasifikuar, bën shpërndarjen e objekteve postare në destinacion. Korrieri i postës së klasifikuar i institucionit dërgues i dorëzon objektet postare vetëm te NJOPIK-u të institucioneve marrëse kundrejt nënshkrimit të njësisë organizative përgjegjëse të institucionit marrës në librin e dorëzimit të korrespondencës së klasifikuar të institucionit dërgues.

3. NJOPIK-u i institucionit marrës, në fillim kontrollon objektin postar (zarfin), nëse i ka të gjitha shenjëzimet dhe vulosjet përkatëse, nëse është i dëmtuar apo mbyllur mirë. Nëse gjithçka është në rregull, nënshkruan marrjen në dorëzim të libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të institucionit dërgues.

4. NJOPIK-u në institucionin marrës nuk e merr dhe nuk nënshkruan marrjen në dorëzim të objektit postar (zarfit), nëse nuk i ka të gjitha shenjëzimet dhe vulosjet përkatëse, nëse është e dukshme se mund të jetë hapur më parë, dëmtuar dhe jo e mbyllur mirë.

5. Korrieri i postës së klasifikuar, pas dorëzimit të objektit postar, kthen në NJOPIK librin e dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar.

6. Kur objekti postar i klasifikuar është i madh, duhet të jetë i ambalazhuar me letër të plotë dhe i lidhur me spango kryq. Në vendin e lidhjes, spangoja dylloset e vulozet. Në një vend të dukshëm shënohet numri i protokollit, dërguesi, niveli i klasifikimit dhe adresa e marrësit.

Neni 25

Transportimi i objekteve postare të klasifikuara nga Filiali i Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë, dhe çdo filial poste

1. Transportimi i objekteve postare të klasifikuara ndërmjet institucioneve shtetërore brenda qytetit të Tiranës mund të kryhet edhe me personelin dhe mjetet e Filialit të Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë, kundrejt tarifave të shërbimit. Ai kryhet nga korrieri dhe shoferi i postës së klasifikuar i Filialit të Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., të caktuar dhe autorizuar nga titullari i këtij institucioni, pasi kanë

marrë më parë certifikatën e sigurisë së personelit nga AKSIK-u.

2. Korrieri i postës së klasifikuar i Filialit të Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a. i merr objektet postare të klasifikuara nga NJOPIK-u i institucionit dërgues. Pasi sigurohet për rregullshmërinë e tyre dhe saktësinë e regjistrimeve të kryera nga kjo njësi, nënshkruan marrjen në dorëzim në librin e dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të institucionit dërgues. Korrieri i postës së klasifikuar, së bashku me shoferin e postës së klasifikuar, bën shpërndarjen e objektit postar në destinacion. Korrieri i postës së klasifikuar i Filialit të Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a. e dorëzon objektin postar vetëm në NJOPIK-un e institucionit marrës kundrejt nënshkrimit të punonjësit të NJOPIK-ut në librin e dorëzimit të korrespondencës së klasifikuar të institucionit dërgues.

3. NJOPIK-u i institucionit marrës në fillim kontrollon objektin postar (zarfin), nëse i ka të gjitha shenjëzimet dhe vulosjet përkatëse, nëse është i dëmtuar apo mbyllur mirë. Nëse gjithçka është në rregull, nënshkruan marrjen në dorëzim të libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të institucionit dërgues.

4. NJOPIK-u në institucionin marrës nuk e merr dhe nuk nënshkruan marrjen në dorëzim të objektit postar (zarfit), nëse nuk i ka të gjitha shenjëzimet dhe vulosjet përkatëse, nëse është e dukshme se mund të jetë hapur më parë, dëmtuar dhe jo e mbyllur mirë.

5. Korrieri i postës së klasifikuar i Filialit të Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., pas dorëzimit të objekteve postare, kthen në NJOPIK-un e institucionit dërgues librin e dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar.

6. Kur objekti postar i klasifikuar është i madh, duhet të jetë i ambalazhuar me letër të plotë dhe i lidhur me spango kryq. Në vendin e lidhjes, spangoja dylloset dhe vulozet. Në një vend të dukshëm shënohet numri i protokollit, dërguesi, niveli i klasifikimit dhe adresa e marrësit.

7. Transportimi i objekteve postare të klasifikuara ndërmjet institucioneve shtetërore brenda çdo qyteti mund të kryhet edhe me personelin dhe mjetet e filialit të postës të atij qyteti kundrejt tarifave të shërbimit. Ai kryhet nga korrieri dhe shoferi i postës së klasifikuar i filialit të postës, të caktuar e të autorizuar nga titullari i këtij institucioni dhe duke zbatuar rregullat e lartpërmendura.



KREU V

TRANSPORTIMI I OBJEKTEVE DHE I
PAKOVE POSTARE TË KLASIFIKUARA
“SEKRET SHTETËROR” NGA
INSTITUCIONET SHTETËRORE NË
TIRANË, TEK INSTITUCIONET
SHTETËRORE NË QYTETET E TJERA

Neni 26

**Transportimi i objekteve postare të
klasifikuara “Sekret shtetëror” të
institucioneve shtetërore në Tiranë te Filiali i
Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a.**

1. Institucionet shtetërore në Tiranë, kur kanë objekte postare të klasifikuara për të dërguar në institucionet shtetërore të qyteteve të tjera, njoftojnë Filialin e Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë.

2. Transportimi i objekteve postare të klasifikuara nga institucionet shtetërore në Tiranë te Filiali i Tranzitit kryhet nga personeli dhe automjeti i Filialit të Tranzitit.

3. Titullari i Filialit të Tranzitit cakton dhe autorizon korrierin e postës së klasifikuar dhe shoferin me automjet, të certifikuar nga AKSIK-u, për të marrë objektet postare të klasifikuara nga institucionet shtetërore, në Tiranë.

4. Korrieri i postës së klasifikuar i Filialit të Tranzitit i merr objektet postare të klasifikuara nga NJOPIK-u i institucionit dërgues. Pasi sigurohet për rregullshmërinë e tyre dhe saktësinë e regjistrimeve të kryera nga kjo njësi, nënshkruan marrjen në dorëzim në librin e dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të institucionit dërgues.

5. Korrieri i postës së klasifikuar i Filialit të Tranzitit, i dorëzon objektet postare të klasifikuara te përpunuesi i qendrës së përpunimit në Filialin e Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë, i cili i regjistron në regjistrin e pranimit të objekteve postare të klasifikuara. Pasi sigurohen për saktësinë e regjistrimeve në këtë regjistër, nënshkruajnë përpunuesi si marrës dhe korrieri i postës së klasifikuar si dorëzues.

Neni 27

**Përpunimi i objekteve postare të
klasifikuara “Sekret shtetëror” në Filialin e
Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë**

1. Përpunimi i objekteve postare të klasifikuara të institucioneve shtetërore në Tiranë për në institucionet shtetërore të qyteteve të tjera bëhet në Filialin e Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë.

2. Objektet postare të klasifikuara të marra nga institucionet shtetërore në Tiranë, ndahen nga përpunuesit sipas drejtimeve (qyteteve). Për çdo drejtim (qytet) regjistrohen në listëdërgesën e objekteve postare të klasifikuara. Në të regjistrohen edhe objektet postare të klasifikuara të ardhura nga filialet e postës së qyteteve të tjera dhe të adresuara për t'u dërguar në të njëjtin drejtim (qytet).

3. Të gjitha objektet postare të klasifikuara, sipas listëdërgesës së objekteve postare të klasifikuara dhe që i përkasin një drejtimi (qyteti), ambalazhohen fort me letër të trashë, me kujdes për të mos dëmtuar vulat e dyllit, duke formuar një pako të vetme për çdo vendmbërritje (qytet). Bashkë me objektet postare të klasifikuara, ambalazhohet edhe listëdërgesa e objekteve postare të klasifikuara, e cila firmoset nga komisioni dërgues i Filialit të Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë. Pakoja lidhet me spango dhe në vendin e lidhjes së spangos, si dhe në vendet e palosjes së letrës së ambalazhimit bëhet dylllosja dhe vulosja me vulën metalike të qendrës së përpunimit të Filialit të Tranzitit. Mbi pako, lart në krahun e majtë, shënohet numri i protokollit që ka marrë pakoja postare te regjistri i pranimit dhe i dorëzimit të pakove postare të klasifikuara, ndërsa lart, në krahun e djathtë, niveli më i lartë i klasifikimit të objektit postar në pako. Në mes të pakos shënohet filiali i postës së qytetit ku do të mbërrijë pakoja postare e klasifikuar.

4. Të gjitha pakot postare të klasifikuara regjistrohen nga përpunuesi në regjistrin e pranimit dhe të dorëzimit të pakove postare të klasifikuara të Filialit të Tranzitit dhe në listëdorëzimin e pakove postare të klasifikuara.



Neni 28

**Transportimi i pakove postare të
klasifikuara “Sekret shtetëror” nga Filiali i
Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., në Tiranë,
në filialet e postës së qyteteve**

1. Transportimi i pakove postare të klasifikuara nga Filiali i Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., në filialet e postës së qyteteve kryhet nga korrieri dhe shoferi i postës së klasifikuar i Filialit të Tranzitit. Ata caktohen dhe autorizohen nga titullari i këtij institucioni dhe pajisen me certifikatë sigurie personeli nga AKSIK-u.

2. Korrieri i postës së klasifikuar për drejtimin përkatës i merr në dorëzim pakot postare të klasifikuara në qendrën e përpunimit të Filialit të Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë. Pasi kontrollon gjendjen e ambalazhimit, lidhjet, vulat, shënimet e bëra dhe sigurohet për rregullshmërinë e tyre, nënshkruan si marrës në regjistrin e pranimit dhe dorëzimit të pakove postare të klasifikuara. Listëdorëzimin e pakove postare të klasifikuara e merr me vete gjatë transportimit.

3. Pakot postare të klasifikuara vendosen me kujdes në kasafortën metalike të fiksuara në automjet, çelësat dhe kodet e së cilës i mban korrieri i postës së klasifikuar. Një kopje të çelësave dhe kodin e kasafortës e mban edhe oficeri i sigurisë i Filialit të Tranzitit. Në këtë kasafortë nuk lejohen të futen materiale të tjera. Në rastet kur ka postë voluminoze, e cila nuk mund të futet në kasafortë, pakot postare të klasifikuara mund të transportohen jashtë tyre, kur një gjë e tillë është pranuar zyrtarisht nga dërguesi.

4. Automjetet e Filialit të Tranzitit duhet të jenë në gjendje të mirë teknike dhe të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme për përballimin e rrugëve të gjata, avarive, kushteve të vështira atmosferike.

5. Në raste avarish, aksidentesh, bllokime rrugësh, njoftohet menjëherë Filiali i Tranzitit i cili merr masa të menjëhershme për sigurimin e postës së klasifikuar dhe dërgimin e saj në destinacionin përkatës. Në raste të tilla kërkohet edhe ndihma e strukturave të policisë në qarkun apo qytetin më të afërt, të cilat janë të detyruara të marrin masa për sigurimin dhe mbërritjen e postës së klasifikuar në destinacion.

6. Gjatë transportimit të pakove postare të klasifikuara, korrieri i postës së klasifikuar komunikon në mënyrë të vazhdueshme me Filialin

e Tranzitit për çdo problem që lidhet me transportimin, sigurinë e postës së klasifikuar.

7. Në raste të jashtëzakonshme, posta e klasifikuar mund të transportohet ose të shoqërohet nga forcat e policisë.

8. Pakoja postare e klasifikuar në filialin e postës së qytetit, merret në dorëzim nga përpunuesi i postës së klasifikuar, i caktuar, autorizuar nga titullari i filialit të postës dhe i certifikuar nga AKSIK-u. Para marrjes në dorëzim, verifikohet gjendja e pakos, lidhjet, vulat dhe shënimet mbi të. Kur çdo gjë është në rregull, përpunuesi i filialit nënshkruan si marrës në listëdorëzimin e pakove postare të klasifikuara të Filialit të Tranzitit ndërsa korrieri nënshkruan si dorëzues.

9. Pakoja postare e klasifikuar do të merret në dorëzim edhe në rastet kur konstatohen parregullsi. Në raste të tilla ajo do të merret në dorëzim me procesverbal nga përpunuesi dhe eprori i tij në filialin e postës, ku do të shënohen hollësisht të gjitha konstatimet, në prani të korrierit të postës së klasifikuar të Filialit të Tranzitit. Një kopje e këtij procesverbali i dërgohet Filialit të Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., në Tiranë, nëpërmjet korrierit të postës së klasifikuar të këtij filiali, ndërsa një kopje qëndron në filialin e postës së qytetit.

10. Listëdorëzimi i pakove postare të klasifikuara i firmosur nga marrësit në dorëzim tek çdo filial poste, kthehet nga korrieri i postës së klasifikuar i Filialit të Tranzitit në qendrën e përpunimit të këtij filiali dhe administrohet nga përgjegjësi i qendrës së përpunimit duke e mbajtur në kasafortë apo dollap metalik.

11. Korrieri i postës së klasifikuar i Filialit të Tranzitit, pasi ka dorëzuar pakon postare të klasifikuar në çdo filial poste, merr edhe pakon postare të klasifikuar e adresuar për t'u përpunuar në Filialin e Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë. Pasi kontrollon gjendjen e pakos, lidhjet, vulat, shënimet mbi pako e merr në dorëzim duke nënshkruar si marrës në regjistrin e pranimit dhe dorëzimit të pakove postare të klasifikuara, i cili mbahet në çdo filial poste.

Neni 29

**Përpunimi i pakos postare të klasifikuar
“Sekret shtetëror” në filialin e postës së qytetit**

1. Pakoja postare e klasifikuar hapet në prani të komisionit, i cili përbëhet nga përpunuesi i pakos



postare dhe një punonjës në filialin e postës së qytetit, të caktuar, autorizuar nga titullari i filialit të postës dhe të certifikuar nga AKSIK-u.

2. Në të gjitha rastet kur pakoja postare e klasifikuar merret në dorëzim me procesverbal, pasi hapet pakoja dhe bëhet verifikimi i të gjitha objekteve postare në të, mbahet një procesverbal tjetër. Ky procesverbal mbahet edhe kur të gjitha objektet postare të klasifikuara janë në rregull dhe të pacenuara. Kopja e këtij procesverbali i dërgohet Filialit të Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë.

3. Në bazë të listëdërgesës së objekteve postare të klasifikuara, e cila është brenda në pako, bëhet verifikimi i objekteve. Kur çdo gjë është në rregull, listëdërgesa firmoset nga të dy pjesëtarët e komisionit marrës në filialin e postës së qytetit. Listëdërgesës së objekteve postare të klasifikuara, e nënshkruar, i bëhet një kopje e cila ruhet në filialin e postës së qytetit ndërsa tjetra i kthehet Filialit të Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., në Tiranë, me korrierin e postës së klasifikuar të radhës.

4. Të gjitha objektet postare të klasifikuara regjistrohen nga përpunuesi i filialit të postës në regjistrin e dorëzimit të objekteve postare të klasifikuara dhe në librin e dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar që mbahen në çdo filial poste.

Neni 30

Transportimi i objekteve postare të klasifikuara “Sekret shtetëror” nga filiali i postës tek institucionet shtetërore në qytet

1. Filiali i postës në qytet me mjetin dhe personelin e tij bën transportimin e objekteve postare të klasifikuara tek institucionet shtetërore në qytet.

2. Transportimi i objekteve postare të klasifikuara bëhet nga korrieri i postës së klasifikuar dhe nga shoferi i automjetit, të caktuar, autorizuar nga titullari i filialit të postës së qytetit dhe të certifikuar nga AKSIK-u.

3. Korrieri i postës së klasifikuar merr në dorëzim objektet postare të klasifikuara nga përpunuesi i filialit të postës kundrejt nënshkrimit si marrës në regjistrin e dorëzimit të objekteve postare të klasifikuara.

4. Korrieri i postës së klasifikuar i filialit të postës, me librin e dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar, bën shpërndarjen e

objekteve postare te NJOPIK-u i institucioneve shtetërore në qytet.

5. NJOPIK-u në institucionin marrës në fillim kontrollon objektin postar (zarfin), nëse i ka të gjitha shenjëzimet dhe vulosjet përkatëse, nëse është i dëmtuar apo mbyllur mirë. Nëse gjithçka është në rregull, nënshkruan marrjen në dorëzim të libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të filialit të postës.

6. NJOPIK-u në institucionin marrës nuk e merr dhe nuk nënshkruan marrjen në dorëzim të objektit postar (zarfit) të libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të filialit të postës, nëse nuk i ka të gjitha shenjëzimet dhe vulosjet përkatëse, është e dukshme se mund të jetë hapur më parë, dëmtuar dhe jo e mbyllur mirë.

7. Libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar kthehet te filiali i postës në qytet, pasi të jenë shpërndarë të gjitha objektet postare të klasifikuara.

KREU VI

TRANSPORTIMI I OBJEKTEVE DHE I PAKOVE POSTARE TË KLASIFIKUARA “SEKRET SHTETËROR” NGA INSTITUCIONET SHTETËRORE NË QYTETE, TEK INSTITUCIONET SHTETËRORE NË TIRANË DHE NË QYTETET E TJERA

Neni 31

Transportimi i objekteve postare të klasifikuara “Sekret shtetëror” nga institucionet shtetërore në qytet te filiali i postës së qytetit

1. Institucionet shtetërore, në qytet, njoftojnë filialin e postës së qytetit kur kanë objekte postare të klasifikuara për të dërguar në institucionet shtetërore në Tiranë apo në qytetet e tjera dhe që duhen përpunuar në Filialin e Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., në Tiranë.

2. Transportimi i objekteve postare të klasifikuara nga institucionet shtetërore në qytet te filiali i postës bëhet nga korrieri i postës së klasifikuar dhe shoferi i automjetit, të caktuar, autorizuar nga titullari i filialit të postës së qytetit dhe të certifikuar nga AKSIK-u.

3. Korrieri i postës së klasifikuar i filialit të postës i merr objektet postare të klasifikuara nga NJOPIK-u i institucionit dërgues. Pasi sigurohet për



rregullshmërinë e tyre dhe saktësinë e regjistrimeve të kryera nga kjo njësi, nënshkruan marrjen në dorëzim në librin e dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të institucionit dërgues. Korrieri i postës së klasifikuar nuk i merr në dorëzim dhe nuk nënshkruan, nëse objektet postare të klasifikuara nuk janë sipas standardeve të përcaktuara në këtë rregullore.

4. Korrieri i postës së klasifikuar i filialit të postës i dorëzon objektet postare të klasifikuara te përpunuesi i filialit të postës, i cili i regjistron në regjistrin e pranimit të objekteve postare të klasifikuara. Pasi sigurohen për saktësinë e regjistrimeve në këtë regjister nënshkruajnë përpunuesi si marrës dhe korrieri i postës së klasifikuar si dorëzues.

Neni 32

Përpunimi i objekteve postare të klasifikuara “Sekret shtetëror” në filialin e postës së qytetit

1. Përpunuesi i filialit të postës, të gjitha objektet postare të klasifikuara, i ambalazhon me letër të trashë, me kujdes për të mos dëmtuar vulat e dyllit, duke formuar një pako të vetme. Bashkë me objektet postare të klasifikuara, ambalazhohet edhe listëdërgesa e objekteve postare të klasifikuara, e cili firmoset nga komisioni dërgues një kopje e së cilës i kthehet filialit të postës pas firmosjes nga komisioni marrës në Filialin e Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë.

2. Pakoja lidhet mirë me spango dhe në vendin e lidhjes së spangos, si dhe në vendet e palosjes së letrës së ambalazhimit, bëhet dylllosja dhe vulosja me vulën metalike të filialit të postës së qytetit. Mbi pako, lart në krahun e majtë, shënohet numri i protokollit që ka marrë pakoja postare te regjistri i pranimit dhe i dorëzimit të pakove postare të klasifikuara, ndërsa lart në krahun e djathtë niveli më i lartë i klasifikimit të objektit postar në pako. Në mes të pakos shënohet Filiali i Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë. Listëdërgesa e objekteve postare të klasifikuara ka atë numër që ka marrë pakoja postare.

3. Pakoja postare e klasifikuar regjistrohet te regjistri i pranimit dhe i dorëzimit të pakove postare të klasifikuara i filialit të postës dhe merr numër protokoll. Ajo i dorëzohet korrierit të postës së klasifikuar të Filialit të Tranzitit të Postës Shqiptare

sh.a., Tiranë, kundrejt nënshkrimit të tij në këtë regjister.

Neni 33

Transportimi i pakove postare të klasifikuara “Sekret shtetëror” nga filiali i postës së qytetit në Filialin e Tranzitit të Postës Shqiptare në Tiranë

1. Korrieri i postës së klasifikuar i Filialit të Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë, në kthim, merr pakot postare të klasifikuara në çdo filial poste të qyteteve sipas linjës përkatëse.

2. Pasi kontrollon gjendjen e çdo pakoje postare të klasifikuar, lidhjet, vulat dhe sigurohet për rregullshmërinë e tyre, nënshkruan në regjistrin e pranimit dhe të dorëzimit të pakove postare të klasifikuara që mbahet në çdo filial poste.

3. Korrieri i postës së klasifikuar i dorëzon pakot postare të klasifikuara te punonjësi dispeçer në qendrën e përpunimit të Filialit të Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., sapo të mbërrijë në Tiranë.

4. Marrësi në dorëzim në qendrën e përpunimit, punonjësi dispeçer, regjistron në regjistrin e pranimit dhe të dorëzimit të pakove postare të klasifikuara të gjitha pakot postare të klasifikuara të ardhura nga filialet e postës të qyteteve duke nënshkruar si marrës, ndërsa korrieri si dorëzues. Për çdo parregullsi mbahet procesverbali përkatës në prani korrierit të postës së klasifikuar.

5. Në vijim, përpunuesi i postës së klasifikuar i Filialit të Tranzitit i merr pakot postare të klasifikuara nga punonjësi dispeçer, duke nënshkruar si marrës në regjistrin e pranimit dhe dorëzimit të pakove postare të klasifikuara që mbahet nga dispeçeri.

Neni 34

Përpunimi i pakove postare të klasifikuara “Sekret shtetëror” në Filialin e Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë

1. Pakoja postare e klasifikuar hapet në prani të komisionit, i cili përbëhet nga përpunuesi dhe një punonjës në Filialin e Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë të caktuar, autorizuar nga titullari i këtij institucioni dhe të certifikuar nga AKSIK-u.

2. Në bazë të listëdërgesës së objekteve postare të klasifikuara, e cila është brenda në pako, bëhet verifikimi i objekteve. Kur çdo gjë është në rregull,



listëdërgesa firmoset nga të dy anëtarët e komisionit marrës. Listëdërgesës së objekteve postare të klasifikuara, e nënshkruar, i bëhet një kopje e cila ruhet në Filialin e Tranzitit, ndërsa tjetra i kthehet filialit të postës në qytetin përkatës me korrierin e postës së klasifikuar të radhës.

3. Të gjitha objektet postare të klasifikuara regjistrohen te regjistri i pranimi i objekteve postare të klasifikuara.

4. Objektet postare të klasifikuara për t'u shpërndarë në institucionet shtetërore në Tiranë, regjistrohen te regjistri i dorëzimit të objekteve postare të klasifikuara dhe te libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar që mbahen në Filialin e Tranzitit.

5. Objektet postare të klasifikuara të adresuara për në institucionet shtetërore të qyteteve të tjera, ambalazhohen sipas drejtimit përkatës së bashku me objektet postare të marra nga institucionet shtetërore në Tiranë dhe që i përkasin të njëjtit drejtim. Bashkë me objektet postare të klasifikuara ambalazhohet edhe listëdërgesa e objekteve postare të klasifikuara.

Neni 35

Transportimi i objekteve postare “Sekret shtetëror” nga Filiali i Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., tek institucionet shtetërore në Tiranë

1. Filiali i Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë, me mjetin dhe personelin e tij, bën transportimin e objekteve postare të klasifikuara tek institucionet shtetërore në Tiranë.

2. Transportimi i objekteve postare të klasifikuara bëhet nga korrieri i postës së klasifikuar, dhe nga shoferi i automjetit, të caktuar, autorizuar nga titullari i Filialit të Tranzitit dhe të certifikuar nga AKSIK-u.

3. Korrieri i postës së klasifikuar, merr në dorëzim objektet postare të klasifikuara kundrejt nënshkrimit në regjistrin e dorëzimit të objekteve postare të klasifikuara, si dhe në bazë të libër dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar ku janë regjistruar. Ai i dorëzon objektet postare të klasifikuara te NJOPIK-u i institucionit shtetëror në Tiranë, ku ata janë adresuar. NJOPIK-u i institucionit marrës kontrollon çdo objekt postar të klasifikuar dhe pasi sigurohet për rregullshmërinë tyre, nënshkruan në librin e dorëzimit të

korrespondencës së informacionit të klasifikuar të Filialit të Tranzitit si marrës.

4. Pasi janë shpërndarë të gjitha objektet postare të klasifikuara, libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar kthehet te Filiali i Tranzitit.

KREU VII

REGJISTRAT, LIBRAT DHE DOKUMENTET KRYESORE, QË MBAHEN NË FILIALIN E TRANZITIT TË POSTËS, TIRANË, DHE NË FILIALET E POSTËS SË QYTETEVE, SISTEMIMI DHE AFATI I RUAJTJES SË TYRE

Neni 36

Regjistrat, librat dhe dokumentet që mbahen në Postë

1. Regjistrat, librat dhe dokumentet kryesore që mbahen në Filialin e Tranzitit të Postës Shqiptare sh.a., Tiranë, dhe në filialet e postës së qyteteve janë:

a) regjistri i regjistrimit të regjistrave për transportimin e informacionit të klasifikuar;

b) regjistri i pranimi të objekteve postare të klasifikuara;

c) regjistri i dorëzimit të objekteve postare të klasifikuara;

ç) regjistri i pranimi dhe i dorëzimit të pakove postare të klasifikuara;

d) libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar;

dh) listëdërgesat e objekteve postare të klasifikuara;

e) listëdorëzimet e pakove postare të klasifikuara;

ë) procesverbalet ose kopjet e tyre, të mbajtura për parregullësitë e konstatuara gjatë gjithë fazave të transportimit fizik të informacionit të klasifikuar;

f) kopjet e autorizimeve të punonjësve që merren me pranimin, përpunimin, shoqërimin, sigurimin, transportimin dhe dorëzimin e objekteve dhe pakove postare të klasifikuara;

g) kopjet e certifikatave të sigurisë së personelit të dhënë nga AKSIK për punonjësit që merren me pranimin, përpunimin, shoqërimin, sigurimin, transportimin dhe dorëzimin e objekteve dhe pakove postare të klasifikuara.

gj) regjistri i tarifimit të objekteve dhe pakove postare të klasifikuara.



2. Modelet dhe regjistrat për transportimin fizik të informacionit të klasifikuar përcaktohen në udhëzimin zbatues të kësaj marrëveshjeje, që miratohet nga AKSIK-u.

Neni 37

Sistemimi i dokumentacionit dhe afati i ruajtjes së tyre

1. Regjistri i pranimit dhe i dorëzimit të pakove postare të klasifikuara hapet në fillim të çdo viti dhe mbyllet më 31 dhjetor të po atij viti.

2. Regjistri i regjistrimit të regjistrave për transportimin e informacionit të klasifikuar, regjistri i pranimit të objekteve postare të klasifikuara, regjistri i dorëzimit të objekteve postare të klasifikuara dhe libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar mbahen deri sa të plotësohen.

3. Listëdërgesat e objekteve postare të klasifikuara dhe listëdorëzimet e pakove postare të klasifikuara sistemohen çdo muaj dhe në fund të vitit mbyllet.

4. Procesverbalet ose kopjet e tyre sistemohen çdo muaj dhe mbahen në një dosje të veçantë.

5. Kopjet e autorizimeve dhe kopjet e certifikatave të sigurisë të dhënë nga AKSIK për punonjësit që merren me pranimin, përpunimin, shoqërimin, sigurimin, transportimin dhe dorëzimin e objekteve dhe pakove postare të klasifikuara, ruhen në dosje të veçanta.

6. Dokumentacioni i krijuar gjatë gjithë fazave të transportimit fizik të informacionit të klasifikuar ruhet në një kasafortë apo dollap metalik të sigurt në çdo filial poste.

7. Dokumentacioni i krijuar gjatë marrjes, përpunimit, transportimit, sigurimit, shoqërimit, dorëzimit të objekteve dhe pakove postare të klasifikuara, ruhet në çdo filial poste për 10 vjet nga koha e krijimit. Pas këtij afati asgjësohen me procesverbal nga një komision prej tre anëtarësh i ngritur nga titullari i çdo filiali poste. Procesverbali i asgjësimit ka afat ruajtjeje 10 vjet nga koha e përpilimit.

KREU VIII

TRANSPORTIMI I OBJEKTEVE DHE I PAKOVE POSTARE TË KLASIFIKUARA NGA INSTITUCIONET SHETËTËRORE NË TIRANË, TE STRUKTURAT PËRKATËSE JASHTË SHETËTIT DHE ANASJELLTAS

Neni 38

Transportimi fizik i objekteve dhe pakove postare të klasifikuara “Sekret shtetëror” nga institucionet shtetërore në Tiranë te strukturat përkatëse jashtë shtetit

1. Transportimi i objekteve dhe pakove postare të klasifikuara “Sekret shtetëror” nga institucionet shtetërore në Tiranë për në strukturat shtetërore jashtë vendit, bëhet nga 2 (dy) korrierë diplomatikë të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ).

2. Në MEPJ ngrihet zyra e korrierit diplomatik, e cila duhet të plotësojë kushtet për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar. Kjo zyrë duhet të ketë banakë ndarës ose rrjete metalike për ndarjen e mjedisit të brendshëm nga ai i jashtëm, dyer të blinduara dhe dritare të sigurta. Ndalohet mbajtja e furnelave elektrike, gazit, fenerëve ndriçues me lëndë djegëse, si dhe pirja e duhanit në ambientet e kësaj zyre. Ndriçimi dhe rrjeti elektrik vendosen sipas kërkesave të shërbimit të mbrojtjes ndaj zjarrit. Në këtë zyrë ndalohet kategorikisht të punojnë persona të pacertifikuar nga AKSIK-u dhe hyrja e personave të paautorizuar nga drejtuesi i direkt ose titullari i institucionit. Veprimet e dorëzimit e të marrjes bëhen në ambientin jashtë banakut. Nga jashtë dera dhe dritaret e zyrës duhet të jenë nën mbikëqyrjen e kamerave të sigurisë.

3. Korrierët diplomatikë të MEPJ-së, më parë pajisen me të gjitha dokumentet e nevojshme të korrierit diplomatik, si dhe me “certifikatë sigurie personeli”, të përshtatshme nga AKSIK-u, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Korrierët diplomatikë mbajnë librin e dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar, i cili regjistrohet te regjistri i regjistrave të informacionit të klasifikuar në MEPJ.

5. Korrierët diplomatike janë përgjegjës për mbajtjen, ruajtjen, sigurinë dhe transportimin e objekteve dhe pakove postare të klasifikuara, deri në destinacionin përkatës.



6. Çdo institucion shtetëror, me mjetin dhe personelin e vet dhe sipas rregullave të caktuara për transportimin fizik të informacionit të klasifikuar, dërgon dhe dorëzon objektet dhe pakot postare të klasifikuara të adresuara për jashtë shtetit, te korrieri diplomatik i MEPJ-së.

7. Objektet dhe pakot postare të klasifikuara të adresuara për jashtë shtetit pas ambalazhimit sipas rregullave përkatëse dyllosen, vulosen me vulën e MEPJ-së.

8. Korrieri diplomatik, para marrjes në dorëzim, kontrollon çdo objekt dhe pako postare të klasifikuar dhe pasi sigurohet se çdo gjë është në rregull, nënshkruan në librin e dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të institucionit dërgues. Objektet dhe pakot postare të klasifikuara transportohen jashtë shtetit duke i siguruar (ruajtur) në valixhen diplomatike. Të gjitha objektet dhe pakot postare të klasifikuara regjistrohen te libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të korrierit diplomatik, i cili mbahet në valixhen diplomatike së bashku me objektet dhe pakot postare të klasifikuara.

9. Korrierët diplomatikë i dorëzojnë objektet dhe pakot postare të klasifikuara në NJOPIK e institucionit marrës jashtë shtetit. NJOPIK para marrjes në dorëzim kontrollon çdo objekt dhe pako postare të klasifikuar dhe në rast se çdo gjë është në rregull, nënshkruan marrjen në dorëzim të tyre te libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të korrierit diplomatik. Në rast se në objektet dhe pakot postare të klasifikuara vërehen mungesa apo pasaktësi, NJOPIK-u ia kthen institucionit dërgues nëpërmjet korrierit diplomatik.

Neni 39

Transportimi fizik i objekteve dhe pakove postare të klasifikuara nga strukturat përkatëse jashtë shtetit tek institucionet shtetërore në Tiranë

1. Korrieri diplomatik në kthim merr edhe objektet dhe pakot postare të klasifikuara që kanë institucionet përkatëse jashtë shtetit për në institucionet shtetërore në Tiranë, duke i regjistruar te libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar. Korrieri diplomatik, para marrjes në dorëzim, kontrollon çdo objekt dhe pako postare të klasifikuar dhe pasi sigurohet se çdo

gjë është në rregull, nënshkruan si marrës te libri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të institucionit dërgues.

2. Korrieri diplomatik i dorëzon objektet dhe pakot postare të klasifikuara në NJOPIK e institucioneve ku janë adresuar, kundrejt nënshkrimit të marrësit në librin e dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të korrierit diplomatik.

3. Korrieri diplomatik, pasi ka përfunduar dorëzimin e objekteve dhe pakove të klasifikuara te NJOPIK-u i institucioneve marrëse, valixhen diplomatike së bashku me librin e dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar, e siguron në zyrën e tij, në një kasafortë apo dollap metalik të sigurt.

4. Ndalohet dërgimi i materialeve dhe sendeve personale, gjatë transportimit ndërkombëtar të objekteve dhe pakove postare të klasifikuara nga institucionet shtetërore në Tiranë, te strukturat përkatëse jashtë shtetit dhe anasjelltas.

KREU IX

DEKLASIFIKIMI DHE ZHVLERËSIMI I INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR”

Neni 40

Kriteret për deklasifikim

1. Deklasifikimi i informacionit të klasifikuar është në dy lloje:

a) “Deklasifikim i plotë”, procesi i ndryshimit të autorizuar të statusit të një informacioni të klasifikuar “Sekret shtetëror” në një informacion të paklasifikuar;

b) “Deklasifikim i pjesshëm”, procesi i ndryshimit të autorizuar të statusit të një pjese të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” në informacion të paklasifikuar.

2. Informacioni mund të deklasifikohet:

a) me ndodhinë e një ngjarjeje apo të një date të veçantë, siç përcaktohet nga autoriteti i klasifikimit të informacionit;

b) me përfundimin e afatit kohor për klasifikim;

c) kur publikimi i tij diktohet nga interesa më të rëndësishme shtetërore, sesa nevoja për ta mbajtur atë të klasifikuar;



ç) me kërkesë të gjykatës, kur informacioni i klasifikuar është sekuestruar nga organi procedues në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

3. Informacioni i klasifikuar nuk deklasifikohet si rezultat i ekspozimit të paautorizuar të një informacioni identik apo të ngjashëm.

Neni 41 **Zhvlerësimi**

Kur informacioni i klasifikuar humbet disa vlera fillestare, ai mund të zhvlerësohet duke u klasifikuar e ruajtur në një nivel më të ulët.

Neni 42 **Kërkesa për deklasifikim dhe për zhvlerësim**

Kërkesa për deklasifikimin dhe për zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” i drejtohet KDZH-së dhe mund të paraqitet nga:

- a) fondkrijuesi;
- b) fondruajtësi;
- c) çdo punonjës apo strukturë e interesuar brenda ministrisë apo institucionit;
- ç) çdo person fizik apo juridik.

Neni 43 **Rishikimi sistematik për deklasifikim**

1. Informacioni i përjashtuar nga deklasifikimi i nënshtrohet rishikimit sistematik të deklasifikimit.

2. Çdo institucion, që zotëron informacion origjinal të klasifikuar, harton dhe zbaton një program për rishikimin sistematik të deklasifikimit për dokumente me vlera historike kombëtare, të përjashtuara nga deklasifikimi.

Neni 44 **Komisioni i deklasifikimit dhe i zhvlerësimit**

1. Në çdo ministri apo institucion shtetëror që administron informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”, krijohet komisioni i deklasifikimit dhe i zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar (në vijim “KDZH”).

2. KDZH-ja krijohet me urdhër të titullarit të ministrisë apo të institucionit, i cili është autoritet klasifikues.

3. Numri i anëtarëve të KDZH-së duhet të jetë gjithmonë numër tek.

4. Anëtarët e KDZH-së duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie personeli të përshtatshme.

Neni 45 **Përbërja e KDZH-së**

1. Kryetar i KDZH-së caktohet një nga anëtarët e komisionit me urdhër të “Autoritetit Klasifikues”.

2. Nënkyetar i KDZH-së caktohet drejtues i një njësie strukturore të ministrisë apo institucionit shtetëror.

3. Sekretar i KDZH-së caktohet fondruajtësi i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”.

4. Urdhri për krijimin e KDZH-së përmban funksionet sipas emërtesës.

Neni 46 **Vendimarrja**

1. KDZH-ja i propozon Autoritetit Klasifikues për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të prodhuar nga vetë ministria apo institucioni. Përjashtimisht nga ky rregull është Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, e cila administron dokumentet e klasifikuara “Sekret shtetëror” përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””.

2. KDZH-ja nuk mund të deklasifikojë informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, të ardhur nga një ministri apo institucion tjetër shtetëror, pa marrë miratimin me shkrim nga “autoriteti klasifikues” nga vjen informacioni.

3. Në rast se institucioni i origjinës shprehet kundër deklasifikimit të tij, KDZH-ja nuk duhet ta deklasifikojë dhe/ose zhvlerësojë informacionin e ardhur nga një institucion tjetër.

4. KDZH-ja mbledhet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve dhe merr vendim me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

5. Çdo anëtar i KDZH-së ka të drejtën e votës pro ose kundër.

6. Anëtar, i cili voton kundër duhet të paraqesë me shkrim arsyet e votimit kundër.

7. Në përfundim të shqyrtimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të relatuar për deklasifikim, KDZH-ja i propozon titullarit, për:



a) deklasifikimin e plotë ose deklasifikimin e pjesshëm të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”;

b) përjashtimin nga deklasifikimi të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”;

c) zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, duke përcaktuar edhe afatin e ri të ruajtjes së klasifikimit.

8. Informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror”, i përjashtuar nga deklasifikimi, i nënshtrohet rishikimit sistematik për deklasifikim.

Neni 47

Relacioni për deklasifikim dhe zhvlerësim

1. Sekretari i KDZH-së studion informacionet e klasifikuara “Sekret shtetëror”, që ndodhen në NJOPIK, kartotekat, arkivat e ministrive / institucioneve shtetërore ose Arkivin Qendror Shtetëror dhe, nëpërmjet një relacioni, i propozon KDZH-së për deklasifikim ose zhvlerësim ato informacione që sipas kritereve të ligjit për informacionin e klasifikuar duhet të deklasifikohen ose të zhvlerësohen.

2. Në relacion për secilin informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror” pasqyrohet fondi, struktura shtetërore që e ka prodhuar, emërtimi / lënda, numri i protokollit, data, viti, niveli i klasifikimit, përmbajtja e shkurtër dhe baza ligjore e propozimit për deklasifikim ose zhvlerësim.

3. Në rastin kur një ministri apo institucion shtetëror ka më shumë se një fondruajtës, secili prej tyre përgatit relacionin për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” që ka në administrim dhe ia paraqet KDZH-së.

Neni 48

Shqyrtimi i informacionit të klasifikuar që nuk i përket institucionit

1. Gjatë procesit të marrjes në shqyrtim për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” që nuk i përket ministrisë apo institucionit, KDZH-ja vepron, si më poshtë vijon:

a) Kur ekziston ministria/institucioni prodhues i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, ftohet të marrë pjesë në mbledhje një përfaqësues i tij.

b) Kur ministria/institucioni prodhues i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” nuk

ekziston, ftohet të marrë pjesë në mbledhje një përfaqësues i ministrisë/institucionit që ka në fushën e përgjegjësisë veprimtarinë e institucionit të origjinës.

c) Kur nuk ekziston ministria/institucioni prodhues i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” dhe veprimtaria apo dokumentacioni i tij nuk i kanë kaluar asnjë institucioni tjetër shtetëror, ftohet të marrë pjesë një përfaqësues i një institucioni, fusha e veprimtarisë e të cilit është e ngjashme me fushën e veprimtarisë së fondkrijuesit.

Neni 49

Vendimi për deklasifikim dhe për zhvlerësim

1. Në vendimin e KDZH-së për deklasifikim dhe për zhvlerësim për secilin informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror” pasqyrohet fondi, struktura shtetërore, që e ka prodhuar, emërtimi/lënda, numri i protokollit, data, viti, niveli i klasifikimit, përmbajtja e shkurtër dhe baza ligjore për deklasifikimin, zhvlerësimin ose përjashtimin nga deklasifikimi.

2. Vendimi hartohet nga sekretari i KDZH-së dhe firmoset nga të gjithë anëtarët e pranishëm.

3. Vendimi merret më shumicë të thjeshtë votash dhe është i vlefshëm kur kanë votuar me shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm.

Neni 50

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar

1. Pas marrjes së vendimit nga KDZH-ja, sekretari i komisionit harton bibliografinë e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të deklasifikuar plotësisht ose pjesërisht. Në bibliografi, për secilin informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”, pasqyrohet fondi, struktura shtetërore që e ka prodhuar, emërtimi/lënda, numri i protokollit, data dhe niveli i klasifikimit.

2. Çdo institucion i administratës publike ka detyrimin të publikojë bibliografinë e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të deklasifikuar plotësisht apo pjesërisht, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e vendimit të KDZH-së.

3. Publikimi bëhet në Fletoren Zyrtare, në faqen zyrtare të internetit të ministrisë apo të institucionit dhe me mënyra të tjera të përshtatshme.

4. Një kopje e bibliografisë i dërgohet zyrtarisht AKSIK.



Neni 51

Deklasifikimi i plotë i një informacioni

1. Mbi çdo informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të deklasifikuar plotësisht, në kreun e tij vendoset vula me shënimin: “Deklasifikuar plotësisht me vendim nr. __, datë __. __. __ të KDZH-së”.

2. Informacioni i deklasifikuar plotësisht trajtohet si informacion i pa klasifikuar.

Neni 52

Deklasifikimi i pjesshëm i një informacioni

Për të bërë deklasifikimin e pjesshëm të një informacioni të klasifikuar “Sekret shtetëror”, veprohet në këtë mënyrë:

a) Fotokopjohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror”. Në fotokopje, me metoda profesionale, bëhen të palexueshëm paragrafët, pjesët, të cilat nuk janë deklasifikuar. Pas këtij veprimi, fotokopja trajtohet si informacion i paklasifikuar.

b) Në krye të fotokopjes vendoset shenjëzimi: “Deklasifikuar me vendim të KDZH nr. __, datë __. __. __”.

c) Në kreun e origjinalit vendoset shenjëzimi: “Deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. __, datë __. __. __”. Informacioni i deklasifikuar pjesërisht do të trajtohet si informacion i klasifikuar.

Neni 53

Deklasifikimi i plotë në median elektronike

Deklasifikimi i plotë në median elektronike bëhet në këtë mënyrë:

Në rastin kur deklasifikohen plotësisht i gjithë informacioni apo të gjitha informacionet e klasifikuara “Sekret shtetëror”, që ruhen në median elektronike, mbi shkresën shoqëruese dhe media vendoset shenjëzimi: “Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. __, datë __. __. __”. Informacioni ose informacionet në këtë media do të trajtohen si informacione të paklasifikuara.

Neni 54

Deklasifikimi i pjesshëm në median elektronike

Deklasifikimi i pjesshëm i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, i ruajtur në median elektronike, bëhet në këtë mënyrë:

a) Krijohet një kopje e medias elektronike, e cila përmban vetëm informacione të deklasifikuara, të shkëputura nga media elektronike origjinale. Në shkresën shoqëruese dhe media vendoset shenjëzimi: “Deklasifikuar me vendim të KDZH-së nr. __, datë __. __. __”. Kopja e medias elektronike do të trajtohet si informacion i paklasifikuar.

b) Në shkresën shoqëruese dhe në media origjinale, e cila përmban edhe informacione të klasifikuara dhe të paklasifikuara, vendoset shenjëzimi: “Deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. __, datë __. __. __”. Originali i medias elektronike do të trajtohet si informacion i klasifikuar.

Neni 55

Zhvlerësimi

Në rastet kur informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” zhvlerësohet mbi informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, në kreun e tij vendoset vula me shënimin: “Zhvlerësuar nga niveli i klasifikimit ... në nivel klasifikimi ... me afat ruajtjeje të mëtejshme ... me vendim të KDZH-së nr. __, datë __. __. __”.

Neni 56

Administrimi i informacionit të deklasifikuar dhe zhvlerësuar

Kur deklasifikohet një informacion i ardhur nga një institucion tjetër, njoftimi i institucionit të origjinës bëhet nga përfaqësuesi i tij në KDZH.

Neni 57

Zbatimi i vendimit

1. Pas marrjes së vendimit për deklasifikimin e plotë apo të pjesshëm të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, punonjësi i njësisë organizative përgjegjëse për informacionin e klasifikuar dhe



sekretarja e komisionit merr masat për zbatimin e vendimit.

2. Në rastet e deklasifikimit të pjesshëm të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, sekretarja e komisionit dhe punonjësi i NJOPIK-ut merr masat që pjesa e mbetur e klasifikuar të mbrohet me mënyra e metoda profesionale, të tilla që e bëjnë të pamundur ekspozimin e plotë apo të pjesshëm të tij.

3. Deklasifikimi i plotë apo i pjesshëm i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” pasqyrohet në të gjitha format e ruajtjes dhe administrimit të tij.

KREU X ASGJËSIMI DHE SHKATËRRIMI I INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR”

Neni 58

Urdhri për kategoritë dhe llojet e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” që u nënshtrohen procedurave të asgjësimit

1. Titullarët e ministrive dhe të institucioneve shtetërore që prodhojnë dhe administrojnë informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, nxjerrin urdhrin për kategoritë dhe llojet e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” që u nënshtrohen procedurave të asgjësimit në institucionin e tyre, përfshirë edhe strukturat e varësisë, një kopje e të cilit i dërgohet AKSIK, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga miratimi i tij. Urdhri dërgohet edhe në strukturat e varësisë që prodhojnë dhe administrojnë informacione të klasifikuara.

2. Në këtë urdhër përfshihen llojet dhe kategoritë e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror”, të cilat, për shkak të humbjes së vlerave për ruajtje të mëtejshme dhe që nuk është e nevojshme të deklasifikohen, u nënshtrohen procedurave për asgjësim, pavarësisht nëse u ka mbaruar apo jo afati i ruajtjes së klasifikimit të tyre.

Neni 59

Urdhri për asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”

1. Titullarët e ministrive dhe të institucioneve shtetërore që prodhojnë dhe administrojnë informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror” nxjerrin urdhrin lidhur me kriteret dhe procedurat për asgjësimin dhe shkatërrimin e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror”, përfshirë edhe strukturat në varësi të tyre.

2. Në këtë urdhër përcaktohen procedurat që ndjekin komisionet e shqyrtimit për asgjësim të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” dhe komisionet e shkatërrimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, mënyra e kalimit (dorëzimit) të informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror”, për të cilat është vendosur asgjësimi nga komisioni i asgjësimit të komisioni i shkatërrimit fizik të tyre, në cilat zona sigurie do të shkatërrohen, vendi, si do të transportohen informacionet për të vendi shkatërrimit dhe mënyra e shkatërrimit.

3. Titullarët e ministrive dhe të institucioneve shtetërore brenda 45 ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij vendimi duhet të nxjerrin urdhrin për asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, një kopje e të cilit i dërgohet AKSIK, brenda 15 ditëve kalendarike nga miratimi i tij. Urdhri i dërgohet edhe në strukturat e varësisë që prodhojnë dhe administrojnë informacione të klasifikuara.

Neni 60

Komisioni i shqyrtimit për asgjësim të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”

1. Në çdo ministri apo institucion shtetëror që prodhon dhe administron informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror” krijohet dhe funksionon komisioni i shqyrtimit për asgjësim të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”. Titullari i ministrisë apo i institucionit shtetëror në rast nevojë autorizon drejtuesit e strukturave në varësi për ngritjen e këtij komisioni në strukturat e tyre.

2. Komisioni i shqyrtimit për asgjësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” krijohet me urdhër të titullarit të institucionit ose të autorizuari prej tij dhe përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë dhe gjithmonë numër tek. Kryetari i komisionit është titullari i institucionit ose i



autorizuari prej tij që ka në zotërim informacionin e klasifikuar. Anëtarët e komisionit duhet të jenë të pajisur me “Certifikatë sigurie personeli” të përshtatshme. Vendimet në komision merren me shumicë të thjeshtë.

3. Çdo komision në ministri, institucion shtetëror apo në strukturat në varësi të tyre, shqyrton dhe i propozon titullarit për asgjësimin ose jo të informacionit të klasifikuar përkatës, vetëm duke u bazuar tek urdhri i titullarit të ministrisë apo institucionit për kategoritë dhe llojet e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” që u nënshtrohen procedurave të asgjësimit.

Neni 61

Relacioni për asgjësim

1. Çdo strukturë e interesuar në ministri apo institucion shtetëror dhe në strukturat në varësi të tyre, ka të drejtë të propozojë për asgjësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, vetëm duke u bazuar tek urdhri i titullarit të ministrisë apo institucionit shtetëror për kategoritë dhe llojet e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, që u nënshtrohen procedurave të asgjësimit.

2. Struktura e interesuar për asgjësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” përgatit një relacion me shkrim për kryetarin përkatës të komisionit të shqyrtimit për asgjësim të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”. Në relacion për çdo informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror” të propozuar për asgjësim përshkruhet emërtimi i informacionit, numri i protokollit dhe data, niveli i klasifikimit, numri i kopjeve (nëse ka) sasia e fletëve për çdo kopje, përmbajtja e shkurtër dhe baza ligjore e propozimit për asgjësim. Relacioni merr nivelin më të lartë të klasifikimit të informacionit që është propozuar për asgjësim.

Neni 62

Vendimi për asgjësim

1. Komisioni i shqyrtimit për asgjësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” merr në shqyrtim relacionin e përgatitur nga struktura e interesuar përkatëse, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e protokollimit të relacionit.

2. Komisioni i shqyrtimit për asgjësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, pasi analizon çdo informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror” të propozuar në relacion për asgjësim, i propozon titullarit vendimin përkatës për asgjësim ose jo. Për çdo informacion të klasifikuar për të cilin komisioni vendosi asgjësimin apo jo asgjësimin, në vendim përshkruhet emërtimi i informacionit, numri i protokollit dhe data, niveli i klasifikimit, numri i kopjeve (nëse ka) sasia e fletëve për çdo kopje, përmbajtja e shkurtër dhe baza ligjore për asgjësim.

3. Kur komisioni i propozon titullarit për mosasgjësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, ai i nënshtrohet rishikimit sistematik, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim. Vendimi merr nivelin më të lartë të klasifikimit të informacionit që është vendosur të asgjësohet ose jo.

Neni 63

Komisioni i shkatërrimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”

1. Në çdo ministri apo institucion shtetëror që prodhon dhe administron informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror” krijohet dhe funksionon komisioni i shkatërrimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”. Titullari i ministrisë apo i institucionit shtetëror në rast nevojë autorizon drejtuesit e strukturave në varësi për ngritjen e këtij komisioni në strukturat e tyre.

2. Komisioni i shkatërrimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” krijohet me urdhër të titullarit të institucionit ose të autorizuari prej tij dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë. Kryetari i komisionit caktohet nga titullari i institucionit ose nga i autorizuari prej tij, që ka në zotërim informacionin e klasifikuar. Anëtarët e komisionit duhet të jenë të pajisur me “Certifikatë sigurie personeli” të përshtatshme.

Neni 64

Marrja në dorëzim dhe shkatërrimi i informacionit të klasifikuar

1. Komisioni i shkatërrimit, bazuar në vendimin përkatës për asgjësim, merr në dorëzim nga sekretarja (fondruajtësi) e komisionit të shqyrtimit për asgjësim të informacionit të klasifikuar, të gjitha informacionet e klasifikuara për të cilat komisioni



përkatës i shqyrtimit për asgjësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, ka vendosur që të asgjësohen. Komisioni i shkatërrimit para marrjes në dorëzim bën edhe verifikimet përkatëse të informacioneve.

2. Çdo komision shkatërrimi në ministri, institucion shtetëror apo në strukturat në varësi të tyre, duke u bazuar në udhëzimin e titullarit të ministrisë apo të institucionit shtetëror për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, bën shkatërrimin fizik të informacioneve të klasifikuara. Komisioni i shkatërrimit, me mënyra dhe mjete që nuk lejojnë rindërtimin e plotë apo të pjesshëm të tij, bën shkatërrimin fizik vetëm të atyre informacioneve të klasifikuara për të cilat komisioni përkatës i shqyrtimit për asgjësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, ka vendosur që të asgjësohen.

3. Shkatërrimi i informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” kryhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga koha e marrjes së vendimit për asgjësimin e tyre.

Neni 65

Procesverbali i shkatërrimit

1. Komisioni i shkatërrimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, pasi ka shkatërruar fizikisht çdo informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”, për të cilin është vendosur asgjësimi i tij, harton procesverbalin përkatës të shkatërrimit.

2. Në procesverbalin e shkatërrimit përshkruhen:

a) emërtimi, numri i protokollit, data, niveli i klasifikimit të vendimit përkatës për asgjësim;

b) vendi i shkatërrimit dhe në cilën zonë sigurie;

c) mënyra dhe mjetet e transportit të përdorura për transportimin fizik të informacioneve të klasifikuara në vendin e shkatërrimit;

ç) mënyra dhe mjetet e përdorura për shkatërrim;

d) për çdo informacion të shkatërruar përshkruhet emërtimi i informacionit, numri i protokollit dhe data, niveli i klasifikimit, numri i kopjeve (nëse ka) dhe sasia e fletëve për çdo kopje.

dh) emri, mbiemri dhe nënshkrimi i çdo anëtar i komisionit të shkatërrimit.

3. Procesverbali i shkatërrimit merr nivelin me të lartë të klasifikimit të informacionit të shkatërruar.

Neni 66

Zbatimi i vendimit për asgjësim

Asgjësimi i informacionit të klasifikuar kombëtar për personat fizikë, juridikë, privatë apo publikë bëhet i plotë, përfshirë edhe të gjitha bazat e të dhënave që disponon institucioni (fizike apo elektronike), ku figurojnë të regjistruar.

Neni 67

Afati i ruajtjes së relacionit për asgjësim, vendimit për asgjësim dhe procesverbalit të asgjësimit

1. Relacioni për asgjësim, vendimi për asgjësim dhe procesverbali për asgjësim në nivelin “tepër sekret” ka afat ruajtjeje klasifikimi 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.

2. Relacioni për asgjësim, vendimi për asgjësim dhe procesverbali për asgjësim në nivelin “sekret” ka afat ruajtjeje klasifikimi 10 (dhjetë) vjet.

3. Relacioni për asgjësim, vendimi për asgjësim dhe procesverbali për asgjësim në nivelin “konfidencial” ka afat ruajtjeje klasifikimi 5 (pesë) vjet.

4. Relacioni për asgjësim, vendimi për asgjësim dhe procesverbali për asgjësim në nivelin “i kufizuar” ka afat ruajtjeje klasifikimi 2 (dy) vjet.

PJESA II

INFORMACIONI I KLASIFIKUAR I NATO-S DHE BE-SË

KREU I

INFORMACIONI I KLASIFIKUAR I NATO-S DHE BE-SË DHE SISTEMI I REGJISTRIT

Neni 68

Informacioni i klasifikuar i NATO-s dhe BE-së

1. Republika e Shqipërisë zbaton standardet e sigurisë në përputhje me nivelin e klasifikimit të informacionit të klasifikuar të ardhur nga NATO dhe BE apo vendet anëtare të saj.

2. Republika e Shqipërisë siguron mospërdorimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së për qëllime të ndryshme nga ato të përcaktuara nga NATO dhe BE, të



vendimeve dhe rezolutave që kanë të bëjnë me këtë traktat.

3. Çdo informacion i klasifikuar i prodhuar nga institucionet shtetërore, misionet jashtë vendit të Republikës së Shqipërisë apo operatorët ekonomik për llogari të NATO-s dhe BE-së, përbën informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror” dhe regjistrohet e administrohet nga Sistemi i Regjistrimit.

4. Çdo informacion i paklasifikuar për llogari të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së i marrë apo i dërguar regjistrohet e administrohet në Sistemin e Regjistrimit.

Neni 69

Sistemi i Regjistrimit i informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së

1. Për administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së në Republikën e Shqipërisë funksionon Sistemi i Regjistrimit.

2. Sistemi i Regjistrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së përbëhet nga zyra e Regjistrimit Qendror pranë AKSIK-ut, zyrat e nënregjistrimit dhe pikat e kontrollit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së që krijohen në ministri dhe institucione të tjera të administratës publike.

3. Ky sistem është përgjegjës për marrjen, regjistrimin, shpërndarjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar të shkëmbyer në kuadrin e bashkëpunimit me NATO-n dhe BE-në.

Neni 70

Zyra e Regjistrimit Qendror të NATO-s dhe BE-së

1. Në AKSIK ngrihet dhe funksionon zyra e Regjistrimit Qendror të NATO-s dhe BE-së.

Kjo zyrë është përgjegjëse për marrjen, regjistrimin, shfrytëzimin, shumëfishimin, transmetimin, transportimin fizik dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së.

2. Zyra e Regjistrimit Qendror është autoriteti përgjegjës për drejtimin e shkëmbimit, mbikëqyrjen dhe kontrollin e aspekteve të sigurimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së në Sistemin e Regjistrimit.

3. Zyra e Regjistrimit Qendror autorizon me shkrim hapjen e zyrave të tjera të nënregjistrimit dhe të pikave

të kontrollit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së.

4. Zyra e Regjistrimit Qendror mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e zyrave të nënregjistrimit dhe të pikave të kontrollit, vendos mbylljen e tyre kur nuk respektohen standardet ligjore për sigurimin e informacionit të klasifikuar dhe kur e gjykon të panevojshme mbajtjen hapur të tyre.

Neni 71

Zyrat e Nënregjistrimit dhe Pikave të Kontrollit

Zyrat e Nënregjistrimit dhe pikat e kontrollit NATO dhe BE janë njësi organizative përgjegjëse për marrjen, regjistrimin, shfrytëzimin, shumëfishimin, transmetimin, transportimin fizik dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, në institucionet e tyre.

Neni 72

Organizimi i zyrave të Sistemit të Regjistrimit

1. Ruajtja fizike e informacionit të klasifikuar të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në zyrën e Regjistrimit Qendror, bëhet në kasaforta të përshtatshme. Kasafortat duhet të plotësojnë këto kërkesa sigurie:

a) të jenë të blinduara, kundër zjarrit, kundër ujit, me metal 10 mm;

b) çelësat të kenë kod;

c) të dhëna teknike duhet të jenë të dokumentuara nga prodhuesi.

2. Dyert dhe dritaret e zyrave të Sistemit të Regjistrimit duhet të jenë të mbikëqyrura nga jashtë me kamera në mënyrë që të sigurojnë kontrollin e tyre gjatë 24 (njëzet e katër) orëve.

3. Zyrat pajisen me sisteme alarmi për ndërhyrjet e paautorizuara dhe sisteme alarmi kundër zjarrit.

4. Dyert e zyrave të jenë të blinduara me material çeliku, kundër zjarrit, me bravë speciale të sigurisë së lartë dhe me çelësa të pakopjueshëm.

5. Dritaret e zyrave duhet të kenë kangjella të brendshme ose të jashtme, me shufra me material çeliku, me trashësi 15 mm, me hapësirë nga njëra-tjetra 15 cm, me kuadrate me përmasa 15 cm.

6. Zyrat duhet të kenë zgarë ndarëse me shufra me material çeliku, me trashësi 15 mm, me hapësirë nga njëra-tjetra 15 cm, me kuadrate me përmasa 15 cm, me banak.



7. Një kopje e çelësave të zyrave, kasafortave dhe një kopje e planit të evakuimit të mbahen në zarf të mbyllur nga eprori direkt.

8. Zyrat duhet të kenë dy kompjuter: një të lidhur në rrjet me internetin dhe një tjetër “*stand alone*”. Kompjuteri “*stand alone*” duhet të akreditohet përshtatshmërisht më parë nga AKSIK-u.

9. Zyrat pajisen me grirëse të cilat duhet të kryejnë një prerje maksimumi prej 0.8 mm gjerësi dhe një prerje kryq prej maksimumi 12 mm gjatësi.

10. Ndriçimi dhe rrjeti elektrik vendosen sipas kërkesave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri.

11. Ndalohet hyrja e personave të paautorizuar, mbajtja e furnelave elektrike, gazit, fenerëve ndriçues me lëndë djegëse, si dhe pirja e duhanit në zyrat e Sistemit të Regjistrimit.

Neni 73

Punonjësi i Sistemit të Regjistrimit të NATO-s dhe BE-së

1. Kriteret për marrjen e detyrës nga punonjësit e Sistemit të Regjistrimit janë:

a) punonjësi i zyrës së Sistemit të Regjistrimit duhet të jetë i pajisur me certifikatë sigurie personeli (CSP) me të njëjtin nivel me informacionin e klasifikuar të cilin ruan dhe administron;

b) para se të marrë në dorëzim regjistrat dhe informacionet e klasifikuara të NATO-s dhe BE-së, duhet të jetë i trajnuar për punën me informacionin e klasifikuar.

2. Detyrat e përgjithshme të punonjësit të Sistemit të Regjistrimit janë, si më poshtë vijon:

a) bën regjistrimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s në nivelin NATO RESTRICTED dhe lart;

b) bën regjistrimin e informacionit të klasifikuar EU RESTRICTED/RESTREINT UE dhe lart;

c) kur informacioni i NATO-s dhe BE-së administrohet në të njëjtën zyrë, regjistrimi dhe ruajtja bëhet në regjistra dhe në kasaforta të veçanta;

ç) punonjësi i Sistemit të Regjistrimit, para regjistrimit të një informacioni të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, i ardhur apo i dërguar nga institucionet shtetërore për llogari të NATO-s dhe BE-së, bën verifikimet përkatëse për shenjëzimet;

d) punonjësi i Sistemit të Regjistrimit nuk e regjistron informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të përgatitur nga institucionet shtetërore apo përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë

vendit, për llogari të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, nëse nuk i ka të gjitha shenjëzimet e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, por me shkresë përcjellëse të firmosur prej titullarit të ministrisë/institucionit, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike ia kthen atë për plotësim institucionit dërgues;

dh) shpërndan për shfrytëzim informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së vetëm me miratim të titullarit, tek ata punonjës të cilët janë pajisur me “certifikatë sigurie personeli” të përshtatshme dhe në bazë të parimit “nevojë për njohje”;

e) bën shkëmbimin në mënyrë të drejtpërdrejtë të informacionit të klasifikuar të NATO-s deri në nivelin NATO SECRET, brenda Sistemit të Regjistrimit;

ë) bën shkëmbimin në mënyrë të drejtpërdrejtë të informacionit të klasifikuar të BE-së;

f) punonjësi i Sistemit të Regjistrimit ndjek zbatimin e afatit për shfrytëzimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së;

g) bën regjistrimin dhe administrimin e kopjeve, përkthimeve, të pjesshme ose të plota, nxjerrja e ekstrakteve dhe të përmbledhjeve në të njëjtin nivel klasifikimi me origjinalin;

gj) bën transmetimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së nëpërmjet sistemeve të akredituara me të njëjtin nivel me informacionin që do të transmetohet;

h) bën administrimin, kontrollin dhe shenjëzimin e mediave të lëvizshme, si DVD, CD, që përmbajnë informacion të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, me nivelin më të lartë të informacionit që mbajnë;

i) bën ndryshimin periodik, por jo më pak se dy herë në vit, të kombinacionit të kasafortave të përshtatshme dhe të veçanta, ku mbahet informacioni i klasifikuar i NATO-s dhe i BE-së;

j) kryen inventarizimin mujor dhe vjetor të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së;

k) depoziton në zyrën e eprorit direkt, në një zarf të mbyllur dhe vulosur, një kopje të çelësave dhe kodeve të derës së zyrës së Sistemit të Regjistrimit, të kodeve në përdorim të kasafortave dhe të një kopjeje të planit të evakuimit;

l) mban të përditësuar listën e personelit të pajisur me CSP për njohjen me informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, në institucion;

ll) në bashkëpunim me anëtarët e komisionit të përcaktuar me urdhër nga titullari i institucionit, bën shkatërrimin e informacionit të klasifikuar të



NATO-s/BE-së dhe pasqyron rekordet e informacioneve të shkatërruara në regjistrin e rekordeve.

3. Detyrat e veçanta të punonjësit të zyrës së Regjistrit Qendror janë:

a) mban bazën e të dhënave për dokumentet e shkëmbyera në Sistemin e Regjistrit të NATO-s dhe BE-së (të hyra dhe të dala) në letër dhe elektronik;

b) mbikëqyr procesin e shkatërrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, nga zyrat e nënregjistrit ose pikat e kontrollit në institucionet shtetërore;

c) mban rekordet për shkatërrimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së të kryera nga zyrat e nënregjistrit ose pikat e kontrollit në institucionet shtetërore dhe evidenton ato në regjistrin e bazës së të dhënave (fizike dhe elektronike);

ç) mbikëqyr dhe kontrollon të gjitha zyrat e nënregjistrit ose pikat e kontrollit në institucionet shtetërore për zbatimin e legjislacionit në fuqi në fushën e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së;

d) mban të përditësuara listën e zyrave të nënregjistrave dhe të pikave të kontrollit për informacionin e klasifikuar CTS dhe ATOMAL dhe emrat e “Oficerëve të kontrollit COSMIC / ATOMAL, zëvendës oficerëve të kontrollit COSMIC/ATOMAL” dhe nënshkrimin e tyre;

dh) nëpërmjet hallkave eprorë, raporton në zyrën e Sigurisë së NATO (NOS), brenda 31 marsit të çdo viti, për inventarin fizik të informacionit të klasifikuar COSMIC TOP SECRET të administruar ose jo në Sistemin e Regjistrit;

e) nëpërmjet hallkave eprorë, raporton në zyrën e Sigurisë së NATO (NOS), brenda 31 marsit të çdo viti, për inventarin fizik të informacionit të klasifikuar ATOMAL të administruar në Sistemin e Regjistrit;

ë) nëpërmjet hallkave eprorë raporton në zyrën e Sigurisë së NATO (NOS) për listën e zyrave të nënregjistrit dhe pikave të kontrollit dhe të oficerëve të kontrollit/zëvendës oficerëve të kontrollit për informacionin e klasifikuar COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL, në Sistemin e Regjistrit.

4. Detyrat e veçanta të punonjësit të zyrës së nënregjistrit ose të pikës së kontrollit janë, si më poshtë vijon:

a) nëpërmjet titullarit të institucionit, njofton zyrën e Regjistrit Qendror në rast ndryshimi të

organizimit të zyrës së nënregjistrit ose të pikës së kontrollit dhe personelit të kësaj zyre (emërim të përhershëm apo të përkohshëm);

b) dërgon në Regjistrin Qendror rekordet për informacionet e shkëmbyera drejtpërdrejt nga zyrat e nënregjistrit ose pikat e kontrollit, marrëse ose dërguese, në një afat jo më vonë se dy ditë nga kryerja e veprimeve, sipas modelit të miratuar nga AKSIK-u;

c) punonjësi i zyrës së Nënregjistrit ose të pikës së kontrollit për informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së dërgon një kopje të inventarit fizik çdo 6 (gjashtë) muaj në zyrën e Regjistrit Qendror;

ç) pas kryerjes së procesit të shkatërrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, dërgon në zyrën e Regjistrit Qendror një kopje të urdhrat për ngritjen e Komisionit të Shkatërrimit dhe një kopje të certifikatës së shkatërrimit;

d) raporton me shkrim në AKSIK, nëpërmjet titullarit të institucionit, shkeljet dhe incidentet e sigurisë, që ndodhin gjatë marrjes, regjistrimit, shumëfishimit, shfrytëzimit, transportimit fizik, transmetimit dhe shkatërrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së.

KREU II

NIVELET E KLASIFIKIMIT, EKUIVALENCA DHE SHENJËZIMET E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR TË NATO-s DHE BE-së

Neni 74

Nivelet e klasifikimit të informacionit të NATO-së

1. Informacioni i klasifikuar i NATO-s merr një nga nivelet e klasifikimit, si më poshtë:

a) “COSMIC TOP SECRET (CTS)” është informacioni i klasifikuar i NATO-s, përhapja e paautorizuar e të cilit do të rezultonte në dëm veçanërisht të rëndë për NATO-n.

b) “NATO SECRET (NS)” është informacioni i klasifikuar i NATO-s, përhapja e paautorizuar e të cilit do të rezultonte në dëm të rëndë për NATO-n.

c) “NATO CONFIDENTIAL (NC)” është informacioni i klasifikuar i NATO-s, përhapja e paautorizuar e të cilit do të shkaktoje dëm për NATO-n.



ç) NATO RESTRICTED (NR) – është informacioni i klasifikuar i NATO-s, përhapja e paautorizuar e të cilit do të ishte e dëmshme për interesat dhe efektivitetin e NATO-s.

Neni 75

Kategoritë speciale të informacionit të klasifikuar të NATO-s

1. “ATOMAL” është kategori e informacioneve speciale, të cilat lidhen me çështjet bërthamore dhe është subjekt i marrëveshjes për shkëmbimin e informacionit ATOMAL.

2. “BOHEMIA” është një shenjëzim i aplikuar për një informacion të kategorisë së veçantë, që rrjedh nga ose që i përket Inteligjencës së Komunikimeve (COMINT).

3. “CRYPTO” është një shenjëzim dhe emërtim i veçantë për të identifikuar të gjitha informacionet që lidhen me materialin çelës për mbrojtjen e informacionit dhe autentifikimit të komunikimeve elektronike që lidhen me sigurinë kriptografike, duke nënkuptuar që një informacion i tillë të mbrohet me politikat e sigurisë dhe direktivat kriptografike.

4. “SIOP” është një shenjëzim i përdorur për një kategori të veçantë të informacionit, duke nënkuptuar informacionin, i cili mbrohet në përputhje me “Procedurat speciale për trajtimin e planit operacional të integruar” dhe mbrohet nga NATO C-M(7127).

Neni 76

Informacioni i paklasifikuar i NATO-s

“NATO UNCLASSIFIED (NU)” ky shënjim aplikohet për informacion zyrtar të NATO-s, por që nuk përmbush kriteret e klasifikimit.

Neni 77

Nivelet e klasifikimit të informacionit të BE-së

1. Informacioni i klasifikuar i BE-së merr një nga nivelet e klasifikimit, si më poshtë:

a) “EU TOP SECRET/TRES SECRET UE” është çdo dokument apo material i përdorur në mënyrë të paautorizuar, përdorimi i të cilit u shkakton dëme veçanërisht të rënda interesave thelbësorë të BE-së apo një e më shumë shteteve anëtare të saj.

b) “EU SECRET/SECRET UE” është çdo dokument apo material i përdorur në mënyrë të paautorizuar, përdorimi i të cilit u shkakton dëme të rënda interesave thelbësorë të BE-së apo një e më shumë shteteve anëtare të saj.

c) “EU CONFIDENTIAL/CONFIDENTIEL UE” është çdo dokument apo material i përdorur në mënyrë të paautorizuar, përdorimi i të cilit dëmton interesat thelbësorë të BE-së apo të një e më shumë shteteve anëtare të saj;

ç) “EU RESTRICTED/RESTREINT UE” është çdo dokument apo material i përdorur në mënyrë të paautorizuar, përdorimi i të cilit mund të ishte i dëmshëm për interesat thelbësorë të BE-së apo të një e më shumë shteteve anëtare të saj.

Neni 78

Ekuivalenca e niveleve të klasifikimit

Ekuivalenca e niveleve të klasifikimit të informacionit është sipas tabelës së mëposhtme.

Në shqip	Ekuivalentja në NATO	Ekuivalente në BE
TEPËR SEKRET	COSMIC TOP SECRET (CTS)	EU TOP SECRET/TRES SECRET UE
SEKRET	NATO SECRET (NS)	EU SECRET/SECRET UE
KONFIDENCIAL	NATO CONFIDENTIAL (NC)	EU CONFIDENTIAL / CONFIDENTIEL UE
I KUFIZUAR	NATO RESTRICTED (NR)	EU RESTRICTED / RESTREINT UE

Neni 79

Klasifikimi i sigurisë dhe shenjëzimet

1. Klasifikimi i informacioneve që prodhohen nga institucionet shtetërore për llogari të NATO-s dhe BE-së bëhet duke u bazuar në listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” të institucionit.

2. Në rast se një informacion i prodhuar për llogari të NATO-s dhe BE-së nuk është parashikuar në listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” të institucionit, atëherë niveli i klasifikimit dhe afati i ruajtjes së këtij klasifikimi është ekuivalent me informacionin e ardhur nga NATO-ja dhe BE-ja.



Neni 80

Shenjëzimet e pajisjeve elektronike

Të gjitha pajisjet ku prodhohet, administrohet dhe ruhet informacion i klasifikuar i NATO-s dhe BE-së, si dhe mediat e lëvizshme kompjuterike duhet të akreditoohen përshtatshmërisht me nivelin më të lartë të klasifikimit të informacionit që prodhojnë dhe administrojnë, duke vendosur dhe shenjëzimet përkatëse.

KREU III

ADMINISTRIMI I INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR TË NATO-s DHE BE-së

Neni 81

Regjistrat për administrimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s në Sistemin e Regjistrat

1. Për regjistrimin, shfrytëzimin, shumëfishimin, transportimin fizik, transmetimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s, zyra e Sistemit të Regjistrat mban këto regjistra:

a) Regjistri i korrespondencës së informacionit të klasifikuar të NATO-s (të hyra dhe të dala), në zyrat e Sistemit të Regjistrat për nivelin NATO RESTRICTED, NATO CONFIDENTIAL dhe NATO SECRET;

b) Regjistri i korrespondencës së informacionit të klasifikuar të NATO-s (të hyra dhe të dala) në zyrat e Sistemit të Regjistrat, për nivelin COSMIC TOP SECRET;

c) Regjistri i korrespondencës së informacionit të klasifikuar të NATO-s (të hyra dhe të dala) në zyrat e Sistemit të Regjistrat, për nivelin ATOMAL;

ç) Regjistri i bazës së të dhënave/rekordeve (elektronike dhe fizike) për informacionin e klasifikuar të NATO-s, për nivelin NATO RESTRICTED, NATO CONFIDENTIAL dhe NATO SECRET, të hyra në zyrat e Sistemit të Regjistrat;

d) Regjistri i bazës së të dhënave/rekordeve (elektronike dhe fizike) për informacionin e klasifikuar të NATO-s, për nivelin COSMIC TOP SECRET, të hyra në zyrat e Sistemit të Regjistrat;

dh) Regjistri i bazës së të dhënave/rekordeve (elektronike dhe fizike) për informacionin e klasifikuar të NATO-s, për nivelin ATOMAL, të hyra në zyrat e Sistemit të Regjistrat;

e) Regjistri i bazës së të dhënave (elektronike dhe fizike) për “Certifikatat e shkatërrimit” për informacionin e klasifikuar të NATO-s në zyrat e Sistemit të Regjistrat;

ë) Regjistri i qarkullimit të brendshëm të informacionit të klasifikuar të NATO, në zyrat e Sistemit të Regjistrat;

f) Regjistri i personave të certifikuar për njohjen me informacionin e klasifikuar të NATO-s;

g) Regjistri i shumëfishimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s, në zyrat e Sistemit të Regjistrat;

gj) Regjistri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të NATO-s, në zyrat e Sistemit të Regjistrat;

h) Regjistri i hyrje-daljes së vizitorëve në zyrat e Sistemit të Regjistrat;

i) Regjistri i regjistrimit të regjistrave të informacionit të klasifikuar të NATO-s.

Neni 82

Regjistrat për administrimin e informacionit të klasifikuar të BE-së në Sistemin e Regjistrat

1. Për regjistrimin, shfrytëzimin, shumëfishimin, transportimin fizik, transmetimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar të BE, zyra e Sistemit të Regjistrat mban këto regjistra:

a) regjistri i korrespondencës së informacionit të klasifikuar të BE (të hyra dhe të dala), në zyrat e Sistemit të Regjistrat, për nivelin EU RESTRICTED / RESTREINT UE dhe EU CONFIDENTIAL / CONFIDENTIEL UE dhe EU SECRET / SECRET UE;

b) regjistri i korrespondencës së informacionit të klasifikuar të BE (të hyra dhe të dala), në zyrat e Sistemit të Regjistrat, për nivelin EU TOP SECRET/TRES SECRET UE;

c) regjistri i bazës së të dhënave/rekordeve (elektronike dhe fizike) për informacionin e klasifikuar të BE, për nivelin EU RESTRICTED/RESTREINT UE, EU CONFIDENTIAL/CONFIDENTIEL UE dhe EU SECRET/SECRET UE, të hyra në Sistemin e Regjistrat;

ç) regjistri i bazës së të dhënave/rekordeve (elektronike dhe fizike) për informacionin e klasifikuar të BE, për nivelin EU TOP



SECRET/TRES SECRET UE, të hyra në Sistemin e Regjistrimit;

d) regjistri i bazës të të dhënave (elektronike dhe fizike) për “Certifikatat e shkatërrimit” për informacionin e klasifikuar të BE në zyrat e Sistemit të Regjistrimit;

dh) regjistri i qarkullimit të brendshëm të informacionit të klasifikuar të BE, në zyrat e Sistemit të Regjistrimit;

e) regjistri i personave të certifikuar për njohjen me informacionin e klasifikuar të BE-së;

ë) regjistri i shumëfishimit të informacionit të klasifikuar të BE, në zyrat e Sistemit të Regjistrimit;

f) regjistri i dorëzimit të korrespondencës së informacionit të klasifikuar të BE, në zyrat e Sistemit të Regjistrimit;

g) regjistri i hyrje-daljes së vizitorëve në zyrat e Sistemit të Regjistrimit;

gj) regjistri i regjistrimit të regjistrave të informacionit të klasifikuar të BE-së.

KREU IV

INFORMACIONI I KLASIFIKUAR COSMIC TOP SECRET DHE ATOMAL

Neni 83

Administrimi i informacionit të klasifikuar COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL

1. Informacioni i klasifikuar i nivelit COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL, që merret nga NATO-ja apo dërgohet në NATO, shkëmbehet vetëm nëpërmjet regjistrit qendror.

2. Transportimi kryhet vetëm fizikisht, me korrier diplomatik ose korrier ushtarak, të miratuar dhe të certifikuar përshtatshëm nga AKSIK-u.

3. Ndalohet mbajtja personale e informacionit të klasifikuar COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4. Ndalohet qarkullimi apo transmetimi i informacionit të klasifikuar i nivelit COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL në sistemet e komunikimit të informacionit (SKI).

5. Përpunimi, prodhimi, shfrytëzimi dhe ruajtja e informacionit të klasifikuar COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL bëhet vetëm në kompjuter të akredituar përshtatshëm.

6. Institucionet shtetërore, të cilat janë autorizuar nga AKSIK-u për ruajtjen dhe administrimin e

informacionit të klasifikuar të NATO-s të nivelit COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL, janë të detyruara të nxjerrin urdhrin për emërimin e personit përgjegjës të zyrës së nënregjistrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s si “Oficer i kontrollit COSMIC/ATOMAL dhe të zëvendësuesit të kontrollit COSMIC/ATOMAL për punën me informacionin e klasifikuar COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL”.

Neni 84

Detyra të veçanta të oficerit të kontrollit COSMIC/ATOMAL dhe të zëvendësuesit të kontrollit COSMIC dhe ATOMAL

1. Në zyrën e Regjistrimit Qendror dhe në zyrat e nënregjistrimit apo në pikat e kontrollit të institucioneve shtetërore, të cilat janë të autorizuar nga AKSIK-u për të administruar informacion të klasifikuar COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL, punonjësi i Sistemit të Regjistrimit është njëkohësisht dhe oficer i kontrollit COSMIC dhe ATOMAL.

2. Me urdhrin e titullarit të institucionit caktohet edhe zëvendësuesi i kontrollit COSMIC dhe ATOMAL.

3. Oficerët e kontrollit COSMIC dhe ATOMAL dhe zëvendësit kryejnë këto detyra:

a) Administrojnë informacionin e klasifikuar COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL, të ndarë në kasaforta dhe regjistra të veçantë, të përshtatshëm dhe veç nga informacionet e tjera;

b) Mbajnë bazën e të dhënave të përditësuar për informacionet e klasifikuara COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL;

c) Plotësojnë bazën e të dhënave të përditësuar, të individëve të autorizuar për akses tek informacionet e klasifikuara COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL;

ç) Shpërndajnë informacionin e klasifikuar COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL, me regjister qarkullimi, në bazë të parimit “nevojë për njohje” për qëllime zyrtare dhe vetëm personave të autorizuar dhe të pajisur përshtatshëm me certifikatë sigurie personeli (CSP), shfrytëzimi i të cilit kryhet vetëm brenda ambienteve të Sistemit të Regjistrimit;

d) Mbajnë bazën e të dhënave të përditësuar bashkë me emrat, mbiemrat dhe nënshkrimet e “Oficerëve të kontrollit COSMIC/ATOMAL dhe



zëvendës oficerëve të tyre të regjistrit qendror, nënregjistrit apo pikave të kontrollit të institucioneve shtetërore, të autorizuar për të shkëmbyer informacionin e klasifikuar COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL;

dh) Kryejnë inventarin fizik mujor të informacionit të klasifikuar COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL dhe dërgojnë çdo 6 muaj një kopje të inventarit fizik në Regjistrin Qendror të AKSIK-ut;

e) Marrin masat për shkatërrimin e informacionit të klasifikuar COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL, si dhe mbajnë rekordet e shkatërrimit në përputhje me këtë rregullore;

ë) Koordinojnë dhe raportojnë me shkrim të gjitha shkeljet e incidentet e sigurisë, që kanë ndodhur ose mund të ndodhin gjatë marrjes, dërgimit, regjistrimit, shfrytëzimit dhe transportimit fizik të informacionit të klasifikuar COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL.

f) Për rastet e sipërpërmendura raportojnë me shkrim, në AKSIK, nëpërmjet titullarit të institucionit.

KREU V

SHUMËFISHIMI, PËRKTHIMI DHE SHFRYTËZIMI I INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR TË NATO-s DHE BE-së

Neni 85

Shumëfishimi dhe përkthimi i informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së

1. Shumëfishimi i një informacioni të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, regjistrohet në regjistrin e shumëfishimit.

2. Përkthimi i pjesshëm ose i plotë, ekstraktet dhe përmbledhjet që kanë të bëjnë me këtë informacion, marrin të njëjtin nivel klasifikimi me informacionin origjinal dhe regjistrohen në regjistrin e shumëfishimit.

Neni 86

Shumëfishimi dhe përkthimi i informacionit të klasifikuar COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL

1. Shumëfishimi, përkthimi i pjesshëm ose i plotë, nxjerrja e ekstrakteve dhe përmbledhjet për

informacionin e klasifikuar COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL nuk lejohet.

2. Për qëllime të misioneve urgjente, vetëm pas miratimit me shkrim nga origjinatori, AKSIK-u mund të bëjë shumëfishimin, përkthimin e pjesshëm ose të plotë, nxjerrjen e ekstrakteve dhe të përmbledhjeve të informacioneve COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL.

3. Shumëfishimi, përkthimi, i pjesshëm ose i plotë, nxjerrja e ekstrakteve dhe përmbledhjet bëhen vetëm në ambientet e zyrës së Regjistrit Qendror nga Oficeri i kontrollit COSMIC/ATOMAL ose, në mungesë të tij, nga zëvendës oficeri i kontrollit COSMIC/ATOMAL dhe vetëm nga mjete e pajisje të akredituara për këtë nivel klasifikimi.

4. Përkthimi, i pjesshëm ose i plotë, nxjerrja e ekstrakteve dhe përmbledhjet të kenë të gjitha shenjëzimet e informacionit origjinal.

5. Oficeri i kontrollit COSMIC/ATOMAL ose në mungesë të tij, zëvendës oficeri i kontrollit COSMIC/ATOMAL bën shumëfishimin, përkthimin e pjesshëm ose të plotë, nxjerrjen e ekstrakteve dhe të përmbledhjeve të informacioneve COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL dhe plotëson regjistrin e shumëfishimit.

Neni 87

Shumëfishimi dhe përkthimi i informacionit të klasifikuar deri në nivelin NATO SECRET dhe deri në nivelin SECRET/SECRET UE dhe EU TOP SECRET/TRES SECRET UE

1. Shumëfishimi dhe përkthimi i informacionit të klasifikuar të NATO-s kryhet për nivelet NATO RESTRICTED, NATO CONFIDENCIAL dhe NATO SECRET. Shumëfishimi bëhet vetëm me autorizim të titullarit të institucionit në ambientet e Sistemit të Regjistrit dhe vetëm nga punonjësit e këtyre zyrave. Çdo kopje regjistrohet në regjistrin e shumëfishimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s.

2. Shpërndarja e kopjeve tek i adresuari bëhet me autorizim të titullarit të institucionit dhe kundrejt nënshkrimit të marrësit në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të informacionit të klasifikuar të NATO-s.

3. Kur origjinatori ka vënë shënimin “të mos shumëfishohet”, ky informacion nuk shumëfishohet.



4. Shumëfishimi i CD-ve dhe i DVD-ve, ku ruhen informacione të klasifikuara të NATO-s kryhet me autorizim të titullarit të institucionit, në ambientet e Sistemit të Regjistrimit, në pajisje të akredituara me të njëjtin nivel klasifikimi me informacionin që do të shumëfishohet. Çdo shumëfishim i CD-ve dhe i DVD-ve regjistrohet në regjistrin e shumëfishimit të informacionit të klasifikuar të NATO.

5. Shumëfishimi dhe përkthimi i pjesshëm ose i plotë i ekstrakteve dhe përmbledhjet për informacionin e klasifikuar EU TOP SECRET/TRES SECRET UE dhe EU SECRET/SECRET UE nuk lejohen.

6. Për qëllime të misioneve urgjente, vetëm pas miratimit me shkrim nga origjinatori, AKSIK-u mund të bëjë shumëfishimin, përkthimin e pjesshëm ose të plotë të ekstrakteve dhe përmbledhjeve të informacioneve EU TOP SECRET/TRES SECRET UE, ndërsa Sistemi i Regjistrimit vetëm pas miratimit me shkrim nga origjinatori, mund të bëjë shumëfishimin, përkthimin e pjesshëm ose të plotë të ekstrakteve dhe përmbledhjeve të informacioneve EU SECRET/SECRET UE.

7. Shumëfishimi, përkthimi i pjesshëm ose i plotë, ekstraktet dhe përmbledhjet bëhen vetëm në ambientet e Sistemit të Regjistrimit.

8. Përkthimi, i pjesshëm ose i plotë, ekstraktet dhe përmbledhjet të kenë të gjitha shenjëzimet e informacionit origjinal.

9. Shumëfishimi bëhet vetëm në fotokopje të akredituara më parë nga AKSIK-u dhe vetëm nga punonjësi i Sistemit të Regjistrimit dhe çdo kopje regjistrohet në regjistrin e shumëfishimit.

10. Shpërndarja për shfrytëzim i kopjeve tek i adresuari bëhet me autorizim të titullarit të institucionit dhe kundrejt nënshkrimit të marrësit në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të informacionit të klasifikuar të BE.

Neni 88

Shumëfishimi i informacionit të klasifikuar të BE për nivelin EU RESTRICTED / RESTREINT UE dhe EU CONFIDENTIAL / CONFIDENTIEL UE

1. Shumëfishimi i informacionit të klasifikuar të BE për nivelet EU RESTRICTED/RESTREINT UE dhe EU CONFIDENTIAL / CONFIDENTIEL UE,

mund të bëhet pa marrë miratimin e origjinatorit të tij.

2. Shumëfishimi bëhet vetëm me autorizim të titullarit të institucionit në zyrat e Sistemit të Regjistrimit, në fotokopje të akredituara më parë nga AKSIK dhe vetëm nga punonjësit e këtyre zyrave. Çdo kopje regjistrohet në regjistrin e shumëfishimit.

3. Rekordet e informacionit të klasifikuar të shumëfishuar apo përkthyer të raportohen në zyrën e Regjistrimit Qendror brenda dy ditëve nga kryerja e veprimit.

4. Kur origjinatori ka vënë shënimin “të mos shumëfishohet”, ky informacion nuk shumëfishohet.

Neni 89

Shfrytëzimi i informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së

1. Shfrytëzimi i informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së për nivelin CONFIDENTIAL dhe më lart bëhet në bazë të parimit “nevojë për njohje”, për ushtrimin e një detyre zyrtare dhe me autorizim të titullarit të institucionit të personat që janë të pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) të përshtatshme.

2. Për shfrytëzimin e informacionit të klasifikuar NATO RESTRICTED dhe nivelet EU RESTRICTED/RESTREINT UE nuk nevojitet CSP.

3. Shpërndarja e kopjeve tek i adresuari bëhet me autorizim të titullarit të institucionit dhe kundrejt nënshkrimit të marrësit në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së.

4. Informacioni i klasifikuar i NATO-s dhe i BE-së, i marrë për shfrytëzim, kthehet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në zyrat e Sistemit të Regjistrimit.

5. Me autorizim të titullarit të institucionit, informacioni i klasifikuar i NATO-s dhe BE-së mund të mbahet për shfrytëzim deri në 3 (tre) muaj.

6. Informacioni i klasifikuar i NATO-s i nivelit CTS dhe ATOMAL shfrytëzohet vetëm brenda ambienteve të zyrës së Sistemit të Regjistrimit.

7. Ruajtja e të dhënave privatisht, mbajtja e ditarëve ose e shënimeve për informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së janë të ndaluara.

8. Nxjerrja e paautorizuar e dokumenteve apo e materialeve të klasifikuara të NATO-s dhe të BE-së



nga ambientet e zyrave të punës dhe zonat e sigurisë është e ndaluar.

9. Punonjësi i zyrës së Regjistrit Qendror, i zyrave të nënregjistrat ose i pikave të kontrollit konfirmon kthimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe të BE-së nga marrësi, duke kryer verifikimin fizik të tij dhe kundrejt nënshkrimit në regjistrin e qarkullimit të brendshëm.

10. Shfrytëzimi i mediave të lëvizshme, ku ruhet informacioni i klasifikuar i NATO-s dhe i BE-së bëhet vetëm në sisteme të akredituara përshtatshëm.

KREU VI

RREGULLA PËR SHPËRNDARJEN DHE TRANSMETIMIN ELEKTROMAGNETIK

Neni 90

Shpërndarja dhe transmetimi i informacionit të NATO-s

1. Informacioni i klasifikuar i NATO-s trajtohet vetëm në Sisteme të Komunikimit dhe Informacionit (SKI) të akredituara përshtatshëm nga AKSIK-u.

2. Të gjitha rekordet e informacionit të klasifikuar të NATO-s të shkëmbyera ndërmjet zyrave të nënregjistrat apo pikave të kontrollit të informacionit të klasifikuar të NATO-s të raportohen brenda 2 (dy) ditëve në zyrën e Regjistrat Qendror.

3. Kur informacioni i klasifikuar i NATO-s transmetohet nëpërmjet Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit (SKI) jashtë zonave të sigurisë duhet siguruar që:

a) Konfidencialiteti i informacionit të klasifikuar NATO SECRET, gjatë transmetimit, do të mbrohet nga mjete kriptografike të aprovuara nga Komiteti Ushtarak i NATO-s (*NATO Military Committee NAMILCOM*);

b) Konfidencialiteti i informacionit të klasifikuar NATO RESTRICTED dhe NATO CONFIDENTIAL, gjatë transmetimit, do të mbrohet nga mjete kriptografike të aprovuara nga Komiteti Ushtarak i NATO-s (*NATO Military Committee NAMILCOM*) ose AKSIK.

Neni 91

Shpërndarja dhe transmetimi i informacionit të BE-së

1. Informacioni i klasifikuar i BE-së pas marrjes së miratimit nga strukturat e sigurisë së BE-së trajtohet vetëm në Sisteme të Komunikimit dhe Informacionit (SKI) të akredituara përshtatshëm nga AKSIK-u.

2. Të gjitha rekordet e informacionit të klasifikuar të BE-së të shkëmbyera ndërmjet zyrave të nënregjistrat apo pikave të kontrollit të informacionit të klasifikuar të BE-së, të raportohen brenda 2 (dy) ditëve në zyrën e Regjistrat Qendror.

3. Kur informacioni i klasifikuar i BE-së transmetohet nëpërmjet Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit (SKI) jashtë zonave të sigurisë, duhet siguruar që:

a) konfidencialiteti i informacionit të klasifikuar EU SECRET/SECRET UE, gjatë transmetimit, do të mbrohet nga mjete kriptografike të aprovuara nga Komisioni i Sigurisë i BE-së (*Council as Crypto Approval Authority (CAA)*);

b) konfidencialiteti i informacionit të klasifikuar EU RESTRICTED/RESTREINT UE dhe EU CONFIDENTIAL/CONFIDENTIEL UE, gjatë transmetimit, do të mbrohet nga mjete kriptografike të aprovuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të BE, si CAA.

Neni 92

Përdorimi i pajisjeve kompjuterike private

1. Ndalohet përdorimi i mediave të lëvizshme kompjuterike, programeve dhe pajisjeve private, për ruajtjen, procesimin dhe transmetimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së.

2. Pajisjet, programet dhe mediat e lëvizshme private nuk lejohen të futen në zonat e sigurisë, ku ruhet, prodhohet ose transmetohet informacion i klasifikuar i NATO-s dhe BE-së.



KREU VII
ZHVLERËSIMI, DEKLASIFIKIMI DHE
SHKATËRRIMI I INFORMACIONIT TË
KLASIFIKUAR TË NATO-s DHE BE-së

Neni 93

Zhvlerësimi dhe deklasifikimi

Zhvlerësimi apo deklasifikimi i informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së kryhet vetëm në rastet kur AKSIK-u është njoftuar ose ka marrë më parë miratimin me shkrim nga origjinatori, i cili ka prodhuar informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së.

Neni 94

Procedurat e shkatërrimit

1. Sistemi i Regjistrimit merr masat dhe kryen shkatërrimin e informacioneve të klasifikuara të NATO-s dhe BE-së, sipas procedurave të përshkruara në vijim:

a) punonjësi i Sistemit të Regjistrimit kryejnë rishikimin e vazhdueshëm të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së që ka në administrim për të vlerësuar, përcaktuar dhe propozuar informacionet e klasifikuara të NATO-s dhe BE-së që do të shkatërrohen si pa vlerë për ruajtje të mëtejshme;

b) vlerësimi për pavlefshmërinë e mëtejshme të informacioneve të klasifikuara të NATO-s dhe BE-së kryhet në bashkëpunim me personat e autorizuar nga titullari i institucionit, të cilët janë njohur e kanë punuar me informacionet e klasifikuara të NATO-s dhe BE-së;

c) titullari i institucionit për çdo rast shkatërrimi, miraton urdhrin “Për ngritjen e komisionit të shkatërrimit të informacioneve të klasifikuara të NATO”, si dhe urdhrin “Për ngritjen e komisionit të shkatërrimit të informacioneve të klasifikuara të BE”. Urdhri bëhet sipas modelit të përcaktuar nga AKSIK-u, në udhëzimin zbatues të kësaj rregulloreje;

ç) zyrat e nënregjistrimit ose pikat e kontrollit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së të institucionit shtetëror dërgojnë pranë zyrës së Regjistrimit Qendror të NATO-s dhe BE-së në AKSIK kopjen e urdhrimit të shkatërrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së

dhe “Certifikatën e shkatërrimit”, jo më vonë se 2 (dy) ditë nga kryerja e procesit të shkatërrimit.

Neni 95

Detyrat e komisionit të shkatërrimit

1. Komisioni për shkatërrimin e informacionit të klasifikuar të niveleve NATO RESTRICTED dhe NATO CONFIDENTIAL” dhe informacionit të klasifikuar të BE-së të niveleve EU RESTRICTED/RESTREINT UE dhe EU CONFIDENTIAL/CONFIDENTIEL UE përbëhet nga jo më pak se 2 (dy) persona, ndërsa për nivelin NATO SECRET dhe EU SECRET/SECRET UE e lart jo më pak se 3 (tre) persona të certifikuar përshtatshëmrisht dhe drejtohen nga punonjësit e Sistemit të Regjistrimit.

2. Pas miratimit të urdhrimit përkatës, komisioni përgatit dhe plotëson me të dhënat e kërkuara dokumentin e emërtuar “Certifikata e shkatërrimit”, sipas modelit të përcaktuar nga AKSIK-u, në udhëzimin zbatues të kësaj rregulloreje. Komisioni i shkatërrimit merr masat dhe mban përgjegjësi që procesi i shkatërrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, veçuar për shkatërrim, të bëhet sipas kësaj radhe veprimesh:

a) Fillimisht, informacioni i klasifikuar i NATO-s dhe i BE-së, veçuar për shkatërrim, kalojnë në grirëse;

b) Pas këtij procesi, masa e grirë duhet t'i nënshtrohet procesit të djegies.

3. Komisioni i shkatërrimit, pasi sigurohet se ka realizuar shkatërrimin e plotë dhe përfundimtar të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, nënshkruan “Certifikatën e shkatërrimit”.

4. Urdhrrat për ngritjen e komisionit dhe certifikatat e shkatërrimit për informacionin e klasifikuar NATO SECRET dhe EU SECRET / SECRET UE e lart duhet të ruhen jo më pak se 10 (dhjetë) vjet nga koha e shkatërrimit të tij. Për nivelin NATO RESTRICTED dhe NATO CONFIDENTIAL dhe informacionit të klasifikuar të BE-së të niveleve EU RESTRICTED / RESTREINT UE dhe EU CONFIDENTIAL / CONFIDENTIEL UE jo më pak se 5 (pesë) vjet nga koha e shkatërrimit të tij.



Neni 96

Mjetet dhe pajisjet për shkatërrim

1. Mjetet dhe pajisjet për shkatërrim vendosen në Zonën e Sigurisë së Klasit të Parë ose në Zonën e Sigurisë të Klasit të Dytë dhe janë të standardizuara, si më poshtë:

a) Grirëset duhet të jenë të ndërtuara në mënyrë të tillë që materiali të mos mbetet i pashkatërruar në makineri gjatë grirjes;

b) Për informacionin e klasifikuar të NATO SECRET dhe EU SECRET/SECRET UE e lart përdoren grirëse, që sigurojnë një prerje maksimumi prej 0.8 mm gjerësi dhe një prerje kryq prej maksimumi 12 mm gjatësi;

c) Për informacionin e klasifikuar NATO RESTRICTED dhe NATO CONFIDENTIAL dhe informacionit të klasifikuar të BE-së të niveleve EU RESTRICTED/RESTREINT UE dhe EU CONFIDENTIAL/CONFIDENTIEL UE përdoren grirëse që sigurojnë një prerje maksimumi 3 mm gjerësi dhe një prerje kryq maksimumi 25 mm gjatësi. Sipërfaqja e materialit të prerë nuk duhet të kalojë 60 mm katror.

KREU VIII**PROCEDURA E KONSTATIMIT TË SHKELJEVE TË SIGURISË**

Neni 97

Procedura e konstatimit të shkeljeve të sigurisë

1. Të gjitha shkeljet e sigurisë për informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së duhet të raportohen menjëherë te struktura ose oficeri i sigurisë i institucionit të administratës publike dhe nëpërmjet tij te titullari i këtij institucioni dhe në AKSIK.

2. Në këto raste, titullari i institucionit, me urdhër, krijon një komision për të shqyrtuar çështjen.

3. Komisioni që shqyrton çështjen duhet të sigurohet që në investigim të mos përfshihet personeli i prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga shkelja e sigurisë, në mënyrë që të përcaktohen qartë faktet.

4. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes komisioni harton një procesverbal ku shënon:

a) nëse informacioni i klasifikuar i NATO-s dhe i BE-së ka rrjedhur, është vjedhur, ka humbur, është shkatërruar në mënyrë të paautorizuar;

b) rrethanat e ngjarjes dhe një përshkrim të përgjithshëm të këtij informacioni;

c) veprimet apo mosveprimet e kryera që janë bërë shkak për rrjedhjen, marrjen, dhënien, vjedhjen, shkatërrimin në mënyrë të paautorizuar të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së;

ç) dëmin e mundshëm, që mund t'u shkaktohet interesave të NATO-s dhe BE-së apo shteteve anëtare të tij;

d) shkeljet ligjore të konstatuara në punën me informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së;

dh) personat përgjegjës dhe individë të tjerë të përfshirë, nëse konstatohet ky fakt;

e) propozimet dhe masat përkatëse.

5. Procesverbali i hartuar me shkrim nga komisioni i dërgohet titullarit të institucionit dhe nëpërmjet tij, AKSIK.

6. Titullari i institucionit merr masa për të vënë para përgjegjësisë ligjore personat përgjegjës dhe veprimet korrektuese për punën me informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

7. AKSIK-u informon me shkrim zyrën e Sigurisë së NATO-s dhe strukturat e sigurisë së Bashkimit Evropian; kur e gjykon të nevojshme, mund të njoftojë me shkrim edhe origjinatorin.

Neni 98

Rekordet/evidentimi e/i shkeljeve të sigurisë

Procesverbalet dhe rekordet e shkeljeve të sigurisë ruhen të klasifikuara në Sistemin e Regjistrimit për 5 (pesë) vjet.

PJESA III**KREU I****RREGULLA PËR MBAJTJEN PERSONALE TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR” TË NATO-s DHE BE-së**

Neni 99

Rastet e mbajtjes personale

1. Mbjajtja personale e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s dhe BE-së mund të



kryhet vetëm për aktivitete, takime ose operacione të përbashkëta të organizuara nga institucionet shtetërore, NATO ose BE.

2. Mbajtja personale e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të NATO-s dhe BE-së u lejohe vetëm punonjësve/nëpunësve të certifikuar përshtatshmërisht, për arsye zyrtare dhe të autorizuar nga titullari i institucionit.

3. Mbajtja personale realizohet me kusht që të mbahen të dhënat, kundrejt nënshkrimit në NJOPIK dhe Sistemin e Regjistrimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së.

4. Informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s ose i BE-së duhet të pakëtohet në mënyrë të tillë që të pengohet aksesimi i pautorizuar, nuk duhet të lihet pa mbikëqyrje dhe të hapet gjatë rrugës ose në vende publike.

5. Në rastet kur informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s dhe BE-së ruhet në media të lëvizshme për mbajtjen personale të tyre aplikohen të njëjtat rregulla.

6. Në rastet e mbajtjes personale të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s dhe BE-së, NJOPIK-u dhe Sistemi i Regjistrimit mban të dhënat në regjistrin përkatës për këtë qëllim.

7. Ndalohe mbajtja personale e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” për nivelin “tepër sekret” të NATO-s për nivelin COSMIC TOP SECRET dhe ATOMAL dhe për nivelin EU SECRET /SECRET UE dhe EU TOP SECRET dhe TOP SECRET UE.

Neni 100

Dispozita të fundit

1. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar të nxjerrë udhëzim në zbatim të kësaj rregulloreje, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e saj, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 79, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”.

2. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar për kontrollin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje.

3. Ministrinë, institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë të marrin masa për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

VENDIM

Nr. 823, datë 26.12.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR SIGURIMIN FIZIK TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR ‘SEKRET SHTETËROR’ TË NATO-s, TË BASHKIMIT EVROPIAN, TË SHTETEVE DHE ORGANIZATAVE TË TJERA NDËRKOMBËTARE”²

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 36, pika 3, 37, pika 5, dhe 38, pika 3, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 189, datë 4.3.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

² Ky projektvendim është përafëruar pjesërisht me: vendimin e Këshillit, të datës 23 shtator 2013, “Mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-Faqe | 80

së” (2013/488 / BE), nr. CELEX 32013D0488, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 274, datë 15.12.2013, faqe 1–50.

**RREGULLORE****PËR SIGURIMIN FIZIK TË
INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR
“SEKRET SHTETËROR” TË NATO-S, TË
BASHKIMIT EVROPIAN, TË SHTETEVE
DHE ORGANIZATAVE TË TJERA
NDËRKOMBËTARE****KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, në zonat teknike të sigurta, mënyrat e sigurisë fizike dhe evakuimin e informacionit të klasifikuar.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për sigurimin fizik, për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar nga humbja, dëmtimi, rrjedhja, komprometimi ose ekspozimi i paautorizuar.

**Neni 3
Fusha e veprimit**

1. Kjo rregullore zbatohet nga institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë, të cilët duhet të marrin masa për sigurinë fizike të informacionit të klasifikuar.

2. Sigurimi fizik i informacionit të klasifikuar ndërmjet Republikës së Shqipërisë, NATO-s, BE-së, shtetit apo organizatës ndërkombëtare, ndërmjet institucioneve shtetërore të vendit me homologët e tyre, me të cilët janë lidhur marrëveshje ndërkombëtare, bëhet në përputhje me këto marrëveshje.

**Neni 4
Përkufizime**

Në kuptim të kësaj rregulloreje, termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Perimetri i sigurisë”, kufiri fizik i zonave të sigurisë, ku ruhet apo administrohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë.

2. “Struktura e sigurisë/oficeri i sigurisë”, punonjësit/nëpunësit në strukturën organike të institucionit ose të operatorit ekonomik, të caktuar me urdhër të veçantë nga titullari i institucionit ose të administratorit të operatorit ekonomik, të cilët ndjekin dhe mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë.

3. “Dezinfektimi elektronik”, tërësia e masave organizative-teknike, që lidhet me verifikimin e pastërtisë së ambienteve brenda perimetrit të zonave të sigurisë nga ndërhyrjet e paautorizuara me mjete teknike stacionare dhe aparatura elektronike ambientale në ndërtesat, zyrat, dhomat, pajisjet ku prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, transmetohet, ruhet, arkivohet dhe shkatërrohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror”, i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, me qëllim marrjen e këtij informacioni dhe përcjelljen ndaj të tretëve me pasojë cenimin e sigurisë kombëtare.

**KREU II
ZONAT E SIGURISË DHE KRITERET NË
ZONAT TEKNIKISHT TË SIGURTA****Neni 5
Siguria fizike**

1. Të gjitha ambientet, ndërtesat, zyrat, dhomat dhe zonat e tjera, në të cilat informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s dhe BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare ruhet, trajtohet dhe/ose diskutohet, duhet të mbrohet nga masat e dhura të sigurisë fizike.

2. Për nivelin e masave të sigurimit fizik për informacionin e klasifikuar merren parasysh faktorët e mëposhtëm:

- a) Niveli i klasifikimit të informacionit;
- b) Sasia dhe forma e informacionit të klasifikuar (kopje e shtypur dhe/ose elektronike) të ruajtura dhe/ose në proces përpunimi;



c) Kontrolli i aksesit dhe i zbatimit të parimit “nevojë për njohje”;

ç) Kërcënimi nga shërbimet e inteligjencës të vendeve jomiqësore ndaj vendit tonë, të NATO-s, BE-së ose një vendi anëtar të NATO-s ose BE-së;

d) Vlerësimi i kërcënimit në nivel lokal i terrorizmit, spiunazhit, sabotimit dhe krimin të organizuar;

dh) Mënyra e ruajtjes së informacionit të klasifikuar (p.sh.: kopje fizike, elektronike ose i koduar).

3. Masat e sigurimit fizik kanë për qëllim mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare nga:

a) veprimtaria e shërbimeve të huaja;

b) sulmet terroriste;

c) vjedhja, dëmtimi, komprometimi, humbja, shkatërrimi;

ç) njohja nga persona të paautorizuar dhe të pacertifikuar;

d) hyrja e fshehtë ose me forcë në zonat e sigurisë, ku ruhet dhe trajtohet informacioni i klasifikuar;

dh) kërcënimi i brendshëm (duke zbuluar e vepruar);

e) të gjitha incidentet e sigurisë sa më shpejt të jetë e mundur (duke penguar e vepruar).

Neni 6

Zonat e sigurisë

1. Informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i nivelit “Tepër sekret” i NATO-s “*Cosmic Top Secret (CTS)*” dhe i BE-së “*EU Top Secret/Tres Secret UE*” prodhohet e administrohet në zonat e sigurisë të klasit të parë.

2. Informacioni i klasifikuar i nivelit “Sekret” e poshtë, për “Sekretin shtetëror”, i NATO-s dhe BE-së, prodhohet e administrohet në zonat e sigurisë të klasit të parë dhe të dytë.

3. Informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i nivelit “I kufizuar”, i NATO-s “*NATO Restricted (NR)*” dhe i BE-së “*EU Restricted/Restreint UE*” mund të prodhohet dhe administrohet edhe në zonën administrative.

4. Në planin e masave, që shoqëron urdhrin për ndarjen e zonave të sigurisë, përcaktohen edhe:

a) masat e jashtme të sigurisë fizike, që duhet të përcaktojnë qartë perimetrin e sigurisë (gardhi

rrethues), barrierat fizike, ndriçimin e sigurisë, mbulimi me kamera sigurie, të cilat pengojnë hyrjen e paautorizuar në zonat e sigurisë;

b) kontrolli në pikat e hyrjes, sistemin e kontrollit të brendshëm të lëvizjes dhe të zjarrit, mbikëqyrjen me kamera, skemën e vendosjes së rojeve të sigurisë;

c) masat e sigurisë fizike, që lidhen me dyert, dritaret dhe kasafortat/dollapët metalikë, të cilët duhet të pengojnë aksesin e paautorizuar dhe mundësinë e reagimit nga forcat e sigurisë.

Neni 7

Zonat e sigurisë të klasit të parë, të dytë dhe administrative

1. Brenda perimetrit të hapësirave të institucionit dhe operatorëve ekonomikë, ku qarkullon informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, përcaktohen zonat e sigurisë, si më poshtë vijon:

a) “Zonë e sigurisë e klasit të parë” është zona, në të cilën prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, shumëfishohet, ruhet, transmetohet, arkivohet dhe diskutohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, të nivelit “Konfidencial” e lart. Zona të sigurisë të klasit të parë mund të jenë hapësirat ku vendosen njësitë organizative përgjegjëse për informacionin e klasifikuar (protokolli, kartoteka, arkivi), Zyra e Regjistrat Qendror të NATO-s dhe BE-së, zyra e nënregjistrat/pikat e kontrollit të NATO-s dhe BE-së, dhomat e serverit për informacionin e klasifikuar, qendrat e komunikimit, shifra, qendrat operacionale dhe hapësirat e tjera, që vlerësohen nga titullari i institucionit. Një zonë e tillë kërkon:

i. një perimetër të mbrojtur e të përcaktuar qartë;

ii. kontrollin e të gjitha hyrje-daljeve;

iii. kontroll të brendshëm të rreptë dhe të përforcuar;

iv. lejimin e hyrjes vetëm për personat e certifikuar përshtatshëmish dhe të autorizuar specifikisht nga titullari i institucionit për të hyrë në këtë zonë;

b) “Zonë sigurie e klasit të dytë” është zona, në të cilën prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, shumëfishohet, ruhet, transmetohet, arkivohet dhe diskutohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe



organizatave të tjera ndërkombëtare të niveleve “Sekret”, “Konfidencial”, “I kufizuar” në një mënyrë të tillë që kontrollet e brendshme të vendosura shmangin aksesin e paautorizuar në informacion të klasifikuar. Një zonë e tillë kërkon:

- i. një perimetër të mbrojtur e të përcaktuar qartë;
- ii. kontroll të të gjitha hyrje-daljeve;
- iii. një sistem kontrolli, që pranon hyrjen e pashoqëruar vetëm për individët e pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) dhe posaçërisht të autorizuar për të hyrë në këtë zonë. Për të gjithë individët e tjerë, vizitor ose operator ekonomik hyrja do të bëhet e shoqëruar nga personeli i sigurisë ose një person i autorizuar;

c) “Zona administrative” është zona përreth zonave të sigurisë së klasit të parë dhe të dytë, me një perimetër të caktuar, ku ekzistojnë mundësitë për monitorimin dhe kontrollin e personave dhe të mjeteve. Në këto zona mund të administrohet vetëm informacioni i klasifikuar i nivelit “I kufizuar”.

2. Institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë kanë për detyrë të marrin masa për sigurimin fizik të mjediseve ku prodhohet, regjistrohët, shfrytëzohet, shumëfishohet, transmetohet, ruhet, arkivohet dhe shkatërrohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

3. Mirëmbajtja e ambienteve brenda perimetrit të zonave të sigurisë duhet të bëhet në çdo rast dhe gjatë të gjithë kohës, nën mbikëqyrjen e personelit të sigurisë ose personave të autorizuar.

4. Në rastet kur organizohen takime apo konferenca, në të cilat trajtohet informacioni i klasifikuar i NATO-s ose BE-së, ndërmjet institucioneve shtetërore dhe strukturave të NATO-s ose BE-së, masat e sigurimit fizik merren në përputhje me politikën e sigurisë së NATO-s dhe BE-së.

Neni 8

Zona teknike e sigurt dhe kriteret e përcaktimit

1. Zona teknike e sigurt nënkupton një zonë të përcaktuar brenda ose jashtë zonave të sigurisë, për zhvillimin e një takimi, aktiviteti apo konference në të cilën do të diskutohet informacioni i klasifikuar.

2. Zona teknike e sigurt është zona provizore në të cilën organizohen takime që përmbajnë informacion të klasifikuar. Këto zona duhet të plotësojnë këto kriteret:

- a) Të përcaktohet saktë vendi, ambienti brenda apo jashtë institucionit shtetëror, ku do të jetë zona;
- b) Të jenë të përkohshme sipas afatit të zhvillimit të aktivitetit;
- c) Të përcaktohet niveli i klasifikimit të informacionit, që do të trajtohet në zonën teknike e sigurt.

Neni 9

Masat e sigurisë së zonës teknike e sigurt

1. Zona teknike e sigurt propozohet nga oficeri i sigurisë/struktura e sigurisë së institucionit dhe miratohet me urdhër të titullarit të institucionit.

2. Zona teknike e sigurt i nënshtrohet rregullave të sigurisë fizike dhe kërkesave për mbrojtje kundër sulmeve teknike dhe elektronike (përgjimeve).

3. Zona teknike e sigurt mbyllet me çelësa dhe ruhet fizikisht gjatë të gjithë periudhës së takimit, aktivitetit apo konferencës.

4. Në rast se kur në zonën teknike e sigurt diskutohet informacioni i klasifikuar i nivelit “Konfidencial” e lart, duhet që pjesëmarrësit të jenë të certifikuar përshtatshmërisht.

5. Gjatë zhvillimit të takimit, të aktivitetit apo të konferencës në zonën teknike e sigurt ndalohej futja e pajisjeve elektronike të paautorizuara.

6. Përpara zhvillimit të takimit, të aktivitetit apo të konferencës, ku do të trajtohet informacioni i klasifikuar, zona teknike e sigurt i nënshtrohet dezinfektimit elektronik.

7. Masat e sigurisë fizike në zonën teknike e sigurt gjatë të gjithë periudhës së zhvillimit të takimit, aktivitetit apo konferencës, kontrollohen nga oficeri i sigurisë/struktura e sigurisë së institucionit ose persona të tjerë të autorizuar nga titullari i institucionit, të certifikuar përshtatshmërisht, sipas nivelit të informacionit të klasifikuar që do të trajtohet në aktivitet.



KREU III MËNYRAT E SIGURISË FIZIKE

Neni 10

Siguria teknike, elektronike dhe sigurimi me rojë

Institucionet e administratës publike ose operatorët ekonomikë, në kuadrin e një prokurimi të klasifikuar, marrin masa, sipas akteve nënligjore në fuqi, për zbatimin e mënyrave të sigurisë fizike të informacionit të klasifikuar.

Neni 11

Siguria teknike

1. Informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare administrohet nga njësi organizative përgjegjëse për informacionin e klasifikuar dhe mbahet në kasaforta apo dollapë metalikë të vendosur në zonën e sigurisë të klasit të parë.

2. Informacioni i klasifikuar i NATO-s dhe BE-së administrohet nga zyrat e sistemit të regjistrimit qendror të NATO-s dhe BE-së e mbahet në kasaforta të sigurta, të përshtatshme dhe të autorizuar nga AKSIK-u, të vendosura në zonën e sigurisë të klasit të parë. Informacioni i klasifikuar i NATO-s mbahet veçmas nga informacioni i klasifikuar i BE-së.

3. Në fund të ditës së punës ose në rastet kur punonjësi, gjatë orarit zyrtar, largohet, për arsye të ndryshme, nga ambientet e punës, informacioni i klasifikuar sigurohet në kasaforta apo dollapë metalike.

4. Një kopje e çelësave/kodeve të derës së zyrës të njësisë organizative përgjegjëse për informacionin e klasifikuar, mbahet nga eprori direkt, mbyllur në një zarf të siguar me shenjë sigurie dhe e vulosur.

5. Një kopje e çelësave/kodeve të derës dhe të kasafortës të zyrave të sistemit të regjistrimit qendror të NATO-s dhe BE-së mbahet nga eprori direkt, i mbyllur në një zarf të siguar me shenjë sigurie dhe e vulosur.

6. Hapja e zarfit dhe përdorimi i çelësave dhe kodeve bëhet me urdhër të titullarit të institucionit për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Në këto raste me urdhër të titullarit të institucionit

ngrihet një komision me jo më pak se tre anëtarë dhe mbahet procesverbali përkatës.

7. Në ambientet ku prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, transmetohet, ruhet, arkivohet dhe shkatërrohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, lejohet vetëm hyrja e personave të autorizuar nga titullari i institucionit ose eprori direkt dhe të certifikuar përshtatshëmish nga AKSIK-u.

8. Ndalohet futja dhe përdorimi, në ambientet ku punohet me informacionin e klasifikuar, i pajisjeve elektronike të paautorizuara.

9. Ndalohet mbajtja e pajisjeve, të cilat mund të shkaktojnë zjarr, si: furnela elektrike, të gazit, fenerëve ndriçues me lëndë djegëse, si dhe pirja e duhanit në ambientet ku punohet me informacionin e klasifikuar. Ndriçimi dhe rrjeti elektrik vendosen sipas kërkesave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri.

10. Institucionet shtetërore, që punojnë me informacionin e klasifikuar, janë të detyruara të marrin masa për krijimin e barrierave fizike, të cilat mbikëqyren me roja dhe mjete teknike.

11. Barrierat fizike vendosen me qëllim që:

a) të shmangin hyrjen me forcë ose të fshehtë të personave dhe të mjeteve të paautorizuara;

b) të bëjnë të mundur ndarjen e mjedisve për personelin brenda institucionit dhe futjen në zonën e sigurisë vetëm në bazë të parimit të “nevojës për t’u njohur”;

c) të zbulojnë dhe ndalojnë veprimet e personelit të pandershëm, i cili përpiqet të hyjë në informacione me nivele më të larta klasifikimi;

ç) të parandalojnë hyrjen e dukshme dhe të padukshme të personave dhe mjeteve të paautorizuara;

d) të pengojnë hyrjen në zonat e sigurisë të personave e mjeteve të paautorizuara, me qëllimin për t’u dhënë kohë për reagim forcave të sigurisë;

dh) të vendosen procedurat e kontrollit për personat dhe mjetet e autorizuar, përmes pikave të hyrjeve të caktuara.

Neni 12

Siguria elektronike

1. Institucionet e administratës publike ose operatorët ekonomikë në kuadrin e realizimit të një prokurimi të klasifikuar, në çdo zonë sigurie dhe në mjediset ku punohet me informacionin e klasifikuar,



marrin masa për vendosjen e pajisjeve dhe sistemeve të sigurimit elektronik, si: sistem sinjalizimi kundër ndërhyrjeve të paautorizuara, sistem alarmi kundër zjarrit, sistem zbulimi me rreze infra të kuqe të lëvizjeve, sistem monitorimi të rrjetit të kamerave me qark të mbyllur.

2. Monitorimi i sistemeve elektronike të sigurisë kryhet nga persona të certifikuar përshtatshëmish, më parë nga AKSIK-u dhe të autorizuar nga titullari i institucionit apo i operatorit ekonomik.

3. Struktura e sigurisë apo oficeri i sigurisë mbikëqyr dhe verifikon gatishmërinë e këtyre sistemeve. Në rastet e defekteve të sistemit të kontrollit elektronik, riparimi i tyre bëhet në ambientet e miratuara nga titullari i institucionit, brenda zonave të sigurisë, nga persona apo operatorë ekonomikë të kontraktuar për këtë qëllim. Kur riparimi është i pamundur të kryhet në mjediset e institucionit, brenda orarit zyrtar të punës mund të kryhet në mjediset e operatorëve ekonomikë, të certifikuar përshtatshëmish më parë nga AKSIK-u, nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të strukturës së sigurisë së institucionit.

4. Zëvendësimi apo zhvendosja e sistemeve të sigurisë elektronike pasqyrohet në skemën e sigurisë fizike të institucionit dhe miratohet nga titullari.

5. Regjistrimet e sistemit të sigurisë elektronike të ruhen jo më pak se 2 (dy) muaj. Në rastet e ndodhjes së incidenteve të sigurisë, mediat, në të cilat është regjistruar intervali kohor, të ruhen jo më pak se 2 (dy) vjet.

Neni 13

Sigurimi me rojë

1. Në mjediset ku punohet me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, të NATO-s, të BE-së, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare është e nevojshme të merren masa për sigurimin me rojë fikse dhe/ose të lëvizshme, gjatë 24 (njëzet e katër) orëve.

2. Rojat janë përgjegjëse për ruajtjen e zonave të sigurisë, ndërtesave, zyrave dhe mjediseve të tjera ku punohet me informacionin e klasifikuar që u janë dhënë për ruajtje. Ato janë përgjegjëse për sigurimin e objekteve të mësipërme edhe gjatë ditëve të pushimeve, pas orarit zyrtar të punës dhe në situata të veçanta. Rojat dhe patrullat duhet të kenë të qarta detyrat që kryejnë dhe u bëhet instruksion i vazhdueshëm për shërbimin. Ato u nënshtrohen

kontrolleve të vazhdueshme, veçanërisht pas orarit zyrtar të punës, gjatë natës dhe në situata të veçanta.

3. Rregullat dhe vendi i shërbimit të rojave dhe patrullave përcaktohen duke bashkëpunuar me autoritetin që ka në zotërim informacionin e klasifikuar me institucionin që ka detyrimin apo është kontraktuar për të kryer shërbimin e rojës.

4. Rojat dhe patrullat duhet të kenë në mbikëqyrje të gjithë personat dhe mjetet që hyjnë dhe dalin nga zonat e sigurisë.

5. Në vendroje duhet të jetë e afishuar lista e institucioneve, pikat e kontaktit në institucione (struktura e sigurisë) dhe numrat përkatës të telefonit që duhen thirrur në rast emergjence.

6. Rojat duhet të kenë në dispozicion mjete teknike të përshtatshme për kontrollin e personave, të mjeteve dhe të vizitorëve që kanë të drejtë të hyjnë në zonat e sigurisë. Ata kanë të drejtë të pengojnë çdo individ që lëviz në zonat e sigurisë në kundërshtim me rregullat e vendosura.

KREU IV

STRUKTURA E SIGURISË

Neni 14

Struktura dhe oficeri i sigurisë

1. Institucionet e administratës publike apo operatorët ekonomikë, që prodhojnë apo administrojnë informacion të klasifikuar, caktojnë strukturën e sigurisë ose oficerin e sigurisë, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të masave në fushën e informacionit të klasifikuar.

2. Struktura e sigurisë/oficeri i sigurisë është pikë kontakti i institucionit të administratës publike ose operatorit ekonomik, me AKSIK-un për organizimin, koordinimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e të gjitha aspekteve ligjore dhe nënligjore për punën me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, të BE-së, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

Neni 15

Detyrat e strukturës së sigurisë/oficerit të sigurisë

1. Struktura e sigurisë/oficeri i sigurisë, në kuadër të vlerësimit të rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë, të ndjekë dinamikën e ndryshimeve të



akteve normative, në zbatim të legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

2. Struktura e sigurisë/oficeri i sigurisë mbikëqyr dhe inspekton, në mënyrë të vazhdueshme, punën me informacionin e klasifikuar brenda institucionit dhe i raporton titullarit të institucionit dhe, nëpërmjet tij, AKSIK, të gjitha shkeljet dhe incidentet e sigurisë që mund të ndodhin ose kanë ndodhur për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, të BE-së, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

3. Struktura e sigurisë/oficeri i sigurisë i rekomandon titullarit të institucionit masat përkatëse, në rast të konstatimit të shkeljeve ose të mosmarrjes së masave për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, të BE-së, të shteteve apo organizatave të tjera ndërkombëtare, nga strukturat e institucionit.

4. Struktura e sigurisë/oficeri i sigurisë është strukturë përgjegjëse për trajnimet dhe edukimin e personelit të institucionit, i cili, për shkak të detyrave zyrtare, mund dhe duhet të njihet me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, të BE-së, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

5. Struktura e sigurisë/oficeri i sigurisë jep përgjigje ligjore dhe teknike për problemet në fushën e informacionit të klasifikuar, si: të sigurisë fizike, sigurimit të personelit, sigurimit të sistemeve të komunikimit dhe të informacionit, sigurimit industrial, klasifikimit, administrimit, transportimit fizik, deklasifikimit, zhvlerësimit, evakuimit, asgjësimit dhe shkatërrimit.

6. Struktura e sigurisë/oficeri i sigurisë ndjek dhe mbikëqyr instalimin, mirëmbajtjen dhe inspektimin e rregullave të sigurisë fizike për pajisjet e sigurimit teknik dhe elektronik, sigurimin me rojë në institucionin përkatës.

Struktura e sigurisë/oficeri i sigurisë propozon:

a) Urdhrin “Për përcaktimin e zonave të sigurisë”, shoqëruar me planin e masave të sigurisë fizike dhe skemën e sigurisë fizike të objektit;

b) Planin e evakuimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare;

c) Planin e evakuimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe të BE-së, në bashkëpunim me punonjësit e zyrave të nënregjistrimit për informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe të BE-së.

7. Në rastet kur në institucionin shtetëror ka shkelje sigurie apo sinjalizime për veprime, të cilat, në kuadër të vlerësimit të rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë, mund të provokojnë shkelje apo incidente të sigurisë për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, të BE-së, të shteteve apo organizatave të tjera ndërkombëtare, struktura e sigurisë/oficeri i sigurisë i raporton titullarit të institucionit dhe nëpërmjet tij, AKSIK-ut. Titullari i institucionit ngre komisionin për të shqyrtuar çështjen, i cili i raporton lidhur me:

- a) vlerësimin për rastin;
- b) evidentimin e shkeljes së sigurisë ose të veprimeve përkatëse;
- c) personat përgjegjës;
- ç) propozimin për masat përkatëse ndaj tyre, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) masat përkatëse për eliminimin ose parandalimin e dëmit.

KREU V

DEZINFEKTIMI ELEKTRONIK

Neni 16

Rastet e kryerjes së dezinfektimit elektronik

1. AKSIK-u, vetëm me qëllim mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, në mënyrë periodike, kryen dezinfektimin elektronik të ndërtesave, zyrave, dhomave, pajisjeve, ku prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, transmetohet, ruhet, arkivohet dhe shkatërrohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

2. Rastet e kryerjes së dezinfektimit elektronik:

a) Sipas një plani inspektimi vjetor të hartuar nga AKSIK-u për kryerjen e dezinfektimit elektronik në institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomik;

b) Me kërkesë të një institucioni shtetëror në rastet kur organizohen takime, konferenca, seminare, në të cilat trajtohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare;

c) Me kërkesë të argumentuar të një institucioni shtetëror në rastet e realizimit të një prokurimi të klasifikuar;

ç) Në çdo rast kur AKSIK-u, institucioni shtetëror ose operatori ekonomik vlerësojnë se ky proces duhet kryer për shkak të një shkelje apo incidenti sigurie.



3. Drejtori i përgjithshëm i AKSIK-ut miraton planin e dezinfektimit elektronik, i cili do të kryhet në institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë.

Neni 17

Kryerja e dezinfektimit elektronik

1. Dezinfektimi elektronik kryhet nga struktura përkatëse dhe e specializuar e AKSIK-ut, e cila gjatë të gjithë procesit shoqërohet nga struktura e sigurisë ose personi i autorizuar nga titullari i institucionit apo i operatorit ekonomik, të cilët duhet të jenë të certifikuar përshtatshmërisht.

2. Për kryerjen e dezinfektimit elektronik, AKSIK-u njofton zyrtarisht paraprakisht institucionin shtetëror ose operatorin ekonomik.

3. Pas çdo procesi të dezinfektimit elektronik, AKSIK-u harton raportin përkatës ku evidentohen gjetjet, mangësitë e konstatuara dhe rekomandimet përkatëse, një kopje e të cilit i dërgohet titullarit të institucionit ose operatorit ekonomik.

4. Drejtori i përgjithshëm i AKSIK-ut nxjerr udhëzim për strukturën e dezinfektimit elektronik në AKSIK dhe për mënyrën e kryerjes së këtij procesi, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 79, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”.

KREU VII

EVAKUIMI I INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Neni 18

Evakuimi i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare

1. Titullarët e institucioneve, ku punohet me informacionin e klasifikuar, miratojnë planin e detajuar të evakuimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

2. Me shpalljen e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera civile, gjithë personeli që administron informacion të klasifikuar ndjek situatën dhe dorëzon informacionin e klasifikuar dhe pajisjet ku prodhohet, ruhet, transmetohet në vendet dhe strukturat, sipas planit të evakuimit.

3. Strukturat e ngarkuara për evakuim marrin masa për sistemin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në arka metalike. Në kapakun e çdo arke etiketohet:

i. Institucioni përkatës dhe numri i arkës;

ii. Viti i krijimit të fondit ose të fondeve që ndodhet në arkë;

iii. Niveli më i lartë i informacionit që ndodhet në arkë.

4. Transportimi i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare dhe pajisjeve, nga vendi i grumbullimit për në vendet e caktuara për ruajtje, bëhet me mjetet e planifikuara dhe i shoqëruar me roja të armatosura. Institucionet që nuk kanë mundësi shoqërimi me roja të armatosura bashkëpunojnë me Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ose me Gardën e Republikës.

5. Operatorët ekonomikë që administrojnë informacion të klasifikuar, marrin masa për evakuimin e informacionit të klasifikuar në përputhje me këtë rregullore, deri tek autoriteti kontraktor.

Neni 19

Evakuimi i informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së

1. Në rastet e gjendjes së luftës, të gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore dhe të emergjencave të tjera civile, për shmangien e përvetësimit, dëmtimit, komprometimit dhe shkatërrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, si dhe pajisjeve kompjuterike, në të cilat është prodhuar, ruajtur, transmetuar informacion i klasifikuar, institucionet e administratës publike përgatisin plane për mbrojtjen, evakuimin ose shkatërrimin e tij.

2. Titullari i institucionit miraton planin për evakuimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe planin për evakuimin e informacionit të klasifikuar të BE-së.

3. Me shpalljen e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera civile, i gjithë personeli, që administron informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, dorëzon në zyrat e sistemit të regjistrimit



këtë informacion dhe pajisjet ku prodhohet e ruhet ai.

4. Punonjësit e zyrave të sistemit të regjistrimit marrin masa për sistemimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së në arka metalike veçmas. Në kapakun e çdo arke etiketohet:

- institucioni përkatës dhe numri i arkës;
- viti i krijimit të fondit ose të fondeve që ndodhet në arkë;
- niveli më i lartë i informacionit që ndodhet në arkë.

5. Punonjësit e zyrave të sistemit të regjistrimit dhe struktura e sigurisë/oficeri i sigurisë ose persona të autorizuar nga titullari i institucionit marrin masa për transportimin e këtij informacioni për të zyrat e Regjistrimit Qendror, në AKSIK, duke zbatuar planin e evakuimit për informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së.

6. AKSIK-u merr masa për evakuimin e të gjithë informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së të zyrave të sistemit të regjistrimit për në destinacionin përfundimtar.

URDHËR

Nr. 1094, datë 19.12.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24 orësh;
- mishit të freskët;
- materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR, që vërteton mosprezencën e virusit;
- vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të Pseudopestit, ku përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2.5

sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2.3 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës të tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

- 65°C në 39.8 sekonda;
- 70°C në 3.6 sekonda;
- 74°C në 0.5 sekonda;
- 80°C në 0.03 sekonda;

f) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Polonisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	*Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Podlaskie	Mońki	Mońki*
2.	Podlaskie	Mońki	Goniadz*
3.	Podlaskie	Mońki	Krypno (Trzcianne)*
4.	Podlaskie	Sokółka	Janów*
5.	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
6.	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
7.	Podlaskie	Siemiatycze	Drohiczyn*
8.	Podlaskie	Białystok	Wasilków*
9.	Podlaskie	Sokółka	Suchowola*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk kanë pasur njohim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrotjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrotjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara në pikën 1.



5. Urdhri nr. 1066, datë 5.12.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 1095, datë 19.12.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E HUNGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, të tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- d) materialit biologjik të shpendëve;
- e) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Hungarisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	* Ndarja administrative e nivelit 2
Nógrád	Salgótarján*
Békés	Sarkad*
Szabolcs-Szatmár-Bereg	Tiszavasvári*
Szabolcs-Szatmár-Bereg	Nyírbátor*

Szabolcs-Szatmár-Bereg	Mátészalka*
Jász-Nagykun-Szolnok	Tiszafeüred*
Komárom-Esztergom	Komárom*
Békés	Szeghalom*
Békés	Szarvas*
Hajdú-Bihar	Hajdúböszörmény*
Bács-Kiskun	Kiskunfélegyháza*
Bács-Kiskun	Kiskunmajsa*
Bács-Kiskun	Baja*
Hajdú-Bihar	Hajdúhadház*
Hajdú-Bihar	Berettyóújfalu*
Békés	Orosháza*
Bács-Kiskun	Jánoshalma*
Hajdú-Bihar	Polgár*
Bács-Kiskun	Kiskunhalas*
Baranya	Komló*
Komárom-Esztergom	Kisbér*
Jász-Nagykun-Szolnok	Szolnok*
Somogy	Kadarkút*
Bács-Kiskun	Kecskemét*
Hajdú-Bihar	Létavértes*
Csongrád-Csanád	Kistelek*
Bács-Kiskun	Kiskőrös*
Bács-Kiskun	Bácsalmás*
Csongrád-Csanád	Mórahalom*
Csongrád-Csanád	Szentes*
Jász-Nagykun-Szolnok	Mezőtúr*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 1065, datë 5.12.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Hungarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.



Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 1096, datë 19.12.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E HOLANDËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,

nga shteti i Holandës, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	*Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
1	Gelderland	Putten*
2	Friesland	Ferwerderadiel*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë,

zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 1024, datë 26.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 1097, datë 19.12.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GJERMANISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,



nga shteti i Gjermanisë, sipas tabelës së mëposhtme:

*Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Nordrhein	Kleve	Kleve*
Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Reußenköge*
Niedersachsen	Aurich	Dornum*
Niedersachsen	Friesland	Wangerland*
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Parchimer Umland*
Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*

Sbënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 1064, datë 5.12.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 1098, datë 19.12.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE DHIVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E GREQISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, sipas njoftimeve të marra nga faja zyrtare e OIE-s dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Aegean	North Aegean	Lesbos*
Thessaly and Central Greece	Central Greece	Lokroi*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Orestiada*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Alexandroupoli*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Soufli*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Pangaio*
Macedonia and Thrace	Central Macedonia	Emmanouil Pappas*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Maroneia-Sapes*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Didymoteicho*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Arriana*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Nestos*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Iasmos*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Komotini*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Abdera*
Peloponez, Greqia Perëndimore dhe Ishujt Jon	Peloponez	Sikyona*
Thessaly and Central Greece	Thessaly	Rigas Feraios*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Topeiros*
Macedonia and Thrace	Central Macedonia	Volvi*



Thessaly and Central Greece	Central Greece	Dorida*
Thessaly and Central Greece	Central Greece	Karystos*
Thessaly and Central Greece	Thessaly	Mouzaki*
Thessaly and Central Greece	Thessaly	Volos*
Thessaly and Central Greece	Thessaly	Tempi*
Thessaly and Central Greece	Thessaly	Notios Pilios*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Kavala*
Thessaly and Central Greece	Thessaly	Tymavos*
Thessaly and Central Greece	Thessaly	Almyros*
Peloponnese, Western Greece and the Ionian Islands	West Greece	Missolonghi*
Macedonia and Thrace	Central Macedonia	Sithonia*
Thessaly and Central Greece	Central Greece	Kymi-Aliveni*
Aegean	North Aegean	Lemnos*
Aegean	South Aegean	Andros*
Thessaly and Central Greece	Central Greece	Istiaia-Aidipsos*
Macedonia and Thrace	Central Macedonia	Dio-Olympos*
Thessaly and Central Greece	Central Greece	Mantoudi-Limni-Agia Anna*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, nga ndarjet administrative të shtetit të Greqisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.3:

2.1 Për kafshët e llojit të dhirta dhe të leshta certifikata veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për 21 ditët e fundit, në një stabiliment ku nuk është raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve ose dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti nuk ka qenë i vendosur në një zonë të infektuar me linë e dhenve ose të dhive; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine për 21 ditë para dërgesës;

d) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

e) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 4 muaj përpara dërgesës (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë, i çaktivizuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshirë në vaksinë duhet të shënohen në certifikatë).

2.2 Për spermën e cjepëve dhe deshëve, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se kafshët dhuruese:

a) nuk shfaqin asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e mbledhjes së spermës dhe për 21 ditët në vijim;

b) janë mbajtur në vendin eksportues për 21 ditë para grumbullimit, në një stabiliment ose qendër fekondimi artificial ku nuk janë raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve dhe dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti ose qendra e mbarështimit artificial nuk është e vendosur në zonën e infektuar të lisë së dhenve dhe dhive;

c) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

d) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virus i gjallë i inaktivuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshira në vaksinë do të tregohen gjithashtu në certifikatë).

2.3 Për lëkurën dhe leshin e kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se këto produkte:

a) vijnë nga kafshë që nuk janë mbajtur në zonën e infektuar me linë e dhenve dhe të dhive; ose

b) janë përpunuar për të garantuar asgjësimin e virusit të lisë së dhenve dhe dhive, në ambiente të kontrolluara dhe të miratuara nga Autoriteti Veterinar i vendit eksportues.

3. Urdhri nr. 1062, datë 5.12.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Greqisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nënprodukteve të tyre dhe materialit biologjik.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e



Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

URDHËR

Nr. 1099, datë 19.12.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, e tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) mishit të freskët;
- d) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR, që vërteton mosprezencën e virusit;
- e) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, ku përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2.5 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2.3 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës të tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

- 65°C në 39.8 sekonda;
- 70°C në 3.6 sekonda;
- 74°C në 0.5 sekonda;

- 80°C në 0.03 sekonda;

f) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Italisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	*Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Toscana	Florence	Borgo San Lorenzo*
2.	Lazio	Rieti	Rieti*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Italisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara në pikën 1.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj



URDHËR

Nr. 1100, datë 19.12.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E ITALISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtura termikisht,

nga shteti i Italisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	*Ndarja administrative e nivelit 3
Sardegna	Cagliari	Cagliari*
Veneto	Padua	Casale Di Scodosia*
Veneto	Verona	Bonavigo*
Emilia-Romagna	Bologna	Crevalcore*
Emilia-Romagna	Ferrara	Codigoro*
Emilia-Romagna	Ferrara	Lagosanto*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	San Giorgio Di Nogaro*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Villa Vicentina*
Lombardia	Lodi	Zelo Buon Persico*
Emilia-Romagna	Parma	Fontanellato*
Veneto	Treviso	Fontanelle*
Lombardia	Mantua	Guidizzolo*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtura termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 1071, datë 5.12.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 1101, datë 19.12.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E KROACISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;



- c) materialit biologjik të shpendëve;
 d) vezëve të shpendëve;
 dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
 e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,

nga shteti i Kroacisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	* Ndarja administrative e nivelit 2
1	Zagrebačka	Ivanić-Grad*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
 ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 1102, datë 19.12.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
 SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË
 SHFAQUR NË SHETETIN E ZVICRËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për

shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, të btranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

Nga shteti i Zvicrës, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Basel-Stadt	Riehen	Riehen*
Basel-Landschaft	Liestal	Bubendorf*
Basel-Landschaft	Sissach	Zunzgen*
Basel-Landschaft	Waldenburg	Arboldswil*
Jura	Porrentruy	Buix*
Jura	Porrentruy	Bressaucourt*
Jura	Porrentruy	Courgenay*
Jura	Porrentruy	Courtedoux*
Jura	Porrentruy	Dampierreux*
Jura	Porrentruy	Chevenez*
Jura	Porrentruy	Fregécourt*
Jura	Les Franches-Montagnes	Le Noirmont*
Jura	Les Franches-Montagnes	Soubey*
Thurgau	Kreuzlingen	Kemmental*
Solothurn	Dorneck	Metzerlen-Mariastein*
Solothurn	Dorneck	Rodersdorf*
Vaud	Lavaux-Oron	Palézieux*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një



stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrukat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitruka për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipave të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrukat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose me nenin 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinarë shëndetësore të garantojë origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikës 1 dhe 2.

4. Urdhri nr. 832, datë 21.10.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Zvicrës”, dhe urdhri nr. 978, datë 19.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Zvicrës”, shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit ruminantë të vegjël dhe spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit



dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 1103, datë 19.12.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË
SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, të tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

Nga shteti i Polonisë, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Dolnośląskie	Wolów	Wrocław*
Zachodniopomorskie	Pyrzyce	Pyrzyce*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën

60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët.

b) Janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha serotipave të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

c) Certifikata shëndetësore veterinarë të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të



mbledhura në fillim dhe përfundim dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

d) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitruat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose me nenin 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikës 1 dhe 2.

4. Urdhri nr. 1060, datë 5.12.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR Nr. 1104, datë 19.12.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve.

nga shteti i Italisë, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Valle d'Aosta	Aosta	Aosta*
Valle d'Aosta	Aosta	Antey-Saint-André*
Valle d'Aosta	Aosta	Arvier*
Valle d'Aosta	Aosta	Arnad*
Valle d'Aosta	Aosta	Ayas*
Valle d'Aosta	Aosta	Aymavilles*
Valle d'Aosta	Aosta	Bard*
Valle d'Aosta	Aosta	Bionaz*
Valle d'Aosta	Aosta	Brissogne*
Valle d'Aosta	Aosta	Brusson*
Valle d'Aosta	Aosta	Charvensod*
Valle d'Aosta	Aosta	Chambave*
Valle d'Aosta	Aosta	Champorcher*
Valle d'Aosta	Aosta	Chamois*
Valle d'Aosta	Aosta	Chatillon*
Valle d'Aosta	Aosta	Challand-Saint-Anselme*
Valle d'Aosta	Aosta	Challand-Saint-Victor*
Valle d'Aosta	Aosta	Cogne*
Valle d'Aosta	Aosta	Courmayeur*
Valle d'Aosta	Aosta	Donnas*
Valle d'Aosta	Aosta	Emarèse*
Valle d'Aosta	Aosta	Fénis*



Valle d'Aosta	Aosta	Fontainemore*
Valle d'Aosta	Aosta	Gignod*
Valle d'Aosta	Aosta	Gressan*
Valle d'Aosta	Aosta	Gressoney-Saint-Jean*
Valle d'Aosta	Aosta	Hone*
Valle d'Aosta	Aosta	Perloz*
Valle d'Aosta	Aosta	Pont-Saint-Martin*
Valle d'Aosta	Aosta	Pontey*
Valle d'Aosta	Aosta	Pollein*
Valle d'Aosta	Aosta	Roisan*
Valle d'Aosta	Aosta	Rhemes-Saint-Georges*
Valle d'Aosta	Aosta	Nus*
Valle d'Aosta	Aosta	Montjovet*
Valle d'Aosta	Aosta	Morgex*
Valle d'Aosta	Aosta	Issime*
Valle d'Aosta	Aosta	La Salle*
Valle d'Aosta	Aosta	Jovençan*
Valle d'Aosta	Aosta	Lillianes*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Christophe*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Denis*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Marcel*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Nicolas*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Vincent*
Valle d'Aosta	Aosta	Torgnon*
Valle d'Aosta	Aosta	Quart*
Valle d'Aosta	Aosta	Valpelline*
Valle d'Aosta	Aosta	Valtournenche*
Valle d'Aosta	Aosta	Verrayes*
Valle d'Aosta	Aosta	Verres*

Shënim, Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe



ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrukat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10, të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2.

4. Urdhri nr. 1057, datë 5.12.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve të vegjël dhe spermën, dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 1105, datë 19.12.2024

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 555, DATË 22.7.2024, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PESTËS SË RUMINANTËVE TË VEGJËL TË SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË”

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 555, datë 22.7.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pestës së ruminantëve të vegjël të shfaqur në shtetin e Rumanisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

VENDIM

Nr. 81, datë 21.11.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;



Marjana Semini anëtare;
Genti Ibrahimimi anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 19.11.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 12 (S) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: SALI BERISHA, përfaqësuar nga avokatët Klodiana Gjyzari dhe Genci Gjokutaj, me prokurorë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët Arben Kraja dhe Enkeleda Millonai, me autorizim.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, Genci Gjonçaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 112, datë 20.10.2023, dhe nr. 117, datë 26.10.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-384, datë 5.3.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 7, 15, 17, 18, 27, 29, 31, shkronja “b”, 32, pika 2, 38, 42, 46, pika 1, 73, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 7, 10, 14 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 9, 14, 15, 25 dhe 26 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të ratifikuar me ligjin nr. 7510, datë 8.8.1991, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”; nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit Sali Berisha (*kërkuar*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të Kuvendit të

Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), i cili nuk ka mbajtur qëndrim për çështjen, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuar është një politikan, ish-president dhe ish-kryeministër, aktualisht deputet i Kuvendit dhe kryetar i partisë kryesore opozitare.

2. Mbi bazën e një kallëzimi për kryerjen e disa veprave penale nga funksionarë të lartë shtetërorë, të bërë nga shtetasi T.B., i cili në atë kohë ka qenë kryetari i grupit parlamentar të partisë në pushtet, Prokuroria e Posaçme në vitin 2020 ka regjistruar procedimin penal nr. 287 për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (*KP*). Objekti i kallëzimit dhe i hetimit në vijim lidhet me procesin e kthimit të pronës në favor të 5 familjeve ish-pronare, procesin e privatizimit të pronës shtetërore (të objekteve të ish-klubit sportiv “Partizani”), procesin e ndryshimit të destinacionit dhe, më pas, edhe të zhvillimit të pronës.

3. Me urdhrin e datës 2.10.2023, prokurorët e çështjes kanë shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale edhe emrin e kërkuarit Sali Berisha, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim me shtetasit J.M. dhe F.B., të parashikuar nga nenet 260 e 25 të KP-së. Për sa i përket kërkuarit, faktet penale objekt hetimi lidhen me sjelljen e dyshuar të tij gjatë kohës kur ai ka ushtruar funksionin e Kryeministrit, pas vitit 2005, në proceset e kthimit të pronës, të privatizimit të pronës shtetërore (objekteve të klubit sportiv “Partizani” në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Klubit Shumësportesh Partizani në varësi të Ministrisë së Kulturës), të ndryshimit të destinacionit dhe të zhvillimit të pronës, duke favorizuar shtetasit J.M., F.B. e XH.B., ku këta të fundit dhe shoqëria e lidhur me ta kanë realizuar ndërtimin e një blloku pallatesh. Për këto procese dyshohet se janë dhënë dhe marrë përfitime monetare, paligjshmëria në origjinën e të cilave është



fshehur nëpërmjet veprimeve financiare, transaksioneve të copëzuara ose në *cash*.

4. Në datën 16.10.2023 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) kërkesën për caktimin e masave të sigurimit personal ndaj personave nën hetim, përfshirë edhe kërkuesin Sali Berisha, për të cilin është kërkuar vendosja e masave të sigurimit personal “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”, të parashikuara nga nenet 234 dhe 233 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Sipas Prokurorisë së Posaçme, ekziston dyshimi i arsyeshëm, i mbështetur në prova, se nga ana e kërkuesit, në ushtrim të pushtetit të tij si Kryeministër, janë kryer veprime konkrete dhe aktive në drejtim të: përgatitjes dhe miratimit të projektligjeve dhe të projektvendimeve të qeverisë, në bashkëpunim me aleatët e vetë politikë, me qëllim përshtatjen e tyre sipas nevojave që paraqiteshin për pesë familjet ish-pronare, ku përfitues i drejtpërdrejt ishte dhe shtetasi J.M., bashkëshorti i vajzës së tij; kryerjes së kontrolleve administrative, duke shfrytëzuar kompetencat e vartësve të tij, me qëllim ushtrimin e presionit dhe dhënien e urdhrave konkrete për veprime që duhet të kryenin funksionarët që pengonin procesin e privatizimit të klubeve sportive në favor edhe të shtetasit J.M.; vendosjes në dispozicion të shtetasit J.M. të strukturave të ndryshme të administratës shtetërore për realizimin e procesit të kthimit të pronës, privatizimit të pronës shtetërore dhe ndryshimit të destinacionit të pronës edhe në favorin e këtij shtetas. Po ashtu, sipas Prokurorisë së Posaçme, përfitimi i parregullt në favor të shtetasit J.M. lidhet me dyshimin se të gjitha këto procedura, pavarësisht interesit publik në lidhje me nevojën për ambiente sportive, janë bërë me qëllimin e vetëm për të shtënë në dorë pronën dhe për ta përdorur atë për përfitime materiale, ku si të tilla janë konsideruar të gjitha ato përfitime monetare që ky shtetas ka marrë përmes shoqërisë ndërtuese, konkretisht nga shpërndarja e fitimeve të saj të akumuluar ndër vite përpara se ai të deklarohet bashkortak i saj, të llogaritura në shumën 672 976 832 lekë ose 5 420 345 euro.

5. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, gjyqtari i hetimeve paraprake, me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023, ka vendosur të pranojë kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke caktuar për kërkuesin masat e sigurimit personal me karakter shtrëngues

“Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, të parashikuara nga nenet 234 dhe 233 të KPP-së. Sipas asaj gjykate, në rastin konkret plotësohen kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për caktimin e masave të sigurimit, të parashikuara në nenin 228 të KPP-së, pasi nga aktet dhe provat e administruara deri në këtë fazë të hetimeve krijohet dyshimi i arsyeshëm se kërkuesi ka konsumuar elementet e veprës penale për të cilën është proceduar penalisht dhe nuk ekzistojnë shkaqe padënueshmërie ose të shuarjes së saj. Në vijim, sipas asaj gjykate, ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës në funksion të hetimit të çështjes, pasi për shkak të marrëdhënieve të krijuara si rezultat i ushtrimit më parë të funksionit të Kryeministrit, por edhe atij aktual si deputet, sikundër edhe të influencave që mund të ketë te persona të tjerë, ekziston mundësia që personi nën hetim të ndërhyjë dhe ndikojë në prishjen ose asgjësimin e provave, si dhe në krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e tyre, çka do të ndikonte në një hetim të mangët për sqarimin e plotë të faktit penal për të cilin dyshohet. Po ashtu, vijon gjykata, ekziston rreziku i largimit të personit nën hetim nisur nga sanksioni dhe marzhi i lartë që parashikon ligji për veprën penale që ai dyshohet, konkretisht nga 4 deri në 12 vjet burgim. Për sa u takon kriteret për caktimin e masave të sigurimit të parashikuara në nenin 229 të KPP-së, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, ajo ka mbajtur parasysh rëndësinë e faktit dhe rrezikshmërinë e lartë të veprës penale, sanksionin me burgim të parashikuar për të dhe përhapjen e gjerë të saj, rolin e personit nën hetim dhe kryerjen e veprës penale në formën e bashkëpunimit, pasojat e ardhura prej saj, si dhe moshën e gjendjen gjyqësore të personit nën hetim, referuar të cilave masat e sigurimit të kërkuara nga prokurori janë në përshtatje me shkallën e nevojave të sigurimit në rastin konkret.

6. Në datën 23.10.2023 Prokuroria e Posaçme, e ngarkuar për ekzekutimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë nëpërmjet shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, i ka paraqitur asaj gjykate aktin e datës 22.10.2023 në lidhje me zbatimin përmes njoftimit të masës së sigurimit personal të vendosur ndaj kërkuesit. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, gjyqtari i hetimeve paraprake, ka caktuar datën 24.10.2023, ora 13:30 për zhvillimin e seancës për marrjen në pyetje të kërkuesit në funksion të verifikimit të



kushteve dhe të kriterëve të caktimit të masës dhe nevojave të sigurimit. Kërkuesi nuk është paraqitur në atë seancë, por janë paraqitur mbrojtësit e zgjedhur prej tij, të cilët kanë parashtruar disa kërkesa procedurale përpara asaj gjykate, më konkretisht: i. përjashtimin e gjyqtarës së hetimeve paraprake; ii. pajisjen me kopje të akteve që ka depozituar organi i akuzës dhe lënien e një kohe të mjaftueshme për t'u njohur me to; iii. dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për interpretimin e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës. Më pas mbrojtësit e kërkuesit janë larguar nga salla e gjykimit. Në vijim, pas disa shtyrjeve, seanca për pyetjen e kërkuesit është zhvilluar në datën 26.10.2023, në mungesë të tij, ndërsa ai është mbrojtur nga një avokat i caktuar kryesisht nga gjykata, në kushtet kur mbrojtësit e zgjedhur nga kërkuesi nuk janë paraqitur.

7. Për sa u takon kërkesave procedurale të paraqitura nga mbrojtësit e zgjedhur nga kërkuesi, GJKKO-ja e Shkallës së Parë në seancën e datës 24.10.2023 ka vendosur shtyrjen e saj për ditën e nesërme, në datën 25.10.2023, me qëllim për t'u dhënë mundësi mbrojtësve të kërkuesit të njihen me aktet e procedimit, si dhe për të paraqitur në formën e kërkuar nga ligji kërkesën për përjashtimin e gjyqtarës së hetimeve paraprake mbi shkakun se vendimi i caktimit të masës së sigurimit është në shkelje të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës dhe se për këtë kanë paraqitur kallëzim penal ndaj saj. Në vijim, në seancën e datës 25.10.2023, ku sërish janë paraqitur vetëm mbrojtësit e zgjedhur nga kërkuesi, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur të rrëzojë kërkesën e paraqitur në atë seancë për dërgimin e çështjes në Gjykatë për interpretimin e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, të shprehjes “t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme”, me arsyetimin se nuk vërehen dyshime për paligshmëri kushtetuese për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues incidental. Edhe në këtë seancë mbrojtësit e kërkuesit kanë deklaruar se kërkojnë përjashtimin e gjyqtarës së hetimeve paraprake për të njëjtin shkak të artikuluar edhe më parë, kërkesë të cilën do ta paraqisnin pasi të merrnin procesverbalin audio të seancës, përveçse edhe dhënien e një kohe të mjaftueshme për t'u njohur me aktet e depozituara nga organi i prokurorisë, duke u larguar sërish nga salla e gjykimit. Seanca për marrjen në pyetje të kërkuesit është shtyrë nga gjykata për ditën e nesërme, në datën 26.10.2023, me qëllim dhënien e mundësisë mbrojtësve të kërkuesit

për t'u njohur me aktet e procedimit penal. Ndërsa, kërkesa me shkrim në formën e kërkuar nga ligji për përjashtimin e gjyqtarës së hetimeve paraprake është paraqitur vetëm në datën 26.10.2023, ndërkohë që ajo dhe është shqyrtuar po atë ditë, nga një gjyqtare tjetër e asaj gjykate, e cila, me vendimin nr. 430, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se nuk ekziston asnjë nga rastet ligjore të parashikuara nga neni 17 i KPP-së që të ketë ndikuar në sjelljen e gjyqtarës së hetimeve paraprake, e cila të sillte cenimin e paanshmërisë. Seanca e marrjes në pyetje të kërkuesit është zhvilluar në këtë datë (26.10.2023), në mungesën e tij dhe në prani të një mbrojtësi të caktuar kryesisht nga gjykata, ndërsa mbrojtësit e zgjedhur nga kërkuesi nuk janë paraqitur pa njoftuar gjykatën për ndonjë shkak të arsyeshëm.

8. Në përfundim të seancës për marrjen në pyetje, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 117, datë 26.10.2023, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masave të sigurimit të vendosura nga ajo më herët ndaj kërkuesit, ku për sa i përket masës “Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore” ka urdhëruar kërkuesin të paraqitet të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10:00, përpara oficerit të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Posaçme, ndërsa për sa i përket masës “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” ka urdhëruar kërkuesin të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, si dhe ndalimin e përdorimit të pasaportës dhe të dokumenteve të tjera identifikuese të vlefshme për daljen jashtë shtetit të tij.

9. Në vlerësimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, edhe pas seancës së pyetjes së personit nën hetim, në mungesë të parashtrimit nga ai të fakteve, argumenteve apo provave në dobi të tij, ndërsa në mënyrë të vullnetshme ka zgjedhur të mos paraqitet duke hequr dorë kështu nga e drejta për t'u pyetur (dëgjuar), rezulton se kushtet dhe kriteret e caktimit të masës, si dhe nevojat e sigurimit të mos kenë ndryshuar, pra ato vijojnë të ekzistojnë, ndaj, për rrjedhojë, zbatimi i masave të sigurimit të caktuara ndaj kërkuesit me vendimin e saj nr. 112, datë 20.10.2023 duhet të vazhdojë. Për këtë, po sipas asaj gjykate, mbahet në konsideratë edhe sjellja e kërkuesit, pas njoftimit të masës, ndërsa referuar deklaratave të tij për të mos e zbatuar atë, ngrihet dyshimi për rrezikun se ai nuk do të jetë në dispozicion të organit procedues gjatë hetimeve paraprake. Ajo gjykatë ka analizuar edhe pretendimin e mbrojtjes së kërkuesit për shkeljen e



nenit 73, pika 2, të Kushtetutës në caktimin e masave të sigurimit ndaj kërkuesit, në kushtet e mungesës së autorizimit nga ana e Kuvendit, duke e gjetur atë të pabazuar.

10. Kundër vendimeve të GJKKO-së së Shkallës së Parë, atij nr. 112, datë 20.10.2023, për caktimin e masave të sigurimit personal dhe atij nr. 117, datë 26.10.2023, për vazhdimin e zbatimit të masave të sigurimit personal, kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit, në përfundim të shqyrtimit të të cilit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*), me vendimin nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, ka vendosur miratimin e vendimeve të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Edhe GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se plotësohen kushtet për caktimin ndaj kërkuesit të masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues dhe se masat e caktuara dhe të zbatuara ndaj tij janë në përputhje me kriteret dhe nevojat e sigurimit në rastin konkret. Sipas saj, ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova për kryerjen nga kërkuesi të veprës penale për të cilën është proceduar penalisht, se nuk ka shkaqe padënueshmërie apo të shuarjes së saj, si dhe se ekziston rreziku i “helmimit” të marrjes ose vërtetësisë së provave, sikundër edhe ai i largimit të kërkuesit. GJKKO-ja e Apelit ka shqyrtuar pretendimet e ngritura në ankim për shkeljen e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, për mungesën e paanësisë së gjyqtarës së hetimeve paraprake, për shkeljen e së drejtës së mbrojtjes efektive dhe për mungesën e arsytimit të vendimit gjyqësor, ku pas një analize të bëra atyre, ka arritur në përfundimin se janë të pabazuara. Kundër vendimit të GJKKO-së së Apelit kërkuesi ka paraqitur rekurs.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-384, datë 5.3.2024, ka vendosur mospranimin edhe të rekursit të paraqitur nga kërkuesi, duke vlerësuar se është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, gjykatat kanë argumentuar mjaftueshëm dhe në mënyrë ezauruese kushtet dhe kriteret për caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues dhe proporcionalitetin e tyre. Po ashtu, Kolegji Penal ka arsyetuar se gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje pretendimeve në ngritura në ankimin e mbrojtësve të kërkuesit, ndërsa në vendimarrjen e saj nuk konstatohet mosrespektim ose zbatim i gabuar i ligjit material apo procedural penal me

rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, apo me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, sikundër nuk konstatohet që vendimi i saj të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

12. Në datën 29.7.2024 kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në po të njëjtën datë. Me vendimin e datës 17.9.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Ndërkohë, në datën 16.9.2024 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatë kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të gjykimit të çështjes së tij, e cila është pranuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin e datës 17.9.2024.

13. Pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, në datën 15.10.2024, një gjyqtar i Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, e cila është rrëzuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin nr. 23/1, datë 17.10.2024. Gjithashtu, edhe kërkuesi në datën 18.10.2024 ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e këtij gjyqtari nga shqyrtimi i çështjes, e cila, po ashtu, është rrëzuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin nr. 24, datë 6.11.2024.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

14. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se në caktimin e masave të sigurimit ndaj tij gjykatat kanë zhvilluar një proces jo të rregullt, në drejtim të:

14.1. *Parimit të paanshmërisë në gjykim dhe të pavarësisë*, pasi: i. në aspektin objektiv gjyqtarët e GJKKO-së nuk ofrojnë garanci paanësie apo pavarësie, sepse sipas neneve 48-51 të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar (*ligji nr. 95/2016*), të gjitha komunikimet elektronike dhe të tjera të gjyqtarëve, përfshirë edhe ato familjarëve të tyre, janë të vëzhguara. Ky vëzhgim është i pakufizuar në kohë dhe hapësirë, kryhet pa asnjë arsye specifike, si edhe nuk monitorohet *a priori* ose kontrollohet *a posteriori* nga ndonjë gjykatë në lidhje me



proporcionalitetin e kësaj ndërhyrjeje. Për më tepër, vëzhgimi realizohet nga hetuesi i telekomunikimeve që është pjesë e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), e cila varet nga Prokuroria e Posaçme, që është organi që ka kërkuar masat e sigurimit personal në rastin e kërkuarit dhe i mbron ato përpara gjykatave; ii. në *aspektin subjektiv*, gjyqtarja e GJKKO-së I.GJ., që ka vendosur masën shtrënguese ndaj kërkuarit, është shkarkuar nga detyra e gjyqtare nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) në vitin 1996, kohë kur ky institucion kryesohej nga kërkuari në cilësinë e Presidentit të Republikës.

14.2. *Së drejtës së mbrojtjes efektive*, pasi: i. kërkuari nuk është njoftuar për përmbajtjen e vendimit nr. 112, datë 20.10.2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë sipas rregullave të parashikuara nga neni 246, pika 3, i KPP-së. Në këtë mënyrë, gjykimi i verifikimit të kushteve të zbatimit të masës së sigurimit është zhvilluar pa u njohur kërkuari me vendimin e arsyetuar me të cilin janë caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij. ii. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk i ka dhënë kohën e mjaftueshme mbrojtësve të zgjedhur nga kërkuari për të realizuar një mbrojtje efektive. iii. Mbrojtësja e caktuar kryesisht nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, shtetasja V.T., ishte e papërshtatshme për të mbrojtur kërkuarin, për shkak të qëndrimeve të saj kundër tij në rrjetet sociale. Ajo duhej të përjashtohej si avokat i caktuar kryesisht për të njëjtin shkak që u përjashtua edhe avokati i mëparshëm i caktuar kryesisht. iv. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk e ka dorëzuar vendimin e arsyetuar sipas afatit të përcaktuar nga neni 248, pika 2, i KPP-së.

14.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit*, pasi: i. Kolegji Penal nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs dhe atyre që kishin të bënin me interpretimin dhe zbatimin e gabuar të dispozitave procedurale penale; ii. në vendimin e tij Kolegji Penal nuk përdor gjuhën shqipe, por një gjuhë me terma dhe fjali të pakuptueshme, të cilat krijojnë konfuzion dhe nuk përcjellin vijimësi të mendimit logjik e juridik dhe konkluzionit të arritur, duke e bërë vendimin të pakuptueshëm; iii. vendimet e gjykatave përmbajnë të dhëna kontradiktore, nuk janë logjike dhe nuk i kanë dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të kërkuarit; (iv) gjykatat nuk kanë marrë parasysh asnjë nga provat dhe pretendimet e

ngritura nga kërkuari dhe nuk kanë analizuar provat e ndodhura në dosjen gjyqësore.

14.4. *Parimit të proporcionalitetit*, pasi gjykatat nuk kanë arsyetuar nevojshmërinë e caktimit të masave të sigurimit personal ndaj kërkuarit, duke cenuar lirinë e tij personale dhe atë të lëvizjes, të drejtën për t'u zgjedhur dhe të drejtë të tjera kushtetuese. Masa e sigurimit personal ndaj kërkuarit është caktuar në shkelje të ligjit, nuk është e arsyeshme ose e nevojshme dhe është qartazi joproporcionale me qëllimin e kërkuar. Procedimi penal ndaj kërkuarit ka filluar në datën 1.12.2020, pas kallëzimit të deputetit T.B., i cili që prej vitit 2012 ka dalë publikisht me të njëjtat pretendime me ato të pasqyruara në kallëzim. Ndërkohë kërkuari nuk ushtron asnjë funksion në administratën publike përveç atij të deputetit. Aktet për të cilat akuzohet janë akte normative me efekt të përgjithshëm dhe nuk i drejtohen një personi apo grupi personash të caktuar. Që nga momenti i fillimit të hetimit paraprak në datën 1.12.2020, për fakte që kanë ndodhur në vitin 2012, dhe deri në datën 16.10.2023, kur është dorëzuar kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal, për kërkuarin nuk ka asnjë të dhënë, dëshmitar, shkresë ose indicie të largët, nga e cila të rezultojë se ai në ndonjë mënyrë ka ndikuar mbi këto akte ose të jetë përpjekur të zhdukë ndonjë prej tyre. Gjykatat nuk arsyetojnë në vendimet e tyre se në cilën mënyrë kërkuari ka ndikuar për ndryshimin e akteve ligjore ose nënligjore të propozuara apo miratuara prej tij, pra të ketë ndikuar mbi provat.

14.5. *Kufizimit të lirive kushtetuese* të kërkuarit, pasi kanë tejkaluar qëllimet për të cilat lejohet kufizimi, duke cenuar nenin 17 të Kushtetutës dhe nenin 18 të KEDNJ-së. Procedimi penal ka filluar para tre vjetësh, për fakte të cilat pretendohet se kanë ndodhur më shumë se 10 vjet më parë dhe që kallëzuesi i ka pretenduar që prej vitit 2012. Qëllimi i vërtetë i izolimit të kërkuarit ka qenë shuarja e zërit të opozitës dhe jo zbulimi i të vërtetës dhe shkaqet për të cilat janë caktuar masat e sigurimit ndaj tij kanë pasur si qëllim pengimin që ai të organizojë opozitën.

14.6. *Mosrespektimit të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës*, duke i kufizuar kërkuarit lirinë personale dhe atë të lëvizjes, të mbrojtura nga nenet 27 dhe 38 të Kushtetutës, në kundërshtim me procedurën e parashikuar në këtë dispozitë, pa autorizim të Kuvendit. Togfjalëshi i përdorur në nenin 73, pika



2, të Kushtetutës “... *t’i hiqet liria në çfarëdo lloj forme*” nuk nënkupton, në asnjë rast, vetëm caktimin e masave të sigurimit personal “Arresti në burg” ose “Arresti në shtëpi”, por përfshin edhe masat e sigurimit personal të vendosura ndaj kërkuesit, të cilat i kanë kufizuar lirinë personale dhe të lëvizjes.

14.7. *Mosrespektimi të nenit 73, pika 1, të Kushtetutës*, pasi i. kërkuesit i është kufizuar liria personale dhe e lëvizjes për fakte të cilat mbrohen nga imuniteti absolut i deputetit. Kërkuesi nuk mund të ndiqet penalisht për veprimet e kryera në ushtrim të detyrës së deputetit; ii. ndaj kërkuesit, drejtues i opozitës parlamentare, është zbatuar një standard i ndryshëm nga ai i mbajtur në rastin e ish-deputetit të shumicës parlamentare dhe ish-ministrit S.T., ku Kuvendi ka vlerësuar se masat e sigurimit personal “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” dhe “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” janë masa shtrënguese të heqjes së lirisë. Interpretimi i Kuvendit në atë rast është ai që duhej të ndiqej nga gjykatat edhe në rastin e tij, pra se masat e sigurimit të caktuara ndaj kërkuesit janë masa shtrënguese të heqjes së lirisë, për të cilat duhet autorizim nga Kuvendi.

14.8. *Kufizimi të të drejtave kushtetuese për veprime që nuk parashikohen nga ligji si veprë penale*, pasi: i. kërkuesi është akuzuar për miratimin e akteve normative me fuqi juridike në të gjithë territorin dhe jo për akte individuale që kanë për qëllim favorizimin e një personi, siç është rasti i bashkëshortit të vajzës së kërkuesit ose një grupi të përcaktuar personash; ii. gjykatat nuk kanë evidentuar se disa nga ndryshimet në aktet ligjore dhe nënligjore, për të cilat kërkuesi akuzohet se i ka kryer për të favorizuar shtetasin J.M., janë bërë gjatë kohës kur në pushtet ka qenë shumica qeverisëse. Për më tepër, nga verifikimi i ndryshimeve ligjore dhe nënligjore për të cilat akuzohet kërkuesi, evidentohet se janë pothuajse të njëjtat formulime me parashikimet e mëparshme, por edhe me parashikimet ligjore të cilat janë aktualisht në fuqi dhe që nuk janë propozuar nga kërkuesi; iii. nuk ekziston asnjë lidhje shkakësore midis akteve nënligjore të miratuara nga organet shtetërore të drejtuara nga kërkuesi në cilësinë e Kryeministrit dhe interesave pasurorë të shtetasit J.M.; iii. nuk rezulton të jetë vërtetuar asnjë nga elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar kërkuesi. Ai nuk rezulton të ketë qenë pjesë e komisionit që ka përgatitur ndryshimet e ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” dhe as të ketë propozuar

asnjëherë ligje si deputet. Edhe ndryshimet e bëra në ligjin për sportin, të cilat janë bërë edhe me mbështetjen e deputetëve të Partisë Socialiste, nuk kanë pasur ndikim dhe nuk mund të ndikojnë në procesin e kthimit apo kompensimit ose në procedurat e privatizimit në favor të familjes, trashëgimtar i së cilës është edhe dhëndri i kërkuesit, shtetasi J.M.

14.9. *Parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve*, pasi duke hetuar dhe ngritur akuza mbështetur në vlerësimin nëse dy ligje dhe vendimi i Këshillit të Ministrave kanë qenë të nevojshme apo të drejta, si dhe mbi bazueshmërinë në prova të disa akteve të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), Prokuroria e Posaçme ka marrë kompetencat e Kuvendit, Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të zakonshme. Prokuroria e Posaçme ka vlerësuar: i. politikën sociale dhe ekonomike, pra programin e qeverisë, duke marrë kompetencat e Kuvendit; ii. nevojshmërinë, drejtësinë apo procedurën e diskutimit dhe miratimit të ligjeve e akteve nënligjore, duke marrë kompetencat e Gjykatës; iii. bazueshmërinë në ligj të vendimeve të formës së prerë të AKKP-së, duke marrë atributet e gjykatave civile; iv. qëllimet dhe përfitimet e palëve në kontrata civile, duke cenuar lirinë kontraktore.

15. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

15.1. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e *parimeve të pavarësisë dhe paanshmërisë* është i pabazuar. Kërkuesi nuk ka arritur të provojë paanshmërinë ose mungesën e pavarësisë së gjyqtarëve, si në aspektin objektiv ashtu edhe atë subjektiv, pasi: i. Ligji nr. 95/2016 ka vendosur garanci të rëndësishme gjatë procesit të monitorimit, ku oficerit përgjegjës nuk i lejohet të dëgjojë telefonatat që cenojnë të drejtën për jetë private të personave që nuk kanë dhënë miratim paraprak për vëzhgim. Ligji nr. 95/2016 e ka kaluar vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën që i është bërë në konsultimin e draftit final nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë në datën 3.10.2016. Në thelb argumentet e kërkuesit në këtë drejtim kanë të bëjnë me shfuqizimin e dispozitave ligjore. Ndërkohë që Gjykata kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji që rishikon Kushtetutën, nuk shqyrton përmbajtjen ose përputhshmërinë e amendamenteve kushtetuese me Kushtetutën e mëparshme, por vetëm procedurën me të cilën janë



miratuar këto ndryshime. Për rrjedhojë, edhe kushtetutshmëria e dispozitave të ligjit nr. 95/2016 nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata. ii. Për sa i përket pretendimit për paanshmërinë subjektive të gjyqtarës I.GJ., kërkuesi u referohet ngjarjeve të vitit 1996, pra një marrëdhënieje të përfunduar para 27 vjetësh, për të cilat nuk ka sjellë asnjë provë në mbështetje të këtij pretendimi.

15.2. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e *së drejtës së mbrojtjes efektive* është i pabazuar, pasi: i. për vendimin nr. 112, datë 20.10.2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë janë kryer të gjitha veprimet për t'ia vënë në dispozicion kërkuesit, por ai ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë për të mos e marrë atë, duke refuzuar kështu njohjen me vendimin; ii. në seancën gjyqësore të datës 24.10.2023 vendimi u është vënë në dispozicion mbrojtësve të kërkuesit, duke qenë se ata gëzonin tagrat për të marrë në dorëzim akte për llogari të kërkuesit. Mbrojtësve të kërkuesit u është lënë një kohë e mjaftueshme për t'u njohur me aktet e dosjes për të realizuar mbrojtjen e tij, por ata zgjodhën të mbroheshin duke kërkuar shtyrjen e seancës dhe nëpërmjet kërkesave të tjera procedurale; iii. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vepruar në respektim të të drejtave të kërkuesit, duke i caktuar atij edhe mbrojtës kryesisht.

15.3. Pretendimet për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* dhe të *së drejtës së aksesit* janë të pabazuara, pasi gjykatat i kanë kushtuar vëmendjen e duhur provave të paraqitura, analizës së tyre, bazës ligjore dhe kanë konkluduar më pas në vendimmarrjet respektive. Pretendimet e kërkuesit kanë marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat dhe vendimi për caktimin e masës së sigurimit përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 245 të KPP-së. Edhe vendimet e GJKKO-së së Apelit dhe Gjykatës së Lartë i përmbajnë elementet për arsyetimin e tyre dhe vendimet e kundërshtuara janë logjike, nuk kanë kundërthënie, si dhe përmbajnë referenca në ligjin e zbatueshëm.

15.4. Edhe pretendimi për cenimin e *lirisë personale*, në kundërshtim me nenet 27 dhe 38 të Kushtetutës, është i pabazuar, pasi nga leximi i neneve 27 dhe 28 të Kushtetutës konstatohet se bëhet fjalë për burgosje të individit ose heqje të lirisë në kuptimin e kapjes së tij. Neni 73 i Kushtetutës nuk ka si qëllim mbrojtjen e çdo lloji lirie, pasi kjo do të binte në kundërshtim me atributet e tjera për të cilat prokurorisë i është lejuar të veprojë pa autorizim të Kuvendit. Autorizimi i Kuvendit

kërkohet vetëm në rast se kërkohet “Arresti në burg” ose “Arresti në shtëpi” dhe jo për çdo lloj heqje lirie të mundshme të personit nën hetim. Termat “në çfarëdo lloji forme” nuk nënkuptojnë “çfarëdo lloji lirie”. Në rastin e ish-deputetit dhe ish-ministrit S.T., Prokuroria e Posaçme nuk ka kërkuar të njëjtat masa sigurimi si në rastin e kërkuesit, por ka kërkuar autorizim për arrestimin e tij, duke mos qenë para rasteve të njëjta. Masa e sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” e vendosur ndaj kërkuesit nuk e ka kufizuar në lirinë e lëvizjes brenda territorit, pjesëmarrjes në Kuvend apo komisione parlamentare, si dhe kryerjen e të gjitha aktiviteteve të tij personale. Ky ndalim nuk është vendosur në atë masë që të barazohet me heqjen e lirisë.

15.5. Pretendimet për kufizimin e *lirisë personale dhe të lëvizjes* për fakte të cilat ai gëzon imunitet, sipas nenit 73, pika 1, i Kushtetutës janë të pabazuara, pasi kërkuesi nuk është ngarkuar me përgjegjësi penale vetëm se ka miratuar ligje apo akte nënligjore, por për faktin se sjellja e tij ka pasur si qëllim dhe motivim realizimin e objektivave të kërkuar nga subjekti aktiv i mitës dhe jo në funksion të ushtrimit të detyrës që i është besuar. Këto objektiva në një pikë përputhen edhe me ato të dhëndrit të tij si trashëgimtar i familjes në favor të cilës është kthyer prona, me qëllim shtënien në dorë të mitës, përfitimit të premtuar. Ai ka ushtruar pushtetin e tij në mënyrë të paautorizuar, duke i dhënë formën që ka dëshiruar ligjeve dhe akteve nënligjore për t'ia përshtatur interesave të familjes së tij.

16. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, ka sjellë përpara Gjykatës raportin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, të shumicës parlamentare, si dhe vendimin nr. 127, datë 21.12.2023 të Kuvendit për miratimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin/heqjen e lirisë së deputetit Sali Berisha, por nuk ka paraqitur prapësime me shkrim dhe qëndrim të tijin në lidhje me çështjen.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

17. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “P” dhe 2, të



Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si edhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Gjykata vëren, fillimisht, se kërkuksi ka kundërshtuar në objektin e kërkesës vendimet gjyqësore që kanë caktuar ndaj tij masat e sigurimit personal. Ndërkohë, në përmbajtje të ankimit kushtetues kërkuksi ka sjellë argumente që lidhen me cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë, duke ngritur si shkak papajtueshmërinë me Kushtetutën të neneve 48 - 51 të ligjit nr. 95/2016 dhe duke pretenduar, në thelb, se për shkak të përmbajtjes së tyre atij i është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh se objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues (*shih vendimin nr. 22, datë 11.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se sipas nenit 48, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000: “kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të”, Gjykata, në vijim, duke e konsideruar si një kërkim të mëvetshëm verifikimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të përmbajtjes së dispozitave ligjore të ligjit nr. 95/2016³, vlerëson të ndalet në verifikimin e kriterëve të legjitimitetit të kërkuksit në drejtëm të secilit prej kërkimeve të kërkesës në shqyrtim.

19. Gjykata, bazuar në parashikimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe neneve 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë se objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ, ka vlerësuar se kërkuksi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriterë: *i.* individ i provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të

pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (*legjitimimi ratione personae*); *ii.* janë shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individ i provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; *iii.* ankimi është paraqitur brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*legjitimimi ratione temporis*); *iv.* individ i provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*legjitimimi ratione materiae*) (*shih vendimet nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Kërkuksi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore që kanë caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij, pasi ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

21. Në lidhje me kërkimin e kërkuksit për cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë, për shkak të parashikimeve të ligjit nr. 95/2016, Gjykata vëren se ligji nr. 95/2016 ka si objekt të tij, ndër të tjera, përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme, e cila është organi që ka vënë në lëvizje këtë proces penal ndaj kërkuksit, sikundër edhe të Njësisë së Posaçme Hetimore, organe kushtetuese këto sipas pikës 4 të nenit 148 të Kushtetutës; përcaktimin e kushteve dhe kriterëve shtesë të sigurisë që duhet të përmbushin gjyqtarët, ndër të tjera, edhe për t'u ngritur në detyrë si gjyqtarë pranë gjykatave të posaçme; përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e procesit të kontrollit të figurës, vëzhgimit të të dhënave financiare dhe të telekomunikacioneve, ndër të tjerë, edhe të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme dhe të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre (neni 1). Sipas nenit 6, pika 1, të ligjit, ndër të tjerë, kandidati për gjyqtar në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit

pavarësisë dhe paansësisë së gjyqtarit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, në funksion të testit objektiv të paansësisë të gjyqtarit, dhe jo si kërkim me vetë.

³ Gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahim i vlerësuan që parashtrimet e kërkuksit lidhur me efektin e këtyre dispozitave të trajtoheshin si argumente në funksion të kërkimit për konstatimin e cenimit të parimeve të



dhe krimi të organizuar duhet të plotësojë kushtet e sigurisë përpara se të caktohet në këtë pozicion dhe asnjë kandidat nuk mund të caktohet në detyrë pa plotësuar këto kushte. Sipas shkronjave “a” dhe “b” të së njëjtës dispozitë të ligjit (nenit 6, pika 1), kushtet e sigurisë para caktimit në detyrë janë: a) kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe të figurës; b) dhënia e pëlqimit nga kandidati për kontrollin periodik të llogarive të tij bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, për të cilën ai plotëson dhe nënshkruan një deklaratë standarde me shkrim; c) dhënia e pëlqimit nga anëtarët e afërt të familjes së kandidatit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, për të cilën ata plotësojnë dhe nënshkruajnë një deklaratë standarde me shkrim. Ndërkohë, rregullat për organizimin dhe funksionimin e procesit të kontrollit të kushteve të sigurisë për besimin dhe konfidencialitetin edhe për kandidatin për gjyqtar të gjykatave të posaçme, janë parashikuar në kreun III të të njëjtit ligj, përkatësisht nenet 48–54, ku përfshihen edhe dispozitat e kundërshtuara nga kërkuesi (nenet 48–51). Në këto dispozita përcaktohet mënyra e heqjes dorë nga të drejtat si kusht për caktimin në detyrë edhe të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme, vëzhgimit periodik të llogarive financiare dhe telekomunikimeve, organi dhe personi përgjegjës për mbikëqyrjen, si dhe roli i prokurorit të posaçëm në kuadër të këtij procesi kontrolli periodik edhe i gjyqtarëve të gjykatave të posaçme.

22. Gjykata vëren se për sa kohë që dispozitat e kundërshtuara nga kërkuesi janë të zbatueshme edhe ndaj gjyqtarëve që ka caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, dhe për sa kohë që kërkuesi ka vënë në dyshim parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë së asaj gjyqtareje, për shkak të rolit të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme në procesin e kontrollit periodik të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme, sipas dispozitave të kundërshtuara, ky pretendim lidhet me garantimin e së drejtës kushtetuese për një proces të drejtë, ndaj konsiderohet se kërkuesi ka justifikuar interesin e tij për të kërkuar shfuqizimin e dispozitave të ligjit nr. 95/2016.

23. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të zbatohet në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore.

Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata vëren se ajo është vënë në lëvizje për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të vendimeve gjyqësore që kanë caktuar ndaj kërkuesit masat e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”. Për shkak të natyrës së ndërmjetme, jo përfundimtare, të këtyre vendimeve, për sa kohë që ato janë dhënë në kuadër të një procedimi penal që është ende duke u zhvilluar, Gjykata do të analizojë në vijim nëse përjashtimisht ato mund të konsiderohen përfundimtare për ushtrimin e kontrollit kushtetues ndaj tyre.

25. Në këtë kuptim, në jurisprudencën kushtetuese janë evidentuar disa kritere që duhet të plotësojë një vendim i ndërmjetëm në mënyrë që të konsiderohet përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës. Konkretisht, Gjykata ka përcaktuar se ai: i. duhet të ketë vendosur një kufizim mbi të drejtën e individit të pretenduar të cenuar, pra që shkelja e pretenduar të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar, që do të thotë se kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes të së drejtës kushtetuese; ii. duhet të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; iii. duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm, në kuptimin që të riparohet në masën e duhur efektet që ai ka sjellë. Kjo do të thotë se cenimi është në atë masë dhe formë që pasojat e ardhura është e vështirë ose e pamundur të riparohen gjatë procesit të themelit (*shih vendimet nr. 22, datë 4.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 14, datë 11.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin në shqyrtim ankimi kushtetues individual i kërkuesit në pjesën që kundërshton kushtetutshmërinë e vendimeve gjyqësore është



mbështetur në dy pretendime kryesore: *i pari*, për cenimin e lirisë personale dhe asaj të lëvizjes, për shkak se prokuroria dhe gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, në kushtet kur kërkuesi është deputet i Kuvendit, për rrjedhojë çdo kufizim i këtyre lirive duhet të bëhet me autorizim të Kuvendit, por edhe cenimin e së drejtës për t'u zgjedhur si rezultat i vendosjes ndaj tij të masave të sigurimit në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, të lidhur edhe me statusin e tij si deputet dhe drejtues i partisë më të madhe opozitare; *i dyti*, për cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të parimit të paanshmërisë në gjykim, së drejtës për mbrojtje efektive, si edhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit.

27. Gjykata, duke pasur parasysh qasjen e saj në drejtim të rasteve përjashtimore për kontrollin e vendimeve që vendosin masa me karakter të ndërmjetëm, ka pohuar se ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues në drejtim të të drejtave substanciale. Ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar. Në këtë kuptim, Gjykata ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Duke iu referuar pretendimeve të kërkuesit, si dhe duke pasur parasysh natyrën e të drejtave që vihen në diskutim (*shih paragrafin 21*), ashtu edhe pasojat që pretendohet se kanë ardhur mbi këto të drejta për shkak të caktimit të masave të sigurimit personal ndaj kërkuesit, Gjykata konsideron se përmbushet kriteri i parë i lartpërmendur, pasi shkella e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar. Vendimi që ka caktuar masat e sigurimit është kundërshtuar në të gjitha shkallët e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, prandaj edhe kriteri i dytë është përmbushur në rastin konkret. Gjithashtu, Gjykata konstaton se gjatë procesit gjyqësor të themelit të çështjes, i cili ka të bëjë me fajësinë e kërkuesit, do të ishte e pamundur që të rikuperohej këto të drejta kushtetuese të pretenduara të cenuara ose të korrigjohen pasojat e ardhura nga vendimet e ndërmjetme në to, për rrjedhojë plotësohet edhe kriteri i tretë. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se

kërkuesi nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion në lidhje me pretendimet që lidhen me vendimet gjyqësore objekt i ankimit kushtetues individual.

29. Gjithashtu, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar se të drejtat dhe liritë e tij janë cenuar për fakte të cilat mbrohen nga imuniteti absolut i deputetit, i parashikuar nga neni 73, pika 1, i Kushtetutës. Për rrjedhojë, sipas tij, ai nuk mund të ndiqet penalisht për veprimet e kryera në ushtrim të kësaj detyre. Në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit, Gjykata vëren se sipas pikës 1 të nenit 73 të Kushtetutës: "*deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit*". Në këtë kuptim, Gjykata, *së pari*, vlerëson se kjo dispozitë nuk është e zbatueshme në rastin konkret, për sa kohë kërkuesi nuk rezulton të jetë ndjekur penalisht për mendimet ose votat e tij gjatë ushtrimit të funksionit të deputetit, por për veprime të kryera gjatë kohës që ai ushtronte detyrën e Kryeministrit, dhe, *së dyti*, ky pretendim i tij lidhet me çështjen e të provuarit nëse ai e ka kryer ose jo veprën penale për të cilën akuzohet, e cila i nënshtrohet procesit të themelit. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se në lidhje me këtë pretendim kërkuesi ka mjete të tjera juridike në dispozicion, duke qenë se argumenti lidhet me fajësinë që është objekt i gjyqimit të themelit dhe nuk mund të merret në shqyrtim në këtë fazë. Për këtë arsye, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

30. Për sa i përket kriterit pretendimeve për cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë, të lidhur me përmbajtjen e dispozitave të ligjit nr. 95/2016, rezulton se kërkuesi nuk e ka ngritur këtë pretendim, në formë dhe përmbajtje, përpara gjykatave të zakonshme. Ai është paraqitur për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Gjykata, duke pasur parasysh natyrën e kontrollit që ushtrohet nga gjykatat e zakonshme dhe kompetencat e këtyre të fundit, të cilat nuk mund të shprehen për antikushtetushmërinë e normave, si edhe qëndrimin e saj se paraqitja e kërkesës për iniciimin e kontrollit incidental të normës nuk përbën element të domosdoshëm në këndvështrim të përmbushjes së kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive (*shih vendimin nr. 4, datë 21.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*), vlerëson se paraqitja e këtij pretendimi përpara gjykatave të zakonshme nuk rezulton se do të kishte perspektivë suksesi për kërkuesin. Për rrjedhojë, lidhur me këtë pretendim,



kërkuesi nuk ka pasur mjete të tjera juridike efektive në dispozicion.

31. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se, në caktimin e masave të sigurimit ndaj tij, gjykatat i kanë cenuar të drejtat kushtetuese edhe në drejtësitë e mëposhtme: i. sepse i kanë kufizuar të drejtat e tij kushtetuese (lirinë personale dhe të lëvizjes) për veprime që nuk parashikohen nga ligji si vepër penale, për sa kohë ai është akuzuar për miratimin e akteve normative me fuqi juridike në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jo për akte individuale të cilat kanë për qëllim favorizimin e një personi apo një grupi të përcaktuar personash; ii. sepse kanë cenuar parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, teksa kanë marrë kompetencat e Kuvendit, Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të zakonshme për vlerësimin e politikave socio – ekonomike të qeverisë, nevojën dhe dobinë e akteve ligjore dhe nënligjore, ligjshmërinë e vendimeve të AKKP-së dhe kontratave civile midis personave privatë. Për sa u përket këtyre pretendimeve, Gjykata vlerëson se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështjen e të provuarit të fajësisë së kërkuesit dhe, si të tilla, mund të parashtrohen përpara gjykatave penale gjatë gjykimit të themelit të çështjes penale, ku kërkuesi ka mundësinë që të paraqesë çdo pretendim dhe provë si në lidhje me akuzën ashtu edhe me juridiksionin e gjykatave. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se edhe në lidhje me këto pretendime kërkuesi ka mjete të tjera juridike në dispozicion, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

32. Po kështu, duke pasur parasysh se në kuadër të verifikimeve për shterimin e mjeteve juridike nga kërkuesi Gjykata vlerëson shterimin e mjeteve të ankimit në aspektin formal dhe substancial, ajo vëren se në drejtëm të së drejtës për proces të rregullt kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë së gjyqtarës së GJKKO-së së Shkallës së Parë që ka caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij. Në drejtëm të këtij pretendimi kërkuesi ka parashtruar dy shkaqe: a) gjyqtarja I.Gj. është shkarkuar nga detyra në vitin 1996 nga ish-KLD-ja, në kohën kur ky institucion kryesohej nga kërkuesi i cili e ushtronte këtë detyrë *ex officio* në cilësinë e Presidentit të Republikës; b) dispozitat e ligjit nr. 95/2016 parashikojnë vëzhgimin periodik nga BKH-ja të telekomunikimeve të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme, përfshirë edhe ato të familjarëve të tyre.

Sipas kërkuesit, duke pasur parasysh se BKH-ja varet nga Prokuroria e Posaçme, që është organi që ka kërkuar masat e sigurimit personal në rastin e kërkuesit dhe që i mbron ato përpara gjykatave, gjyqtarët e gjykatave të posaçme nuk mund të jenë të pavarur dhe të paanshëm.

33. Për sa i përket shkakut të parë, Gjykata vëren se gjatë gjykimit pranë GJKKO-së së Shkallës së parë kërkuesi ka ngritur pretendimin për anshmërinë e gjyqtarës, duke argumentuar se ndaj saj është paraqitur një kallëzim penal prej tij dhe se vendimi i dhënë më parë prej saj, ku janë vendosur masat e sigurimit personal, është antikushtetues, fakte këto që ngrenë dyshimin se ajo gjyqtare është e njëanshme. Në vlerësimin e kësaj kërkesë, një tjetër gjyqtare e GJKKO-së së Shkallës së Parë, me vendimin nr. 430, datë 26.10.2023, ka vendosur mospranimin e saj, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Në këtë kuptim, nuk rezulton se shkakut i paraqitur nga kërkuesi në këtë ankim kushtetues, pra shkarkimi i gjyqtarës nga ish-KLD-ja, të jetë ngritur përpara GJKKO-së së Shkallës së Parë. Duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi pretendon se kjo është një rrethanë e rëndësishme e njëanshmërisë së gjyqtarës, Gjykata vëren se është e paqartë/e pakuptueshme përse ai nuk e ka ngritur atë përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk u ka dhënë atyre mundësinë që të mbajnë një qëndrim të shprehur, duke ritheksuar se shterimi i mjeteve, në thelb, synon t'u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 25, datë 13.10.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Po ashtu, në raste të ngjashme, edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka vlerësuar se për sa kohë kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues, sipas parashikimeve të dispozitave procedurale, pra nuk ka përdorur procedurën standarde për këtë qëllim, konsiderohet se ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion (*shih vendimin nr. 67, datë 3.10.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këtë qasje, Gjykata vlerëson se në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë për shkak të shkarkimit të gjyqtarës nga ish-KLD-ja në vitin 1996, edhe pse ai është ngritur formalisht në rekurs, për sa kohë që kërkuesi



nuk ka paraqitur përpara GJKKO-së së Shkallës së Parë kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës pikërisht për këtë shkak, edhe pse dispozitat procedurale, nenet 15 e vijuese të KPP-së, ia garantonin këtë të drejtë, dhe për sa kohë që ai nuk ka parashtruar ndonjë shkak për mospasjen dijeni të shkakut të përjashtimit apo për pamundësinë për të përdorur këtë mjet procedural, konsiderohet se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës. Për rrjedhojë, ky pretendim, për këtë shkak, nuk mund të merret në shqyrtim.

35. Ndërkohë, për sa i përket shkakut tjetër të pretenduar të paanshmërisë dhe pavarësisë, që lidhet me antikushtetutshmërinë e pretenduar të dispozitave ligjore, Gjykata ka vlerësuar më sipër se do e trajtojë këtë aspekt si kërkim për kontrollin e kushtetutshmërisë së neneve 48–51 të ligjit nr. 95/2016, pra nëse këto dispozita ofrojnë garanci për gjyqtarin në drejtim të pavarësisë dhe paanshmërisë së tij në proces.

36. Në drejtim të legjitimitetit *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 5.3.2024, i cili u është komunikuar mbrojtësve të kërkuesit në adresat e tyre të postës elektronike me e-mail-in e datës 30.5.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 29.7.2024, pra brenda afatit 4-mujor. Duke llogaritur datën e komunikimit të vendimit të Gjykatës së Lartë si momentin nga i cili fillon afati 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues për të dyja kërkimet e kërkesës në shqyrtim, konsiderohet se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

37. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuesit, Gjykata konstaton se ai ka pretenduar cenimin e lirisë personale dhe të lirisë së lëvizjes, të mbrojtura nga nenet 27 dhe 38 të Kushtetutës, si rezultat i një procesi të parregullt ligjor, me argumentin se masat e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” janë caktuar në kundërshtim me procedurën e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, që parashikon se deputetit nuk mund “... t’i hiqet liria në *farëdo lloj forme*”. Po

ashtu, sipas kërkuesit, atij i janë kufizuar disa të drejta dhe liri themelore, midis të cilave edhe e drejta për t’u zgjedhur, në kundërshtim me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës.

38. Gjykata, fillimisht evidenton se masat e sigurimit të caktuara ndaj kërkuesit, kanë vendosur ndaj tij detyrimin për t’u paraqitur të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10:00 përpara oficerit të Policisë Gjyqësore, pranë Prokurorisë së Posaçme dhe detyrimin për të mos u larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, detyrime të cilat nuk kanë intensitet të tillë që të mund të barazohen me heqjen e lirisë. Në këtë këndvështrim, Gjykata duke mbajtur në konsideratë se neni 27, garanton lirinë personale, e cila është e ndryshme nga liria e lëvizjes, e garantuar nga neni 38 i Kushtetutës (*shih infra paragrafët 59–60 të këtij vendimi*), funksionin e deputetit që ushtron kërkuesi, si edhe thelbin e argumenteve të kërkuesit për kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore, bazuar në parimin *iura novit curia*, vlerëson t’i shqyrtojë ato nën prizmin e të drejtave substanciale të mëposhtme: *i. e drejta për t’u zgjedhur* në drejtim të ushtrimit të mandatit përfaqësues të deputetit nga kërkuesi, e mbrojtur nga neni 45 i Kushtetutës, për shkak të caktimit të dy masave të sigurimit personal ndaj tij; *ii. liria e lëvizjes*, e mbrojtur nga neni 38 i Kushtetutës, për shkak të caktimit të masës së sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”. Në këtë kuptim, Gjykata do të shqyrtojë, fillimisht, në drejtim të së drejtës kushtetuese për t’u zgjedhur dhe lirisë së lëvizjes⁴, nëse ka pasur shkelje të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës në lidhje me autorizimin e Kuvendit. Në vijim, në varësi të përfundimit të arritur në lidhje me këtë pretendim, Gjykata do të shqyrtojë, në të njëjtën këndvështrim, edhe aspektet e tjera të procesit gjyqësor që kanë të bëjnë me: *i. cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë të gjykatës si rezultat i rregullimeve ligjore*, të cilat Gjykata do t’i shqyrtojë në drejtim të elementit objektiv të parimit të paanshmërisë *ii. cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive*; *iii. cenimin e standardit të arsyetimit si aspekte procedurale të të drejtave substanciale të sipërpërmendura*; *iv. aspektin substancial të kufizimit të këtyre të drejtave në drejtim të parimit të proporcionalitetit të masave të sigurimit të vendosura mbi kërkuesin*.

⁴ Gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahimiri vlerësuan se pretendimi i kërkuesit duhej të shqyrtohej nga Faqe | 112

Gjykata edhe në drejtim të lirisë personale, të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës.

*B. Për themelin e pretendimeve**B.1. Për cenimin e së drejtës për t'u zgjedhur dhe të lirisë së lëvizjes (aspekti procedural)**B.1.1. Për autorizimin nga Kuvendi sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës*

39. Sipas kërkesit, Prokuroria e Posaçme ka vepruar në kundërshtim me nenin 73, pika 2, të Kushtetutës, duke mos ndjekur procedurën e parashikuar në këtë dispozitë, për shkak se duke qenë ai deputet i Kuvendit, çdo kufizim i lirisë personale dhe lirisë së lëvizjes duhej të bëhej me autorizim të këtij të fundit, çka nuk është bërë në rastin e tij. Sipas kërkesit, dispozita kushtetuese nuk nënkupton në asnjë rast caktimin ndaj deputetit vetëm të masave të sigurimit personal “Arresti në burg” ose “Arresti në shtëpi”, por përfshin edhe masat e tjera të sigurimit personal që kufizojnë lirinë personale dhe atë të lëvizjes. Ai ka pretenduar se ndaj tij është zbatuar një standard i ndryshëm nga ai i mbajtur nga organet gjyqësore dhe Kuvendi në rastin deputetit S.T., për të cilin, për vendosjen e masave të sigurimit personal “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” dhe “Detyrimi për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, të parashikuara nga neni 232, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të KPP-së, në kohën kur kryente funksionin e deputetit dhe të ministrit, është kërkuar autorizimi nga Kuvendi, i cili, në cilësinë edhe të organit që ka miratuar KPP-në, është shprehur se këto janë masa shtrënguese të heqjes së lirisë. Sipas kërkesit, ky është interpretimi institucional që u ka bërë këtyre dispozitave vetë Kuvendi, i cili duhej të merrej parasysh edhe nga gjykatat dhe jo të bënin ato një interpretim të ndryshëm, duke shmangur marrjen e autorizimit nga Kuvendi.

40. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e lirisë personale, në kundërshtim me nenet 27 dhe 38 të Kushtetutës, është i pabazuar, pasi nga leximi i neneve 27 dhe 28 të Kushtetutës konstatohet se bëhet fjalë për burgosje të individit, ose heqje e lirisë në kuptimin e kapjes së tij. Sipas Prokurorisë së Posaçme, referuar nenit 73 të Kushtetutës, legjislatori nuk ka pasur si qëllim mbrojtjen e çdo lloji lirie, pasi kjo do të binte në kundërshtim me atributet e tjera, për të cilat prokurorisë i është lejuar të veprojë pa autorizim të Kuvendit dhe se autorizimi i Kuvendit kërkohet vetëm në rast se kërkohet arresti në burg ose arresti në shtëpi dhe jo për çdo lloj heqjeje lirie të mundshme që ka personi nën

hetim. Gjithashtu, subjekti i interesuar ka parashtruar se termat “në çfarëdo lloji forme” nuk nënkuptojnë “çfarëdo lloji lirie” dhe se në rastin e ish-deputetit dhe ish-ministrit, shtetasit S.T., Prokuroria e Posaçme nuk ka kërkuar të njëjtat masa sigurimi si në rastin e kërkesit, por ka kërkuar autorizimin për arrest. Sipas Prokurorisë së Posaçme, masa e sigurimit “ndalim i daljes jashtë shtetit” vendosur ndaj kërkesit, sipas subjektit të interesuar, nuk e ka kufizuar atë në lirinë e lëvizjes së tij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pjesëmarrjes së tij në Kuvend ose komisione parlamentare, si edhe në kryerjen e të gjitha aktiviteteve të tij personale dhe ky ndalim nuk është vendosur në atë masë që të barazohet me heqjen e lirisë.

41. Gjykata vëren se neni 124 i Kushtetutës përcakton funksionin kryesor të kësaj Gjykate, që është garantimi i respektimit të Kushtetutës dhe interpretimi përfundimtar i saj, të cilin ajo e ushtron sa herë vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese, sepse gjatë kontrollit kushtetues është i nevojshëm, në çdo rast, interpretimi i kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim (*shih vendimet nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 24, datë 9.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Nëpërmjet këtij interpretimi, Gjykata synon që t'u japë jetë normave kushtetuese përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre (*shih vendimet nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 29, datë 30.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Gjykata vëren se, sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloji forme ose ndaj tij të ushtrohet kontroll personal, ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit. Në këtë kuptim, duke qenë se pretendimi i kërkesit në thelb ka natyrë kushtetuese, Gjykata, bazuar edhe në parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë, e cila duhet të investohet në shqyrtimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 68, datë 8.10.2024; nr. 13, datë 9.3.2021; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*), në vijim do të analizojë edhe arsyetimin e gjykatave të zakonshme për interpretimin e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës,



si dhe të dispozitave procedurale penale në lidhje me këtë pretendim të kërkuarit.

43. Lidhur me pretendimin e kërkuarit se mungesën e autorizimit nga Kuvendi, sipas parashikimit të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, për vendosjen ndaj tij të masave të sigurimit (*detyrim paraqitjeje dhe ndalim i daljes jashtë shtetit*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se koncepti i lirisë së përmendur në nenin 73, pika 2, të Kushtetutës duhet krahasuar me atë të parashikuar në nenin 27 të saj dhe se bazuar në interpretimin sistematik, rezulton e qartë se autorizimi paraprak i Kuvendit kërkohej vetëm për rastet e disponimit të lirisë personale të deputetit, por jo për liritë e tjera, ndërsa liria e personit nënkupton lirinë nga arrestimi dhe ndalimi, kurse siguria e personit nënkupton mbrojtjen kundër ndërhyrjes arbitrare ndaj lirisë së tij. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se në analizë të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, “liria” i referohet vetëm “lirisë personale” të personit nën hetim dhe jo lirisë së tij për të dalë lirisht jashtë shtetit, kurse shprehja “në çfarëdo lloj forme” nuk nënkupton çfarëdo lloj lirie, por format që mund të zbatohen për heqjen e saj, siç mund të jenë: paraburgimi i urdhëruar nga gjykata, ndalimi i urdhëruar nga prokurori ose Policia Gjqësore, arrestimi në flagrancë. Sipas saj, ky interpretim është në përputhje me parashikimin e pikës 3 të kësaj dispozite kushtetuese, që lejon ndalimin ose arrestimin e deputetit pa autorizim të Kuvendit në rastin kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë, sikundër edhe me parashikimet e nenit 289 të KPP-së, sipas të cilit, mosdhënia e autorizimit nga Kuvendi, sipas nenit 288 të këtij kodi, nuk pengon prokurorin të kërkojë një nga masat e tjera të sigurimit personal sipas nenit 244 të tij. Po sipas saj, edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, “e drejta e lirisë”, në kuptim të nenit 5 të KEDNJ-së, ka të bëjë me lirinë fizike të personit, qëllimi i së cilës është që askush të mos privohet nga kjo liri në mënyrë arbitrare, ndërkohë që objekti i mbrojtjes së këtij neni nuk ka të bëjë me kufizimet e “lirisë së lëvizjes”, e cila rregullohet nga neni 2 i Protokollit nr. 4 të Konventës. Mbi këtë arsyetim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se masat e sigurimit të caktuara prej saj nuk kanë cenuar lirinë personale të kërkuarit dhe në kuptim të dispozitës kushtetuese, si dhe dispozitave procedurale penale ato përbëjnë “masa të tjera”, që nuk përbëjnë “heqje të lirisë personale”, por kufizim të “lirisë për të

lëvizur jashtë shtetit”, masa për të cilat shprehimisht nuk kërkohej autorizimi paraprak i Kuvendit (*shih faqet 25–26 të vendimit nr. 117/2023, të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

44. Po kështu, edhe sipas GJKKO-së së Apelit, për caktimin e masave të sigurimit personal që nuk heqin lirinë personale ose fizike të deputetit, nuk kërkohej autorizim paraprak nga Kuvendi. Sipas saj, duke pasur parasysh formën e qeverisjes (republikë parlamentare), parimin e ndarjes dhe balancimin ndërmjet tre pushteteve dhe se Kuvendi përbëhet nga deputetë të cilët zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare, me qëllim për të siguruar pavarësinë dhe integritetin e Kuvendit në tërësi dhe për ta mbrojtur atë nga çdo ndërhyrje arbitrare të pushteteve të tjera, Kushtetuta ka parashikuar garanci ose mbrojtje paraprake të deputetëve, e njohur si imunitet parlamentar, situatë juridike e privilegjuar dhe e garantuar për deputetët, duke pasur parasysh pozicionin dhe funksionin institucional të tyre. Pjesë e imunitetit parlamentar, vijon ajo, është edhe imuniteti procedural, të cilit i referohet mbrojtja e kërkuarit, imunitet për të cilin GJEDNJ-ja është shprehur se garancitë që ky imunitet ofron, në të dyja aspektet e tij (papërgjegjshmëri dhe paprekshmëri), shërbejnë për të njëjtën nevojë, pikërisht për të siguruar pavarësinë e parlamentit në kryerjen e misionit të tij, ku paprekshmëria e deputetit parandalon çdo lloj mundësie ndjekjesh penale të frymëzuara nga qëllimi për të dëmtuar veprimtarinë politike të tij, duke mbrojtur kështu në të njëjtën kohë opozitën nga trysitë dhe abuzimet e shumicës. GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se me ndryshimet kushtetuese të vitit 2012, imuniteti procedural është kufizuar nisur nga rëndësia që paraqet për interesat e shoqërisë procedimi penal, ku pika 2 e nenit 73 të Kushtetutës, garanton imunitetin e kufizuar procedural penal të deputetëve, veçanërisht në lidhje me masat e sigurimit dhe të kontrollit, për rastet kur deputeti i nënshtrohet procedimit penal. Edhe sipas GJKKO-së së Apelit, në interpretim të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, me termin “heqje të lirisë” nënkuptohet liria personale ose fizike e deputetit ose liria nga arrestimi arbitrar, e njohur si nga më të rëndësishmet në nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së, nocioni i së cilës, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, përmban njëherazi një aspekt objektiv, konkretisht mbylljen e një personi brenda një hapësire të kufizuar për një periudhë kohore të konsiderueshme dhe një aspekt



subjektiv, domethënë që ky i fundit nuk ka dhënë në mënyrë të vlefshme pëlqimin për mbylljen e tij, duke mos pasur të bëjë me kufizime të thjeshta ndaj lirisë së lëvizjes, të cilat përcaktohen nga një dispozitë me vete, konkretisht neni 2 i Protokollit nr. 4 të Konventës, referuar të cilit kemi të bëjmë me një dallim shkalle ose shpeshësie, por jo natyre ose thelbi. Ky interpretim i nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, edhe sipas GJKKO-së së Apelit, është në harmoni me parashikimet e nenit 288 të KPP-së, ndërsa plotësohet edhe me parashikimin e nenit 289 të këtij kodi, nga deduktohet se për cilëndo masë tjetër sigurimi, që nuk çon në heqjen e lirisë personale (arrest në burg ose arrest në shtëpi), nuk është i nevojshëm dhënia e autorizimit nga Kuvendi. Po sipas saj, liria për të lëvizur jashtë shtetit, e njohur nga neni 38 i Kushtetutës, nuk barazohet me lirinë personale ose fizike, ndaj, në këtë kuptim, caktimi i një mase sigurimi personale ndaj kërkuesit edhe pse me fuqi shtrënguese, që nuk heq lirinë personale, por vetëm lirinë e lëvizjes ose e detyron të paraqitet në ditë të caktuara përpara Policisë Gjyqësore, nuk kërkon autorizim nga Kuvendi sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës (*shih faqet 14–16 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

45. Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se caktimi i një mase sigurimi shtrënguese që nuk heq lirinë personale dhe fizike të deputetit, por vetëm lirinë e lëvizjes jashtë shtetit ose e detyron të paraqitet në Policinë Gjyqësore, nuk kërkon autorizim nga Kuvendi, pasi del jashtë mburojës garantuese të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, neni 5, pika 1, të KEDNJ-së dhe neni 288, pika 1, të KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, qëndrimi i prokurorit dhe, në vijim, edhe i gjykatave më të ulëta, është në përputhje dhe në koherencë të plotë me parashikimin dhe qëllimin e imunitetit parlamentar të pjesëm të garantuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës, sikundër edhe me përcaktimin pothuajse identik të nenit 288, paragrafi 1, të KPP-së (normë zbatuese e përcaktimit kushtetues), i cili identifikon dy nga format klasike të heqjes së lirisë, atyre përmes masave të sigurimit personal “Arresti në burg” dhe “Arresti në shtëpi”, por pa përjashtuar forma të tjera të heqjes së lirisë. Detyrimi i organit procedues për të kërkuar autorizim nga Kuvendi kërkohet qartazi vetëm në kushtet e paraqitjes së një kërkese për caktimin e masave të sigurimit paragyjkuese të lirisë së personit, në format e heqjes, eliminimit të saj, ndërsa nuk e pengon atë për të

kërkuar në gjykatë caktimin e një mase sigurimit të ndryshme, më të butë se ato. Në lidhje me kuptimin e termit “heqje e lirisë në çfarëdo lloj forme” në nenin 73, pika 2, të Kushtetutës, sipas Kolegjit Penal, neni 27 i saj, pasi shpall paprekshmërinë e lirisë së personit, si e drejtë themelore, në pikën 2 rendit dhe specifikon rastet përjashtimore të heqjes së saj, duke sqaruar në mënyrë ezauruese dhe pa asnjë ekuivok përmbajtjen e këtij termi në lidhje me format e përkohshme të heqjes së kësaj lirie, të cilat pa asnjë dyshim kërkojnë në thelb eliminimin integral të saj në kuptimin e izolimit të personit. Mbi këtë bazë, Kolegji Penal ka vlerësuar se masat e caktuara ndaj deputetit të hetuar në rastin konkret, me të drejtë, janë vlerësuar se nuk kufizojnë ushtrimin lirisht të mandatit të tij si deputet dhe se liria ose e drejta për të lëvizur jashtë vendit nuk mund të barazohet me lirinë fizike ose personale, ndërsa termi “heqja e lirisë në çfarëdo lloj forme” nuk nënkupton liri të ndryshme nga liria personale, por format që mund të zbatohen për heqjen e saj, të përcaktuara në nenin 27 të Kushtetutës, përfshirë këtu edhe ato në dispozicion të organit procedues të aplikuara në kushte urgjence dhe provizorisht, të identifikuar si masat parasiguruese të “ndalimit” dhe të “arrestimit në flagrance”, të parashikuara nga nenet 253 dhe 251 të KPP-së (*shih paragrafët 41–45 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

46. Për të arritur në një përfundim lidhur me pretendimin se mosmarrja e autorizimit nga Kuvendi sipas parashikimit të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, për vendosjen e masave të sigurimit (*detyrim paraqitje dhe ndalim i daljes jashtë shtetit*), përbën ose jo cenim të së drejtës së kërkuesit për t’u zgjedhur dhe lirisë së tij të lëvizjes, Gjykata do të vlerësojë për sa më poshtë: i. nëse ky rregullim kushtetues shtrihet vetëm mbi *lirinë personale* ose edhe mbi *lirinë e lëvizjes* apo *liri të tjera* të garantuara nga Kushtetuta; ii. më tej, në varësi të rezultatit të analizës për pyetjen e parë, Gjykata do të vlerësojë nëse masa “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore” përbën ose jo cenim të së drejtës për t’u zgjedhur dhe lirisë së lëvizjes. Për kryerjen e kësaj analize që synon të shpjegojë kuptimin e normës kushtetuese, Gjykata, bazuar edhe në nenin 124 të Kushtetutës, sipas të cilit ajo bën interpretimin përfundimtar të saj, do të ndalet edhe në identifikimin e qëllimit të kushtetutëbërësit për fushën e veprimit dhe të mbrojtjes që ofron neni 73, pika 2, i Kushtetutës, duke iu referuar në këtë



drejtim: *travaux préparatoires* të procesit kushtetues të vitit 2012 që ka çuar në miratimin e përmbytjes së kësaj dispozite; analizës semantike të dispozitës kushtetuese në fjalë; dhe precedentit të zbatimit të kësaj dispozite në rastin e deputetit S.T., të referuar nga kërkuesi, si dhe doktrinës .

47. Për sa i takon qëllimit të kushtetutëbërësit, Gjykata, fillimisht, vëren se rregullimi i nenit 73 të Kushtetutës, së bashku me rregullimin e neneve 126 dhe 137 të saj, përbën të ashtuquajturin *regjim të imuniteteve* të njohur nga Kushtetuta për disa funksionarë të lartë publikë. *Regjimi i imuniteteve*, në çdo rast, synon, nga njëra anë, të garantojë ushtrimin e qetë dhe të pandikuar të funksioneve të rëndësishme publike nga zyrtarët e lartë të shtetit, të cilët nuk duhet të druhen se veprimtaria e tyre shtetërore mund të bëhet shkas për pasoja personale, si, për shembull, një padi civile ose një akuzë penale. Nga ana tjetër, dispozitat që përbëjnë *regjimin e imuniteteve* synojnë të garantojnë përgjegjshmërinë e këtyre funksionarëve të lartë në qoftë se, në përfundim të verifikimeve përkatëse dhe një procesi të rregullt ligjor, rezultojnë se veprimet e tyre nuk janë të motivuara nga interesi publik, por nga interesi privat ose keqbesimi. Në doktrinën juridike koncepti i imunitetit përfshin 2 (dy) aspekte⁵: i. *Mospërgjegjësinë* – një formë e mbrojtjes nga përgjegjësia që lind tipikisht si rezultat i ushtrimit të funksioneve publike, si, për shembull, një fjalim ose prononcim zyrtar, opinione teknike ose politike të shprehura ose vota të hedhura në ushtrim e sipër të detyrës; ii. *Paprekshmërinë* – një formë e mbrojtjes së përkohshme e të posaçme nga procedurat e ndryshme ligjore (p.sh., aspekte të caktuara të procedimit penal, paditë civile, procedimet disiplinore etj.) për aktet e zyrtarëve publikë që kryhen jashtë ushtrimit të funksioneve të tyre publike (p.sh. kryerja e një krimi, shkelja e një kontrate etj.). Kjo mbrojtje e përkohshme dhe e posaçme, tipikisht, konsiston në detyrimin e organeve ligjzbatuese për të marrë paraprakisht autorizimin e organit përkatës për kryerjen e disa veprimeve procedurale kundër funksionarëve publikë të veshur me imunitet.

48. Duke iu kthyer përmbytjes së nenit 73 të Kushtetutës, Gjykata vëren se ai i garanton deputetit

imunitet në të dyja format e lartpërmendura, ku paragrafi i parë ofron mbrojtje në formën e *mospërgjegjësisë*, ndërsa paragrafi i dytë ofron mbrojtje në formën e *paprekshmërisë*. Gjykata vëren, gjithashtu, se neni 73 i Kushtetutës në përmbytjen e tij fillestare të miratuar në vitin 1998 parashikonte se: “*Deputeti nuk mund të ndiqet penalisht pa autorizimin e Kuvendit. Autorizimi kërkohet edhe në rastin kur ai do të arrestohet.*”. Në vitin 2012 kjo dispozitë kushtetuese u ndryshua sipas përmbytjes aktuale të saj dhe konkretisht pika 2 e saj parashikon: “*Deputeti nuk mund të arrestohet ose t’i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit.*”. Referuar diskutimeve në Këshillin për Legjislacionin dhe Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, është e qartë se diskutimet e ligjvënësve janë përqendruar rreth pengesave që vendosen mbi veprimtarinë parlamentare të deputetit si rezultat i zbatimit ndaj tij të masave të sigurimit personal që kufizojnë lirinë. Nga ana tjetër, nga *travaux préparatoires* nuk rezultojnë e qartë nëse qëllimi i kushtetutëbërësit ka qenë shtrirja e mbrojtjes së posaçme që ofron pika 2 e nenit 73 edhe mbi masa të tjera të sigurimit përtej asaj të arrestit (në burg ose në shtëpi).

49. Megjithatë, duke pasur parasysh se qëllimi i kushtetutëbërësit në marrjen e nismës për miratimin e reformës kushtetuese të vitit 2012, që lidhet me regjimin e imuniteteve, ishte kufizimi i paprekshmërisë së deputetit nga ndjekja penale, i cili sipas Kushtetutës së vitit 1998 ishte i plotë (deri në marrjen e një autorizimi nga Kuvendi), Gjykata evidenton qëndrimin e mbajtur nga Komisioni Venecias, sipas të cilit, rregullat për paprekshmërinë e deputetëve në çështjet penale nuk duhet të shkojnë përtej asaj që është e justifikuar për qëllime të ligjshme dhe rrjedhimisht ato duhet të interpretohen të mënyrë të kufizuar. Sipas Komisionit të Venecias, rregullat për paprekshmërinë e deputetëve mund të justifikohen në rast se mjetet e tjera të mbrojtjes nuk janë të përshtatshme, por ato duhet gjithnjë të interpretohen në mënyrë të kufizuar⁶. Po kështu, edhe sipas GJEDNJ-së, mungesa e ndonjë lidhjeje të qartë me një aktivitet parlamentar kërkon një interpretim të ngushtë të konceptit të proporcionalitetit midis qëllimit që kërkohet të

⁵ Ky kuptim i imunitetit është zhvilluar origjinalisht nga komiteti GRECO (*Group of States Against Corruption*) i Këshillit të Evropës dhe referohet gjerësisht në doktrinën juridike.

⁶ Raporti i Komisionit të Venecias CDL-AD (2014) 011 (14 maj 2014), paragrafët 157 dhe 185.



arrihet dhe mjeteve të përdorura (*shih Cordova kundër Italisë* (nr. 1), datë 30 janar 2003, § 63). Në këtë kuptim, Gjykata thekson se imuniteti i deputetit nuk përbën përjashtim nga rregulli, sipas të cilit çdo person që kryen një veprë penale është subjekt i përgjegjësisë penale, e cila ndiqet nga prokurorët dhe në fund vendoset nga gjykatat e pavarura. Për këtë arsye, kur interpretohen rregullat për imunitetin, duhet të përjashtohet metoda e interpretimit të zgjeruar, ndaj Gjykata vlerëson se edhe fusha e rregullimit të pikës 2 të nenit 73, që lidhet me imunitetin procedural të deputetëve, duhet interpretuar në mënyrë të kufizuar/ngushtë.

50. Kështu, në vlerësimin e Gjykatës, mbrojtja që ofrohet nga kjo dispozitë (neni 73, pika 2, i Kushtetutës) kuptohet e lidhur, si rregull, me procesin penal në kuadër të të cilit individit mund t'i kufizohet liria edhe përpara marrjes së një vendimi përfundimtar nga gjykata në lidhje me themelin e çështjes penale dhe fajësinë e tij. Duke parashikuar marrjen e autorizimit nga Kuvendi për zbatimin e masave që kufizojnë paraprakisht lirinë e deputetit, pika 2 e nenit 73 synon të mbrojë veprimtarinë e vetë Kuvendit (*jo të deputetëve të veçantë*) për aq sa ajo mund të cenohet si rezultat i procedimeve penale me sfond politik ndaj deputetëve të veçantë. Megjithatë, Gjykata pajtohet në këtë drejtim edhe me qëndrimin e Komisionit të Venecias, sipas të cilit imuniteti i deputetëve nuk është privilegj personal i tyre, por qëllimi kryesor i tij (imunitetit parlamentar) është mbrojtja e vetë parlamentit dhe në veçanti funksionimi i duhur i tij⁷. Në këtë kuptim, Gjykata pajtohet edhe me qëndrimin tjetër të Komisionit të Venecias, sipas të cilit duhet të ekzistojë një prezumim themelor që imuniteti duhet të hiqet në të gjitha rastet kur nuk ka asnjë arsye për të dyshuar se akuzat ndaj deputetit përkatës janë të motivuara politikisht dhe se paprekshmëria e tij duhet të zbatohet vetëm në rastet kur ka arsye për të dyshuar se në vendimin për ndjekjen penalisht të deputetit ka element partiakopolitik⁸. Për këto arsye, në referencë të qëllimit të kushtetutëbërësit, Gjykata vlerëson se neni 73, pika 2, i Kushtetutës i garanton deputetit mbrojtje të posaçme nga ato veprime procedurale të ndërmarra nga organet ligjzbatuese në kuadër të procedimit penal, të cilat kufizojnë lirinë e tij personale.

51. Për sa i takon analizës semantike, Gjykata vlerëson të ndalet në analizën e togfjalëshit “ose t'i hiqet liria në gfarëdo lloj forme” në përmbajtjen e pikës 2 të nenit 73, për të kuptuar nëse ky togfjalësh i referohet vetëm lirisë personale, të mbrojtur nga neni 27 i Kushtetutës ose edhe lirive të tjera kushtetuese, përfshirë atë të lëvizjes, të mbrojtur nga neni 38 i Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se katalogu i lirive dhe të drejtave kushtetuese përfshin disa liri (nenet 21-58 të Kushtetutës), ndër të cilat me interes, në rastin në shqyrtim, janë liria personale e garantuar nga neni 27 Kushtetutës dhe liria e lëvizjes e garantuar nga neni 38 i saj, të cilat janë të ndryshme në thelbin e tyre. Sipas nenit 27, pikat 1 dhe 3, të Kushtetutës, askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj dhe askujt nuk mund t'i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor. Ndërkohë që në pikën 2 të kësaj dispozite janë parashikuar edhe rastet e kufizimit të lirisë, kurse në nenin 28 të Kushtetutës janë parashikuar të drejtat që i garantohen menjëherë personit të cilit i hiqet liria. Gjykata, referuar përmbajtjes së nenit 27 të Kushtetutës, vëren se ai përdor alternativisht konceptet “heqje lirie” dhe “kufizim lirie” pa bërë ndonjë dallim të dukshëm midis tyre.

52. Për sa më lart, për qëllim të kësaj analize, Gjykata çmon t'i referohet edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, e cila ka bërë dallimin midis “heqjes” së lirisë dhe “kufizimit” të saj. Kështu, sipas GJEDNJ-së, dallimi midis “heqjes” dhe “kufizimit” të lirisë, sipas nenit 5, pika 1, dhe kufizimit të lirisë së lëvizjes, sipas qëllimit të nenit 2 të Protokollit nr. 4, përcaktohet nga shkalla ose intensiteti dhe jo nga natyra ose substanca (*shih Guzzardi kundër Italisë*, 6 nëntor 1980, § 92-93; *Nada kundër Zvicrës* [DHM], nr. 10593/08, § 225, GJEDNJ 2012; *Austin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 39692/09, 40713/09 dhe 41008/09, § 57, GJEDNJ 2012; *Stanev kundër Bullgarisë* [DHM], nr. 36760/06, § 115; dhe *Medvedjev dhe të tjerët kundër Francës* [DHM], nr. 3394/03, GJEDNJ 2010). Në këtë kuptim, sipas GJEDNJ-së, në rastet kur ngrihen pretendime për të dyja dispozitat e mësipërme, gjykata duhet të përcaktojë se cila është e zbatueshme. Nëse ankimi që lidhet me një kufizim të caktuar rezulton se bie

⁷ Raporti I Komisionit të Venecias CDL-AD (2006) 005 (20 mars 2006), paragrafi 10.

⁸ Raporti i Komisionit të Venecias CDL-AD (2014) 011 (14 maj 2014), paragrafi 162.



në fushën e nenit 5, gjykata nuk e shqyrton atë sipas nenit 2 të Protokollit nr. 4 (*shih Assanidze kundër Gjeorgjisë [DHM], 2004, § 194*). Kur neni 5 rezulton të jetë i pazbatueshëm, ankimi shqyrtohet sipas nenit 2 të Protokollit nr. 4 (*shih De Tommaso kundër Italisë [GC], 2017, § 91; M.S. kundër Belgjikës, 2012, § 195*), përveç rastit kur kërkuesi kërkon në mënyrë specifike të provojë se një masë e caktuar përbën një heqje lirie dhe jo thjesht një kufizim të lirisë së lëvizjes (*shih Terheş kundër Rumanisë, nr. 49933/20, 2021, § 38*).

53. Për rrjedhojë, Gjkata vlerëson të ndalet në përdorimin e lidhëzave “ose” dhe “apo” në formulimin e pikës 2 të nenit 73 të Kushtetutës për të kuptuar nëse togfjalëshi “ose t’i hiqet liria në fjarëdo lloj forme”, i cili pason togfjalëshin “Deputeti nuk mund të arrestohet” i referohet ndonjë lirie tjetër, të ndryshme nga liria personale, e cila qartësisht hiqet/kufizohet për shkak të zbatimit të masës së sigurimit personal të arrestit të personit. Gjkata vëren të theksojë se pjesa e dytë e fjalisë së pikës 2 të nenit 73 “ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës”, e cila ndahet në dy nënpjesë, i referohet qartësisht të drejtave të mbrojtura nga neni 37 i Kushtetutës, që janë paprekshmëria e banesës dhe e personit. Ndërkohë Gjkata vëren se, në të njëjtën mënyrë, edhe pjesa e parë e fjalisë së pikës 2 të nenit 73 ndahet në dy nënpjesë nga lidhëza “ose” (“nuk mund të arrestohet” ose “t’i hiqet liria në fjarëdo lloj forme”). Nga ana tjetër, të dyja pjesët e fjalisë të pikës 2 të nenit 73, të cilat ndahen në vetvete në nënpjesë nga lidhëza “ose”, ndahen midis tyre nga lidhëza “apo”. Në kuptimin gjuhësor lidhëzat “ose” dhe “apo” nuk kërkojnë praninë e njëkohshme të të dyja elementeve, në dallim nga rastet e tjera kur në dispozitën ligjore përdoret lidhëza “dhe”. Ndonëse të dyja këto lidhëza përdoren për të shprehur alternativa, në formulimin e dispozitës kushtetuese këto lidhëza kanë dallime semantike dhe përdorimi të tyre duhet të kuptohet në varësi të kontekstit.

54. Gjkata vlerëson se përdorimi i lidhëzës “apo” në pikën 2 të nenit 73 për të ndarë dy pjesët përbërëse të fjalisë ka pasur qëllim që të theksojë ndarjen ndërmjet rasteve në të cilat e shtrin mbrojtjen e saj dispozita kushtetuese. Ndërsa pjesa e parë e fjalisë i ofron deputetit mbrojtje të përkohshme procedurale nga masat e sigurimit të cilat kufizojnë lirinë personale të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, derisa Kuvendi të autorizojë vendosjen e këtyre masave, pjesa e dytë e fjalisë i

ofron deputetit mbrojtje të përkohshme procedurale nga masat e kontrollit personal dhe të banesës, të cilat kufizojnë të drejtat e mbrojtura nga neni 37 i Kushtetutës, derisa Kuvendi të autorizojë vendosjen e këtyre masave. Në këtë kuptim, në vlerësimin e Gjykatës, edhe analiza semantike e dispozitës konfirmon rezultatin e analizës qëllimore se neni 73, pika 2, i Kushtetutës i garanton deputetit mbrojtje të posaçme nga ato veprime procedurale të ndërmarra nga organet ligjzbatuese në kuadër të procedimit penal të cilat kufizojnë lirinë e tij personale. Ky interpretim është në përputhje edhe me parashikimin e pikës 3 të nenit 73, të Kushtetutës, që lejon ndalimin ose arrestimin e deputetit pa autorizim të Kuvendit në rastin kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Për më tepër, duke mbajtur në konsideratë kohën e hartimit të kushtetutës dhe legjislacionin penal të mëparshëm, Gjkata vëren se koncepti i heqjes së lirisë në atë legjislacion i referohej izolimit në burg të individit.

55. Për sa i takon analizës se precedentit, në rastin e deputetit të shumicës parlamentare S.T., Gjkata vëren se Kuvendi, i vënë në lëvizje me kërkesën e prokurorisë për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë, si dhe kontrollit personal dhe të banesës së atij deputeti, me vendimin nr. 104/2017, datë 25.10.2017, ka vendosur pranimin e kërkesës për: dhënien e autorizimit për kontrollin personal dhe të banesës; dhënien e autorizimit për ndalimin e daljes jashtë shtetit, detyrimin për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore, ndalimin dhe detyrimin për të qëndruar në një vend të caktuar si masë shtrënguese të heqjes së lirisë, në kuptim të shkronjave “a”, “b” dhe “c” të nenit 232 të KPP-së; rrëzimin e kërkesës për dhënien e autorizimit për masën e arrestit në burg ose në shtëpi për deputetin, në kuptim të shkronjave “d” dhe “dh” të nenit 232 të po këtij kodi.

56. Thënë këtë, Gjkata konstaton se në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se Kuvendi shfaqet edhe si interpretuesi i parë i normës kushtetuese dhe hapësira e këtij interpretimi varet nga karakteri dhe natyra e dispozitave kushtetuese (*shih vendimet nr. 16, datë 27.6.2022; nr. 9, datë 1.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, duke iu referuar vetëm asaj çka ka disponuar në rastin konkret Kuvendi, Gjkata vëren se ndonëse i ka dhënë përgjigje kërkesës së prokurorisë për zhveshjen e deputetit nga imuniteti parlamentar, ka autorizuar,



midis të tjerash, edhe vendosjen e masës “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, duke dhënë në pamje të parë idenë se ky lloj autorizimi ishte i nevojshëm edhe për zbatimin e këtyre masave. Në fakt, duke iu referuar specifikave të atij rasti konkret, Gjykata vëren se nuk ndodhet përpara rrethanave të njëjta që kanë çuar në vënien në lëvizje të Kuvendit, për sa kohë që kërkesa e prokurorisë e paraqitur për deputetin S.T. në fakt kishte për objekt vetëm autorizimin e arrestimit të tij, çka në kuptim të dispozitës kushtetuese nuk linte vend për interpretim në drejtim të detyrimit të prokurorisë për marrjen e autorizimit për atë qëllim. Nga ana tjetër, referuar edhe përmbajtjes së vendimit të Kuvendit të dhënë në atë rast, gjuha e përdorur rezultoi e përgjithshme, për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet se ajo ka bërë apo se lejon ndonjë interpretim për shtrirjen e regjimit të autorizimeve edhe për masat e tjera siç janë “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”.

57. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se ky rast i vetëm, i cili për më tepër ka rrethana të ndryshme, nuk mund të përbëjë shkak për të krijuar pritshmëri të ligjshme për kërkuesin dhe as detyrim për gjykatat, në kuptimin e praktikës së konsoliduar të Kuvendit ose barazisë përpara ligjit. Në vlerësimin e Gjykatës, edhe pse çështja në dukje ka problematikë për shkak se rasti i parë i referohej një deputeti të shumicës parlamentare, ndërsa në rastin konkret atij të pakicës, kjo nuk do të thotë që një praktikë pune e Kuvendit, e paqartë në zbatimin e Kushtetutës, të përliqet vetëm për këtë shkak, sepse në këtë mënyrë krijohen norma të reja kushtetuese. Për këto arsye, Gjykata çmon se edhe analiza e precedentit konfirmon rezultatin e analizës qëllimore dhe semantike se neni 73, pika 2, i Kushtetutës i garanton deputetit mbrojtje të posaçme nga ato veprime procedurale të ndërmarra nga organet ligjzbatuese në kuadër të procedimit penal të cilat kufizojnë lirinë e tij personale.

58. Gjithashtu, Gjykata vëren se argumenti i kërkuesit, sipas të cilit, Kuvendi duhet të japë autorizimin në rastin e caktimit të masave të detyrimit për paraqitje në Policinë Gjyqësore dhe të ndalimit të daljes jashtë shtetit, nuk pajtohet me parashikimin e nenit 73 të Kushtetutës. Një argument i tillë, nëse pranohet, tejkalon qëllimin e normës kushtetuese për imunitetin procedural

(paprekshmërinë) e deputetit, të detajuar në nenet 288-289 të KPP-së, sipas të cilave, mosdhënia e autorizimit nuk e pengon prokurorin që të kërkojë një masë tjetër sigurimi. Një argument i tillë, nëse pranohet, jep rezultatin se ndaj një deputeti, përgjatë procedimit penal, nuk mund të caktohet asnjë masë sigurimi personal pa autorizim të Kuvendit. Në këtë drejtim, Gjykata eidenton se KPP-ja parashikon dy kategori të masave të sigurimit personal, ato shtrënguese dhe ato ndaluese (neni 227). Në kategorinë e masave shtrënguese, KPP-ja ka listuar sipas rëndësës, ndalimin e daljes jashtë shtetit, detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore, ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar, garancia pasurore, arresti në shtëpi, arresti në burg dhe shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik (neni 232), ku është e qartë se ndaj kërkuesit janë caktuar dy masat më të lehta. Ndërsa në kategorinë e masave ndaluese, kodi ka parashikuar dy masa, që janë pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik dhe ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste (neni 240). Mirëpo të dyja këto masa ndaluese nuk mund të caktohen ndaj deputetit, sepse neni 242, pika 2, i KPP-së parashikon shprehimisht se pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik nuk zbatohet ndaj personave të zgjedhur sipas ligjit elektoral, ndërsa neni 243 tregon se ndalimi i ushtrimit të veprimtarive profesionale ka të bëjë me persona që ushtrojnë profesionin pranë personave juridikë privatë.

59. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se togfjalëshi “ose t’i biqet liria në çfarëdo lloj forme” i referohet vetëm *lirisë personale*, të mbrojtur nga neni 27 i Kushtetutës dhe ai gjen zbatim vetëm në ato raste kur ndaj deputetit vendoset një masë kufizuese, që i heq lirinë personale. Për pasojë, autorizimi i Kuvendit është i nevojshëm vetëm nëse masat kufizuese të vendosura ndaj kërkuesit përbëjnë kufizim/heqje të lirisë së tij personale, i cili është i tillë që sjell pasoja në vetë të drejtën e deputetit për t’u zgjedhur, në aspektin e ushtrimit të të drejtave të tij si deputet, pra të vetë veprimtarisë parlamentare. Gjykata vlerëson se masa e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, në këndvështrim të së drejtës për t’u zgjedhur, sipas nenit 45 të Kushtetutës, duke iu referuar llojit të detyrimit dhe shpeshësisë së zbatimit të saj (në rastin konkret një herë në dy javë), nuk prek



funksi­on­et legjisla­tive të Kuvendit dhe nuk e pengon kërkuesin të ushtrojë të drejtat e tij si deputet. Mbi të njëjtin argument, Gjykata vlerëson se edhe masa e sigurimit e ndalimit për të dalë jashtë shtetit nuk e pengon kërkuesin të zhvillojë jetën e tij parlamentare. Për rrjedhojë, për sa kohë që kjo masë nuk përbën kufizim të lirisë personale pika 2 e nenit 73 të Kushtetutës nuk kërkon autorizimin e Kuvendit për zbatimin e saj ndaj deputetit. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit në drejtim të mënyrës së zbatimit të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, është i pabazuar.

B.1.2. Për cenimin e parimit të paanshmërisë për shkak të dispozitave ligjore

60. Referuar pretendimeve të kërkuesit për cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë të gjykatës si rezultat i dispozitave të ligjit nr. 95/2016 për kontrollin periodik të telekomunikimeve, Gjykata, në vijim do t'i shqyrtojë ato në drejtim të testit objektiv të parimit të paanshmërisë së gjyqtarit. Sipas kërkuesit, atij i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, pasi referuar dispozitave të ligjit nr. 95/2016, gjyqtarët e gjykatave të posaçme nuk ofrojnë garancitë e nevojshme të pavarësisë për arsyet e mëposhtme: i. të gjitha komunikimet elektronike të këtyre gjyqtarëve dhe të familjarëve të tyre të afërt janë të vëzhguara nga Prokuroria e Posaçme. Ky vëzhgim është i pakufizuar në kohë dhe hapësirë, bëhet pa asnjë arsye specifike, si edhe nuk monitorohet *a priori* ose kontrollohet *a posteriori* nga ndonjë gjykatë në lidhje me proporcionalitetin e kësaj ndërhyrjeje; ii. oficeri përgjegjës për vëzhgimin është pjesë e strukturës së BKH-së, e cila varet nga Prokuroria e Posaçme, që është organi që ka kërkuar masat e sigurimit personal në rastin e tij dhe i mbron ato përpara gjykatave të posaçme; iii. referuar nenit 53, Prokuroria e Posaçme ka të drejtë të hetojë çdo gjyqtar të gjykatave të posaçme edhe për veprat penale të cilat nuk janë brenda kompetencës së saj lëndore. Për sa më sipër, në vlerësimin e kërkuesit, ky ligj cenon procesin e rregullt të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

61. Subjekti i interesuar ka parashtruar se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë është i pabazuar, pasi: i. ligji nr. 95/2016 ka vendosur garanci të rëndësishme gjatë procesit të monitorimit, ku oficerit përgjegjës nuk i lejohej të dëgjojë telefonatat që cenojnë të drejtën për jetë private të personave që

nuk kanë dhënë miratim paraprak për vëzhgim; ii. Prokuroria e Posaçme e ushtron ndjekjen penale vetëm përpara gjykatave të posaçme dhe janë këto të fundit, të cilat, në mënyrë të pavarur, kontrollojnë veprimet e saj procedurale, duke filluar që në fazat e hetimit paraprak dhe dhënien e miratimit të mjeteve hetimore të mbledhjes së provave. Po kështu, Prokuroria e Posaçme ka prapësuar se ligji nr. 95/2016 e ka kaluar vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën që i është bërë në konsultimin e draftit final nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar në Sistemin e Drejtësisë në datën 3.10.2016. Sipas Prokurorisë së Posaçme, në thelb, argumentet e kërkuesit në këtë drejtim kanë të bëjnë me shfuqizimin e dispozitave ligjore, ndërkohë që Gjykata kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji që rishikon Kushtetutën, nuk shqyrton përmbajtjen ose përputhshmërinë e amendamenteve kushtetuese me Kushtetutën e mëparshme, por vetëm procedurën me të cilën janë miratuar këto ndryshime. Për rrjedhojë, sipas Prokurorisë së Posaçme, edhe kushtetutshmëria e dispozitave të ligjit nr. 95/2016 nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata.

62. E drejta për një proces të drejtë, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, kërkon që një çështje duhet të shqyrtohet nga një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme”. Pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës, kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat ndërsa japin drejtësi, t'u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve (*shih vendimet nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 5, datë 16.2.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

63. Po kështu, Gjykata ka pranuar se vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre. Kjo pavarësi, e parë në kontekstin e parimit kushtetues të shtetit të së drejtës, nuk është privilegj, por një nga detyrimet më të rëndësishme të gjyqtarëve dhe gjykatave që buron nga të drejtat e garantuara kushtetutshmërisht individit që pretendon cenimin e të drejtave dhe lirive të tij, për të pasur një arbitër të paanshëm të mosmarrëveshjes, që do ta zgjidhë atë në themel sipas Kushtetutës dhe ligjeve (*shih vendimin nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Nën frymën e dispozitave të Kushtetutës për pavarësinë e gjyqësorit dhe ndarjen e pushteteve, Gjykata ka



pohuar se nuk duhet të cenohen elementet e pavarësisë, të cilat në thelb prekin vetë funksionin e dhënies së drejtësisë (*shih vendimin nr. 20, datë 9.7.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

64. Për sa i përket së drejtës për një gjykatë të paanshme, ajo nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 7, datë 11.3.2008, të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëm i bazuar (*shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

65. Bazuar në thelbin e pretendimeve të kërkuarit për mungesën e pavarësisë së gjyqtarëve të gjykatave të posaçme, Gjykata vëren se ato (pretendimet) lidhen me faktin që ligji nr. 95/2016 parashikon një regjim të kontrollit periodik edhe të telekomunikimeve vetjake të këtyre gjyqtarëve dhe familjarëve të tyre të afërt nga BKH-ja, e cila varet nga Prokuroria e Posaçme, që është organi që ka kërkuar masat e sigurimit personal në rastin e tij. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuari ka evidentuar edhe

përmbajtjen e nenit 53 të ligjit, sipas të cilit prokurorët e Prokurorisë së Posaçme mund të nisin një hetim penal kundër secilit gjyqtar të gjykatave të posaçme edhe për vepra penale të cilat nuk janë brenda kompetencës së saj lëndore, për të mbështetur pretendimet e tij për mungesën e pavarësisë së gjyqtarëve të gjykatave të posaçme. Duke qenë se regjimi i kontrollit të telekomunikimeve vetjake të gjyqtarëve të GJKKO-ve autorizohet nga neni 135, pika 4, i Kushtetutës, se BKH-ja është organ i parashikuar nga neni 148, pika 4, i Kushtetutës, si një njësi e posaçme hetimore në varësi të Prokurorisë së Posaçme, dhe se kompetenca lëndore e Prokurorisë së Posaçme për hetimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar përcaktohet nga neni 148, pika 4, dhe 148/dh të Kushtetutës, përfshirë edhe i çështjeve penale të kryera nga subjektet e posaçme sipas nenit 135, pika 2, i Kushtetutës, në vijim Gjykata do të vlerësojë nëse ligji nr. 95/2016 përmban rregullimet e duhura organizative dhe procedurale të cilat janë në gjendje të garantojnë pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme dhe, për pasojë, të drejtën e kërkuarit për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Në këtë kuptim, ashtu siç është theksuar edhe më sipër në këtë vendim (shih supra paragrafin 38 i vendimit), Gjykata do t'i shqyrtojë pretendimet e kërkuarit për pavarësinë e gjyqtarit në drejtim të testit objektiv të parimit të paanshmërisë.

66. Gjykata vëren se sipas neneve 148, pika 4 dhe 148/dh, pika 1, të Kushtetutës, Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën për veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër funksionarëve më të lartë të shtetit. Ndërsa, sipas nenit 135, pika 4, të Kushtetutës, kandidatët për gjyqtarë në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e tyre të afërm, japin pëlqimin për kontrollin periodik edhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit. Në bazë edhe të këtij delegimi kushtetues, ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 95/2016, që ka për objekt, ndër të tjera, edhe përcaktimin e rregullave për organizimin dhe zbatimin e regjimit të vëzhgimit të telekomunikimeve të gjyqtarëve të GJKKO-ve, të cilat parashikohen edhe në nenet 48–54.

67. Referuar përmbajtjes së këtyre dispozitave rezulton se ligji nr. 95/2016 ka rregulluar procesin e vëzhgimit periodik të telekomunikimeve vetjake të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme dhe të familjarëve të tyre të afërt. Në këtë proces marrin pjesë disa



aktorë, të cilët kanë role të mirëpërcaktuara nga ligji. Kështu, organi përgjegjës për zbatimin e vëzhgimit të telekomunikimeve vetjake është BKH-ja, specifikisht oficeri përgjegjës për mbikëqyrjen, që është një hetues i saj (nenet 42, 49 dhe 51), i cili përzgjidhet me short çdo 6 muaj (neni 42). Vëzhgimi nga oficeri përgjegjës i BKH-së bëhet sipas një plani të krijuar nga vetë ai çdo muaj, plan i cili ndryshohet çdo 3 muaj dhe nuk i bëhet i ditur askujt (neni 51, pika 1). Oficeri përgjegjës i BKH-së, nëse gjatë vëzhgimit të telekomunikimeve vetjake të gjyqtarit të posaçëm i lind dyshimi i arsyeshëm se një telefonatë, mesazh ose komunikim me postë elektronike është provë e korrupsionit, nxjerrjes së informacionit, komunikimit me organizata kriminale, ndikimit politik apo çfarëdo veprimi tjetër që mund të jetë në shkelje të KP-së, ia raporton atë një prokurori të posaçëm të gatshëm (nenet 42, pika 5, 51, pika 3 dhe 53, pika 1), i cili edhe ai përzgjidhet me short çdo muaj (neni 42, pika 5), duke pasur ai në vijim kompetencën për nisjen e një hetimi penal (neni 53, pika 2), hetim që zhvillohet në përputhje me rregullat e përcaktuara nga KPP-ja. Po ashtu, oficeri përgjegjës i BKH-së, nëse gjatë vëzhgimit të telekomunikimeve vetjake të gjyqtarit të posaçëm vëren shkelje të etikës nga gjyqtari i posaçëm, ia raporton atë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (neni 42, pika 9), i cili ka kompetencën për fillimin e procedimit disiplinor, procedim i cili zhvillohet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 96/2016). Në këtë kuptim rezulton se në procedurën e kontrollit periodik të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme Prokuroria e Posaçme luan rolin e saj sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 95/2016, si organi në varësi të të cilit janë vetë oficerët përgjegjës të BKH-së.

i. Ndikimi i regjimit të vëzhgimeve në pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme

68. Për sa i përket vëzhgimit të telekomunikimeve vetjake të pjesëtarëve të afërt të familjes së gjyqtarëve të posaçëm, ky vëzhgim mund të bëhet vetëm nëse: a) ekziston dyshim i arsyeshëm se telefoni është përdorur nga gjyqtari i posaçëm për të shmangur vëzhgimin e tij apo për të shërbyer si ndërmjetës për atë; b) anëtar i afërt i familjes ka dhënë pëlqimin për vëzhgimin periodik, por jo ndaj anëtarëve të familjes nën 18 vjeç. Në një rast të tillë, oficeri përgjegjës i BKH-së, brenda 24 orëve,

përgatit një raport me shkrim për rezultatet e monitorimit të anëtarit të afërt të familjes dhe ia paraqet prokurorit të posaçëm të gatshëm, ndërsa ky i fundit mund të autorizojë me shkrim vazhdimin e monitorimit të telefonit të pjesëtarit të afërt të familjes në situatën e përmendur në pikën “a” ose i kërkon gjykatës një autorizim për përgjim sipas kërkesave të KPP-së kur ka dyshime të arsyeshme për veprimtari kriminale (neni 42, pikat 6 dhe 7).

69. Në lidhje me vëzhgimin e telekomunikimeve vetjake të personave që nuk kanë dhënë miratim paraprak për vëzhgimin, oficeri përgjegjës i BKH-së nuk dëgjon telefonatat që shkelin të drejtën e tyre për jetë private, por nëse ai ka dyshim të arsyeshëm se ka ndodhur apo do të ndodhë një veprë penale dhe se vëzhgimi i asaj telefonate me këta persona do të japë prova për këtë veprë penale, ai i raporton menjëherë prokurorit të posaçëm për të marrë nga gjykata autorizim për përgjim sipas kërkesave të KPP-së (neni 51, pika 5).

70. Regjistrat e telekomunikimeve vetjake dhe shënimet e tjera, si rregull, shkatërrohen brenda 3 ditëve nga oficeri përgjegjës i BKH-së, ndërsa ato ruhen për një periudhë 6-mujore nëse ngrenë dyshime të arsyeshme për veprimtari të papërshtatshme apo kriminale, gjë e cila urdhërohet me shkrim nga një prokuror i posaçëm ose gjykata e posaçme (neni 42, pika 8). Kurse të dhënat nga vëzhgimi i telekomunikimeve vetjake, si rregull, shkatërrohen pas muajit të dytë nga oficeri përgjegjës i BKH-së, me përjashtim të rastit kur ruajtja e tyre urdhërohet nga një prokuror i posaçëm nëse ngrenë dyshime të arsyeshme për veprimtari të papërshtatshme apo kriminale (neni 51, pika 4). Në çdo rast, për sa u përket të dhënave personale, oficeri përgjegjës i BKH-së është përgjegjës për mbrojtjen e tyre dhe ato ruhen e përpunohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale (neni 51, pika 4 dhe 52).

71. Nga analiza si më lart e ligjit nr. 95/2016, ndryshe nga sa pretendohet nga kërkuksi, nuk rezulton që: i. komunikimet elektronike të gjyqtarëve të posaçëm dhe të familjarëve të tyre të afërt të vëzhgohen nga Prokuroria e Posaçme, por nga oficeri përgjegjës i BKH-së, i cili në këtë proces nuk është në lidhje varësie me atë prokurori në kuptimin e përcaktimit të planit të vëzhgimit dhe realizimit të tij, përveçse kur ngrihen dyshime për veprimtari të papërshtatshme ose kriminale, rast në të cilin ajo ka kompetencën për ushtrimin e ndjekjes penale sipas



ligjit. Vëzhgimi i telekomunikimeve vetjake të gjyqtarëve të posaçëm nuk është i pakufizuar në kohë dhe në hapësirë, ndërsa ai bëhet me qëllim garantimin e besimit tek ata dhe integriteti i tyre, duke u siguruar që mos kenë lidhje me grupe kriminale apo burime të tjera ndikimi të papërshtatshme. Gjykata vëren se këto çështje janë sjellë në vëmendje të hartuesve të Kushtetutës edhe nga Komisioni i Venecias në Opinionin e tij nr. 824/2015. Në këtë Opinion Komisioni i Venecias vlerësonte, midis, të tjerash, se: “*çdo ‘vëzhgim i tillë i telekomunikimeve’ duhet të shoqërohet me garanci procedurale të përshtatshme dhe efektive, të përshkruara qartë në ligj [...] në veçanti duhet të ketë një autorizim gjyqësor të bazuar në një dyshim të arsyeshëm[...]*” (faqe 12)⁹. Ky vëzhgim është përcaktuar nga Kushtetuta, ndaj kushtetutshmëria e kësaj ndërhyrjeje nuk mund të vihet në diskutim, ndërkohë që në rastin e dyshimit për kryerjen e një veprë penale, ndërhyrja përmes përgjimit të telekomunikimeve vetjake, si mjet për kërkimin e provës, ndjek rregullat e përcaktuara në KPP, ndërsa është gjykata ajo që autorizon një veprim të tillë; ii. oficeri përgjegjës për vëzhgimin është pjesë e strukturës së BKH-së, e cila varet nga Prokuroria e Posaçme, por kjo varësi nënkupton varësinë procedurale hetimore, jo varësinë e saj administrative për sa i përket procesit të vëzhgimit të telekomunikimeve vetjake; iii. neni 53 i ligjit nuk rregullon kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme dhe në këtë kuptim kjo dispozitë nuk i jep bazë ligjore kompetencës së asaj prokurorie për të hetuar çdo gjyqtar të gjykatave të posaçme edhe për veprat penale të cilat nuk janë brenda kompetencës së saj lëndore.

72. Në lidhje me pretendimin për ndikimin që mund të ketë në pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme regjimi i vëzhgimit periodik të telekomunikimeve të tyre vetjake, Gjykata rithekson, *së pari*, se ky regjim autorizohet nga neni 135, pika 4, i Kushtetutës. Gjyqtarët që shërbejnë në gjykatat e posaçme janë të vetëdijshëm për zbatimin periodik të këtij vëzhgimi, i cili bëhet i mundur pikërisht falë pëlqimit paraprak të dhënë nga vetë gjyqtarët dhe familjarët e tyre të afërt. *Së dyti*, Gjykata, referuar nenit 1 të ligjit nr. 95/2016, që përcakton objektin e tij, konstaton se rregullave, kushteve dhe

procedurave në lidhje me kontrollin e figurës, vëzhgimin e të dhënave financiare dhe vëzhgimin e telekomunikacioneve, u nënshtrohen, në të njëjtën mënyrë si gjyqtarët e gjykatave të posaçme, edhe prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, ashtu edhe familjarët e tyre. Thënë ndryshe, ligji nuk parashikon një regjim kontrolli vetëm për gjyqtarët. *Së treti*, Gjykata vëren se ligji nr. 95/2016, duke marrë në konsideratë edhe rekomandimet e Komisionit të Venecias, parashikon disa garanci në mënyrën e zbatimit të vëzhgimit, si më poshtë: i. shqyrtimi i komunikimeve telefonike, mesazheve apo postës elektronike të gjyqtarëve është periodik (jo permanent). Ai kryhet bazuar në një plan mujor shqyrtimi të krijuar nga oficeri përgjegjës i BKH-së. Ky plan ndryshohet çdo 3 muaj (*neni 51, pika 1*); ii. oficeri i BKH-së përgjegjës për vëzhgimin i ruan të dhënat e përfutuara nga vëzhgimi për 2 muaj dhe, në rast se nuk urdhërohet nga një prokuror i Prokurorisë së Posaçme t’i ruajë të dhënat për më gjatë, i shkatërron ato pas muajit të dytë. Oficeri i BKH-së është gjithashtu përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale të gjyqtarëve dhe familjarëve të tyre të afërt në përputhje me legjislacionin përkatës (*neni 51, pika 4*); iii. oficeri përgjegjës për vëzhgimin nuk mund të dëgjojë telefonatat e personave që nuk kanë dhënë miratim paraprak për vëzhgimin. Në qoftë se ai mendon se vëzhgimi i telekomunikimeve të personave që nuk kanë dhënë pëlqim paraprak për vëzhgimin është i rëndësishëm për zbulimin e një veprë penale, ai duhet të kontaktojë menjëherë një prokuror të posaçëm të papërfshirë në shkelje për të marrë autorizim nga gjykata (*neni 51, pika 5*); iv. vëzhgimet e kryera mbi telekomunikimet vetjake të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme dhe të familjarëve të tyre të afërt kanë vlerën ligjore të përgjimeve parandaluese në kuptimin e nenit 221, pika 5, të KPP-së dhe të ligjit nr. 9157, datë 4.12.2003, “Për përgjimin e komunikimeve elektronike”. Dallimi i vetëm lidhet me procedurën e autorizimit, e cila është automatike dhe periodike sipas ligjit nr. 95/2016. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se rregullimet e dispozitave të ligjit nr. 95/2016 lidhur me regjimin e vëzhgimit periodik të telekomunikimeve vetjake të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme, të cilave, sipas

⁹ Shih opinionin e Komisionit të Venecias CDL-AD (2016) 009, datë 14 mars 2016 ([https://www.venicecoe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)009-e](https://www.venicecoe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)009-e))



nenit 1 të tij, u nënshtrohen në të njëjtën mënyrë edhe vetë prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, për sa kohë që edhe vetë këta të fundit janë subjekte kontrolli, ofrojnë garanci të mjaftueshme kundër abuzimit dhe arbitraritetit në fazën e zbatimit, duke garantuar në këtë mënyrë edhe pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme. Për sa më sipër, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim nuk janë të bazuara.

ii. Ndikimi i strukturës përgjegjëse për vëzhgimin mbi pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme

73. Në lidhje me pretendimin për ndikimin që mund të ketë mbi pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme fakti që struktura përgjegjëse për vëzhgimin e telekomunikimeve të tyre vetjake është BKH-ja, e cila varet nga Prokuroria e Posaçme, që është organi që ka kërkuar masat e sigurimit personal në rastin e tij dhe i mbron ato përpara gjykatave të posaçme, Gjykata vëren, *së pari*, se sipas nenit 148, pika 4, të Kushtetutës BKH-ja është në varësi të Prokurorisë së Posaçme. *Së dyti*, Gjykata sjell në vëmendje se BKH-ja ushtron funksionet e Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Posaçme (neni 30, pika 4, i KPP-së). Në këtë funksion, BKH-ja duhet të kërkojë në mënyrë aktive dhe me nismën e vet informacione për veprat penale, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme të veprave penale, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë të dhëna që i shërbejnë zbatimit të ligjit penal (neni 30, pika 1, i KPP-së). Në cilësinë e saj si polici gjyqësore, BKH-ja ka varësi procedurale nga Prokuroria e Posaçme, pasi oficerët e saj përgjigjen para prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme për veprimtarinë e kryer në kuadër të procedimit penal (neni 39 i ligjit nr. 95/2016). Në këtë kuptim, Gjykata nuk vëren ndonjë dallim në mënyrën e funksionimit të BKH-së në krahasim me njësitë e tjera të Policisë Gjyqësore të parashikuara nga KPP-ja dhe ligji nr. 25/2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. *Së treti*, Gjykata vëren se, pavarësisht faktit se BKH-ja është një njësi e Policisë Gjyqësore që funksionon nën drejtimin procedural të Prokurorisë së Posaçme, në bazë të ligjit nr. 95/2016, ajo ka elemente autonomie administrative në raport me Prokurorinë e Posaçme, e cila ilustron nga parashikimet e mëposhtme ligjore: i. oficerët e Policisë Gjyqësore nga Policia e Shtetit dhe institucionet e tjera shërbejnë nën drejtimin administrativ të zëvendësudrejtorit të BKH-

së (neni 31, pika 3, i ligjit 95/2016); ii. organizimi dhe funksionimi i shërbimeve të Policisë Gjyqësore të BKH-së rregullohet në përputhje me urdhrat e drejtorit të saj (BKH-së), me pëlqimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme (neni 31, pika 4, i ligjit nr. 95/2016); iii. drejtori i BKH-së, i cili emërohet dhe shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, është përgjegjës për funksionimin e asaj strukture dhe nuk është në raporte të mirëfillta varësie me drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme. Ai (drejtori) mbikëqyret nga një komision i përbërë prej tre prokurorësh të Prokurorisë së Posaçme, njëri prej të cilëve është drejtuesi i saj dhe dy të tjerët zgjidhen çdo vit me short (neni 33, pikat 1 dhe 5, i ligjit nr. 95/2016); iv. drejtori i BKH-së përzgjedh nga radhët e hetuesve një zëvendësudrejtor me pëlqimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme (neni 33, pika 6); v. hetuesit e BKH-së emërohen nga drejtori i saj, me pëlqimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme; vi. oficeri i BKH-së përgjegjës për vëzhgimin e telekomunikimeve të gjyqtarëve vepron në mënyrë të pavarur nga drejtuesi ose prokurorët e Prokurorisë së Posaçme (neni 51). Në këtë kuptim, Gjykata, duke pasur parasysh edhe përmbajtjen e dispozitave të sipërcituara, vlerëson se ndryshe nga sa pretendon kërkuesi rregullimi i ligjit nr. 95/2016 lidhur me strukturën që kryen vëzhgimin periodik të gjyqtarëve, ndonëse ia vesh këtë përgjegjësi BKH-së, e cila është një njësi e posaçme hetimore në varësi të Prokurorisë së Posaçme, ofron garanci të mjaftueshme për pavarësinë e gjyqtarëve të posaçëm.

iii. Ndikimi i kompetencës së Prokurorisë së Posaçme për hetimin e veprave penale të kryera nga gjyqtarët e gjykatave të posaçme mbi pavarësinë e tyre

74. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit se, referuar nenit 53 të ligjit nr. 95/2016, bazuar në informacione dhe prova të servirura nga kushdo, Prokuroria e Posaçme ka të drejtë të hetojë çdo gjyqtar të gjykatave të posaçme, edhe për veprat penale të cilat nuk janë brenda kompetencës së saj lëndore, dhe se ky fakt ndikon negativisht mbi pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme, Gjykata vëren se rregullimi i nenit 53 nuk ka të bëjë me rregullat e përgjithshme të kompetencës lëndore, siç përcaktohen ato nga neni 75/a i KPP-së, por me një proces administrativ të raportimit të informacioneve dhe provave i cili, nëse rezulton në një procedim penal, do të ndjekë rregullat e përgjithshme të kompetencës lëndore. Për këtë



arsye, Gjykata çmon se, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, rregullimi i nenit 53 të ligjit 95/2016 nuk cenon garancitë për pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme.

75. Për sa më sipër, Gjykata vëren se në procedurën e vëzhgimit periodik të telekomunikimeve vetjake të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme, oficeri përgjegjës i BKH-së nuk vepron nën drejtimin e prokurorit të posaçëm për sa kohë nuk ngrihen dyshime për veprime të papërshtatshme ose të karakterit penal. Përkundrazi vëzhgimi i telekomunikimeve është një veprimtari rutinore administrative e cila mund të përshkallëzohet në një procedim penal të nisur nga prokurori i posaçëm vetëm nëse nga kjo veprimtari konstatohen elemente të konsumimit të një veprime penale që është në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme. Për më tepër, rezultatet e këtij vëzhgimi i nënshtrohen kontrollit gjyqësor, për sa kohë ato janë objekt vlerësimi nga gjykata në rastet e procedimit penal (kur konstatohen elemente të veprës penale) dhe nga KLGJ-ja (një organ i përbërë në shumicë nga gjyqtarë) në rastet e procedimeve disiplinore të gjyqtarëve. Po kështu, dispozitat e ligjit nuk pengojnë apo përjashtojnë të drejtën e gjyqtarit që të kërkojë pushimin e cenimit për shkak të veprimtarisë së kontrollit nëse ai pretendon se ajo është kryer në kundërshtim me të drejtat e tij kushtetuese, siç janë edhe e drejta për jetë private dhe familjare për aq sa ato janë të zbatueshme. Për sa më sipër, Gjykata vëren se, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, ligji përmban garanci të mjaftueshme për të siguruar pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme lidhur me mënyrën se si realizohet vëzhgimi i telekomunikimeve të tyre vetjake dhe, për pasojë, pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim nuk janë të bazuara.

76. Për më tepër, Gjykata vlerëson të theksojë se kuadri ligjor në fuqi që rregullon statusin e magjistratit dhe të drejtat që burojnë prej tij, përmban një tërësi garancish ligjore dhe procedurale shtesë, të cilat sigurojnë pavarësinë e këtyre gjyqtarëve të posaçëm në ushtrim të funksionit të tyre, ku përfshihet sistemi i emërimit, pagës, karrierës, shkarkimit ashtu edhe trajtimin e posaçëm të tyre.

77. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit në drejtim të përmbajtjes së

neneve 48-51 të ligjit nr. 95/2016, nuk është i bazuar.

B.1.3. Për cenimin e së drejtës së mbrojtjes efektive

78. Në lidhje me pretendimet për cenim të së drejtës së mbrojtjes efektive, kërkuesi ka paraqitur në thelb argumentet si më poshtë: i. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk e ka njoftuar rregullisht kërkuesin për vendimin nr. 112, datë 20.10.2023, me anë të të cilit mbi kërkuesin u vendosën masat e sigurimit personal; ii. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk u ka dhënë kohën e mjaftueshme mbrojtësve të zgjedhur nga ai për të realizuar një mbrojtje efektive; iii. mbrojtësja e caktuar kryesisht nga ajo gjykatë, avokatja V.T., ishte e papërshtatshme për ta mbrojtur, për shkak të qëndrimeve të saj kundër tij në rrjetet sociale dhe duhej të përjashtohet si avokat i caktuar kryesisht për të njëjtin shkak që u përjashtua edhe avokati i mëparshëm i caktuar kryesisht; iv. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk e ka dorëzuar vendimin për vazhdimin e masave të sigurimit ndaj kërkuesit (vendimi nr. 117, datë 26.10.2023) të arsyetuar sipas afatit të përcaktuar nga KPP-ja.

79. Në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive, subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar për arsyet e mëposhtme: i. për sa i takon pretendimit për mosnjoftimin e rregullt të vendimit nr. 112, datë 20.10.2023, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka kryer të gjitha veprimet për t'ia vënë në dispozicion kërkuesit, por ky i fundit ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë për të mos e marrë atë, duke refuzuar kështu njohjen me vendimin. Në seancën gjyqësore të datës 24.10.2023 për marrjen në pyetje të personit ndaj të cilit është ekzekutuar masa e sigurimit, vendimi nr. 112, datë 20.10.2023 iu është vënë në dispozicion mbrojtësve të kërkuesit, duke qenë se ata gëzonin tagrat për të marrë në dorëzim akte për llogari të tij; ii. për sa i takon pretendimit për mungesën e kohës së mjaftueshme për përgatitjen e një mbrojtjeje efektive, subjekti i interesuar ka prapësuar se mbrojtësve të kërkuesit u është lënë një kohë e mjaftueshme për t'u njohur me aktet e dosjes për të realizuar mbrojtjen, por ata zgjedhën të mbroreshin duke kërkuar shtyrjen e seancës dhe nëpërmjet kërkesave të tjera procedurale; iii. për sa i takon pretendimit për papërshtatshmërinë e mbrojtësit të caktuar kryesisht, subjekti i interesuar ka parashtruar se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vepruar në



respektim të mbrojtjes së të drejtave të kërkuarit, duke i caktuar atij edhe mbrojtës kryesisht.

80. Për sa më lart, bazuar në thelbin e pretendimeve të kërkuarit, konkretisht, në lidhje me: *i.* parregullsinë në njoftimin e vendimit për caktimin e masave të sigurimit; *ii.* kohën e pamjaftueshme për të realizuar mbrojtjen dhe *iii.* mosarsyetimin e vendimit sipas afatit të parashikuar nga KPP-ja, Gjykata do t'i analizojë në aspekt të pamjaftueshmërisë së kohës për realizimin e mbrojtjes. Ndërsa për sa i përket pretendimit për *iv.* papërshtatshmërinë e mbrojtësës së caktuar kryesisht, Gjykata do ta analizojë atë në aspekt të cilësisë së mbrojtjes.

81. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal ka përmbajtje substanciale, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35, datë 1.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht në procesin penal, mbrojtja e të pandehurit lidhet ngushtë me barazinë e armëve dhe kontradiktoritetin, të cilat së bashku përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e tyre, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 71, datë 30.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, realizimi substancial i mbrojtjes së individit është, në radhë të parë, përgjegjësi e mbrojtësit që pranon detyrën e caktuar (*shih vendimin nr. 34, datë 17.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

i. Pamjaftueshmëria e kohës për realizimin e mbrojtjes efektive

82. Në lidhje me pretendimet për pamjaftueshmërinë e kohës për realizimin e mbrojtjes efektive, Gjykata vëren se ato mund të ndahen në 3 nënpretendime: *i.* mosnjoftimi i vendimit nr. 112, datë 20.10.2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë që ka vendosur caktimin ndaj kërkuarit të masave të sigurimit personal; *ii.* koha e pamjaftueshme për t'u njohur me vendimin nr. 112 dhe aktet e depozituara nga organi i akuzës përpara seancës së marrjes në pyetje të kërkuarit; *iii.* mosarsyetimi brenda afatit ligjor i vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë për vazhdimin e masave të sigurimit ndaj kërkuarit (vendimi nr. 117, datë 26.10.2023).

83. Për sa më sipër, referuar pretendimeve të kërkuarit, bazuar në nenet 31 dhe 42 të Kushtetutës, Gjykata çmon t'i analizojë ato në drejtim të standardeve të mësipërme kushtetuese (*shih paragrafin 81 të vendimit*) të përshtatura me natyrën e gjykimit në procesin e kundërshtuar nga kërkuari që lidhet me vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë për marrjen në pyetje të personit ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit, i cili, sipas nenit 248, pika 1, të KPP-së, duhet të jepet brenda 5 ditëve nga dita e zbatimit të masës së sigurimit.

84. Lidhur me nënpretendimin e parë, se GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk e ka dorëzuar/njoftuar vendimin për vendosjen ndaj tij të masave të sigurimit (vendimi nr. 112, datë 20.10.2023), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se kërkuari dhe familjarët e tij kanë refuzuar të marrin në dorëzim vendimin e gjykatës, dokumentuar kjo nga procesverbalet përkatëse të përpiluara nga oficerët e Policisë Gjqësore, të cilët në mënyrë të vazhdueshme kanë bërë të gjitha përpjekjet për t'ia dorëzuar atë kërkuarit personalisht. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, kërkuari ka marrë dijeni për vendimin e gjykatës dhe ka refuzuar ta nënshkruajë atë, dokumentuar kjo nga qëndrimi që ka mbajtur në konferencën për shtyp në media të ndryshme në datën 21.10.2023. Në lidhje me këtë nënpretendim, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se e konsideron të ezauruar atë, për sa kohë ai është ankuar personalisht ndaj atij vendimi, duke ngritur shkaqe konkrete ankuese. Në lidhje me po këtë nënpretendim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se ai është i pabazuar, për sa kohë që kërkuari qartazi ka paraqitur ankim ndaj masës së sigurimit personal dhe për sa kohë është konstatuar investimi ezaurues i GJKKO-së së Shkallës së Parë, gjyqtarës të



hetimeve paraprake, për realizimin e këtij njoftimi. Sipas Kolegjit Penal, përpjekjet e palëve në funksion të evitimit/devijimit të realizimit të procedurës së njoftimit përbëjnë sjellje të “abuzimit me procesin” dhe si të tilla nuk mund të shërbejnë për të kërkuar pavlefshmërinë (në formën e inekzistencës) e procedurës së realizimit të njoftimit, për sa kohë që është “kontribuar intensivisht” (prej tyre) në pengimin e realizimit të saj. Sipas atij kolegj, ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, nuk konstatohen shkelje të dispozitave të KPP-së për njoftimin e kërkuarit (*shih faqet 80–81 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

85. Lidhur me *nënpretendimin e dytë* (koha e pamjaftueshme për t’u njohur me vendimin nr. 112 dhe aktet e tjera), rezulton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka konstatuar formalisht se kërkuar në mënyrë të vullnetshme ka hequr dorë nga e drejta për t’u pyetur dhe për t’u mbrojtur. Rezulton, gjithashtu, se ajo ka ndërprerë seancën për marrjen në pyetje të kërkuarit, për t’u dhënë kohë mbrojtësve për t’u njohur me aktet. Me riçeljen e seancës mbrojtësit e kërkuarit kanë deklaruar se me vendimin sapo janë njohur dhe për të siguruar një mbrojtje efektive ishte e pamundur të vijohej seanca. Në këto kushte, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka ndërprerë seancën dhe e ka shtyrë atë për në datën 25.10.2023, ora 14:30 për t’u dhënë kohë mbrojtësve të njihen me aktet. Në seancën e datës 25.10.2023 mbrojtësit e kërkuarit kanë paraqitur kërkesë për marrjen e kopjes së akteve që ka depozituar organi i akuzës, si dhe kërkesën për dërgimin e çështjes në Gjykatë për interpretimin e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, bazuar në nenet 38, 73, 124 dhe 145 të Kushtetutës. GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendim të ndërmjetëm ka disponuar lidhur me kërkesat e parashtruara nga mbrojtja. Në lidhje me po këtë nënpretendim, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se koha e vënë në dispozicion të përfaqësuesve të kërkuarit për njohjen me provat dhe aktet ka qenë e nevojshme dhe e mjaftueshme për realizimin e një mbrojtjeje efektive (*shih faqet 17–18 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Qëndrimi i gjykatave të faktit lidhur me pretendimet e kërkuarit për pamjaftueshmëri të kohës për përgatitjen e një mbrojtjeje efektive është gjykuar i drejtë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

86. Lidhur me *nënpretendimin e tretë* se GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka arsyetuar brenda afateve ligjore të parashikuara nga KPP-ja vendimin për

vazhdimin e masave të sigurimit (vendimi nr. 117, datë 26.10.2023), GJKKO-ja e Apelit dhe Kolegji Penal kanë arsyetuar se, në thelb, kjo vonesë nuk ka sjellë pasoja në të drejtën e kërkuarit për kundërshtimin e tyre në një gjykatë më të lartë dhe për të pasur përgjigje përfundimtare për pretendimet e tij.

87. Për sa më lart, në analizë të pretendimeve, prapësimeve dhe arsyetimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, Gjykata vlerëson se nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë janë marrë të gjitha masat për njoftimin e kërkuarit të vendimit nr. 112, datë 20.10.2023, i cili ka disponuar për masat e sigurimit personal të vendosura ndaj tij. Gjithashtu, nga faktet e parashtruara më sipër, të evidentuara nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, Gjykata evidenton se kërkuar i është dhënë koha e nevojshme për të realizuar mbrojtjen në raport me volumin e akteve dhe afatin 5-ditor brenda të cilit, sipas parashikimeve të KPP-së, duhej të përfundonte gjykimi. Gjykata vëren se brenda këtij afati kohor, në një përpjekje për të mbyllur në kohë procedimin gjyqësor, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka zhvilluar 3 seanca gjyqësore, të cilat janë shtyrë për shkak të kërkesave procedurale të mbrojtësve dhe largimit të tyre. Disa prej këtyre seancave janë ndërprerë dhe rifilluar brenda ditës, fakt ky që dëshmon për angazhimin maksimal të GJKKO-së së Shkallës së Parë për përmbylljen në kohë të procesit gjyqësor në ngarkim të kërkuarit. Ndërsa në lidhje me vonesën në arsyetimin e vendimit për vazhdimin e masave të sigurimit, Gjykata vlerëson se kjo vonesë nuk ka sjellë pasoja mbi të drejtën e kërkuarit për mbrojtje efektive, për sa kohë ai ka ushtruar normalisht të drejtat procedurale të ankimit dhe rekursit në përgjigje të të cilave GJKKO-ja e Apelit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë kanë disponuar me vendimet përkatëse. Në këto kushte, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuarit lidhur me njoftimin e vendimit që ka disponuar për masat e sigurimit personal ndaj tij, mungesën e kohës së nevojshme për të realizuar mbrojtjen dhe mosarsyetimin në kohë të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë për vazhdimin e masave të sigurisë nuk janë të bazuara.

ii. Cilësia e mbrojtjes

88. Në lidhje me pretendimin se mbrojtësja e caktuar kryesisht nga gjykata, avokatja V.T., ishte e papërshtatshme për ta mbrojtur kërkuarin, për shkak të qëndrimeve të saj kundër tij në rrjetet



sociale, Gjykata vëren se në seancën e datës 24.10.2023 për marrjen në pyetje të personit ndaj të cilit është zbatuar masa e sigurimit sipas nenit 248 të KPP-së, janë paraqitur Prokuroria e Posaçme dhe mbrojtësit e zgjedhur të kërkuesit, të pajisur me prokurë të posaçme, avokatët G.GJ. dhe S.M., të cilët, pas legjitimit të tyre, ndër të tjera, kanë deklaruar se kërkonin përjashtimin e gjyqtarës së çështjes, me pretendimin se vendimi i caktimit të masës së sigurimit ishte antikushtetues dhe se për këtë shkak kanë paraqitur një kallëzim penal ndaj asaj gjyqtareje për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 24.10.2024, kërkesa për dorëheqjen e gjyqtarës, e formuluar verbalisht në seancë gjyqësore, nuk u materializua në atë seancë, nëpërmjet paraqitjes së saj, sipas nenit 19, pika 1, të KPP-së.

89. Seanca e radhës është caktuar të nesërmen. Gjykata ka urdhëruar njoftimin e kërkuesit për seancën nëpërmjet shërbimeve të Policisë Gjyqësore sipas shkresës nr. 676 prot., datë 25.10.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Departamenti i Policisë Kriminale. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka konstatuar se kërkuesi ka refuzuar të marrë personalisht njoftimin për seancën gjyqësore të datës 25.10.2023 dhe në këto kushte, duke qenë se ai ka autorizuar avokatët e zgjedhur prej tij për përfaqësimin dhe mbrojtjen në mungesë, duke i autorizuar, ndër të tjera, të merrnin çdo njoftim drejtuar tij, bazuar në nenin 351 të KPP-së, ka vendosur deklarimin e mungesës së vullnetshme të kërkuesit, duke e konsideruar të pranishëm atë nëpërmjet avokatëve të zgjedhur prej tij.

90. Po në të njëjtën seancë gjyqësore (datë 25.10.2023, ora 14:30), mbrojtësit e zgjedhur kanë paraqitur kërkesë për t’u pajisur me një kopje audio të seancës gjyqësore të datës 24.10.2023 dhe një kopje të transkriptimit/procesverbalit të seancës së po kësaj date. Këto kërkesa janë pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë kundrejt pagesës së tarifave. Në vijim të gjykimit, mbrojtësit e kërkuesit kanë kërkuar të pajisen me kopje të akteve të paraqitura nga prokuroria, për të garantuar mbrojtje efektive. GJKKO-ja u ka sjellë në vëmendje që të vijonin të realizonin mbrojtjen, pasi i kanë pasur të gjitha mundësitë për t’u njohur dhe pajisur me kopje të akteve pranë sekretarisë së asaj gjykate, duke qenë se përveç kohës së lënë në seancën gjyqësore të datës 24.10.2023, u është lënë edhe një ditë kohë (seanca

e ardhshme është caktuar më 25.10.2023, ora 14:30) për njohjen me aktet, në funksion të një mbrojtjeje efektive. Në vijim, mbrojtësit e kërkuesit kanë parashtruar kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës së çështjes nga gjykimi, lidhur me qëndrimin e mbajtur në seancën gjyqësore të datës 25.10.2023 dhe janë larguar nga salla me pretendimin se nuk mund të realizonin një mbrojtje efektive. Në këto kushte, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vijuar gjykimin duke caktuar avokat kryesisht për kërkuesin.

91. Në seancën gjyqësore të datës 26.10.2023, ora 10:39, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka urdhëruar njoftimin e kërkuesit për zhvillimin e seancës nëpërmjet shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas adresave respektive, në banesën e tij, në selinë e Partisë Demokratike dhe pranë selisë së Kuvendit. Po ashtu, nëpërmjet shkresës nr. 17, datë 25.10.2023 i është bërë me dije kërkuesit se mbrojtësit e tij të zgjedhur sipas prokurës së posaçme kanë braktisur seancën gjyqësore të datës 25.10.2023. Në këto kushte, bazuar në nenet 6, 49 dhe 248 të KPP-së, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur të caktojë dy avokatë kryesisht nga lista e avokatëve kryesisht të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë.

92. Duke qenë se avokatët e caktuar kryesisht nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë kanë kërkuar një kohë më të gjatë për t’u njohur me aktet dhe provat e çështjes, duke marrë parasysh kompleksitetin e saj, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor dhe seanca gjyqësore është caktuar për t’u zhvilluar po në datën 26.10.2023, ora 15:00, me qëllim që t’u lihej kohë avokatëve të caktuar kryesisht për t’u njohur me aktet e dosjes, të cilat u janë vënë në dispozicion. Po ashtu, rezulton se në seancën e datës 26.10.2023 nga kërkuesi është paraqitur një kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës nga shqyrtimi i çështjes, për shkak se, sipas tij, vendimi nr. 112, datë 20.10.2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë është marrë në kundërshtim me nenet 38 dhe 73 të Kushtetutës. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga një gjyqtare tjetër e GJKKO-së, e cila, me vendimin nr. 430, datë 26.10.2023, ka vendosur mospranimin e saj.

93. Në lidhje me avokatët e caktuar kryesisht, sipas procesverbalit të seancës të datës 25.10.2023, rezulton se avokati A.S. është përjashtuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, për shkak se ka bërë disa postime në rrjetet sociale, të cilat ngrinin dyshime për realizimin e mbrojtjes së tij. Në vijim



është proceduar me caktimin e dy avokateve të tjera kryesisht, të cilat sipas procesverbalit të seancës të datës 26.10.2023 rezulton se janë përjashtuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, për shkak se avokatja R.B. ka deklaruar se nuk ishte gati të realizonte mbrojtjen, ndërsa avokatja tjetër, shtetasja J.K. është përjashtuar nga gjykata për shkak se realizimi i mbrojtjes së saj ishte joprofesional. Këto avokate kryesisht janë zëvendësuar në të njëjtën seancë të datës 26.10.2023 me një tjetër avokate kryesisht, shtetasen V.T., së cilës gjykata i ka lënë kohën e nevojshme për t'u njohur me aktet e çështjes. Në vijim, seanca e datës 26.10.2023 është zhvilluar në prani të kësaj avokate dhe përfundimisht, po në të njëjtën seancë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur vazhdimin e masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues “Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore”, të parashikuar nga neni 234 i KPP-së dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, në referim të nenit 233, pika 1, të KPP-së.

94. Lidhur me avokaten V.T., të caktuar për të mbrojtur kryesisht kërkuesin, pas largimit të mbrojtësve të tij të zgjedhur, GJKKO-ja e Apelit ka konstatuar se ajo ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrën e saj, në përputhje me detyrimet që i burojnë nga ligji procedural penal dhe ligji për avokatinë. Qenia aktive në rrjetet sociale e saj (avokates V.T.), sipas GJKKO-së së Apelit lidhet me liritë dhe të drejtat e saj personale dhe nuk mund të jetë objekt i këtij gjykimi, për sa kohë që nuk provohet të ketë ndikuar në përmbushjen e rregullt të detyrës së saj. Po ashtu, mosparaqitjen e vetë kërkuesit dhe largimin vullnetar të mbrojtësve të besuar të tij, GJKKO-ja e Apelit i ka konsideruar si veprime që nuk kanë ndikuar në standardet e mbrojtjes në procesin objekt gjykimi, në kushtet kur atij i është garantuar mbrojtja me një mbrojtës kryesisht. Ndërsa, lidhur me kohën e ofruar dhe mundësinë e qasjes me provat dhe aktet, GJKKO-ja e Apelit ka arritur në përfundimin se ato kanë qenë të nevojshme dhe të mjaftueshme për mbrojtjen *(shih faqet 17–18 të vendimit të GJKKO-së së Apelit)*.

95. Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka konsideruar të pabazuara pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes efektive sipas nenit 248 të KPP-së, të ngritura në rekurs. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, ndodhur para faktit të mosparaqitjes së vetë kërkuesit dhe largimit vullnetar të mbrojtësve të zgjedhur prej tij, konstatohet se nuk janë cenuar standardet e

mbrojtjes në procesin objekt gjykimi, në kushtet kur atij i është garantuar mbrojtja me mbrojtës të caktuar kryesisht.

96. Për sa më lart, Gjykata, duke marrë parasysh sjelljen e vetë kërkuesit për të mos marrë pjesë në gjykim dhe mbrojtësve të zgjedhur prej tij, të cilët janë larguar nga seanca e marrjes në pyetje të kërkuesit, ku ata kanë qenë të autorizuar ta përfaqësonin atë në mungesë të tij, vëren se vetë ai (kërkuesi) ka hequr dorë nga e drejta për t'u marrë në pyetje dhe për të parashtruar përpara gjykatave fakte, argumente ose prova për sqarimin e pozitës së tij dhe kundërshtimin e argumenteve të parashtruara në kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për caktimin e masave të sigurimit personal, si dhe për të paraqitur fakte, argumente ose prova për lehtësimin apo revokimin e masës së sigurimit personal të dhënë më parë ndaj tij. Ndërsa në lidhje me pretendimin e kërkuesit se mbrojtësja e caktuar kryesisht, avokatja V.T., nuk ishte e përshtatshme për të realizuar mbrojtjen e tij, për shkak të qëndrimeve të saj në rrjetet sociale kundër tij, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk ka sjellë ndonjë provë për të mbështetur këtë pretendim dhe nuk ka argumentuar se si qëndrimet e saj në rrjetet sociale kanë ndikuar në realizimin e mbrojtjes. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se ecuria e procesit për vendosjen dhe vazhdimin e masave të sigurimit përpara GJKKO-së së Shkallës së Parë tregon se ajo gjykatë ka treguar angazhimin e duhur në identifikimin dhe caktimin kryesisht të një mbrojtësi që do të ishte në gjendje t'i garantonte kërkuesit një mbrojtje efektive. Ky angazhim dëshmohet, veç të tjerash, edhe nga fakti që deri në caktimin e avokates V.T. gjykata ka zëvendësuar 3 mbrojtës të tjerë, të cilët në vlerësimin e asaj gjykate, për arsye të ndryshme, ishin të papërshtatshëm për t'i garantuar kërkuesit një mbrojtje efektive. Për më tepër, Gjykata vlerëson se diskrecioni i gjykatës si organ procedues në identifikimin dhe caktimin e mbrojtësit kryesisht është i kufizuar, pasi ajo mund të zgjedhë vetëm midis atyre avokatëve emrat e të cilëve gjenden në listën e vënë në dispozicion nga Dhoma e Avokatisë.

97. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në procesin gjyqësor për caktimin dhe vazhdimin e masave të sigurimit në ngarkim të kërkuesit nuk vërehet mospërmbushje e dukshme e detyrave të mbrojtjes deri në atë shkallë që të përbëjë cenim të së drejtës së kërkuesit për mbrojtje efektive.



98. Për sa u përket afateve të shpejta procedurale të veprimit të gjykatave në kontekstin e vendosjes së masave të sigurimit dhe pasojave të tyre mbi të drejtën e kërkuesit për mbrojtje efektive, Gjykata vëren se këto afate të shpejta imponohen nga përmbajtja e nenit 248, pika 1, të KPP-së, i cili parashikon se marrja në pyetje e personit ndaj të cilit janë zbatuar masat e sigurisë “Detyrimi për paraqitje” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” duhet të bëhet brenda pesë ditëve nga zbatimi i masës dhe nenit 249, pika 7, të KPP-së, sipas të cilit kur vendimi për caktimin e masave të sigurimit nuk shpallet ose zbatohet brenda afatit, ai e humbet fuqinë. Për sa i përket seancës për vlerësimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit, qëllimi i saj është që të dëgjohet subjekti i masave të sigurimit, për të vlerësuar nëse masa e caktuar ndaj tij është apo jo e arsyeshme. Referuar veprimeve të kërkuesit, që ka zgjedhur të mos marrë pjesë në këtë seancë, ashtu edhe veprimeve të mbrojtësve të tij, që kanë kërkuar kohë nga gjykata dhe në vijim janë larguar nga salla, Gjykata vlerëson se ato, në dukje, duket se janë një zgjedhje e vullnetshme e kërkuesit dhe, për këtë shkak, ai (kërkuesi) duhet të ishte në gjendje të parashikonte zëvendësimin e mbrojtësve të zgjedhur me një avokat të caktuar kryesisht nga lista e avokatëve. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkuesi e ka ushtruar lirisht të drejtën e mbrojtjes në të gjitha shkallët e gjykimit, nëpërmjet mbrojtësve të caktuar kryesisht në shkallën e parë, nëpërmjet paraqitjes së ankimit dhe rekursit nga mbrojtësit e zgjedhur prej tij dhe pjesëmarrjes së tyre në gjykim (në rastin e gjykimit në gjykatën e apelit). Për këto arsye, Gjykata çmon se edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin së drejtës së mbrojtjes, lidhur me mbrojtësen e caktuar kryesisht nuk është i bazuar.

99. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se në tërësi pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes efektive është i pabazuar.

B. 1.3. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit

100. Kërkuesi ka pretenduar se në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është përdorur një gjuhë e pakuptueshme, e cila krijon konfuzion dhe nuk përcjell vijimësi të mendimit logjik dhe juridik, si dhe konkluzionit të arritur, duke e bërë vendimin të pakuptueshëm. Po ashtu, sipas kërkuesit, vendimet e gjykatave përmbajnë të dhëna kontradiktore, nuk janë logjike dhe nuk u kanë dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të tij.

101. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, pasi gjykatat i kanë kushtuar vëmendjen e duhur provave të paraqitura, analizës së tyre, bazës ligjore dhe kanë konkluduar më pas në vendimmarrjet respektive. Sipas Prokurorisë së Posaçme, pretendimet e kërkuesit kanë marrë përgjigje të arsyetuara nga gjykatat dhe vendimi për caktimin e masës së sigurimit përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 245 të KPP-së. Po ashtu, Prokuroria e Posaçme ka argumentuar se edhe vendimet e GJKKO-së së Apelit dhe Gjykatës së Lartë i përmbajnë elementet për arsyetimin e tyre dhe vendimet e kundërshtuara janë logjike, nuk kanë kundërhënie, si dhe përmbajnë referenca në ligjin e zbatueshëm.

102. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit kanë të bëjnë me mjaftueshmërinë dhe qartësinë e arsyetimit nga të tria gjykatat. Për rrjedhojë, bazueshmëria e këtyre pretendimeve do të vlerësohet nga Gjykata duke analizuar mënyrën e arsyetimit të gjykatave të zakonshme.

103. Në jurisprudencën e saj në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata ka theksuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërhënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 63, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 19, datë*



21.3.2024; nr. 4, datë 31.1.2024; nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese).

104. Për sa më lart, Gjykata, referuar edhe arsyetimit të gjykatave të zakonshme, vëren se ato kanë arsyetuar në mënyrë shteruese pretendimet e kërkuarit duke u dhënë përgjigje të arsyetuar atyre. Në vlerësimin e Gjykatës, vendimet e gjykatave të zakonshme plotësojnë kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tyre. Ato pasqyrojnë tërësinë e fakteve/ngjarjeve ashtu siç janë administruar në gjykim, si dhe mënyrën mbi bazën e së cilës janë analizuar dhe vlerësuar provat, mbi bazën e të cilave është vlerësuar vazhdimi i masave të sigurimit personal. Ato nuk rezultojnë që të jenë alogjike, të kenë kundërthënie, të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojnë elementet e trajtuara nga jurisprudenca kushtetuese, ndërkohë që përmbajnë arsyetim të plotë dhe të detajuar të pretendimeve të parashtruara në mjetin e ankimit mbi të cilin janë vënë në lëvizje. Gjithashtu, Gjykata konstaton se edhe Gjykata e Lartë ka ushtruar rolin e saj si gjykatë e ligjit, duke u dhënë përgjigje në thelb pretendimeve të kërkuarit të ngritura në rekurs me një vendim të arsyetuar sipas standardeve të jurisprudencës kushtetuese.

105. Për sa i përket arsyetimit të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në vlerësimin e Gjykatës, edhe pse në atë vendim janë përdorur terma teknikë që vështirësojnë në pamje të parë kuptimin e vendimit, përdorimi i tyre nuk është në atë nivel që të cenojë standardin e arsyetimit nga pikëpamja e qartësisë. Për më tepër që në Gjykatën e Lartë, në përputhje me parashikimet ligjore, kërkuari ka qenë i përfaqësuar nga mbrojtës të zgjedhur prej tij, të cilët kanë kualifikimin e nevojshëm për të kuptuar termat teknikë të përdorur në vendim. Për këto arsye, Gjykata arrin në përfundimin se argumentet e parashtruara në vendimet e kundërshtuara janë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese të tyre dhe nuk cenojnë ndonjë prej elementeve të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

106. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

B.2. Për aspektin substancial

107. Kërkuari ka pretenduar se gjykatat nuk kanë arsyetuar nevojshmërinë e caktimit të masave të sigurimit personal të vendosura ndaj tij, duke cenuar lirinë e tij personale dhe atë të lëvizjes, si edhe të

drejta të tjera të parashikuara nga Kushtetuta. Sipas tij, masat e sigurimit personal të vendosura për të janë bërë në shkelje të ligjit, nuk janë të arsyeshme ose të nevojshme, si edhe janë qartazi joproporcionale me qëllimin e kërkuar.

108. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka parashtruar se gjykatat i kanë kushtuar vëmendjen e duhur provave të paraqitura, analizës së tyre, bazës ligjore dhe kanë konkluduar më pas në vendimmarrjet respektive. Sipas Prokurorisë së Posaçme, pretendimet e ngritura nga kërkuari kanë marrë përgjigje të arsyetuara nga gjykatat dhe vendimi për caktimin e masës së sigurimit përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 245 të KPP-së.

109. Në referim të pretendimeve të kërkuarit dhe prapësimeve të subjektit të interesuar, Gjykata, në vijim, do të vlerësojë nëse kërkuari i janë cenuar e drejta për t'u zgjedhur dhe liria e lëvizjes, pra nëse ka pasur ndërhyrje në to, nëse ndërhyrja ka qenë me ligj, për një qëllim legjitim dhe nëse ka qenë proporcionale. Me fjalë të tjera, në këndvështrim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata, në vijim, do të analizojë masat e sigurimit personal të caktuara ndaj kërkuarit përkundrejt parashikimeve të nenit 17 të Kushtetutës, sipas të cilit kufizimi i të drejtave dhe lirive mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik dhe duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka shkaktuar atë, si dhe kushteve e kriterëve të përcaktuara në nenet 228 e 229 të KPP-së. Për të vlerësuar nëse në rastin e kërkuarit janë respektuar kriteret kushtetuese për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe së drejtës për t'u zgjedhur në drejtim të ushtrimit të funksionit të deputetit, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë dhe parimin e subsidiaritetit, në vijim, do të verifikojë nëse gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar dhe interpretuar në drejtim të nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masave të sigurimit të caktuara ndaj kërkuarit, si dhe nëse kanë mbajtur në konsideratë se ato përmbushin qëllimin për të cilin janë caktuar.

110. Në lidhje me të drejtën për t'u zgjedhur, Gjykata evidenton se ajo garantohet nga neni 45 i Kushtetutës dhe, sipas kësaj dispozite, çdo shtetas që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u zgjedhur shtrihet jo vetëm mbi të drejtën për të kandiduar, por edhe mbi të



drejtën për të ushtruar funksionin publik të besuar nga zgjedhësit (*shih vendimin nr. 19, datë 21.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, sipas nenit 38 të Kushtetutës, kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin, si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit dhe askush nuk mund të pengohet të dalë lirisht jashtë shtetit.

111. Sipas GJEDNJ-së, çdo masë që kufizon lirinë e lëvizjes duhet të jetë në përputhje me ligjin, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të respektojë një ekuilibër të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave të individit (*shih De Tommaso kundër Italisë [GC], 2017, § 104; Pagerie kundër Francës, 2023, § 171; Battista kundër Italisë, 2014, § 37; Khlyustov kundër Rusisë, 2013, § 64; Labita kundër Italisë [GC], 2000, §§ 194–195*). Një ndërhyrje do të konsiderohet “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për një qëllim të ligjshëm nëse i përgjigjet një “nevoje sociale urgjente” dhe, në veçanti, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe nëse arsyet e paraqitura nga autoritetet kombëtare për ta justifikuar atë janë “relevante dhe të mjaftueshme”. Testi i proporcionalitetit të ndërhyrjes kërkon që masa të jetë e përshtatshme për të arritur funksionin mbrojtës (*shih Bartik kundër Rusisë, 2006, § 46; Soltyshyak kundër Rusisë, 2011, § 48 Berkovich dhe të tjerët kundër Rusisë, 2018, § 93*). Me fjalë të tjera, sipas GJEDNJ-së, një kufizim është i justifikueshëm vetëm për aq sa ai ndihmon në arritjen e qëllimit legjitim të synuar (*shih Gochev kundër Bullgarisë, 2009, § 49; Battista kundër Italisë, 2014, § 41*). Sipas GJEDNJ-së, vlerësimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes bazohet në tri shtylla kryesore: justifikimi i kufizimit nën dritën e funksionit të tij mbrojtës; cilësia e vlerësimit të brendshëm; ashpërsia e kufizimit. Kjo e fundit përfshin kohëzgjatjen e masës dhe ndikimin specifik të kërkuar (*shih Bartik kundër Rusisë, 2006, § 46; Soltyshyak kundër Rusisë, 2011, § 48 Berkovich dhe të tjerët kundër Rusisë, 2018, § 93*).

112. Në rastin konkret, Gjykata vëren se masat e sigurimit personal në ngarkim të kërkuar janë caktuar nga gjykatat në kuadër të procedimit penal të nisur ndaj tij, në zbatim të neneve 228 e vijuese të KPP-së, në cilësinë e personit të dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 260 e 25 të KP-së. Lidhur me interesin publik, Gjykata sjell në vëmendje se rregullat procedurale penale që lejojnë vendosjen e masave të

sigurimit personal i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal të lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale dhe zhvillimin e procesit të rregullt ligjor, ndaj ai është i prezumuar. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ndërhyrja në të drejtat e tij kushtetuese është bërë me ligj dhe i përgjigjet një interesi publik.

113. Për sa më sipër, Gjykata, në vijim do të shqyrtojë kriterin e proporcionalitetit, duke analizuar aspektet e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë në raport me parashikimet e neneve 228 e vijuese të KPP-së. Në lidhje me kriterin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, pra që marrëdhënia midis masave të sigurimit personal dhe qëllimit të ndjekur të jetë e arsyeshme, Gjykata, do të analizojë, nevojën për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe së drejtës për t’u zgjedhur, në drejtim të ushtrimit të funksionit të deputetit, në raport me nevojat konkrete për mbarëvajtjen e procedimit penal. Në këtë kontekst dhe në bazë të parimit të subsidiaritetit, Gjykata thekson se u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, në lidhje me parimin e proporcionalitetit dhe se ajo duhet të konsiderohet si mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

114. Në gjykimin kushtetues lidhur me nevojën e ndërhyrjes mbi të drejtat kushtetuese të kërkuar, Gjykata analizon fillimisht nëse masat konkrete të sigurimit të vendosura mbi të (kërkuar) janë të nevojshme për të realizuar qëllimin e ligjshëm të mbarëvajtjes së procedimit penal në kuadër të të cilit ato janë vendosur. Më tej, Gjykata vlerëson nëse masat e vendosura janë të përshtatshme për të realizuar këtë qëllim. Së fundi, Gjykata vlerëson nëse qëllimi i ligjshëm i mbarëvajtjes së procedimit penal mund të arrihet me vendosjen e masave më pak të ashpra. Nën këtë prizëm, Gjykata vëren se sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së, masat e sigurimit personal vendosen: i. kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; ii. kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; iii. kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet. Po kështu, Gjykata konstaton se sipas nenit 232 të KPP-së, masat shtrënguese janë edhe ndalimi i daljes



jashtë shtetit dhe detyrimi për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore, të caktuara në rastin konkret ndaj kërkuesit. Masa e ndalimit të daljes jashtë shtetit është parashikuar nga neni 233 i KPP-se dhe me caktimin e saj gjyqtari urdhëron të pandehurin të mos largohet nga territori shtetëror shqiptar pa autorizimin e tij. Për sa i përket masës tjetër, ajo për detyrimin për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore, të parashikuar nga neni 234 i KPP-së, përmes saj gjykata urdhëron të pandehurin të paraqitet në një zyrë të caktuar të Policisë Gjyqësore dhe ajo cakton ditët dhe orët e paraqitjes, duke mbajtur parasysh punën dhe vendbanimin e të pandehurit.

115. Në rastin konkret, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023, ka arsyetuar se për kërkuesin plotësohen kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228, pika 3, shkronjat “a” dhe “b”, të KPP-së. Në vlerësimin e saj, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës në funksion të kësaj çështjeje, për shkak të funksionit që ka ushtruar më parë kërkuesi në kohën e kryerjes së veprës penale. Për këtë arsye, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, ekziston mundësia që ai të ndërhyjë dhe të ndikojë në prishjen ose asgjësimin e provave, si dhe në krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e provave, çfarë do të ndikonte në një hetim të mangët për sqarimin e plotë të faktit penal objekt gjykimi. Gjithashtu, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë plotësohet edhe kushti i dytë i veçantë i parashikuar nga shkronja “b”, pika 3, e nenit 228 të KPP-së, pasi për shkak të rrethanave të faktit ekziston rreziku i ikjes së kërkuesit. Vazhdimi i masës së sigurimit personal të vendosur ndaj kërkuesit me vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, nr. 112, datë 20.10.2023, është konfirmuar edhe nga vendimi nr. 117, datë 26.10.2023 i së njëjtës gjykatë, e cila ka konkluduar në ekzistencën e të gjitha kushteve dhe kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për caktimin e një mase sigurimi personal, të parashikuara në nenet 228, 229 dhe 230 të KPP-së.

116. Po kështu, GJKKO-ja e Apelit, në arsyetimin e saj ka vlerësuar se për të hetuarin (kërkuesin), plotësohet kushti i tretë për caktimin e një mase garantuese personale që është një ndër

kushtet e përgjithshme, të kërkuara nga dispozita e nenit 228, pika 3, të KPP-së. Sipas GJKKO-së së Apelit ekzistojnë kushtet për kufizimin e lirisë së tij, të parashikuar në pikën 3 të nenit 228 të KPP-së, pasi vërtetohet ekzistenca e të paktën një prej tri rrethanave të parashikuara nga ajo dispozitë, siç është helmimi i procesit të marrjes ose vërtetësisë së provave dhe rreziku i ikjes së tij. Ndërkohë, vlerësimi i gjykatave të zakonshme është çmuar i drejtë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili nuk ka gjetur të meta në arsyetimin dhe interpretimin që ato i kanë bërë nevojës për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe së drejtës për t'u zgjedhur në drejtim të ushtrimit të funksionit të deputetit, të kërkuesit.

117. Për sa më sipër, referuar arsyetimit dhe interpretimit të vendimeve të gjykatave të zakonshme lidhur me shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për caktimin ndaj kërkuesit të këtyre dy masave, Gjykata konstaton se atyre (gjykatat e juridiksionit të zakonshëm – GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit) u mungon arsyetimi, për rrjedhojë nuk rezulton të kenë vlerësuar nevojën për caktimin e dy masave të sigurimit personal për të njëjtin procedim ndaj kërkuesit. Gjykata thekson se kjo mungesë arsyetimi, interpretimi dhe vlerësimi, ngre dyshime nëse ato e kanë vlerësuar kriterin e proporcionalitetit të masave në drejtim të nevojës për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe së drejtës për t'u zgjedhur në drejtim të kërkuesit, në funksionin e deputetit, sipas neneve 228 e vijuese të KPP-së, në raport të drejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal. Në këtë kuptim, për sa kohë u konstatua mungesë në vlerësimin e elementit të nevojës për kufizimin e të drejtave dhe lirive të kërkuesit, në raport mbarëvajtjen e procedimit penal, çka është e detyrueshme sipas Kushtetutës dhe KPP-së, Gjykata vlerëson se kjo përbën shkak të mjaftueshëm për të konstatuar cenimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”. Po kështu, Gjykata, mbi bazën e të njëjtave argumente, konstaton se edhe vetëm masa e sigurimit personal “Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësor” duket se i plotëson nevojat e sigurimit të mbarëvajtjes së procedimit penal¹⁰.

mos rrezikimin e marrjes apo vërtetësisë së provave të këtij procedimi (ose siç shprehen gjykatat për helmimin e provave). Për këtë arsye, kjo përbënte shkak të mjaftueshëm për të konstatuar cenim të parimit të proporcionalitetit, në drejtim të nenit 45 të Kushtetutës, në caktimin edhe të kësaj mase. Për rrjedhojë, në lidhje me aspektin substancial, kërkesa e kërkuesit duhej të pranohej pjesërisht, edhe për këtë shkak.

¹⁰ Gjyqtarët Holta Zaçaj dhe Genti Ibrahim, vlerësuan se përtej asaj që ka vendosur Gjykata, vendimet e gjykatave të zakonshme nuk kanë vlerësuar, arsyetuar dhe interpretuar veçmas për secilën masë të sigurimit personal, dhe se si këto masa i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal. Më konkretisht, gjykatat nuk kanë arsyetuar dhe vlerësuar se si caktimi i masës “Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore”, ishte i nevojshëm në kuptim të nenit 228 e vijuese të KPP - së, për të garantuar



118. Për sa më lart, Gjykata çmon se, në mungesë të arsyetimit të nevojës për caktimin e dy masave të sigurimit, si dhe të faktit që qëllimi legjitim i mbarëvajtjes së procedimit penal përmbushet nga masa e sigurimit të detyrimit për paraqitje, arrin në përfundimin se ka cenim të parimit të proporcionalitetit nga caktimi i masës së sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”. Në vlerësimin e Gjykatës, mungesa e arsyetimit të nevojës në përcaktimin e dy masave tregon ndër të tjera, mosvlerësimin e këtij aspekti kushtetues dhe ligjor nga ana e gjykatave të zakonshme në caktimin e masave të sigurimit personal. Për rrjedhojë, caktimi i kësaj mase të fundit ka cenuar, në aspektin substancial, të drejtën për t’u zgjedhur dhe lirinë e lëvizjes.

119. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuarit në drejtim të së drejtës për t’u zgjedhur dhe të lirisë së lëvizjes, në shkelje të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, parimeve të paanësisë dhe pavarësisë të Gjykatës, si rezultat i rregullimeve ligjore, së drejtës për mbrojtje efektive, standardit të arsyetimit, janë të pabazuara, kurse pretendimi për cenimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës së sigurimit personal “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht. Nisur nga rrethanat e çështjes, bazuar edhe në arsyetimin e mësipërm, Gjykata çmon se nuk është rasti për ta kthyer çështjen për rishqyrtim.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

2. Shfuqizimin, e vendimeve nr. 112, datë 20.10.2023 dhe nr. 117, datë 26.10.2023, të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe nr. 00-2024-384, datë 5.3.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, vetëm për pjesën që kanë caktuar masën “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” ndaj kërkuarit Sali Berisha.

3. Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.11.2024.

Shpallur më 31.12.2024.

Kryetare pjesërisht kundër: Holta Zaçaj

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Marjana Semini

Anëtarë pjesërisht kundër: Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Genti Ibrahim

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në çështjen nr. 12 (S) 2024 të Regjistrat Themeltar, që i përket kërkuarit Sali Berisha, me objekt shfuqizimin e vendimeve penale që kanë caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij, jam e qëndrimit se kërkesa është e bazuar, dhe duhej të ishte vendosur pranimi tërësisht i saj, duke u shfuqizuar vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjyqimit për shkak se janë bazuar në një procedurë jokushtetuese, në kundërshtim me detyrimin e përcaktuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës.

2. Shumica, bazuar në parimin *iura novit curia*, duke mbajtur në konsideratë se neni 27 garanton lirinë personale, e cila është e ndryshme nga liria e lëvizjes, e garantuar nga neni 38 i Kushtetutës, funksionin e deputetit që ushtron kërkuari, si edhe thelbin e argumenteve të kërkuarit, i ka trajtuar ato në themel nën prizmin: *i. e së drejtës për t’u zgjedhur* në drejtim të ushtrimit të mandatit përfaqësues të deputetit nga kërkuari, e mbrojtur nga neni 45 i Kushtetutës, për shkak të caktimit të dy masave të



sigurimit personal ndaj tij; *ii. lirisë së lëvizjes*, e mbrojtur nga neni 38 i Kushtetutës, për shkak të caktimit të masës së sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”. Në këtë kuptim, ajo ka vlerësuar të shqyrtojë, fillimisht, në drejtim të së drejtës kushtetuese për t’u zgjedhur dhe lirisë së lëvizjes, nëse ka pasur shkelje të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës dhe, në vijim, në varësi të përfundimit të arritur në lidhje me këtë pretendim, të vijojë me shqyrtimin e aspekteve të tjera të procesit gjyqësor (*shih paragrafin 38 të vendimit*).

3. Fillimisht, vlerësoj të theksoj se nuk jam dakord me mënyrën e trajtimit të çështjes nga shumica, e cila i ka parë të ndara dy masat e sigurimit personal të caktuara ndaj kërkuesit, duke i trajtuar ato edhe në themel në lidhje me aspekte të ndryshme të lirive e të drejtave kushtetuese të kërkuesit. Në vlerësimin tim, për sa kohë që në rastin konkret të dyja këto masa sigurimi janë kërkuar nga prokuroria dhe janë caktuar nga gjykatat në një procedurë të vetme gjyqësore, e cila është edhe objekt kundërshtimi, ato nuk mund të shihen dhe analizohen në mënyrë të shkëputur nga njëra-tjetra, pasi kjo qasje, siç ka ndodhur edhe në rastin konkret, çon në një qëndrim dhe përfundim të gabuar në lidhje me pretendimet e kërkuesit, duke shmangur kështu kontrollin kushtetues në drejtim të mënyrës së zbatimit të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, që është edhe thelbi i pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual.

4. Për sa i përket detyrimit të parashikuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës, shumica e ka vlerësuar pretendimin e kërkuesit në drejtim të: i. nëse ky rregullim kushtetues shtrihet vetëm mbi *lirinë personale* ose edhe mbi *lirinë e lëvizjes* apo *liri të tjera*, të garantuara nga Kushtetuta; ii. nëse masa “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” përbën ose jo cenim të së drejtës për t’u zgjedhur dhe lirisë së lëvizjes. Për kryerjen e kësaj analize ajo ka vlerësuar të ndalet në identifikimin e qëllimit të kushtetutëbërësit, duke iu referuar: *travaux préparatoires* të procesit kushtetues të vitit 2012; analizës semantike të dispozitës kushtetuese në fjalë; precedentit të zbatimit të kësaj dispozite në rastin e deputetit S.T., të referuar nga kërkuesi, si dhe doktrinës. Në përfundim, shumica ka arritur në përfundimin: “*Togfjalëshi “ose t’i biqet liria në gfarëdo lloj forme” i referohet vetëm lirisë personale, të mbrojtur nga neni 27 i Kushtetutës dhe ai gjen zbatim vetëm në ato raste kur ndaj deputetit vendoset një masë kufizuese, që i heq lirinë*

personale. Për pasojë, autorizimi i Kuvendit është i nevojshëm vetëm nëse masat kufizuese të vendosura ndaj kërkuesit përbëjnë kufizim/ heqje të lirisë së tij personale, i cili është i tillë që sjell pasojë në vetë të drejtën e deputetit për t’u zgjedhur, në aspektin e ushtrimit të të drejtave të tij si deputet, pra të vetë veprimtarisë parlamentare. Gjykata vlerëson se masa e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, në këndvështrim të së drejtës për t’u zgjedhur, sipas nenit 45 të Kushtetutës, duke iu referuar llojit të detyrimit dhe shpeshësisë së zbatimit të saj (në rastin konkret një herë në dy javë), nuk prek funksionet legjislative të Kuvendit dhe nuk e pengon kërkuesin të ushtrtojë të drejtat e tij si deputet. Mbi të njëjtin argument, Gjykata vlerëson se edhe masa e sigurimit e ndalimit për të dalë jashtë shtetit nuk e pengon kërkuesin të zhvillojë jetën e tij parlamentare. Për rrjedhojë, për sa kohë që kjo masë nuk përbën kufizim të lirisë personale pika 2 e nenit 73 të Kushtetutës nuk kërkon autorizimin e Kuvendit për zbatimin e saj ndaj deputetit. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit në drejtim të mënyrës së zbatimit të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, është i pabazuar (shih paragrafët 46 e 59 të vendimit).

5. Për sa më sipër, referuar qëndrimit të shumicës, ajo ka vlerësuar, se: “gjykatave të juridiksionit të zakonshëm u mungon arsyetimi, për rrjedhojë nuk rezulton të kenë vlerësuar nevojën për caktimin e dy masave të sigurimit personal për të njëjtin procedim ndaj kërkuesit. Në vlerësimin e shumicës, kjo mungesë arsyetimi, interpretimi dhe vlerësimi, ngre dyshime nëse ato e kanë vlerësuar kriterin e proporcionalitetit të masave në drejtim të nevojës për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe së drejtës për t’u zgjedhur në drejtim të kërkuesit, në funksionin e deputetit, sipas neneve 228 e vijuese të KPP-së, në raport të drejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal. Në këtë kuptim, për sa kohë u konstatua mungesë në vlerësimin e elementit të nevojës për kufizimin e të drejtave dhe lirive të kërkuesit, në raport mbarëvajtjen e procedimit penal, çka është e detyrueshme sipas Kushtetutës dhe KPP-së, shumica ka vlerësuar se kjo përbën shkak të mjaftueshëm për të konstatuar cenimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”. Po kështu, shumica, mbi bazën e të njëjtave argumente, ka konstatuar se edhe vetëm masa e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” duket se i plotësonte nevojat e sigurimit të mbarëvajtjes së procedimit penal. Për rrjedhojë, shumica ka çmuar se, në mungesë të arsyetimit të nevojës për caktimin e dy masave të sigurimit, si dhe



të faktit që qëllimi legjitim i mbarëvajtjes së procedimit penal përmbushet nga masa e sigurimit të detyrimit për paraqitje, ka arritur në përfundimin se ka cenim të parimit të proporcionalitetit nga caktimi i masës së sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”. Në vlerësimin e shumicës, mungesa e arsytimit të nevojës në përcaktimin e dy masave tregon ndër të tjera, mosvlerësimin e këtij aspekti kushtetues dhe ligjor nga ana e gjykatave të zakonshme në caktimin e masave të sigurimit personal. Për rrjedhojë, caktimi i kësaj mase të fundit ka cenuar, sipas shumicës, në aspektin substancial, të drejtën për t’u zgjedhur dhe lirinë e lëvizjes (*shih paragrafët 117 dhe 118 të vendimit*).

6. Në ndryshim nga shumica, për sa kohë që në rastin konkret masat e sigurimit ndaj kërkuesit janë caktuar në një procedurë të vetme, që është edhe objekt i këtij gjykimi kushtetues, unë kam mbajtur qasjen që zbatimi dhe interpretimi i nenit 73, pika 2, të Kushtetutës duhet të verifikuar në lidhje me këtë procedurë në tërësinë e saj dhe jo i shkëputur për secilën masë sigurimi, duke qenë kjo e vetmja mënyrë për të arritur në përfundimin nëse ka pasur shkelje të nivelit kushtetues që e bëjnë të gjithë këtë proces jokushtetues, pra nëse pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim janë të bazuara.

7. Fillimisht, vlerësoj të sqaroj qëndrimin tim në lidhje me mënyrën se si unë e lexoj dhe interpretoj tekstin kushtetues në drejtim të konceptit “*t’i hiqet liria në çfarëdo lloj forme*”. Për këtë arsye e çmoj të nevojshme të ndalem në vlerësimin e asaj se çfarë ka synuar të kuptojë norma kushtetuese me heqje të lirisë dhe se cilat janë ato forma të tjera të heqjes së lirisë së deputetit, përveç rastit të arrestimit të tij (siç ka vlerësuar shumica), për të cilat kërkohet në çdo rast marrja e autorizimit nga Kuvendi. Kjo me qëllimin për të arritur në përfundimin nëse edhe këto dy masa sigurimi personale të vendosura ndaj kërkuesit janë të tilla që përfshihen në fushën e mbrojtjes së normës kushtetuese.

8. Konstatoj se neni 73 i Kushtetutës është ndryshuar në përmbajtjen e tij aktuale në vitin 2012, ndërkohë që në përmbajtjen e tij fillestare, të miratuar në vitin 1998, kjo dispozitë parashikonte se deputeti nuk mund të ndiqej penalisht pa autorizimin e Kuvendit dhe se autorizimi kërkohet edhe në rastin kur ai do të arrestohej. Referuar përmbajtjes së normës kushtetuese në momentin e miratimit të saj, rezulton se ajo e kishte lidhur qartësisht detyrimin për marrjen e autorizimit në

mënyrë të shprehur me ndjekjen penale dhe arrestimin e deputetit. Ndërkohë, që ndryshimet që i janë bërë kësaj dispozite në vitin 2012 e kanë shtrirë tashmë mbrojtjen e saj përtej rasteve të arrestimit, duke iu referuar konceptit të “heqjes së lirisë” së deputetit.

9. Sipas nenit 27, pikat 1 dhe 3, të Kushtetutës, askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. Ndërkohë që në pikën 2 të kësaj dispozite parashikohen si raste të kufizimit të lirisë: a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente; b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj; c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj; ç) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent; d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë; dh) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit. Ndërkohë që në nenin 28 të Kushtetutës janë përcaktuar garancitë dhe të drejtat që i njihen personit të cilit i hiqet liria.

10. Liria dhe siguria personale gjejnë mbrojtje edhe nga neni 5 i KEDNJ-së, që parashikon se askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve të përcaktuara prej kësaj dispozite dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj. GJEDNJ-ja ka theksuar se neni 5 i Konventës, në deklarin e “së drejtës për liri”, parashikon lirinë fizike të personit dhe qëllimi i kësaj dispozite është që të sigurojë që askush të mos privohet nga liria në mënyrë arbitrare. Sipas GJEDNJ-së, heqja e lirisë nuk kufizohet në rastin klasik të paraburgimit pas arrestimit ose dënimit, por mund të marrë forma të tjera të shumta (*shih Guzzardi kundër Italisë, 1980, § 95*). Çështja e zbatueshmërisë së nenit 5 është ngritur në një sërë rrethanash, duke përfshirë: vendosjen e individëve në institucionet psikiatrike ose të kujdesit social (*shih De Eilde, Ooms dhe Veryyp kundër Belgjikës, 1971; Nielsen kundër Danimarkës, 1988; H.M. kundër Zvicrës, 2002; H.L. kundër Mbretëria e Bashkuar, 2004; Storck kundër Gjermanisë, 2005; A. dhe të tjerët kundër Bullgarisë, 2011; Stanev kundër Bullgarisë [DHM], 2012*); dërgimin nga mjekët ndihmës dhe oficerët e policisë në spitale (*shih Aftanache kundër Rumanisë, 2020*); izolimin në zonat e transitit të aeroportit (*shih*



Z.A. dhe të tjerët kundër Rusisë [DHM], 2019; *Amuur kundër Francës*, 1996; *Shamsa kundër Polonisë*, 2003; *Mogoş dhe të tjerët kundër Rumanisë (dhjetor)*, 2004; *Mehdidi dhe Haddar kundër Austrisë (dhjetor)*, 2005; *Riad dhe Idiab kundër Belgjikës*, 2008); mbylljen në zonat e transitit kufitar tokësor (*Ilias dhe Ahmed kundër Hungarisë [DHM]*, 2019; *R.R. dhe të tjerët kundër Hungarisë*, 2021); marrjen në pyetje në një stacion policie (*shih Caçan kundër Rumanisë*, 2016; *I.I. kundër Bullgarisë*, 2005; *Osyenko kundër Ukrainës*, 2010; *Salayev kundër Azerbajxhanit*, 2010; *Farbad Aliyev kundër Azerbajxhanit*, 2010; *Kreangă kundër Rumanisë [DHM]*, 2012); vendosjen në një makinë policie për të hartuar një kallëzim për kundërvajtje administrative (*shih Zeltš kundër Letonisë*, 2020); ndalimet dhe kontrollat nga policia (*shih Foka kundër Turqisë*, 2008; *Gillan dhe Quinton kundër Shteteve të Bashkuara Mbretërisë*, 2010; *Shimovolos kundër Rusisë*, 2011); kontrollin e banesës (*shih Stănculeanu kundër Rumanisë*, 2018); shoqërimin policor (*shih Rozhkov kundër Rusisë (nr. 2)*, 2017; *Tsvetkova dhe të tjerët kundër Rusisë*, 2018); masat e kontrollit të turmës të miratuara nga policia për arsye të rendit publik (*Austin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC]*, 2012); masa e arrestit në shtëpi (*Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [GC]*, 2016; *Mancini kundër Italisë*, 2001; *Lavents kundër Letonisë*, 2002; *Nikolova kundër Bullgarisë (nr. 2)*, 2004; *Dacosta Silva kundër Spanjës*, 2006); mbajtjen e emigrantëve nga deti në ambientet e pritjes dhe në anije (*shih Kblajfia dhe të tjerët kundër Italisë [GC]*, 2016); mbajtjen e emigrantëve të parregullt në objektet e vendeve të azilit (*shih J.R. dhe të tjerët kundër Greqisë*, 2018); bllokimin kombëtar për shkak të pandemisë COVID-19 (*shih Terheş kundër Rumanisë (dhjetor)*, 2021).

11. Sipas GJEDNJ-së, për të përcaktuar nëse dikujt i është “hequr liria”, sipas nenit 5 të KEDNJ-së, së pari, duhet të merret parasysh gjendja specifike e personit ndaj të cilit është marrë ajo masë dhe një sërë faktorësh të tjerë, siç janë lloji, kohëzgjatja, efektet dhe mënyra e zbatimit të masës në fjalë. Dallimi midis “heqjes” dhe “kufizimit”, sipas nenit 5, pika 1, dhe kufizimit të lirisë së lëvizjes, sipas qëllimit të nenit 2 të protokollit nr. 4 të KEDNJ-së, përcaktohet nga shkalla ose intensiteti dhe jo nga natyra ose substanca (*shih Guzzardi kundër Italisë*, 6 nëntor 1980, §§ 92-93; *Nada kundër Zvicrës [DHM]*, nr. 10593/08, § 225, GJEDNJ 2012; *Austin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar [DHM]*, nr. 39692/09,

40713/09 dhe 41008/09, § 57, GJEDNJ 2012; *Stanev kundër Bullgarisë [DHM]*, nr. 36760/06, § 115; dhe *Medvedyev dhe të tjerët kundër Francës [DHM]*, nr. 3394/03, GJEDNJ 2010). Gjithsesi, nocioni i “heqjes së lirisë”, sipas kuptimit të nenit 5, pika 1, të KEDNJ-së, përmban si elementin *objektiv* të izolimit të një individi në një hapësirë të caktuar dhe të kufizuar për një kohë jo të papërfillshme, ashtu edhe një element shtesë *subjektiv* në atë që personi nuk ka dhënë pëlqimin në mënyrë të vlefshme për izolimin në fjalë (*shih Storck v. Germany*, 2005, § 74; *Stanev v. Bulgaria [GC]*, 2012, § 117).

12. Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se kufizimi i lëvizjes, në disa rrethana specifike, mund të jetë mjaft serioz sa të konsiderohet heqje lirie, e cila mund të marrë forma të ndryshme nga rasti klasik i paraburgimit ose dënimit (*shih Guzzardi kundër Italisë*, 6 nëntor 1980, § 95). Faktorët objektivë që duhet të merren parasysh përfshijnë dimensionet dhe karakteristikat e një zone të kufizuar në të cilën është kufizuar lëvizja e një individi, mundësia për t'u larguar nga kjo zonë, shkalla e mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi lëvizjet e tij, shtrirja e izolimit dhe disponueshmëria e kontakteve sociale (*shih Guzzardi kundër Italisë*, 1980, § 95; *De Tommaso kundër Italisë [DH]*, 2017, §§ 83-88; *Nada kundër Zvicrës [DHM]*, 2012, §§ 229-232).

13. Duke iu referuar analizës së mësipërme të GJEDNJ-së në drejtim të lirisë personale dhe ndërthurjes së saj me lirinë e lëvizjes, në vijim do të ndalem në vlerësimin se në çfarë mase kufizimi i lirive dhe i të drejtave të deputetit përmes caktimit të masave të sigurimit është i tillë që mund të barazohet me heqjen e lirisë ndaj tij. Dua të ritheksoj edhe njëherë në këtë drejtim se kushtetutëbërësi jo pa qëllim në tekstin kushtetues nuk i është referuar në mënyrë të shprehur arrestimit të deputetit, duke dashur ai të shtrijë mbrojtjen kushtetuese jo vetëm në këto raste, por në çdo rast kur ndërhyrja në gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave dhe lirive nga deputeti është e tillë që mund të përbëjë, në thelb, heqje të tyre. Edhe pse i bashkohem qëndrimit të shumicës se imuniteti i deputetëve nuk është privilegj personal i tyre, por qëllimi kryesor i tij është mbrojtja e vetë parlamentit dhe në veçanti funksionimi i duhur i tij (*shih paragrafin 50 të vendimit*), nuk jam dakord me qëndrimin e shumicës, se: “*kur interpretohen rregullat për imunitetin duhet të përjashtohet metoda e interpretimit të zgjeruar, ndaj edhe fusha e rregullimit të pikës 2 të nenit 73, që lidhet me imunitetin procedural të*



deputetëve, duhet interpretuar në mënyrë të kufizuar/ ngushtë” (shih paragrafin 49 të vendimit).

14. Qasja e shumicës në fakt ka zhveshur normën kushtetuese nga qëllimi dhe fusha e mbrojtjes së saj, për rrjedhojë duke e bërë të pavlefshëm parashikimin aktual të kësaj dispozite. Nëse kushtetutëbërësi do të kishte pasur qëllim të ofronte një mbrojtje kaq të kufizuar ndaj deputetëve ai do ta kishte bërë këtë në mënyrë të shprehur, ashtu siç ka vepruar në miratimin e Kushtetutës në vitin 1998 dhe në të njëjtën mënyrë siç është vepruar edhe në tekste kushtetuese të vendeve të tjera, në të cilat gjenden parashikime të shprehura në drejtim të dhënies së autorizimit nga Kuvendi, duke përcaktuar qartësisht llojin e masës së sigurimit personal ndaj së cilës zbatohet ky detyrim.

15. Në këtë kuptim, në ndryshim nga shumica, jam e mendimit se togfjalëshi *“ose t’i hiqet liria në çfarëdo lloj forme”* nuk i referohet dhe nuk gjen zbatim vetëm në ato raste kur ndaj deputetit vendoset një masë kufizuese e lirisë personale, siç është arrestimi i tij, por i referohet dhe gjen zbatim edhe në lidhje me masat e tjera me karakter shtrëngues personal për sa kohë ato janë të afta të prekin në forma të ndryshme ushtrimin e lirisë dhe të drejtave themelore. Duke pasur parasysh se heqja e lirisë nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet në kuptim të ngushtë dhe strikt literal se nënkupton vetëm arrestimin e deputetit, unë vlerësoj se togfjalëshi *“ose t’i hiqet liria në çfarëdo lloj forme”* nuk i referohet vetëm lirisë personale, të mbrojtur nga neni 27 i Kushtetutës, por se ai gjen zbatim në të gjitha ato raste kur masat e sigurimit me karakter personal prekin liritë dhe të drejtat e deputetit në atë masë që konsiderohen, në thelb, si heqje të tyre.

16. Në këtë këndvështrim, vlerësoj se mbrojtja e dhënë nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës nuk kufizohet vetëm në rastin klasik të arrestimit të deputetit, por se ajo mund të shfaqet dhe të marrë edhe forma të tjera, pra zbatohet edhe në lidhje me masat e tjera me karakter shtrëngues, llojet e të cilave janë të përcaktuara në dispozitat e KPP-së. Për rrjedhojë, me qëllim arritjen në një përfundim të drejtë në lidhje me zbatimin e kësaj dispozite kushtetuese kërkohet vlerësimi, rast pas rasti, i llojit të masës së caktuar në drejtim të lirisë/së drejtës kushtetuese që preket dhe, në vijim, në drejtim të mënyrës në të cilën ajo ndërhyr në ato liri dhe të drejta të deputetit dhe pasojat që sjell konkretisht në ushtrimin e këtyre të fundit.

17. Thënë sa më sipër, qasja ime është se zbatimi i nenit 73, pika 2, të Kushtetutës nuk është i lidhur në vetvete me llojin e masës së sigurimit, por me pasojat që vijnë prej saj në liritë dhe të drejtat kushtetuese. Kjo do të thotë se vlerësimi në rastin konkret nuk ka të bëjë thjesht me llojin e masës personale shtrënguese që kërkohet nga prokuroria dhe caktohet nga gjykata, por me pasojat e ardhura dhe të provuara në ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave dhe lirisë kushtetuese, pra nëse kufizimi është në atë masë që e bën thuajse të pamundur ushtrimin e tyre, duke u konsideruar kështu se përbën, në thelb, heqje të tyre.

18. Referuar vendimeve gjyqësore objekt kërkese, rezulton se për zbatimin e masës së sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” është përcaktuar për kërkuesin detyrimi që ai të paraqitet të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10:00, përpara OPGJ-së pranë Prokurorisë së Posaçme. Për rrjedhojë, duke pasur parasysh mënyrën e zbatimit të kësaj mase në drejtim të pasojave të ardhura në ushtrimin dhe gëzimin e lirisë dhe të drejtave kushtetuese të kërkuesit, ku përfshihet edhe e drejta për t’u zgjedhur, e garantuar nga neni 45 i Kushtetutës, vlerësoj se detyrimi që kërkuesi të paraqitet një herë në dy javë përpara OPGJ-së në drejtim të natyrës së këtij detyrimi dhe vetë periodicitetit të masës, nuk është provuar dhe as nuk rezulton që ta ketë vendosur atë në pamundësinë për të ushtruar të drejtat që burojnë nga mandati përfaqësues ose ndonjë liri a të drejtë tjetër kushtetuese. Vetëm në këtë aspekt unë vlerësoj se kjo masë sigurimi nuk e kufizon lirinë personale të kërkuesit në atë masë e formë që të konsiderohet si heqje e saj, për sa kohë që jo vetëm nuk përbën kufizim të veprimtarisë parlamentare në atë masë që të cenojë thelbin e saj, pra të kufizojë, deri në pamundësinë e ushtrimit të tij, mandatin e deputetit, por as kufizim të ndonjë lirie pse të drejtë tjetër kushtetuese.

19. Për rrjedhojë, vlerësoj se në rastin konkret nuk gjen zbatim detyrimi i parashikuar nga pika 2 e nenit 73 të Kushtetutës për caktimin e masës së sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Ndaj jam e qëndrimit se në lidhje me këtë masë nuk ishte e detyrueshme marrja e autorizimit nga Kuvendi, duke arritur në këtë përfundim, bazuar ngushtësisht në rrethanat konkrete të çështjes në shqyrtim dhe vetëm në pasojat konkrete të ardhura në të drejtat e kërkuesit.



20. Megjithatë, vlerësoj të theksoj edhe njëherë se çështje të kësaj natyre duhet të trajtohen rast pas rasti, duke u vlerësuar nëse mënyra e zbatimit të masës së sigurimit personal “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, e caktuar ndaj një deputeti të Kuvendit, për nga lloji i detyrimit dhe shpeshtësia e tij, pra për nga mënyra e zbatimit të saj, është e tillë që sjell pasoja që ndërhyjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në ushtrimin e funksionit kushtetues nga vetë deputeti ose në liritë dhe të drejtat e tjera kushtetuese të tij.

21. Në vijim, duke e parë çështjen në tërësinë e saj, vlerësoj se për sa i përket masës tjetër personale të caktuar ndaj kërkuesit “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”, ajo ka ndërhyrë në liritë kushtetuese vetjake të tij në atë masë që kërkonte respektimin e detyrimit të përcaktuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës. Për sa kohë që vlerësova më sipër se heqja e lirisë së individit merr dhe shfaqet në forma të ndryshme, në rastin konkret vlerësoj se masa e sigurimit “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*” është e tillë që e pengon individin në ushtrimin e një të drejte themelore, duke përbërë kështu zhveshje nga kjo e drejtë, pra, në thelb, heqje të saj.

22. Në lidhje me këtë masë sigurimi personale, unë jam e qëndrimit se ajo është e tillë që nuk sjell thjesht një kufizim të një lirie, por e zhvesh kërkuesin nga njëra prej lirive themelore kushtetuese, të parashikuara në kreun II të Kushtetutës. Në këtë kre, së bashku me të drejtat dhe liritë themelore të individit, ku përfshihet edhe liria personale, e garantuar në nenin 28, është përfshirë edhe liria e lëvizjes, duke parashikuar neni 38, pika 2, i Kushtetutës, se: “*Askush nuk mund të pengohet për të dalë lirisht jashtë shtetit*”. Liria e lëvizjes është një nga të drejtat vetjake të individit, e cila është e përfshirë nën të njëjtën ombrellë kushtetuese dhe gëzon të njëjtën mbrojtje sikundër të drejtat e tjera kushtetuese vetjake, ku përfshihet edhe liria personale. Kjo nënkupton se çdo ndërhyrje në të drejtat dhe liritë vetjake duhet të vlerësohet dhe konsiderohet nën dritën e garancive të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, pra nëse ajo për nga pasojat dhe efektet e saj është e tillë që e zhvesh individin në atë masë sa ia heq tërësisht lirinë/të drejtën.

23. Për sa i takon rastit konkret, urdhërimi i kërkuesit për të mos u larguar jashtë territorit të vendit pa vendim të gjykatës e ka asgjësuar tërësisht lirinë e tij kushtetuese të lëvizjes jashtë shtetit, duke e bërë nul atë dhe duke përbërë kjo ndërhyrje, në

thelb, heqje të kësaj lirie. Kjo nënkupton se në lidhje me këtë masë sigurimi personale të caktuar ndaj kërkuesit, për shkak të natyrës së saj dhe mënyrës se si ka ndërhyrë në lirinë vetjake të tij të garantuar nga neni 38, pika 2, i Kushtetutës, duhet të ishte kërkuar në çdo rast autorizimi i Kuvendit në përputhje me parashikimet e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës. Mosrespektimi i kësaj kërkesë e bën tërësisht jokushtetuese të gjithë procedurën e ndjekur nga Prokuroria e Posaçme, për pasojë edhe vendimmarrjen e gjykatave që e kanë vlerësuar të ligjshme atë.

24. Në këto kushte, për sa kohë që arrita në përfundimin se procedura e ndjekur në rastin e kërkuesit përmban probleme kushtetutshmërie, unë nuk e vlerësoj të nevojshme të ndalem në aspekte të tjera të procesit të kundërshtuar që kanë të bëjnë me ligjshmërinë e masave të caktuara ndaj kërkuesit në drejtim të proporcionalitetit të tyre.

25. Në përfundim, bazuar në argumentet e mësipërme, vlerësoj se kërkesa duhet të ishte pranuar tërësisht, për sa kohë që në procedurën e caktimit të masave të sigurimit ndaj kërkuesit nuk është respektuar detyrimi i parashikuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës, çka e bën këtë procedurë dhe vendimet gjyqësore të dhëna nga gjykatat jokushtetuese në tërësinë e tyre.

Anëtare: Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Sali Berisha, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimeve nr. 112, datë 20.10.2023 dhe nr. 117, datë 26.10.2023, të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-384, datë 5.3.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajftueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e pjeshëm të kërkesës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhet të ishte rrëzuar tërësisht. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.



2. Nga rrethanat e çështjes, rezulton se ndaj kërkuesit, deputet i Kuvendit, ka filluar një procedim për kryerjen e disa veprave penale të kryera gjatë kohës kur ai ushtronte funksionin e Kryeministrit. Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesën për caktimin e masave të sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, të cilat janë pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, si për caktimin, ashtu edhe vazhdimin e zbatimit të tyre. Këto vendime janë lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit, ndërsa për rekursin e kërkuesit Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij.

3. Në këto kushte, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke pretenduar se vendimet gjyqësore për caktimin e masave të sigurimit personal i kanë cenuar lirinë personale dhe lirinë e lëvizjes, në aspektin substancial dhe procedural. Fillimisht, theksojmë se bashkohemi me shumicën, e cila, bazuar në parimin *iura novit curia*, i ka trajtuar pretendimet e kërkuesit në lidhje me: *i. të drejtën për t’u zgjedhur në drejtim të ushtrimit të mandatit përfaqësues të deputetit nga kërkuesi, të mbrojtur nga neni 45 i Kushtetutës, për shkak të caktimit të dy masave të sigurimit personal ndaj tij; ii. lirinë e lëvizjes, të mbrojtur nga neni 38 i Kushtetutës, për shkak të caktimit të masës së sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”.* Po në këtë kuptim, në drejtim të së drejtës kushtetuese për t’u zgjedhur dhe lirisë së lëvizjes, jemi me të njëjtin mendim me shumicën në vlerësimin në lidhje me autorizimin e Kuvendit të parashikuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës, si dhe me analizën për aspektet e tjera procedurale të procesit gjyqësor, që kanë të bëjnë me: *i. cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë së gjykatës si rezultat i rregullimeve ligjore; ii. cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive; iii. cenimin e standardit të arsyetimit.*

4. Ajo që na ndan nga shumica ka të bëjë me vlerësimin e aspektit substancial të kufizimit të së drejtës për t’u zgjedhur në lidhje me ushtrimin e funksionit të deputetit dhe së drejtës kushtetuese të lëvizjes së lirë, të garantuara nga nenet 45 dhe 38 të Kushtetutës, në drejtim të parimit të proporcionalitetit të masave të sigurimit personal të vendosura për kërkuesin. Për këtë qëllim, shumica ka evidentuar se këto masa kanë sjellë si pasojë një kufizim në të drejtat kushtetuese të lartpërmendura. Për këtë arsye, ajo ka analizuar nëse ky kufizimi plotëson kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, pra nëse

ai është bërë vetëm me ligj, për interes publik dhe nëse është në raport të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (kriteri i proporcionalitetit) (*shih paragrafin 109 të vendimit*).

5. Ndërsa bashkohemi me shumicën për dy kriteret e para, pra që masat e sigurimit personal marra janë bërë me ligj (në kuadër të një procedimi penal për veprat penale të parashikuara nga nenet 260 dhe 25 të KP-së) dhe për interes publik, i cili në këto raste është i prezumuar dhe lidhet me mbarëvajtjen e procesit penal në funksion të dhënies së drejtësisë (*shih paragrafin 112 të vendimit*), nuk ndajmë të njëjtin qëndrim në lidhje me kriterin e proporcionalitetit. Në analizën e këtij kriteri shumica bazuar në parimin e subsidiaritetit sipas të cilit u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të shprehën fillimisht në lidhje me parimin e proporcionalitetit, ka analizuar aspektet e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masave në raport me parashikimet e neneve 228 e vijuese të KPP-së. Në këtë drejtim në mënyrë që marrëdhënia midis masave të sigurimit personal dhe qëllimit të ndjekur të jetë e arsyeshme, shumica ka analizuar nevojën për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe të drejtës për t’u zgjedhur, në drejtim të ushtrimit të funksionit të deputetit, në raport me nevojat konkrete për mbarëvajtjen e procedimit penal (*shih paragrafin 113 të vendimit*).

6. Kriteri i proporcionalitetit është analizuar nga shumica në drejtim të nevojës dhe arsyetimit të gjykatave të zakonshme në lidhje me të. Sipas saj (shumicës), referuar arsyetimit dhe interpretimit të vendimeve të gjykatave të zakonshme lidhur me shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për caktimin ndaj kërkuesit të këtyre dy masave, atyre (gjykatave të juridiksionit të zakonshëm) u mungon arsyetimi, për rrjedhojë nuk rezulton të kenë vlerësuar nevojën për caktimin e dy masave të sigurimit personal për të njëjtin procedim ndaj kërkuesit. Në vlerësimin e shumicës kjo mungesë arsyetimi, interpretimi dhe vlerësimi, ngre dyshime nëse ato e kanë vlerësuar kriterin e proporcionalitetit të masave në drejtim të nevojës për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe së drejtës për t’u zgjedhur në drejtim të kërkuesit, në funksionin e deputetit, sipas neneve 228 e vijuese të KPP-së, në raport të drejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal. Në këtë kuptim, shumica ka vlerësuar se për sa kohë u konstatua mungesë në vlerësimin e elementit të nevojës për kufizimin e të drejtave dhe lirive të



kërkuesit, në raport mbarëvajtjen e procedimit penal, çka është e detyrueshme sipas Kushtetutës dhe KPP-së, kjo përbën shkak të mjaftueshëm për të konstatuar cenimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”. Po kështu, shumica, mbi bazën e të njëjtave argumente, ka konstatuar se edhe vetëm masa e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësor” duket se i plotësonte nevojat e sigurimit të mbarëvajtjes së procedimit penal (*shih paragrafin 117 të vendimit*).

7. Në vlerësimin tonë, analiza për proporcionalitetin e masave të sigurimit personal dhe verifikimi nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar në këtë drejtim lidhet me nevojat e sigurimit në rastin konkret, të identifikuar përmes kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 228, pika 3 dhe 229 të KPP-së. Konkretisht, sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së, masat e sigurimit personal vendosen: i. kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; ii. kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; iii. kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet. Ndërsa sipas nenit 229 të KPP-së, në caktimin e masave, gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës masë me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret (*pika 1*) dhe ato duhet të jenë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Në këtë rast, mbahen parasysh vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga KPP-ja (*pika 2*).

8. Në këtë kuptim vërejmë se në vlerësimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për vendosjen e masave të sigurimit personal ndaj kërkuesit “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023, ka arsyetuar se, në rastin konkret, për kërkuesin, plotësohen kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228, pika 3, shkronjat “a” dhe “b”, të KPP-së. Në vlerësimin e saj, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës në funksion të kësaj çështjeje, për shkak të marrëdhënieve të krijuara si

rezultat i ushtrimit më parë nga kërkuesi të funksionit të Kryeministrit, por edhe atij aktual si deputet, sikundër edhe të influencave që mund të ketë te persona të tjerë. Për këtë arsye, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, ekziston mundësia që ai të ndërhyjë dhe të ndikojë në prishjen ose asgjësimin e provave, si dhe në krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e provave, çfarë do të ndikonte në një hetim të mangët për sqarimin e plotë të faktit penal objekt gjykimi. Gjithashtu, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë plotësohet edhe kushti i dytë i veçantë i parashikuar nga shkronja “b”, pika 3, i nenit 228 të KPP-së, pasi nisur nga natyra e veprës penale që ai dyshohet dhe sanksioni që ligji parashikon për të, ekziston rreziku i ikjes së kërkuesit. Për sa u takon kriterëve për caktimin e masave të sigurimit, të parashikuara në nenin 229 të KPP-së, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka mbajtur parasysh rëndësinë e faktit dhe rrezikshmërinë e lartë të veprës penale, sanksionin me burgim të parashikuar për të dhe përhapjen e gjerë të saj, rolin e personit nën hetim dhe kryerjen e veprës penale në formën e bashkëpunimit, pasojat e ardhura prej saj, si dhe moshën e gjendjen gjyqësore të personit nën hetim, referuar të cilave, sipas saj, masat e sigurimit të kërkuara nga prokurori janë në përshtatje me shkallën e nevojave të sigurimit në rastin konkret.

9. Vazhdimi i zbatimit të masës së sigurimit personal të vendosur ndaj kërkuesit është konfirmuar në vijim me vendimin nr. 117, datë 26.10.2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, pas realizimit të seancës për pyetjen e kërkuesit, ndërsa ajo ka rikonfirmuar vijimin e ekzistencës së kushteve dhe kriterëve të caktimit të masës, si dhe të nevojave të sigurimit, duke mbajtur në konsideratë për këtë edhe sjelljen e tij, pas njofimit/zbatimit të masës, ku referuar deklaratave të tij për të mos e zbatuar masën e sigurimit, ngrihej dyshimi për rrezikun se ai nuk do të ishte në dispozicion të organit procedues gjatë hetimeve paraprake.

10. Analiza për plotësimin e kushteve dhe kriterëve të caktimit të masave të sigurimit personal, të parashikuara nga neni 228 i KPP-së, është bërë edhe nga GJKKO-ja e Apelit, e cila ka arritur në të njëjtat përfundime si dhe GJKKO-ja e Shkallës së Parë. Vendimet e gjykatave të posaçme, mbi rekursin e kërkuesit, i janë nënshtruar kontrollit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili i ka vlerësuar se në rekurs nuk janë ngritur shkaqe nga ato të parashikuara nga ligji, duke i gjetur praktikisht



të drejta ato vendime. Sipas tij, gjykatat më të ulëta kanë argumentuar mjaftueshëm dhe në mënyrë ezauruese kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal të parashikuara nga nenet 228 dhe 229 të KPP-së, bazuar në një vlerësim cilësor të provave dhe jo në konstatime të përgjithshme.

11. Për sa më lart, ne, gjyqtarët në pakicë, vërejmë se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në vlerësimin e tyre për masat e sigurimit personal të vendosura ndaj kërkuesit, kanë arsyetuar mjaftueshëm në lidhje me justifikimin e vendosjes bashkërisht të tyre, duke arsyetuar edhe në drejtim të “masës së duhur”, pra nëse ajo ishte e “përshtatshme” në raport me nevojat e sigurimit. Po kështu, ato (gjykatat) kanë analizuar rrezikun e “helmimit” të marrjes ose vërtetësisë së provave, sikundër edhe atë të largimit të kërkuesit, referuar rrethanave konkrete të faktit, situata këto që, sipas tyre, do të ndikonin në mbarëvajtjen e procesit penal dhe dhënien e drejtësisë.

12. Në arsyetimin e tyre, në kuadër të vlerësimit të përshtatshmërisë së masës së sigurimit personal dhe nevojave të sigurimit në rastin konkret, krahas rrezikut që diktonte dhe justifikonte vendosja e masave të sigurimit, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë analizuar dhe vlerësuar atë edhe në raport me rëndësinë e faktit, rrezikshmërinë e lartë të veprës penale dhe pasojat e ardhura prej saj, sanksionin vetëm me burgim që parashikohet për atë veprë penale, rolin e personit nën hetim, sikundër edhe me praninë e rrethanave rënduese dhe atyre lehtësuese. Në vlerësimin tonë, ato (gjykatat) kanë arsyetuar mjaftueshëm në drejtim të proporcionalitetit të masave së sigurimit personal, duke parashtruar gjerësisht arsyet se përse nevojat e sigurimit në rastin konkret diktonin caktimin ndaj kërkuesit të atyre masave. Nga ana tjetër, vlen të përmendet se kërkuesi në asnjë moment të procesit gjyqësor, por edhe në ankimin e tij kushtetues individual, papërshtatshmërinë e masave të sigurimit personal nuk e ka lidhur me aspektin numerik të tyre, pra se caktimi dhe zbatimi ndaj tij i dy masave të sigurimit personal ishte në vetvete jo proporcional.

13. Në përfundim, ne, gjyqtarët në pakicë, mbajtëm qëndrimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës së sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” është i pabazuar, prandaj duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës.

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Ilir Toska

VENDIM

Nr. 82, datë 26.11.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Ilir Toska,	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 7.11.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 16 (A) 2024 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Ardian Hysa, Violeta Hysa, Orjeta Hysa, Alidrije Kullolli, Brunilda Kullolli, Nadire Allani, Leonard Allani, Olgert Brahja, Mustafa Brahja, Meliha Brahja, përfaqësuar nga avokat Arsen Baltëza, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Shoqëria “Sigal Uniq Group Austria” sh.a., përfaqësuar nga administratori i përgjithshëm, Avni Ponari.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4412, datë 20.9.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 27, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesve (*kërkuesit*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar,



shoqërisë “Sigal Uniq Group Austria” sh.a., që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN :

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 7.5.2011, ka ndodhur një aksident rrugor, në të cilin kanë humbur jetën shtetasi E. H., ndërsa kanë pësuar dëmtime të përhershme trupore dhe përkeqësim të shëndetit shtetasi Leonard Allani, Olgert Brahja dhe Brunilda Kullolli. Aksidenti ka ndodhur si rezultat i shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesi i mjetit Sh. H., i cili, gjithashtu, ka humbur jetën në aksident, ndërsa pronari i mjetit ka qenë i siguar për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, sipas ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” (*ligji nr. 10076/2009*), pranë shoqërisë “Sigal Uniq Group Austria” sh.a. (“*Sigal*” sh.a.).

2. Në datën 2.4.2012, përfaqësuesi i posaçëm i familjarëve të të ndjerit E. H. (kërkuesve Adrian, Violeta dhe Orjeta Hysa), i kërkuesit të dëmtuar Leonard Allani dhe familjarëve të tij (kërkueses Nadire Allani dhe shtetasit N. A.), i kërkueses së dëmtuar Brunilda Kullolli dhe familjarëve të saj (kërkueses Alidrije Kullolli dhe shtetasit A. K.), si dhe i kërkuesit Olgert Brahja dhe familjarëve të tij (kërkuesve Mustafa e Meliha Brahja dhe shtetasit A. B.), i janë drejtuar me kërkesë për dëmshpërblim “Sigal” sh.a. (*subjekti i interesuar*) dhe pasi nuk kanë marrë përgjigje prej saj, në datën 31.7.2012, ata i janë drejtuar gjykatës me padi për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror për shkak të vdekjes së shtetasit E. H. dhe për shkak të dëmtimeve trupore e të shëndetit të kërkuesve Leonard Allani, Olgert Brahja dhe Brunilda Kullolli. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 12298, datë 23.12.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar të paditurin, “Sigal” sh.a., të dëmshpërblejë secilin nga paditësit në vlerat respektive, ku në tërësi atyre u është akorduar shpërblim për dëmin pasuror në vlerën 13,481,006 lekë dhe për dëmin jopasuror në vlerën 24,049,594.5 lekë, krahas kamatëvonesave për këto shuma nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim dhe deri në ekzekutimin e vendimit,

sipas aktit të ekspertimit kontabël të administruar në gjykim.

3. Mbi ankimin e të dyja palëve ndërgjyqëse, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2060, datë 5.10.2015, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke detyruar të paditurin, “Sigal” sh.a., të dëmshpërblejë secilin nga paditësit në vlerat respektive, ku në tërësi atyre u është akorduar shpërblim për dëmin pasuror në vlerën 7,721,258 lekë dhe për dëmin jopasuror në vlerën 4,141,666 lekë, krahas kamatëvonesave për këto shuma, të llogaritura sipas kriterit të Bankës së Shqipërisë për depozitat me afat 1-vjeçar, për periudhën nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim pranë “Sigal” sh.a. dhe deri në ditën e paraqitjes së padisë, datë 31.7.2012.

4. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kanë paraqitur rekurs kërkuesit dhe paditësit e tjerë, ndërsa subjekti i interesuar ka paraqitur kundërrekurs. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4412, datë 20.9.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të palës paditëse, me arsyetimin se nuk ekzistonin shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), të cilat ta bënë të cënueshëm vendimin e gjykatës së apelit.

5. Në datën 3.5.2024, përmes shërbimit postar, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili është regjistruar në Gjykatë në datën 7.5.2024. Kolegji i Gjykatës, në datën 11.7.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.1 *Së drejtës së aksesit*, pasi gjykata e apelit nuk i ka trajtuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje problematikave kryesore të ngritura në gjykim, sikurse është ai për ligjin e zbatueshëm dhe fuqinë juridike të rregullores nr. 53, datë 25.6.2009, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (*rregullorja nr. 53/2009 e AMF-së*). Edhe Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka vlerësuar shkaqet e rekursit të kërkuesve në këtë



drejtim, megjithëse ato janë sipas kërkesave të nenit 472 të KPC-së në kohën e paraqitjes së tij. Po kështu, kjo e fundit nuk ka bërë as kalimin procedural sipas nenit 199 të KPC-së, ndërsa në dosjen gjyqësore nuk ndodhen as kërkesa e depozituar pranë saj dhe e protokolluar me nr. 4633 prot., datë 20.9.2023, dhe as parashtrimet me shkrim të kërkuësve të protokolluara me nr. 4634 prot., datë 20.9.2023.

6.2 *Së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuësve në rekurs, në veçanti atij për zbatimin e gabuar të ligjit material nga gjykata e apelit në lidhje me pazbatueshmërinë dhe zbatimin me fuqi retroaktive të rregullores nr. 53/2009 të AMF-së, si dhe për sa i përket moszbatimit nga ajo gjykatë të dispozitave të Kodit Civil (KC) dhe vendimit unifikues nr. 12, datë 14.9.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (vendimi unifikues nr. 12/2007).

6.3 *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka trajtuar me hollësi pretendimet dhe argumentet në rekursin e kërkuësve, por vetëm ato të palës së paditur, të cilat kishin marrë përgjigje nga gjykata e apelit.

6.4 *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka kryer një vlerësim ligjor si gjykatë ligji për pretendimet në rekurs të kërkuësve, ndërsa vendimi i saj është tërësisht i paarsyetuar dhe mungon analiza juridikoligjore, duke mos garantuar ajo kështu zhvillimin e një gjykimi të bazuar në dispozitat ligjore.

6.5 *Parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë zbatuar me efekt prapaveprues një akt nënligjor, rregulloren nr. 53/2009 të AMF-së, ndërsa ajo nuk ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur ngjarja rrugore. Ky akt nënligjor, në bazë të nenit 117 të Kushtetutës, i fillon efektet pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe jo pas publikimit në faqen zyrtare të AMF-së. Për më tepër, ky akt nënligjor ka dalë në kundërshtim me nenin 118, pika 2, të Kushtetutës, ndërsa ligji i posaçëm nr. 10076/2009, ka autorizuar AMF-në vetëm për nxjerrjen e rregullave për trajtimin e dëmeve, por jo për të përcaktuar masën e dëmit dhe figurat e tij, ndërkohë që ligji nuk ka përcaktuar as parimet në bazë të të cilave do të nxirrej akti i AMF-së. Për pasojë, në rastin konkret, ligji i zbatueshëm, krahas ligjit nr. 10076/2009, për sa u përket rregullimeve të tij eksplicite, është edhe KC-ja dhe vendimi

unifikues nr. 12/2007, për aq sa ky vendim rregullon në mungesë të rregullimeve të bëra në ligjin e posaçëm. Në këtë drejtim, i njëjti kolegji i Gjykatës së Lartë, ka trajtuar në mënyrë diametralisht të kundërt çështje krejtësisht të ngjashme me atë të kërkuësve, sikurse evidentohet në buletin informativ nr. 2/2023 të asaj gjykate, duke mos luajtur ajo rolin e saj kushtetues për unifikimin e praktikës gjyqësore.

7. ***Subjekti i interesuar, shoqëria “Sigal” sh.a.***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

7.1 Pretendimet e kërkuësve kanë të bëjnë me çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, të cilat nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues.

7.2 Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit është i pabazuar, pasi, në aspektin procedural, Gjykata e Lartë nuk ka kryer asnjë cenim të të drejtave të palëve në proces. Kërkesa për kalimin procedural sipas nenit 199 të KPC-së dhe parashtrimet e kërkuësve janë dorëzuar vetëm ditën e seancës gjyqësore, pra jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar në nenin 465/a, pika 2, të KPC-së, megjithëse njoftimi për seancën është bërë që në datën 1.9.2024. Për më tepër, paditësi në proces, shtetasi N. A., kishte rreth 4 vjet që kishte ndërruar jetë. Edhe në aspektin financiar, kërkuësit, në cilësinë e trashëgimtarëve të të ndjerit, nuk preken nga moskalimi procedural, sepse shuma e dëmshpërblimit është tërhequr nga vetë ai kur ka qenë gjallë.

7.3 Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur praktikën e saj në shqyrtimin e rasteve të dëmshpërblimit të rrjedhur nga sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit, bazuar edhe në rekomandimet e Gjykatës në vendimin nr. 6, datë 17.2.2012 (vendimi nr. 6/2012), duke u dhënë zgjidhje përfundimtare qëndrimeve të palëve ndërgjyqëse në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 10076/2009 dhe rregullores nr. 53/2009, të AMF-së të dalë në zbatim të tij. Nuk qëndron pretendimi i kërkuësve se ajo gjykatë ka mbajtur qëndrime të ndryshme për raste të njëjta, ndaj jo vetëm nuk ka lindur nevoja për unifikimin e praktikës gjyqësore, por një gjë e tillë tashmë është e pamundur, pasi ligji nr. 10076/2009 është shfuqizuar me ligjin nr. 32/2021, datë 16.3.2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesësve

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Në këtë këndvështrim, kërkesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P”, të pikës 1, të nenit 131 dhe shkronjës “I”, të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkesit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata është shprehur se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen

zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata vëren se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 20.9.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur, përmes shërbimit postar, në datën 3.5.2024. Sipas shkresës nr. 217/1 prot., datë 24.1.2024, të Gjykatës së Lartë, të paraqitur bashkëlidhur kërkesës, vendimi i kundërshtuar i asaj gjykate është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 4.1.2024, datë në të cilën palët mund ta dispononin atë, ndaj është kjo datë momenti nga i cili ka filluar të ecë afati ligjor 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, kërkesit legjitimohen edhe *ratione temporis*.

13. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkesit, pavarësisht se në objektin e kërkesës kanë kundërshtuar vetëm vendimin e Gjykatës së Lartë, në përmbajtjen e saj kanë ngritur pretendime edhe për vendimin e gjykatës së apelit, duke pretenduar se këto vendime u kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt në drejtim të së drejtës së aksesit, së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, sikundër edhe parimin e sigurisë juridike, pretendime këto që janë me natyrë kushtetuese.

14. Gjykata vëren se për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit, kërkesit kanë parashtruar se Gjykata e Lartë nuk ka bërë kalimin procedural sipas nenit 199 të KPC-së, për paditësin e ndjerë N. A., gjë për të cilën kanë depozituar në atë gjykatë kërkesën e protokolluar me nr. 4633 prot., datë 20.9.2023. Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje në rastin konkret edhe mbi bazën e rekursit të paraqitur nga shtetasi N. A., i cili ka qenë në cilësinë e paditësit në atë proces gjyqësor, duke shqyrtuar ajo pranueshmërinë e rekursit edhe për të. Nga ana tjetër, trashëgimtare e këtij shtetasi, sipas dëshmisë së trashëgimisë testamentare të datës 4.9.2019, është bashkëshortja, kërkesja Nadire Allani, e cila edhe ajo ka qenë paditëse në atë proces gjyqësor. Në kontekst të këtyre rrethanave, Gjykata vëren se kërkesit në përgjithësi ose ndonjë nga ata në veçanti, nuk kanë argumentuar në aspektin kushtetues cenimin konkret të pretenduar si pasojë e moskalimit procedural për paditësin e ndjerë N. A. në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e



Lartë. Për rrjedhojë, ky pretendim për këtë argument është haptazi i pabazuar.

15. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, Gjykata vëren se kërkuessit kanë parashtruar edhe se Gjykata e Lartë, për më tepër i njëjti kolegji, ka trajtuar në mënyrë diametralisht të kundërt çështje krejtësisht të ngjashme me atë të tyre, duke mos luajtur ajo rolin kushtetues për unifikimin e praktikës gjyqësore. Në rastet e ekzistencës së disa vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë, ku ajo është shprehur në mënyrë të ndryshme për interpretimin e ligjit, për pretendimet e ngritura në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se ky fakt nuk mund të sjellë pritshmëri të ligjshme të kërkuessit për zbatimin e ligjit, në kushtet kur nuk është kryer një interpretim unifikues ose njëses në lidhje me të (*shih vendimet nr. 47 datë 11.6.2024; nr. 4, datë 31.1.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, një argument të tillë Gjykata e ka trajtuar edhe në këndvështrim të parimit të barazisë përpara ligjit, duke u shprehur se vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti, duke iu referuar edhe rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethanat, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 17, datë 23.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuessve për këtë argument nuk mund të merret në shqyrtim.

16. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuessve për cenimin e së drejtës së aksesit, së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme dhe të caktuar me ligj, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të sigurisë juridike, në thelb, kanë të bëjnë me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Lartë në lidhje me pretendimet e tyre në rekurs në drejtim të mënyrës se si gjykata e apelit ka identifikuar ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete dhe zbatimit të tij në atë rast. Nisur nga kjo, pretendimet e kërkuessve do të analizohen në vijim në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur

me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Po kështu, pavarësisht se kërkuessit kanë kundërshtuar për shkaqet e mësipërme edhe vendimin e gjykatës së apelit, duke pasur parasysh jo vetëm natyrën e pretendimeve, por edhe pozicionin e Gjykatës së Lartë dhe funksionin e saj si gjykatë ligji, në ushtrimin e të cilit ajo kontrollon jo vetëm mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta, por edhe respektimin e standardeve kushtetuese për proces të rregullt, për shkak të natyrës subsidiare të kontrollit kushtetues, Gjykata vlerëson të analizojë në vijim çështjen në këndvështrim të mënyrës si Gjykata e Lartë ka vepruar në rastin konkret, në drejtim të së drejtës së kërkuessve për proces të rregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

17. Kërkuessit kanë pretenduar, në thelb, se edhe pse në rekursin e tyre kanë ngritur pretendime për zbatimin e gabuar të ligjit material nga gjykata e apelit në lidhje me pazbatueshmërinë dhe zbatimin me fuqi retroaktive të rregullores nr. 53/2009, si dhe për sa i përket moszbatimit nga ajo gjykatë të dispozitave të KC-së dhe vendimit unifikues nr. 12/2007, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, nuk u ka dhënë përgjigje atyre, duke mos e arsyetuar vendimin e saj.

18. Subjekti i interesuar, “Sigal” sh.a., ka prapësuar se pretendimet e kërkuessve kanë të bëjnë me çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, të cilat nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues. Po sipas tij, pretendimet e kërkuessve edhe në themel janë të pabazuara, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur praktikën e saj në shqyrtimin e rasteve të dëmshpërblimit të rrjedhur nga sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit, bazuar edhe në rekomandimet e Gjykatës në vendimin nr. 6/2012, duke u dhënë zgjidhje përfundimtare qëndrimeve të palëve ndërgjyqëse në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 10076/2009 dhe rregullores nr. 53/2009 të dalë në zbatim të tij.

19. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se të drejtat kushtetuese dhe ligjore nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i



drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar, po ashtu, se në rastet kur kërkuesi nuk merr përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm standardi i arsyetimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, si dhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 23 datë 25.4.2023; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjyqimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar është vënë në lëvizje nga kërkuesit në datën 31.7.2012, ndërsa ata, sipas ligjit, kanë kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar

për shkak të cenimit të së drejtës së jetës dhe të shëndetit në një aksident rrugor. Gjykata e shkallës së parë, pasi ka vënë në diskutim ligjin e zbatueshëm, ka arritur në përfundimin se ai është ligji i posaçëm për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit rrugor, i cili ka qenë në fuqi në momentin e ndodhjes së aksidentit rrugor, ligji nr. 10076/2009, si dhe për sa ai nuk rregullon, nenet 608, 625 dhe 640 të KC-së referuar interpretimit të tyre në vendimin unifikues nr. 12/2007, të Gjykatës së Lartë. Për sa i përket rregullores nr. 53/2009 të AMF-së, të dalë në zbatim të ligjit të posaçëm, ajo gjykatë ka arritur në përfundimin se nuk mund të zbatohet në atë rast, pasi akti nënligjor në fjalë nuk kishte marrë fuqi ligjore për zbatim në rrethanat kur ai ishte botuar vetëm në faqen zyrtare elektronike të AMF-së, por jo në Fletoren Zyrtare, sikurse kërkohej nga neni 117 i Kushtetutës. Ndërkohë, ndryshe nga ajo, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se ligji i zbatueshëm, në rastin konkret, krahas ligjit të posaçëm nr. 10076/2009, është edhe rregullorja nr. 53/2009, e AMF-së, e cila, pavarësisht se është miratuar dhe botuar pas momentit të ndodhjes së aksidentit rrugor, në nenin 51 të saj, parashikonte se zbatohet me efekt prapaveprues nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit të posaçëm. Mbi këtë bazë, duke zbatuar përcaktimet e bëra në rregulloren nr. 53/2009 të AMF-së, gjykata e apelit ka ulur masën e dëmshpërblimit të akorduar në favor të kërkuesve nga gjykata e shkallës së parë.

22. Kërkuesit kanë kundërshtuar vendimin e gjykatës së apelit dhe në rekursin e tyre kanë ngritur pretendime për zbatimin e gabuar të ligjit material në lidhje me pazbatueshmërinë dhe zbatimin me fuqi retroaktive të rregullores nr. 53/2009 të AMF-së, si dhe për sa i përket moszbatimit nga ajo gjykatë të dispozitave të KC-së dhe vendimit unifikues nr. 12/2007 të Gjykatës së Lartë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, duke vlerësuar se shkaqet e parashtruara në të nuk bënin pjesë në ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së dhe se nuk rezultonte që gjykatat më të ulëta të kishin lejuar shkelje procedurale që ta bënin të pavlefshëm procesin dhe të ndikonin në vendimmarrjen e tyre. Sipas atij kolegji, gjykatat më të ulëta kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, ndërsa vendimet e tyre nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim



të Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

23. Gjykata vëren se çështja e papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 13, pika 1, të ligjit nr. 10076/2009, mbi bazën e delegimit të të cilit ka dalë rregullorja nr. 53/2009 e AMF-së, i është referuar asaj nga Gjykata e Lartë, ku është parashtruar edhe çështja që ka të bëjë me momentin e hyrjes në fuqi të rregullores nr. 53/2009 të AMF-së. Mbledhja e Gjyqtarëve të kësaj Gjykate, me vendimin nr. 94, datë 14.7.2022, ndërsa ka vlerësuar se nuk plotësoheshin kriteret kushtetuese për shqyrtimin e kërkesës në seancë plenare, ka theksuar se çështjet e veprimt të ligjit në kohë ose të vendosjes respektive hierarkike të normave në konflikt, hyjnë në sferën e kompetencës së gjykatës referuese. Megjithatë, me qëllim orientimin e gjykatave në zgjidhjen e problematikave të konstatuara, për të rikonfirmuar rëndësinë e respektimit të parimeve të tilla kushtetuese si siguria juridike, barazia përpara ligjit ose hierarkia e burimeve të së drejtës, Mbledhja e Gjyqtarëve ka theksuar se dyshimet në lidhje me veprimin në kohë të normave juridike duhet të zgjidhen nga gjykatat e zakonshme, bazuar në parashikimet kushtetuese që përcaktojnë momentin e hyrjes në fuqi të tyre (neni 117 i Kushtetutës), si edhe bazuar në parimin kushtetues të hierarkisë së akteve ligjore (nenet 4 dhe 116 të Kushtetutës), nga të cilat burojnë edhe parimet ku bazohen gjykatat për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm në rast të përplasjeve mes normave me fuqi të njëjtë ose të ndryshme juridike (*shih paragrafin 24 të vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

24. Nisur nga sa më lart, Gjykata konstaton se në rekursin e tyre kërkuarit kanë ngritur pretendime për sa i përket identifikimit dhe zbatimit nga gjykata e apelit të ligjit të zbatueshëm të lidhur me momentin e lindjes së marrëdhënies juridikocivile për shkak të së cilës është krijuar mosmarrëveshja mes palëve, si dhe me momentin e hyrjes në fuqi të aktit nënligjor dhe efektet juridike të tij, konkretisht për zbatimin me fuqi prapavepruese të rregullores nr. 53/2009 të AMF-së, pretendime të cilat, në thelb, kanë të bëjnë me parimet e sigurisë juridike dhe të hierarkisë së akteve, ashtu sikundër edhe me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, të cilat kanë natyrë kushtetuese. Megjithatë, Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, nuk u ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve të kërkuarëve, për më tepër kur ajo është ndodhur përpara dy vendimeve

të gjykatave më të ulëta që kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me ligjin e zbatueshëm dhe zbatimin e tij në rastin konkret, ndërkohë që nga gjykata e apelit nuk ka përgjigje shteruese për pretendimin e ngritur në gjykim nga kërkuarët në këtë drejtim dhe të pranuar nga gjykata e shkallës së parë. Edhe pse kjo, në vlerësimin e Gjykatës, nuk sjell *apriori* cenim të së drejtës për proces të rregullt, mënyra se si kanë vepruar gjykatat, në rastin konkret, ka sjellë edhe një mënyrë të ndryshme analize dhe vlerësimi ligjor të çështjes nga ana e tyre, çka impononte për Gjykatën e Lartë ushtrimin e rolit të saj si gjykatë e ligjit, për të verifikuar pikërisht mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Ajo gjykatë ka disponuar sipas nenit 480 (shkronja “a”) të KPC-së, që përcakton se mospranimi i rekursit bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, por pa treguar se përse shkaqet e ngritura në rekursin e kërkuarëve nuk përfshihen në ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, sipas përmbajtjes së tij në kohën e depozitimit të rekursit ose se ato shkaqe nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, duke qenë kështu haptazi të pabazuara. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar edhe se gjykatat më të ulëta kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, megjithëse ato kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për sa i përket ligjit të zbatueshëm dhe zbatimin e tij në rastin konkret.

25. Gjykata mban në konsideratë, në kuadër të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, se vetëm një vendim i arsyetuar i jep asaj mundësinë të vlerësojë nëse gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim pretendimet kryesore të palëve dhe mënyrën se si i kanë trajtuar ato. Veçanërisht kur bëhet fjalë për pretendime me natyrë kushtetuese, në kuadër të parimit të subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit zakonshëm gjyqësor, mungesa e arsyetimit të Gjykatës së Lartë e vë në vështirësi/pamundësi Gjykatën për të vlerësuar nëse ajo i ka marrë në shqyrtim dhe nëse i ka vlerësuar ato pretendime.

26. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se, referuar natyrës kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në rekurs, Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të ligjit të zbatueshëm, në përputhje edhe me parimet kushtetuese dhe praktikën e kësaj Gjykate, ashtu edhe në drejtim të



bazueshmërisë në themel të shkaqeve të rekursit që kishin të bënin me aspekte kushtetuese të procesit gjyqësor. Në këto kushte, në kontekst të rrethanave të rastit konkret, mospranimi i rekursit të kërkuarve nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me parashtrimin në vendim të shkaqeve të rekursit dhe me arsyetimin *de plano* se këto shkaqe nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese, të çon në përfundimin se zbatimi i ligjit procedural nga ajo është haptazi i paarsyeshëm dhe vë në dyshim të drejtën e aksesit të kërkuarve në drejtëm të së drejtës për ankim efektiv në një gjykatë më të lartë. Për pasojë, është cenuar e drejta e aksesit substancial e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

27. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarve për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është i bazuar, ndaj ky vendim duhet të shfuqizohet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim.

28. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuarve duhet të pranohet sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-4412, datë 20.9.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 26.11.2024.

Shpallur më 30.12.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Marjana Semini

Anëtarë kundër: Fiona Papajorgji

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që u përket kërkuarve Ardian Hysa, Violeta Hysa, Orjeta Hysa, Leonard Allani, Nadire Allani, Brunilda Kullolli, Alidrije Kullolli, Olgert Brahja, Mustafa Brahja dhe Meliha Brahja, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4412, datë 20.9.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi vlerësoj se kërkesa duhej të ishte rrëzuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Nga rrethanat e çështjes rezulton se tre prej kërkuarve dhe shtetasi E. H. kanë pësuar një aksident automobilistik nga i cili u janë shkaktuar dëmtime fizike, ndërsa ky i fundit ka humbur jetën. Përfaqësuesi i kërkuarve dhe familjarëve të tyre, si dhe trashëgimtarëve të E. H., pasi nuk ka marrë përgjigje nga shoqëria e sigurimeve, i është drejtuar gjykatës me padi për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke dëmshpërblyer kërkuarve në tërësi për dëmin pasuror në vlerën 13,481,006 lekë dhe për dëmin jopasuror në vlerën 24,049,594.5 lekë si dhe kamatëvonesat. Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë për sa i përket vlerës së dëmshpërblimit, duke akorduar shpërblim për dëmin pasuror në vlerën 7,721,258 lekë dhe për dëmin jopasuror në vlerën 4,141,666 lekë, krahas kamatëvonesave. Për rekursin e kërkuarve Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij.

3. Në këto kushte, kërkuarve i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual duke ngritur disa pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të cilat shumica ka vendosur t'i analizojë në drejtim të cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit.



4. Konkretisht, shumica, pasi ka konstatuar se kërkuessit në rekursin e tyre kanë ngritur pretendime për sa i përket identifikimit dhe zbatimit nga gjykata e apelit të ligjit të zbatueshëm të lidhur me momentin e lindjes së marrëdhënies juridiko-civile, për shkak të së cilës është krijuar mosmarrëveshja mes palëve, si dhe me momentin e hyrjes në fuqi të aktit nënligjor dhe efektet juridike të tij, konkretisht për zbatimin me fuqi prapavepruese të rregullores nr. 53/2009 të AMF-së, ka analizuar faktin nëse Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim dhe u ka kthyer përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuessve. Sipas shumicës, duke vendosur mospranimin e rekursit, ajo gjykatë nuk u ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve, veçanërisht e ndodhur në kushtet e dy vendimeve me qëndrime të ndryshme në lidhje me ligjin e zbatueshëm. Ajo duhet të kishte mbajtur qëndrim të shprehur në drejtim të ligjit të zbatueshëm dhe bazueshmërisë në themel të shkaqeve të rekursit. Mospranimi i rekursit të kërkuessve nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me parashtrimin në vendim të shkaqeve të rekursit dhe me arsyetimin *de plano* se këto shkaqe nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese, të çon në përfundimin se zbatimi i ligjit procedural nga ajo është haptazi i paarsyeshëm dhe vë në dyshim të drejtën e aksesit të kërkuessve (*shih paragrafët 24–26 të vendimit*).

5. Nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës në lidhje me këtë pretendim, pasi vlerësoj se Gjykata e Lartë ka vepruar brenda rolit dhe funksionit të saj kushtetues për interpretimin e ligjit. Në këtë kuptim, sikurse thekson edhe shumica, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 6, datë 22.2.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*), po ashtu e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës (*vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor

që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 42, datë 7.7.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, Gjykata në çdo rast nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, por ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në rastin në shqyrtim Gjykata e Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit ka arsyetuar se gjykata e apelit ka respektuar ligjin material dhe e ka interpretuar dhe zbatuar drejt atë. Kjo do të thotë se Gjykata e Lartë, ndonëse nuk është shprehur specifikisht për ligjin e zbatueshëm për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, për sa kohë ka vlerësuar se nuk rezulton që gjykata e apelit të ketë lejuar shkelje procedurale që do ta bënë në pavlefshëm procesin dhe do të ndikonin në vendimmarrjen e saj (*shih paragrafin 14 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), ka çmuar të drejtë qëndrimin dhe interpretimin ligjor që ka bërë kjo e fundit për mënyrën e zbatimit të ligjit/rregullores.

8. Prandaj jam e mendimit se interpretimi që gjykata e apelit ka bërë në lidhje me ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, konkretisht rregulloren e AMF-së dhe efektin e saj prapaveprues, duket se është pranuar edhe nga Gjykata e Lartë. Vetëm fakti se Gjykata e Lartë ndodhej në kushtet e dy vendimeve me qëndrime të ndryshme të dy gjykatave më të ulëta, nuk e detyron këtë gjykatë të shprehet në mënyrë të zgjeruar për secilin pretendim apo për mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta (*shih vendimet nr. 39, datë 25.6.2015; nr. 45, datë 29.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo edhe në linjë me jurisprudencën kushtetuese, e cila ka pranuar se arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë nuk cenon standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e saj (*shih vendimet nr. 16, datë 12.3.2024; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 9, datë 26.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim vendimmarrja e Gjykatës së Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të



kërkuesve, nuk duket të jetë arbitrare dhe e paarsyeshme.

9. Për më tepër, sikurse rezulton nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore, kërkuesit kanë ushtruar të drejtën e tyre të paraqitjes së ankimit/rekursit, ku përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes, me vendim përfundimtar kanë marrë përgjigje të arsyetuar për të gjitha pretendimet e tyre, në veçanti për shumën e dëmshpërblimit që u takonte sipas ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete, duke iu garantuar në këtë mënyrë edhe e drejta e aksesit.

10. Në përfundim, unë, gjyqtarja në pakicë, vlerësoj se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit është i pabazuar, prandaj duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës.

Anëtare: Fiona Papajorgji

KËRKESË

Nr. 1046/11, datë 23.12.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 384, datë 29.6.2023, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga

ndërtimi i segmentit rrugor “Rehabilitimi i rrugës së ish-Repartit Ushtarak për në Aeroportin e Rinasit”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “arë”, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1 005 312 (një milion e pesë mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA EMËRORE “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 384, DATË 29.6.2023, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “REHABILITIMI I RRUGËS SË ISH-REPARTIT USHTARAK PËR NË AEROPORTIN E RINASIT”

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE					Çmimi (lekë/ m ²)	VLERA (m ²)	VLERA TOTALE (LEKË)	Shënime
	Emër	Atësi	Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqja e shpronësi- mit (m ²)				
1	Balfin Construction, Blendi Hektor Fevzi			1669	241/6	Arc	89177.2	2,244	448	1,005,312	1,005,312	

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 624 lekë